



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK SHKODËR



Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al](mailto:keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al), Tel: +35522490206

V E N D I M

Nr. 17, datë 28.4.2016

**Për miratimin e Buxhetit të vitit 2016 të Bashkisë Shkodër**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës 28.4.2016, në mbështetje të nenit 34, 40, 41, shkronja "dh" e nenit 54, pikës 3 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr.147/2015 "Për buxhetin e vitit 2016", udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012 të ministrisë së financave "Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, udhëzimit plotësues të ministrisë së financave nr.1, date 15.01.2015 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016", ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM nr.1108, datë 30.12.2015 "Për transferimin, nga ministria e bujqësisë, zhvillimit rural dhe administrimit të ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit", VKM nr. 915, datë 11.11.2015 "Për transferimin në pronësi, nga këshillat e qarqeve të bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, pas diskutimeve,

V E N D O S I :

1. Të miratojë Buxhetin për Bashkinë e Shkodrës për vitin 2016 si më poshtë :

1.1 Të miratojë planin e të ardhurave të vitit 2016, gjithsej në vlerën **1,655,453** (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesëmijë e katërqind e pesëdhjetë e tre) mijë lekë, sipas tabelës Nr. 1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

1.2 Të miratojë detajimin e shpenzimeve për vitin 2016 gjithsej në vlerën **1,655,453** (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesëmijë e katërqind e pesëdhjetë e tre) mijë lekë, sipas tabelave Nr.2; 2/1 ; 2/2 ;2/3 ; 2/4; 2/5 pjesë përbërëse e këtij vendimi.

1.3 Të miratojë detajimin e investimeve në Buxhetin e vitit 2016 sipas tabelës Nr.3 pjesë përbërëse e këtij vendimi.



2. Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve në varësi për vitin 2016, si më poshtë dhe sipas tabelës nr. 4, pjesë përbërëse e këtij vendimi:

2.1 Numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Shkodër për vitin 2016 do të jetë **930** (nëntëqind e tridhjetë), nga të cilët:

- a) punonjës të administratës dhe shërbimeve publike: 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë);
- b) punonjës të institucioneve të varësisë: 565 (pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë), nga të cilët: 335 (treqind e tridhjetë e pesë) të transferuar nga funksionet e reja.

2.2 Numri i përgjithshëm i punonjësve me kohë të pjesshme pune do të jetë: **65** (gjashtëdhjetë e pesë), nga të cilët:

- a) roje zëvendësues për sistemin e arsimit parauniversitar: 25 (njëzet e pesë) punonjës;
- b) vrojtues në zonat pyjore për mbrojtjen kundër zjarreve: 10 (dhjetë) punonjës me kontratë 5-mujore;
- c) punonjës për shuarje vatra zjarri: 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës për 4 ditë për pesë raste shuarje të vatrave të zjarrit;
- ç) punonjës shërbimi sezonal për plazhin e Velipojës: 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës.

3. Është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë:

- a) rishpërndarja e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program;
- b) rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program;
- c) rishpërndarja brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miraturar në datën 28.4.2016

Shpallur në datën 29.4.2016

Sekretar i këshillit

Suel Hadri



KRYETAR,

Xhemal BUSHATI

LLOJET E TË ARDHURAVE		Plani 2016
<b>A</b>	<b>TË ARDHURAT NGA BORMET E VETA (GJITHSEJ)</b>	<b>600,101</b>
<b>A.I</b>	<b>TË ARDHURA TË MËDHE NGA TAKSAT VENDORE</b>	<b>366,258</b>
I.1	Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	7,275
I.1.0	Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogël (e prapambetur)	1,373
I.2	Të ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	114,774
I.2.1	Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	86,296
I.2.1.1	Ndërtesa banimi	24,791
I.2.1.2	Ndërtesa të tjera	61,475
I.2.1.3	Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si lehtëza turistike	-
I.2.4	Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	18,584
I.2.5	Të ardhura nga taksa mbi truallin	9,924
I.3	Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	8,700
I.4	Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	155,824
I.5	Të ardhura nga garanci financiare	-
I.6	Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	10,500
I.7	Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura	51,000
I.8	Të ardhura nga taksa e rentës minerare	-
I.9	Të ardhura nga taksa e tabelës	16,809
<b>A.II</b>	<b>TË ARDHURAT TË TËMËDHE</b>	<b>233,842</b>
<b>B</b>	<b>TË ARDHURAT NGA TARIFA E PASTRIMIT</b>	<b>199,096</b>
II.1	Të ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	124,009
II.1.1	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga familjet	58,844
II.1.2	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga institucione	250
II.1.3	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga biznesi	63,915
II.2	Të ardhura nga tarifa për ndricimin publik	28,163
II.2.1	Të ardhura nga tarifë për ndricimin publik nga familje	18,372
II.2.2	Të ardhura nga tarifë ndricimi nga institucione/institucione	75
II.2.3	Të ardhura nga tarifë ndricimi nga biznesi	9,716
II.3	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	19,166
II.3.1	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga familjet	9,188
II.3.2	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga institucionet	75
II.3.3	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga biznesi	9,905
II.4	Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	27,758
II.4.1	Nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	100
II.4.2	Nga tarifa për vulosje veterinerë të bagetive të thurura	280
II.4.3	Nga Tarifat e licencimit të veprimtarive të transportit	1,375
II.4.4	Nga tarifa parkimi për mjetat e licensuara, dhe për vendopokime publike	2,493
II.4.5	Nga tarifë për dhënie licensa për fregtimin e natisë bruto dhe nënprodukteve të saj	400
II.4.6	Nga tarifat në sektorin e pyeve dhe kullotave.	-
II.4.7	Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ	1,925
II.4.8	Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	19,685
II.4.9	Nga tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfillë	-
II.4.10	Nga linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energi, TV Kablor, Internet)	1,500
<b>A.III</b>	<b>TË ARDHURA TË TJERA</b>	<b>34,749</b>
III.1	Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj	15,160
III.1.1	Biblioteka "Marin Barleti"	100
III.1.2	Muzeumet	2,100
III.1.3	Teatri "Migjeni"	600
III.1.4	Qendra Kulturore e fëmijëve	250
III.1.5	Pallati sportit " Qazim Dervishi"	1,000
III.1.6	Qendra Komunitare	-
III.1.7	Nga Marka "ZAHOTEX" nga artizanet e zonës	-
III.1.8	Nga dokumentat për tender ose ankand	-
III.1.9	Nga kopshtet	7,920
III.1.10	Nga cerdhet	3,100
III.2	Të ardhura nga kundrravajtjet administrative (Gjobat)	8,850
III.3	Të ardhura nga dhënie me qira e asetëve në pronësi të Bashkisë	5,520
III.4	Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdukime	100
III.5	Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve	1,500
III.6	Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	-
III.7	Të ardhura nga privatizimi	-
III.8	Të ardhura nga sponsorizimet	2,616
<b>B</b>	<b>TRANSFERTA E PAKUISHTEZUARA</b>	<b>490,677</b>
<b>C</b>	<b>TRANSFERTA SPECIFIKE</b>	<b>366,947</b>
<b>A+B+C</b>	<b>TOTALI I TË ARDHURAVE (Transferta e të ardhura nga bormet e veta)</b>	<b>1,397,721</b>
<b>D</b>	<b>TRANSFERTA E KUSHTEZUAR</b>	<b>233,842</b>
<b>E</b>	<b>TË ARDHURA QË TRASHËGOHEN NGA VITI I MËPARSHM</b>	<b>21,889</b>
E.1	Transferta e trashëguar e reformës tarifore 2015	20,983
E.2	Sponsorizime të trashëguara	909
<b>A+B+C+D+E</b>	<b>TOTALI I TË ARDHURAVE (A+B+C+D+E)</b>	<b>1,655,459</b>




Nr	TRANSPERTYA SPECIFIKE	Viti 2016
1	Konviktet e arsimit parauniversitar	55,763
2	Arsimi parauniversitar	19,963
	Punonjësit e shërbimeve mbështetëse, Arsimi I Mesëm	19,963
3	Arsimi parashkollor	143,133
	Arsimi parashkollor (kopshitet e fëmijëve), edukatorë dhe punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve	90,929
	Punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 8-vjeçar (Parashkollori + Qendrat Kulturore)	49,204
3	Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi	30,578
2	Mbrojtja Sociale	18,480
6	Administrimi i pyjeve	3,679
5	Rrugët rurale	17,857
7	Ujitja dhe Kullimi	17,380
<b>TOTALI</b>		<b>308,941</b>



Sekretar i Keshillit

Suel Hadri

KRYETAR

Xhemal Bushati



DETAJIMI I BUXHETIT TE VITIT 2016

BUXHETI 2016

PRIMITJEDEHE

TABELA 2

Nr. artikulli	Titulli i artikullit	Shifra	V. rreze	Emri i artikullit	SHPENDET DHE VE DALAT					Pjesa e vendosur	Pjesa e rreze	Pjesa e buxhetit	Pjesa e ndalohe
					Shifra	V. rreze	Emri i artikullit	Shifra	V. rreze				
I	VE ARDHURAT E VETIA	802,101			295,580			175,864		27,918	15,560	360	27,358
1	Ia. e ardhurat te mitme	366,288		1110	14,410			12,950		2,060			
2	Ia. e ardhurat te mitme	235,842		5	3,693			1,369		810			
2.a	Ia. e ardhurat nga tarifa vendore	139,008		4240	37,029			7,220		1,015			10,000
2.b	Ia. e ardhurat te tjera	31,132		5	6,259			4,594		827			5,000
2.c	Donacioni	3,816		6	17,857					17,857			1,015
II	TRANSFERTAT	1,033,460		4530	137,139								
1	Transferente e Pajumtuar	480,679		6	14,378								
2	Transferente Specifike	303,941		6	4,770								
3	Transferente e kushtezuar	248,840		11	12,000					4,770	7,000		13,000
				12	5,772						12,000		
				12	387,761			24,364		3,874	282,456	360	5,772
III	TRASHEGUARA	21,862		3	6,040					1,040			
1	Transferente e Pajumtuar	20,903		4	102,205			8,448		1,236	38,530		50,000
2	Donacione	-		13	10,128						2,280		62
				17	70,389			20,110		5,656	19,287		7,675
				18	218,480			128,400		20,722	53,758		3,793
				19	117,196			50,374		6,412	39,070		2,000
				20	12,573						12,573		
				21	30,807			18,106		2,886	9,189	84	
				22	153,689			4,113		958	4,301	17,044	167,300
				23	808						628		
				23	30,711			23,585		4,007	10,442	277	
				23	888,483			493,733		79,728	543,128	168,163	30,087
				23	1,050,643			687,468		84,738	12,909	144,163	243,269

Sekretar i keshillit

Suel Hadri

KRYETAR

Xhemal Bushati



BUXHETI 2016  
BURIMI I FINANCIM - TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR

TABELA 21

N. i	TE ARRIJEN QINDËZIMET	SHUMË	N. i	PROJ. e	PUB. e	SHUMË TË PËRVEÇITURA		SHUMË TË PËRVEÇITURA	SHUMË TË PËRVEÇITURA	SHUMË TË PËRVEÇITURA	SHUMË TË PËRVEÇITURA	SHUMË TË PËRVEÇITURA	SHUMË TË PËRVEÇITURA
						SHUMË TË PËRVEÇITURA	SHUMË TË PËRVEÇITURA						
I	TE ARRIJEN QINDËZIMET	31011				130,209	67,947	13,368	8,768	-	-	180	-
1	TE ARRIJEN QINDËZIMET		1	1110	Planifikim Menaxhim Administrativ	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Te ardhurat teknike		2	1170	Shërbimi Ligjvendes Civile	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Te ardhurat teknike		3	4130	Mbrojtja për Zhvillim Ekonomik	-	-	-	-	-	-	-	-
2.a	Te ardhura nga islefia vendore		4	4240	Mbrojtja e mirëmbajtjes së kalimit dhe ujtes	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Te ardhura te tjera		5	4230	Aktivizimi i Pajës	-	-	-	-	-	-	-	-
2.c	Donacioni		6	4620	Transferimi i mjeteve të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-
II	TRANSFERTAT		7	4630	Mbrojtja mjegje	117,031	1,849	-	-	-	-	-	-
1	Transferente e Pakushtezuar	480 879	8	4570	Transferimi publik	4,074	-	-	-	-	-	-	-
2	Transferente Specifike		9	4700	Zhvillimi i Turizmit	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Transferente e kushtezuar		10	4800	Shërbime të tjerat rezervë & kontraktimes	12,000	-	-	-	-	-	-	-
			11	5130	Planifikim urban dhe shtetimi	-	-	-	-	-	-	-	-
			12	5200	Strukturimet publike vendore	147,713	12,182	1,937	106,707	-	-	180	-
			13	6330	Udhëtimet, kontraktimes vendore	-	-	-	-	-	-	-	-
			14	8140	Zhvillimi i Sportit	18,715	4,073	649	13,452	-	-	41	-
			15	8230	Arti dhe Kulturë	867	-	-	950	-	-	-	-
			16	8300	Programet specifike kulturore dhe turistike	25,869	17,956	2,928	1,119	-	-	-	-
			17	9120	Kontraktimes për shërbime dhe shërbime	11,103	-	-	-	-	-	-	-
			18	9230	Kontraktimes për shërbime (musem, pe gjatëse)	25,555	5,360	895	-	-	-	-	-
			19	9340	Kontraktimes për shërbime (inseam-profesionale)	10,497	9,994	1,443	-	-	-	-	-
			20	10140	Shërbime e kujdesit social	-	-	-	-	-	-	-	-
			21	10430	Perfojmancë Sociale	-	-	-	-	-	-	-	-
			22	10460	Perfojmancë Sociale	-	-	-	-	-	-	-	-
			23	10970	Emergjenca civile	-	-	-	-	-	-	-	-
III	TE TRASHIEGUARA												
1	Transferente e Pakushtezuar	20,983											
2	Donacione	20,983											

Shënim: Shuma e investime + projekte prej 207,914 mijë leke mbulonhet plotësisht nga transferente e pakushtezuar e vitit 2016 prej 490,679 mijë leke.

Sekretar i keshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI





BUXHETI 2016  
BURIMI I FINANCIMI - TRANSFERTE SPECIFIKE

TABELA 2/C

Kategoria	Emri i burimit	Grupi	Nr. Program	Emri i shprehur	2016		2015		Diferenca	Shprehur me % te 2016	Shprehur me % te 2015	Diferenca
					Q1	Q2	Q1	Q2				
I	TE ARDHURAT E VETA											
1	Te ardhurat te limonave		1	1110	Planifim	Menaxhir	Administrim	-	-	-	-	-
2	Te ardhurat jutelembore		2	1170	Shperr	mi	gjinjtes	Civile	-	-	-	-
3	Te ardhurat jutelembore		3	4130	Ministritje	per	Zhvillim	Ekonomik	-	-	-	-
4	Te ardhurat nga liria venders		4	4240	Menaxhim	administrativ	si	te	9,024	-	-	-
5	Te ardhurat te tjera		5	4280	Administrim	te	te	te	419	-	-	-
6	Donacion		6	4620	Transport	te	te	te	17,807	-	-	-
7	TRANSFERAT	300,541	7	4530	Menaxhim	te	te	te	-	-	-	-
8	Transferente e Pakushtruar		8	4570	Transporti	te	te	te	-	-	-	-
9	Transferente Specifike	300,541	9	4760	Zhvillim	te	te	te	-	-	-	-
10	Transferente e kushtruar		10	4080	Shprehim	te	te	te	-	-	-	-
11			11	5180	Planifim	te	te	te	-	-	-	-
12			12	5280	Shprehim	te	te	te	-	-	-	-
13			13	5330	Ueshtjess	te	te	te	-	-	-	-
14			14	5140	Zhvillim	te	te	te	-	-	-	-
15			15	5230	Arti	te	te	te	-	-	-	-
16			16	5250	Program	te	te	te	-	-	-	-
17			17	5120	Arsim	te	te	te	-	-	-	-
18			18	5240	Arsim	te	te	te	-	-	-	-
19			19	5240	Arsim	te	te	te	-	-	-	-
20			20	10140	Shprehim	te	te	te	-	-	-	-
21			21	10430	Perkujdesi	te	te	te	-	-	-	-
22			22	10960	Partisipim	te	te	te	-	-	-	-
23			23	10610	Emergjenciale	te	te	te	-	-	-	-
									143,135	172,661	20,462	-
									75,725	36,777	6,147	32,806
									14,480	863	145	17,044
									30,579	25,454	3,916	3,652
									99,941	70,899	33,978	44,857
												277

Sekretar i keshillit

Suel Hadri



KRYETAR

Xhemal Bushati





N	EMRI I VEPRËS FINANCIMET	SHUMË	M	N. VEPRËS	EMRI I VEPRËS	SHUMËT E VEPRËS				TOTAL	PËRQENTËSI DHE B. D. A.	PËRQENTËSI DHE B. D. A.	PËRQENTËSI DHE B. D. A.
						1	2	3	4				
I	TE ARDHURAT E VETA												
1	Te ardhurat tarrmore			1	1170	Planifikim merrsaftim Administrativ	-	-	-	-	-	-	-
2	Te ardhurat zellimore			2	1170	Shërbime Jenerale Civile	14,410	12,350	2,060	-	-	-	-
2.a	Te ardhura nga leria vendore			3	4130	Mëshirëje aut. Zhvillim Economic/DIKR	1,343	1,919	184	60	-	-	-
2.b	Te ardhura te tjera			4	4200	Merrsaftim i intrastruktures se kufirit dhe jllas	10,000	-	-	-	-	-	-
2.c	Donaçionit			5	4200	Administrim i Pyjeve	-	-	-	-	-	-	10,000
II	TRANSFERAT	235,840		6	4530	Transferat merrsaftim Mësimorje muge rurale	-	-	-	-	-	-	-
1	Transferate e Pakushtetshuar			7	4530	Merrsaftim murgova	-	-	-	-	-	-	-
2	Transferate Specifike			8	4570	Transport publik	-	-	-	-	-	-	-
3	Transferate e kushtetshuar	235,840		9	4730	Zhvillim i Turizmit	-	-	-	-	-	-	-
				10	4980	Shërbime te tjera af and rezerve akomigjence	-	-	-	-	-	-	-
				11	6100	Planifikim urban dhe stehsim	5,772	-	-	-	-	-	-
				12	6300	Shërbime publike vendore	-	-	-	-	-	-	-
				13	6330	Ujshartes kanalizim vendore	-	-	-	-	-	-	-
III	TE TRASHËGIMARA			14	8140	Zhvillim i Sportit	-	-	-	-	-	-	-
1	Transferate e Pakushtetshuar			15	8230	Art dhe Kultura	-	-	-	-	-	-	-
2	Donaçione			16	8260	Programme specifike kulturore dhe te tjetra	-	-	-	-	-	-	-
				17	9170	Arsimi parauniversitar dhe 9-jecor	52,931	-	-	-	-	-	-
				18	9230	Arsimi parauniversitar (mesim përgjithshem)	-	22,891	-	-	-	-	-
				19	9240	Arsimi parauniversitar i mesim profesional	1,911	-	-	-	-	-	-
				20	10440	Shërbimet e Kujdesit social	12,973	-	-	-	-	-	-
				21	10450	Rekujdes Social	-	-	-	-	-	-	-
				22	10460	Rehabilitim Sociale	167,000	-	-	-	-	-	-
				23	10610	Emancipim Civil	-	-	-	-	-	-	-
							23,240	37,240	3,240	167,000	167,000	-	16,772

Sekretar i keshillit

Suel Hadri



Xhemal Bushati



Nr. i	Emri i Burimit	Shuma	Pikimi	Programi	Kategoria		Shuma
					137A0	137A1	
<b>I. TE ARDHURAT E VEIA</b>							
1	Te ardhurat te tjera	3,613	1	Planifikim dhe Administrim	-	-	-
2	Te ardhurat te tjera	3,613	2	Shërbime dhe shërbime tjera	-	-	-
2.a	Te ardhurat nga taksat e vendore	3,613	3	Mbledhje për Zhvillim Ekonomik	-	-	-
2.b	Te ardhurat te tjera	-	4	Mendimet dhe shërbime tjera	800	-	800
2.c	Donacione	3,613	5	Aktivitetet e tjera	-	-	-
<b>II. TRANSFERTAT</b>							
1	Transferte e paktshuar	-	6	Transferte nga institucione tjera	-	-	-
2	Transferte Specifike	-	7	Mendimet dhe shërbime tjera	-	-	-
3	Transferte e kushtecuar	-	8	Transferte tjera	-	-	-
<b>III. TE TRASHEGUARA</b>							
1	Transferte e paktshuar	800	9	Zhvillim i Turizmit	-	-	-
2	Donacione	800	10	Shërbime dhe shërbime tjera	-	-	-
<b>IV. TE TRASHEGUARA</b>							
1	Transferte e paktshuar	800	11	Planifikim dhe Administrim	-	-	-
2	Donacione	800	12	Shërbime dhe shërbime tjera	-	-	-
<b>V. TE TRASHEGUARA</b>							
1	Transferte e paktshuar	800	13	Udhëzime dhe shërbime tjera	-	-	-
2	Donacione	800	14	Udhëzime dhe shërbime tjera	-	-	-
<b>VI. TE TRASHEGUARA</b>							
1	Transferte e paktshuar	800	15	Udhëzime dhe shërbime tjera	-	-	-
2	Donacione	800	16	Udhëzime dhe shërbime tjera	-	-	-
<b>VII. TE TRASHEGUARA</b>							
1	Transferte e paktshuar	800	17	Udhëzime dhe shërbime tjera	-	-	-
2	Donacione	800	18	Udhëzime dhe shërbime tjera	-	-	-
<b>VIII. TE TRASHEGUARA</b>							
1	Transferte e paktshuar	800	19	Udhëzime dhe shërbime tjera	-	-	-
2	Donacione	800	20	Udhëzime dhe shërbime tjera	-	-	-
<b>IX. TE TRASHEGUARA</b>							
1	Transferte e paktshuar	800	21	Udhëzime dhe shërbime tjera	-	-	-
2	Donacione	800	22	Udhëzime dhe shërbime tjera	-	-	-
<b>TOTALI</b>					<b>800</b>	<b>800</b>	<b>800</b>

Sekretar i keshillit

Suel Hadri



KRYETAR

Xhemal Bushati



INVESTIME 2016

TABELA NR

090/lekë



Nr programi	Programi	Emertimi	Projekte	
4530	Menaxhimi rugeve	Rikonstruksion ruge Degëzimi "Isuf Sokoli"	128	2,847
		Rikonstruksion ruge "Qazim Llazarin"	215	4,420
		Rikonstruksion degezimi ruge "Draçin"	769	15,849
		Rikonstruksion l ruges varrezave "Belloje"	448	9,240
		Rikualifikim Urban blloqe banimi "Qendral Draçin" ; (Pallati me hark)	698	14,382
		Rikualifikim Urban blloqe banimi "Bardelove"(Pogë)	344	7,105
		Rikualifikim Urban blloqe banimi Tepe-te fusha e druve	1,725	35,548
		"SISTEMIMI I PERROIT KUFIRI MURIQAN"	300	8,048
		Rikonstruksion l ruges hidrovorit-Dobrac NJA Rrethina Projektim	6,250	
		Projekt i plote Rehabilitimi i sheshit " Gjon Palli" 50% e 1333124 Sipas marreveshjes me FSHZH	667	
		Projekt i plote "Rikualifikim urban l mugicave ne Qendren Historike ( kthimi l tyre me kalldrem dhe ndricim dekorativ) shoqeruar me nderhyrje ne Dyer e objekteve -kthim i tyre ne dyer druri karakteristike) 50% e 2883796 sipas marreveshjes me FSHZH	1,445	
		Rikualifikim urban i mugicave ne Qendren Historike, (Rikonstruksion sistemit Ujesjelles kanalizime)		18,260
		Rikonstruksion shesho plazhi Velipoje		4,370
		Mbikqyrje+kolaudim Rikonstruksion blloqe pallatet Xhatijej		697
		<b>TOTAL PROGRAMI</b>	<b>13,060</b>	<b>120,374</b>
6260	Sherbimet publike vendore	Blerje kazana, Sherbimi i pastrimit,		16,950
		Investime ndricim rruge dytesore +mbikqyrje+kolaudim		6,550
		Varroza NJA Rrethina		
		Shpronosim		644
		Rruga e fshatit		1,372
		Rrethim		1,011
		Tabela e Isjmerimeve		180
		<b>TOTAL PROGRAMI</b>		<b>26,707</b>
4570	Transporti publik	Blerje makine vijejzimi,		3,500
		<b>TOTAL PROGRAMI</b>		<b>3,500</b>
1110	Planifikim Menaxhim Administrim	Blerje pajisje te ndryshme zyre,		1,176
		Rikonstruksion rrjeti elektrik godina e Bashkise Shkoder		3,500
		Sigurimi l ambienteve shtese per Arkivin e Bashkise Shkoder		2,744
		Ristrukturim fizik dhe teknik te Dhomes se Server-ave		244
		Implementimi i Sistemit te Menaxhimit te Dokumentave ne nje Bazë te Dhënash Qendrore te Qendëruar dhe te Integruar (Integrated Active Directory System)(Bashkia Qendër dhe Njësite administrative Rrethinat, Gur i Zi, Bërdicë, Ana e Maftit, Postribë, Velipojë, Dajç)		644
		Zgjenimi i rrjetit kompjuterik (Intranet) për komunikimin elektronik të brendshëm, Implementimi i Sistemit të Kontrollit të Aksesit dhe Sistemit të Vëzhgimit (Bashkin Qendër)		6,050
		Implementimi i sistemit të informacionit për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore		5,000
		Blerje Pajisje TIK		8,000
		<b>TOTAL PROGRAMI</b>		<b>27,258</b>
8250	Programa specifike kulturore dhe te t	Blerje implant audio dhe sistem ndricimi dhe pod per koncerte live		1,555
		Projekt i plote Rikonstruksion i godines se Teatrit " Migjeni", 50% e 397	1 989	
		Nje piano per qytetin e artit		4,000
		Zhvillimi dhe pasurimi i fondit te bibliotekes Blerje libra, revista, periodik		1,000
		Blerje Raftë per Bibliotaken		800
		Pajisje teknike per zyre dhe evente kulturore		180
		Ruajtja e Galerise te Artëve, Kamera sigurie		180
		Përmirësimi i kushteve teknike të ambienteve te ruajtjes se koleksionit të Galerisë së		541
		Orendi zyre		80
		Pajisje dhe risistemim l fondit te arkives		448
		Mobilimi me orendi për mjodiset e Galerisë së Artëve Shkodër		80
		Restaurimi i kthines se arkeologjise si depo ruajtese		598
		Përmirësim i sistemit ndricimit te oborrit te muzaut		250
		Mobilim për Qendrën Kulturore "Pjetër Gaci"		545
		Pajisje Zyre për Qendrën Kulturore "Pjetër Gaci" (komputer dhe printer)		170
		Blerje pajisje zyre kompjuterike		100
		Raft per ruajtjen e objekteve dhe dokumentave		50
		Rinovim i ekspozites fotografike me materiale te reja		30
		Sistem l kamerava te sigurise		350
		Mobilimi l 10 dhomave te akteveve		360
		<b>TOTAL PROGRAMI</b>		<b>41,373</b>



TABELA NR. 3

## INVESTIME 2016

800/lekë

				10,000
4240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit	Rehabilitimi i pjeshëm i skemës ujtesë Gur i Zi		
		Projekte teknike të ndryshme për rrafshimin e kanaleve kulluese	5,000	
		<b>TOTAL PROGRAMI</b>	<b>5,000</b>	<b>10,000</b>
4260	Administrimi i Pyjeve	Zbatimi i projektit për ndërtimin e leres së ujit kullota -Zogaj		1,015
		<b>TOTAL PROGRAMI</b>		<b>1,015</b>
10430	Perkujdesi Social	PC për qendrat komunitare		330
		Printer për qendrat komunitare		140
		Pajisje zyre për qendrat komunitare (tavolinë, raft, etj)		175
		<b>TOTAL PROGRAMI</b>		<b>645</b>
6180	Planifikimi urban dhe strehimi	Rikonstruksion objekte banimi për strehim shtresave në nevoje (banesa sociale)		5,772
		<b>TOTAL PROGRAMI</b>		<b>5,772</b>
10140	Shërbimet e kujdesit social	Blerje pajisje (orëndi)		390
		Blerje pajisje zyre dhe vendosje interneti		140
		<b>TOTAL PROGRAMI</b>		<b>530</b>
9120	Arsimi parashkollor dhe 9-vjeçar	Blerje pajisje orëndi		1,000
		Blerje pajisje operacionale		1,480
		Kaldaja shkollë Xheladin Fishta		1,700
		Rikonstruksion i pjeshëm shkollë Tringa Smajla Fshati Grude e Re		9,400
		<b>TOTAL PROGRAMI</b>		<b>13,580</b>
9230	Arsimi parauniversitar	Rikonstruksion i plotë i shkollës Oso Kuka		19,300
		<b>TOTAL PROGRAMI</b>		<b>19,300</b>
8140	Zhvillimi i Sportit	Shah i madh butafonk		100
		Blerje kompjuter ,printer		80
		Tapet për ringun e boksit		150
		Rikonstruksion 3 dhoma+2 banjo e dushe		770
		Pajisje për stadiumin		2,000
		<b>TOTAL PROGRAMI</b>		<b>3,100</b>
		<b>TOTALI</b>	<b>80,057</b>	<b>248,289</b>

Sekretar i Keshillit

Suel Hadri



KRYETAR

Xhemal Bushati




NUMRI PUNONJESVE VITI 2016 BASHKIA SHKODER

TABELA 4

<b>1</b>	<b>Numri punonjeshve gjithsej</b>	<b>930</b>
	Nga te cilet:	
1.a	Punonjes te administrates dhe te shërbimeve publike	365
1.b	Punonjes te institucioneve te varesise	565
<b>2</b>	<b>Numri punonjeshve me kontrate</b>	<b>65</b>
2.a	Punonjes zevendesues ne sistemin e arsimit	25
2.b	Vrojtuës ne zonat pyjore	10
2.c	Punonjws per shuarje vatra zjarri	15
2.d	Punonjws sherbimi sezonal ne plazhin e Velipojes	15

Sekretar i Keshillit

Suel Hadri



KRYETAR

Xhemal Bushati





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QARKU SHKODËR  
PREFEKTI

Pr. 5044 dt. 4.5.2016

Nr.339/1 Prot

Shkodër me, 03/05/2016

Lënda: Lidhur me vendimin nr. 17 datë 28.04.2016 të këshillit të Bashkise Shkoder.

Drejtuar: Këshillit të Bashkise Shkoder

Prefekti i qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit nr.8927, datë 25.07.2002 "Për Prefektin", neni 14, paragrafi 2, ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për veteqeverisjes vendore", nenet 41, 54/dh dhe 55 pika 3, ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", neni 6, ligjit nr. 147/2015 date 17.12.2015 "Per buxhetin e vitit 2016", neni 15, Udhezimi Plothesues i MF nr. 1 date 15.01.2016 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2016", udhezimi nr. 2 date 06.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", shkresa e Ministrise se Financave nr. 2288/3 prot. date 23.02.2016 "Mbi zbatimin e VKM nr. 129 date 17.02.2016", analizoi vendimin nr. 17 datë 28.04.2016 të këshillit të Bashkise Shkoder: "Per miratimin e Buxhetit te vitit 2016 per Bashkine Shkoder".

Pas shqyrtimit, Prefekti analizon te hyrat e buxhetit te Bashkise Shkoder ne shumen 1.655.453 mije lek (te ardhurat e veta 600.101 mije leke, transferta e pakushtezuar 490.679 mije leke, transferta specifikke 306.941 mije leke dhe te trasheguara ne shumen 21.892 mije leke) dhe te dalat ne po kete shume, dhe ju autorizon te procedoni, por konstatohet se:

- Nuk eshte parashikuar kuota e Keshillit te Qarkut kerkese e nenit 38 pika 3 e ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për veteqeverisjes vendore", e cila duhet të jetë përbërëse e buxhetit 2016.
- Ne buxhetin e 2016 mungojne parashikimi i te ardhurave dhe shpenzimeve per dy vitet buxhetore pasardhese, parashikimi i shpenzimeve per investimet e reja me informacion: qellimin e investimit, planin e financimit perfshire monyren dhe burimet, shpenzimet vjetore qe duhen per shlyerjen e kredise nese perdoret, kërkesë e nenit 41/ç te ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për veteqeverisjes vendore", (duhet të jenë pjesë e buxhetit)

Me respekt,

PREFEKTI

Paulin RADOVANI



## **BUXHETI BASHKIA E SHKODRËS**

**"Shkodra, me njerëzit kreativ, historinë e kulturën, mikpritjen e burimet natyrore, një komunitet që jeton e zhvillohet, derë e hapur për integrim"**

## Përmbajtja

I.	Buxheti i Bashkisë për Vitin 2016. ....	9
II.	Të Ardhurat e Bashkisë për vitin 2016 .....	14
	II.1 Të ardhurat nga burimet qendrore	15
	II.2 Te ardhurat e veta vendore	16
	II.2.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore	16
A.	Kapacitetet fiskale të taksapaguesve	20
	A.1 Taksapaguesit familjarë	21
	A.2 Taksapaguesit biznese dhe institucione	23
B.	Analiza e të ardhurave të veta vendore dhe ndikimet e tyre në të ardhurat e bashkisë	26
	B.1 Te ardhurat nga taksat vendore	26
	II.2.2 Te ardhurat nga Tarifat Vendore	42
	II.2.3 Te ardhura nga burime te tjera	48
III.	Transfertat nga Buxheti i Shtetit .....	51
	III.2 Transferta specifike sipas funksioneve.	52
	III.3 Transferta e kushtëzuar	55
IV.	Burime të Tjera Financimi.....	55
V.	Parashikimi i shpenzimeve për vitin 2016 .....	55
VI.	Programet e Zhvillimit të Bashkisë. ....	60
	P1. Programi i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)	60
	P2. Programi i Planifikimit urban (Urbanistikë vendore)	71
	P3. Programi i Infrastrukturës rrugore	76
	P4. Programi i Shërbimeve Publike	80
	P5. Transporti publik dhe lëvizshmëria	91
	P7. Programi i Bujqësisë dhe zhvillimit rural	103
	P8. Programi i Mjedisit dhe mbrojtjes së pyjeve e kullotave.	108
	P9. Arsimi parauniversitar dhe edukimi	113
	P10. Strehimi dhe Shërbimet sociale	123
	P11. Kultura dhe shërbimet rekracionale	133
	P12. Rinia dhe Sporti	149
	Projektet dhe Aktivitetet.....	157
	Aneks 1: Baza ligjore .....	584
	Aneks 2: Lista e projekteve të investimeve kapitale.....	585
	Aneksi 3: Lista e projekteve të investimeve kapitale prioritare .....	589



## LISTA E TABELAVE

TABELA 1 PLANIFIKIMI SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE.....	9
TABELA 2 PLANIFIKIMI I BUXHETIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK .....	10
TABELA 3 PLANIFIKIMI I BUXHETT SIPAS FUNKSIONEVE.....	11
TABELA 4 TË ARDHURAT E VETA TË BASHKISË PËR VITIN 2016.....	14
TABELA 5 TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA .....	15
TABELA 6 TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA VENDORE .....	16
TABELA 7 PLANI E TË ARDHURAVE TË VETA TË BASHKISË SË SHKODRËS PËR VITIN 2016.....	18
TABELA 8 NGARKESA FISKALE SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE .....	19
TABELA 9 KAPACITETI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE.....	20
TABELA 10 KAPACITETI I FAMILJEVE TAKSAPAGUESE.....	22
TABELA 11 KAPACITETI I BIZNESEVE DHE INSTITUCIONEVE TAKSAPAGUESE .....	23
TABELA 12 KAPACITETI I BIZNESEVE TE VEGJEL SIPAS NATYRES .....	24
TABELA 13 KAPACITETI I BIZNESEVE TË MËDHA SIPAS NATYRËS SË TYRE .....	25
TABELA 14 EFEKTI NEGATIV NE TAKSAT VENDORE NGA HEQJA E TATIMIT MBI BIZNESIN.....	28
TABELA 15 TË ARDHURA NGA TATIMI I THJESHTUAR.....	28
TABELA 16 TË ARDHURAT NGA TAKSA MBI NDËRTESAT E BANIMIT.....	30
TABELA 17 TË ARDHURAT NGA TAKSA MBI NDËRTESAT E TJERA/BIZNESI .....	32
TABELA 18 TË ARDHURAT NGA TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE.....	34
TABELA 19 TË ARDHURAT NGA TAKSA MBI TRUALLIN .....	36
TABELA 20 TË ARDHURAT NGA TAKSA E FJETJES NË HOTEL .....	38
TABELA 21 TË ARDHURAT NGA TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË .....	39
TABELA 22 TË ARDHURA NGA TAKSA E TABELAVE, SIPAS LLOJIT DHE ZONAVE.....	41
TABELA 23 TË ARDHURAT NGA TARIFAT .....	42
TABELA 24 TË ARDHURAT NGA TARIFA E PASTRIMIT SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE.....	45
TABELA 25 TË ARDHURAT NGA TARIFA E NDRIÇIMI PUBLIK, SIPAS LLOJIT DHE ZONAVE.....	45
TABELA 26 TË ARDHURAT NGA TARIFA E GJELBËRIMIT PUBLIK, SIPAS LLOJIT DHE ZONAVE.....	46
TABELA 27 TË ARDHURA NGA TARIFA E PARKIMIT PËR MJETET E LIÇENSUARA, DHE PARKINGJET E REZERVUARA .....	47
TABELA 28 TË ARDHURAT NGA TARIFA E ZËNIES SË HAPËSIRAVE PUBLIKE, SIPAS LLOJIT DHE ZONAVE.....	48
TABELA 29 TE ARDHURAT NGA BURIME TË TJERA PËR VITIN 2016 : .....	49
TABELA 30 BUXHETI I BASHKISE SHKODËR SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE DHE ZËRAVE TË BURIMEVE TË FINANCIMIT .....	58
TABELA 31 BUXHETI I BASHKISE SHKODËR SIPAS PROGRAMEVE FUNKSIONEVE.....	59
TABELA 32 KUADRI I PROGRAMIT TË ADMINISTRATËS VENDORE .....	61
TABELA 33 AKTIVITETET DHE PROJEKTET E PROGRAMIT TË ADMINISTRATËS VENDORE.....	66
TABELA 34 KUADRI I PROGRAMIT TË PLANIFIKIMIT URBAN .....	72
TABELA 35 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË PLANIFIKIMIT URBAN .....	74
TABELA 36 AKTIVITETET E PROJEKTET E PROGRAMIT TË PLANIFIKIMIT URBAN .....	74
TABELA 37 KUADRI I PROGRAMIT TË INFRASTRUKTURËS RRUGORE .....	76
TABELA 38 BUXHETIMI PROGRAMIT TË INFRASTRUKTURËS RRUGORE .....	79
TABELA 39 AKTIVITETE E PROJEKTE TË PROGRAMIT TË INFRASTRUKTURËS RRUGORE .....	79
TABELA 40 KUADRI I PROGRAMIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE.....	81
TABELA 41 BUXHETIMI PROGRAMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE .....	90
TABELA 42 AKTIVITETE E PROJEKTE TË PROGRAMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE .....	90
TABELA 43 KUADRI I PROGRAMIT TË TRANSPORTIT PUBLIK DHE LËVIZSHMËRISË .....	92
TABELA 44 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË TRANSPORTIT PUBLIK DHE LËVIZSHMËRISË .....	93
TABELA 45 AKTIVITETET E PROJEKTET E PROGRAMIT TË TRANSPORTIT PUBLIK DHE LËVIZSHMËRISË .....	93
TABELA 46 KUADRI I PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL DHE TURIZMIT .....	96
TABELA 47 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL DHE TURIZMIT .....	101
TABELA 48 AKTIVITETE E PROJEKTE TË PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL DHE TURIZMIT .....	101
TABELA 49 KUADRI I PROGRAMIT TË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL.....	105
TABELA 50 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL.....	106
TABELA 51 AKTIVITETE E PROJEKTE TË PROGRAMIT TË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL .....	106

TABELA 52 KUADRI I PROGRAMIT TË MJEDISIT DHE MBROJTJES SË PYJEVE E KULLOTAVE .....	108
TABELA 53 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË MJEDISIT DHE MBROJTJES SË PYJEVE E KULLOTAVE .....	111
TABELA 54 AKTIVITETE E PROJEKTE TË PROGRAMIT TË MJEDISIT DHE MBROJTJES SË PYJEVE E KULLOTAVE ..	112
TABELA 55 KUADRI I PROGRAMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE EDUKIMIT .....	114
TABELA 56 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE EDUKIMIT .....	119
TABELA 57 AKTIVITETE E PROJEKTE TË PROGRAMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE EDUKIMIT .....	120
TABELA 58 KUADRI I PROGRAMIT TË STREHIMIT DHE SHËRBIMEVE SOCIALE .....	124
TABELA 59 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË STREHIMIT DHE SHËRBIMEVE SOCIALE .....	130
TABELA 60 AKTIVITETE E PROJEKTE TË PROGRAMIT TË STREHIMIT DHE SHËRBIMEVE SOCIALE .....	131
TABELA 61 KUADRI I PROGRAMIT TË KULTURËS DHE SHËRBIMEVE REKREACIONALE .....	134
TABELA 62 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË KULTURËS DHE SHËRBIMEVE REKREACIONALE .....	141
TABELA 63 AKTIVITETE E PROJEKTE TË PROGRAMIT TË KULTURËS DHE SHËRBIMEVE REKREACIONALE .....	142
TABELA 64 KUADRI I PROGRAMIT TË RINISË DHE SPORTIT .....	150
TABELA 65 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË RINISË DHE SPORTIT .....	153
TABELA 66 AKTIVITETE E PROJEKTE TË PROGRAMIT TË RINISË DHE SPORTIT .....	154
TABELA 67 LISTA E PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE KAPITALE PËR VITIN 2016 .....	585
TABELA 68 LISTA E PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE KAPITALE PRIORITYARE .....	589



## LISTA E GRAFIKËVE

GRAFIKU 1 PLANIFIKIMI SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE.....	10
GRAFIKU 2 SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK .....	13
GRAFIKU 3 TË ARDHURAT NË PËRQINDJE.....	15
GRAFIKU 4 TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA .....	16
GRAFIKU 5 TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA VENDORE .....	17
GRAFIKU 6 NDIKIMI NË PLANIN E TË ARDHURAVE PËR VITIN 2016, I ÇDO TAKSE DHE TARIFE.....	17
GRAFIKU 7 PLANIFIKIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2016 SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE.....	19
GRAFIKU 8 TAKSAPAGUESIT.....	21
GRAFIKU 9 NUMRI I FAMILJEVE TAKSAPAGUESE .....	21
GRAFIKU 10 FAMILJE ME LEHTËSI FISKALE .....	22
GRAFIKU 11 NUMRI I BIZNESEVE.....	24
GRAFIKU 12 KAPACITETI I BIZNESEVE TE VEGJEL SIPAS NATYRES .....	26
GRAFIKU 13 TË ARDHURAT VENDORE NGA TAKSAT VENDORE .....	27
GRAFIKU 14 TË ARDHURAT NGA TAKSA E NDËRTESAVE TË BANIMIT .....	31
GRAFIKU 15 TË ARDHURAT NGA TAKSA E NDËRTESËS PËR BIZNESIN .....	33
GRAFIKU 16 TË ARDHURAT NGA TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE SIPAS KATEGORIVE.....	35
GRAFIKU 17 TË ARDHURAT NGA TAKSA MBI TRUALLIN SIPAS KATEGORIVE .....	37
GRAFIKU 18 TË ARDHURAT NGA TARIFAT SIPAS SHËRBIMEVE .....	43
GRAFIKU 19 TË ARDHURA NGA BURIME TË TJERA .....	50
GRAFIKU 20 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË INFRASTRUKTURËS RRUGORE.....	79
GRAFIKU 21 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE .....	89
GRAFIKU 22 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË TRANSPORTIT PUBLIK.....	93
GRAFIKU 23 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL.....	106
GRAFIKU 24 BUXHETIMI I PROGRAMIT MJEDISIT DHE MBROJTJES SË PYJEVE E KULLOTAVE.....	111
GRAFIKU 25 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE EDUKIMIT .....	119
GRAFIKU 26 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË STREHIMIT DHE SHËRBIMEVE SOCIALE .....	130
GRAFIKU 27 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË KULTURËS DHE SHËRBIEMEVE REKREACIONALE.....	141
GRAFIKU 28 BUXHETIMI I PROGRAMIT TË RINISË DHE SPORTIT .....	153

*\* Falenderojmë ekspertët që ndihmuan në hartimin dhe detajimin e projekt - buxhetit 2016, programin dldp (programi për decentralizim dhe zhvillim lokal) dhe kooperacionin Zviceran për mbështetjen.*

Të dashur bashkëqytetarët e mi,

Të nderuar këshilltarë të Bashkisë së Shkodrës,

Pas reformës territoriale Bashkia jonë tashmë përfshin një territor rreth 50 herë më të madh, me një sipërfaqe prej 872.71 km<sup>2</sup>, dhe një popullsi dy herë më e madhe prej rreth 204,000 banorë të regjistruar. Bashkia e re e Shkodrës ka në përbërjen e saj 11 njësi administrative: Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh, Velipojë. Ajo ka nën administrimin e saj një qytet dhe 93 fshatra.




Figure 1 Harta treguese Bashkia Shkodër

Menjëherë pas zgjedhjeve të qershorit 2015, u përfshimë në një proces të vështirë të bashkimit administrativ dhe funksional të Bashkisë. Gjatë këtyre muajve procesi i tranzicionit është shoqëruar me vështirësi në menaxhimin, shpërndarjen dhe administrimin e burimeve njëzore, është përballur me mungesën e burimeve financiare për vazhdimin e ofrimit të shërbimeve në territor. Bashkia e re Shkodrës trashëgoi a) asete të dëmtuara, të zaptuara dhe jo funksionale, b) mungesa në inventare dhe materiale referuar bilanceve të deklaruara më 30 qershor 2015, c) një sërë detyrimesh financiare kryesisht për kontrata për shërbime dhe investime me të tretë por të pa financuara nga buxhetet vendore, d) detyrime nga vendimet gjyqësore të formës së prerë ose dhe në proces. Procesi i transformimit dhe tranzicionit akoma nuk ka përfunduar. Një sërë aktesh normative, udhëzime dhe urdhëresa të paqarta kanë vështirësuar procesin duke sjellë vonesa, ripërsëritje të procedurave, mungesë koordinimi ndërmjet institucioneve vendore e qendrore.

Të dashur bashkëqytarët e mi,

Të nderuar këshilltarë të Bashkisë së Shkodrës,

Projekt-buxheti i vitit të parë pas reformës territoriale ka pasuar një proces listimi dhe analizimi të problemeve dhe sfidave emergjente, programeve dhe projekteve afatshkurtra dhe afatmesme. Gjatë këtyre muajve komunikimi me njerëzit, takimet e diskutimet publike kanë ndihmuar për të përcaktuar shqetësimet dhe nevojat aq të shumta dhe me mundësi të kufizuara për t'u realizuar në një kohë afat-shkurtër.

Gjatë këtij viti, së bashku, do të punojmë duke dhënë maksimumin për të përmbushur detyrimet, përgjegjësitë dhe premtimet tona.

Unë, ne, Bashkia e Shkodrës duam të punojmë mirë, me përgjegjësi, duke zbatuar me rigorozitet ligjin, me transparencë, duke përdorur paratë në mënyrë efçiente për gjërat e duhura, me besimin se vetëm kështu mund të ndryshojmë dhe të zhvillohemi.

Për këtë do të punojmë për ndërtimin dhe fuqizimin e administratës publike si një instrument thelbësor e pikënisje për t'i shërbyer qytetarëve. Rekrutimi i burimeve njerëzore cilësore dhe trajnimi i vazhdueshëm për përmirësimin e punës në administrim është synimi ynë. Modernizimi i punës në administratën publike përmes zhvillimit dhe përdorimit të inovacionit, elektronikës dhe teknologjisë së komunikimit janë një alternativë që ne e mbështesim fort.

Njerëzit janë zemra e Shkodrës! Me traditën, diversitetin, besimin, trashëgiminë, burimet, njohuritë, vlerat do të jenë gjithmonë pasuria dhe energjia e zhvillimit të territorit. Integrimi i kësaj larmije do të jetë përgjigja që Plani i Përgjithshëm Vendor do të mundësojë përmes instrumentave praktik të zhvillimit.

Në territorin e Shkodrës ne kemi zona me diferenca të dallueshme përsa i përket infrastrukturës ekszistuese rrugore, shërbimeve publike, gjendjes së objekteve të arsimit dhe shërbimit shëndetësor, gjendjes ekonomike dhe sociale të komuniteteve.

Përmirësimi në vijimësi sidomos i shërbimeve publike: kujdesi, pastrimi e mbrojtja e mjedisit, mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese, përmirësimi me furnizim me ujë të pijshëm, rritja e sigurisë-ndriçimi i ambjenteve publike, përmirësimi i aksesit dhe lëvizshmërisë mbetet sfidë e Bashkisë së Shkodrës.

Me kontributet e qytetarëve do të mundësojmë përmirësimin e shërbimeve dhe kushtet duke krijuar një klimë pozitive për zhvillimin e biznesit, mikpritëse për vizitorët vendas dhe të huaj. Promovimi i territorit me vlerat e veta turistike, të trashëgimisë, të artit, të kulturës e traditës do të ndihmojë rritjen e ekonomisë. Agroturizmi dhe prodhimi i produkteve bujqësore janë një aspekt tjetër i rëndësishëm i ekonomisë në Shkodër. Zonat e prodhimit bujqësor në Shkodër përballen me nevojën e madhe për mirëmbajtje dhe investime në kullim dhe vaditje. Tashmë kjo është një përgjegjësi e jona, por që kërkon një angazhim bashkë me komunitetin në pamundësi për të patur financa kombëtare direkte. Për këtë Bashkia e Shkodrës do të jetë e vëmendshme për të hartuar projekte dhe ofruar shërbim mirëmbajtje. Pasuritë e natyrës, pyjet dhe kullotat, uji, lumenjtë dhe liqeni janë pasuri që do të vlerësohen dhe projektohen si mundësi për zhvillim të aktiviteteve ekonomike.

Shkodra është një qytet që jeton, i ri, i gjallë dhe aktiv! Në Shkodër mësojnë dhe edukohen mbi 10 mijë të rinj studentë dhe nxënës në nivele të ndryshme arsimit. Në territore të ndryshme vërehen diferenca të theksuara të kushteve për mësimdhënie. *Përmirësimi i kushteve dhe përafrimi i standardeve* do të jetë përpjekja dhe sfida e punës sonë. Kujdesi dhe shërbimet për familjen, për fëmijët, për të rinjtë, për personat me aftësi ndryshe do të jetë një risi duke besuar se kështu mund të ndihmojmë për një shoqëri më të shëndetshme.


Shkodra, me njerëzit kreativ, me historinë dhe kulturën, mikëpritjen dhe vlerat njerësore është një komunitet që jeton e zhvillohet. Mbrojtja e vlerave, zhvillimi dhe promovimi i traditës e historisë, gjallërimi i jetës kulturore, artistike e sportive janë për Shkodrën frymëzim dhe shpirt e frymëmarrje.

Unë besoj që bashkë me ju, me bashkeqytetarët, me shumë punë e përkushtim do të marrim dhe përmbushim përgjegjësitë për të administruar dhe zhvilluar Shkodrën.

Unë besoj në kontributin dhe mbështetjen tuaj!

Voltana Ademi

Kryetar




## I. Buxheti i Bashkisë për Vitin 2016.

Buxheti i Bashkisë së Shkodrës për vitin 2016 është 1,655,453 mijë lekë, ndër të cilat 596,485 mijë lekë (36%) nga të ardhurat e veta, 511,662 mijë lekë (31%) transfertë e pakushtëzuar, 306,941 mijë lekë (18.5%) transfertë specifike, 4,525 mijë lekë nga donatorë, dhe 235,840 mijë lekë (14%) transfertë e kushtëzuar.

Tabela 1 Planifikimi sipas programeve buxhetore

	<b>Programet buxhetore</b>	<b>Buxheti ne /000 lekë</b>
P1.	Planifikim Manaxhim Administrim	340,051
P2.	Planifikimin, administrimin dhe kontrollin e territorit sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	10,957
P3.	Infrastruktura rrugore	144,040
P4.	Shërbimet publike	313,801
P.5	Transporti publik dhe lëvizshmëria (mobiliteti)	14,376
P.6	Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit	7,120
P7	Bujqesia dhe zhvillimi rural	37,030
P8	Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.	8,294
P9	Arsimi parauniversitar dhe edukimi	348,191
P10	Strehimi dhe Shërbimet sociale	230,857
P11	Kultura dhe shërbimet rekracionale	86,534
P12	Rinia dhe Sportet	102,203
	Fondi rezervë	6,000
	Fondi i Kontigjencës	6,000
	<b>TOTAL I SHPENZIMEVE</b>	<b>1,655,453</b>



Grafiku 1 Planifikimi sipas programeve buxhetore

Tabela 2 Planifikimi i buxhetit sipas klasifikimit ekonomik

								/000 lekë
Programe	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvensioni	Transferta	Investime	Fondi rezervë	Fondi i Kontigjencës	Totali
TOTALI	573,447	543,727	12,000	262,962	263,317	6,000	6,000	1,655,453




Tabela 3 Planifikimi i buxhett sipas funksioneve

<b>Funksionet</b>	<b>/000 lekë</b>
Arsimi parashkollor parauniversitar	348,191
Administrata vendore	301,340
Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane;	195,255
Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	170,078
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;	144,040
Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreacionale, zhvillimi dhe administrimi i institucioneve dhe objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.	100,227
Ndriçimi i mjediseve publike	65,088
Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.	57,634
Emergjencat civile	38,710
Ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.	37,354
Administrimi i infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave si dhe menaxhimi i institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;	37,030
Parqet, lulishtet dhe hapësirat gjelbra publike;	35,000
Zhvillimi, mbrojtja, dhe promovimi i bibliotekave dhe ambienteve për lexim me qëllimin e edukimit të përgjithshëm të qytetarëve.	23,811
Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	17,652
Transporti publik vendor	14,376
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit;	11,297
Planifikimi, administrimi dhe kontrolli i territorit sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	10,957
Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	8,294
Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm	6,040
Fondi i kontingjences	6,000

Fondi rezerve	6,000
Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	5,772
Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.	5,089
Zhvillimi i Turizmit	4,770
Programet/projektet rinore	1,976
Dhënie e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjisllacionin në fuqi.	1,600
Shërbimi i dekorit publik;	1,121
Publikim i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik etj.	400
Mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike;	200
Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal;	150
<b>TOTALI</b>	<b>1,655,453</b>

#### Disa tregues të rëndësishëm për buxhetin

- Të ardhurat nga taksat janë 366,259 mijë lekë dhe zënë 61% të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- Të ardhurat nga tarifatat vendore janë 199,096 mijë lekë dhe zënë 33% të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- Të ardhurat nga burime të tjera janë 34,746 mijë lekë dhe zënë 6% të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- Totali i shpenzimeve kapitale është 263,317 mijë lekë dhe zë 16 % të totalit të shpenzimeve
- Totali i shpenzimeve operative është 543,727 mijë lekë dhe zë 33% të totalit të shpenzimeve
- Totali i shpenzimeve për paga dhe sigurime është 573,447 mijë lekë dhe zë 35% të totalit të shpenzimeve.



Grafiku 2 Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik

Buxheti i vitit 2016 është hartuar sipas programeve buxhetore dhe funksioneve të përcaktuara me ligj. Për periudhën fillestare të planifikimit, pas reformës administrative territoriale, ka qenë e vështirë mbledhja dhe analizimi i të dhënave për planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve si rezultat i:

- Mungesës së një analize dhe plani menaxhimi për shërbimet publike (mbledhja-grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane, ndriçimi rrugor, gjelbërim, mirëmbajtje infrastrukturë rrugore, mirëmbajtje rrugë rurale, ofrimi dhe menaxhimi i shërbimit me ujë të pijshëm, mirëmbajtje objekte të arsimit parashkollor, mirëmbajtje të objekteve të arsimit, mirëmbajtje të objekteve në shërbimin shëndetësor, etj.);
- Mungesës së analizës së kostove sipas standarteve për shërbimet publike;
- Mungesës së bazës së të dhënave të plota për bizneset;
- Mungesës së bazës së të dhënave të plota për familjet dhe individët;
- Mungesës së bazës së të dhënave për ndërtesat;
- Mungesës së bazës së të dhënave për tokën bujqësore;
- Mungesës së një plani për zënie e hapësirës publike;
- Mungesës së një plani për parkimin publik;

Formulimi dhe prezantimi i buxhetit të vitit 2016 është risi përse i përket metodologjisë së hartimit, duke ndjekur me korrektësi në fakt zbatimin e detyrueshëm të Ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i orientuar drejt produktit për shërbime dhe zhvillim për banorët e Shkodrës. Planifikimi i buxhetit është bërë mbi bazën e përcatimit të politikave programore dhe objektivave specifik të matshëm përmes treguesve sasiorë dhe cilësorë, të lexueshëm dhe të monitorueshëm lehtësisht në çdo kohë, gjatë gjithë procesit të zbatimit dhe realizimit, nga çdokush: nga administrata vendore, nga këshilltarët vendore, nga organizata të shoqërisë civile, nga çdo qytetar dhe i interesuar.

## II. Të Ardhurat e Bashkisë për vitin 2016

Sipas nenit 34 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 3 dhe 4, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj. Njësitë vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

Për vitin 2016 të ardhurat e përgjithshme të Bashkisë Shkodër, Nga të gjitha burimet e financimit parashikohen të jenë 1,655,453 mijë lekë.

Ëto të ardhura, sipas ligjit të mësipërm, vjen nga dy burime të ardhurash si më poshtë:

- 1. Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike për funksionet e reja që i transferohen Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.
- 2. Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat tatimore ( nga taksat vendore), jo tatimore (nga tarifat për shërbimet publike që ofrojnë dhe të ardhurat e tjera vendore).

Bashkia Shkodër për vitin 2016, duke përfshirë dhe të ardhurat e trashëguara nga viti i mëparshëm, transfertën e pa kushtëzuar, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhura të tjera parashikon të përdorë rreth 1,113 mijë lekë të ardhura të veta.

Tabela e mëposhtme paraqet të ardhurat e veta të Bashkisë Shkodër për vitin 2016 sipas çdo burimi.

Tabela 4 Të ardhurat e veta të Bashkisë për vitin 2016


### Të ardhurat e veta të Bashkisë për vitin 2016 (000/lekë)

Nr.	Të ardhurat e veta	Plan 2016
<b>I</b>	<b>Nga burimet e veta vendore</b>	<b>600,101</b>
1	Të ardhurat tatimore/taksat	366,259
2	Të ardhurat jo tatimore	233,842
<b>II</b>	<b>Të ardhura të trashëguara nga viti i mëparshëm</b>	<b>21,892</b>
<b>III</b>	<b>Nga burimet qendrore</b>	
1	Transfertat e pakushtëzuar	490,679
	<b>TOTALI</b>	<b>1,112,672</b>

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave të Bashkisë Shkodër me parashikim prej 601,101 mijë lekë, dhe zënë 56% të totalit të të ardhurave të veta.

Të ardhurat nga burimet qendrore (transferta e pakushtëzuar) prej 490,679 mijë lekë zënë 44% të totalit të të ardhurave

Për vitin 2016 krahas transfertës së pakushtëzuar është akorduar edhe fondi transferta specifike prej 306,941 mijë lekë për funksionet e reja.



Grafiku 3 Të ardhurat në përqindje

## II.1 Të ardhurat nga burimet qendrore


Të ardhurat nga burimet qendrore përfshijnë të ardhurat nga Transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, transferta e kushtëzuar.

Tabela 5 Të ardhurat nga burimet e veta

Të ardhurat nga burimet qendrore	/mijë lekë
Transferta e pakushtëzuar	490,679
Transferta specifike	306,941
Transferta e kushtëzuar	235,840
<b>TOTAL</b>	<b>1,033,460</b>

Të ardhurat nga burimet qendrore janë 1,033,460 mijë lekë dhe përfshijnë transfertën e pakushtëzuar dhe atë specifike për funksionet e reja si dhe transfertën e kushtëzuar.

## Të ardhurat nga burimet qendrore



Grafiku 4 Të ardhurat nga burimet e veta

## II.2 Te ardhurat e veta vendore

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës së kushtëzuar. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Specifika e këtyre të ardhurave, sipas nenit 40/1 të ligjit është që nëse nuk shpenzohen brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal. Pra, pjesë përbërëse e këtyre të ardhurave janë dhe ato që trashëgohen nga viti i mëparshëm. Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër për vitin 2016, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.


Gjithashtu planifikimi i të ardhurave të veta u realizua si proces në bashkëpunim me administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet e Agjentët tatimorë, etj. Ky proces bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave të mundshme për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorin e bashkisë.

## II.2.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore

Të ardhurat nga burimet e veta vendore llogariten në **600,101** mijë lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifat dhe të ardhurat nga burime të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga taksat (61%).

Tabela 6 Të ardhurat nga burimet e veta vendore


	/mijë lekë
<b>Të ardhurat nga Burimet e Veta Vendore</b>	<b>600,101</b>
Të ardhura nga taksat	366,259
Të ardhura nga tarifat	199,096
Të ardhura nga burime të tjera vendore	34,746



Grafiku 5 Të ardhurat nga burimet e veta vendore

Zërat e taksave dhe tarifave që ndikojnë pjesën më të madhe të planit të të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2016 janë kryesisht taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë rreth 26%, tarifaf për pastrimin që zë rreth 21%, taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 19%, taksa e mjeteve të përdorura që zë rreth 8%. Këto 10 zëra kryesorë mbulojnë 74% të planit të të ardhurave të Bashkisë Shkodër.

Ndikimi në planin e të ardhurave viti 2016 i çdo takse dhe tarife



Grafiku 6 Ndikimi në planin e të ardhurave për vitin 2016, i çdo takse dhe tarife

Tabela e mëposhtme pasqyron planin e të ardhurave të veta për vitin 2016, të kategorizuar sipas sipas klasifikimit ekonomik ligjor:

Tabela 7 Plani e të ardhurave të veta të Bashkisë së Shkodrës për vitin 2016

	LLOJET E TË ARDHURAVE	Plani 2016
<b>A</b>	<b>TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA GJITHSEJ</b>	<b>600,101</b>
<b>A.I</b>	<b>TË ARDHURA TATIMORE/NGA TAKSAT VENDORE</b>	<b>366,259</b>
<b>I.1</b>	<b>Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël</b>	<b>7,275</b>
<b>I.1.0</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)</b>	<b>1,377</b>
<b>I.2</b>	<b>Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme</b>	<b>114,774</b>
I.2.1	Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	86,266
I.2.1.1	Ndërtesa banimi	24,791
I.2.1.2	Ndërtesa të tjera	61,475
I.2.1.3	Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike.	-
I.2.4	Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	18,585
I.2.5	Të ardhura nga taksa mbi truallin	9,925
<b>I.3.</b>	<b>Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel</b>	<b>8,700</b>
<b>I.4</b>	<b>Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja</b>	<b>155,824</b>
<b>I.5</b>	<b>Të ardhura nga garanci financiare</b>	<b>-</b>
<b>I.6</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme</b>	<b>10,500</b>
<b>I.7</b>	<b>Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura</b>	<b>51,000</b>
<b>I.8</b>	<b>Të ardhura nga taksa e rentës minerare</b>	<b>-</b>
<b>I.9</b>	<b>Të ardhura nga taksa e tabelës</b>	<b>16,809</b>
<b>A.II</b>	<b>Të ARDHURAT JOTATIMORE</b>	<b>233,842</b>
<b>II</b>	<b>Të ardhurat nga Tarifat vendore</b>	<b>199,096</b>
<b>II.1</b>	<b>Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave</b>	<b>124,009</b>
II.1.1	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga familjet	59,844
II.1.2	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga institucione	250
II.1.3	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga biznesi	63,915
<b>II.2</b>	<b>Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik</b>	<b>28,163</b>
II.2.1	Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga familje	18,372
II.2.2	Te ardhura nga tarifë ndricimi nga institucione institucione	75
II.2.3	Të ardhura nga tarifë ndricimi nga biznesi	9,716
<b>II.3</b>	<b>Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin</b>	<b>19,166</b>
II.3.1	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga familjet	9,186
II.3.2	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga institucionet	75
II.3.3	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga biznesi	9,905
<b>II.4</b>	<b>Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë</b>	<b>27,758</b>
II.4.1	Nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	100
II.4.2	Nga tarifa për vulosje veterinerë të bagëtive të therura	280
II.4.3	Nga Tarifat e licënsimit të veprimtarive të transportit	1,375
II.4.4	Nga tarifa parkimi për mjetet e licënuara, dhe për vendparkime publike	2,492
II.4.5	Nga tarifë për dhënie licënsa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	400
II.4.6	Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	-
II.4.7	Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ	1,925
II.4.8	Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	19,685
II.4.9	Nga tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille	-
II.4.10	Nga linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	1,500
<b>A.III</b>	<b>TË ARDHURA TË TJERA</b>	<b>34,746</b>
<b>III.1</b>	<b>Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj</b>	<b>15,160</b>
III.1.1	Biblioteka "Marin Barleti"	100
III.1.2	Muzeumet	2,100
III.1.3	Teatri "Migjeni"	600
III.1.4	Qendra Kulturore e fëmijëve	250
III.1.5	Pallati sportit " Qazim Dervishi"	1,000
III.1.6	Qendra Komunitare	-
III.1.7	Nga Marka "ZAHOTEX" nga artizanet e zonës	-
III.1.8	Nga dokumentat për tender ose ankand	-
III.1.9	Nga kopshtet	7,920
III.1.10	Nga çerdhet	3,190
<b>III.2</b>	<b>Të ardhura nga kundravajtjet ad ministrative (Gjobat)</b>	<b>8,850</b>
<b>III.3</b>	<b>Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve në pronësi të Bashkisë</b>	<b>5,520</b>
<b>III.4</b>	<b>Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime</b>	<b>100</b>
<b>III.5</b>	<b>Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e sherbimeve</b>	<b>1,500</b>
<b>III.6</b>	<b>Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara</b>	<b>-</b>
<b>III.7</b>	<b>Të ardhura nga privatizimi</b>	<b>-</b>
<b>III.8</b>	<b>Të ardhura nga sponsorizimet</b>	<b>3,616</b>


Pesha kryesore në realizimin e të ardhura për vitin 2016 i ngarkohet Njësisë administrative Shkodër në vlerën 446,386 mije Lekë, ose 74% të planit total të të ardhurave.



Tabela e mëposhtme pasqyron në mënyrë analitike ngarkesën fiskale sipas njësive administrative:

Tabela 8 Ngarkesa fiskale sipas njësive administrative

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2016 sipas Njësive Administrative/ mijë lekë																		
	Njësi Administrative Qendër						Njësi Administrative të tjera											
Totali	Shuma	Lagje 1	Lagje 2	Lagje 3	Lagje 4	Lagje 5	Shuma	Pult	Shosh	Shalë	Postribë	Guri i Zi	Bërdicë	Velipojë	Dajç	Ana e Malit	Rrethina	
<b>600,101</b>	<b>446,371</b>	103.490	90.031	88.552	95.516	68.782	153.730	2.556	2.459	2.761	8.466	11.539	13.527	71.150	12.644	6.673	21.955	



Grafiku 7 Planifikimi i të ardhurave për vitin 2016 sipas njësive administrative

## A. Kapacitetet fiskale të taksapaguesve


Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat për taksapaguesit e një viti më parë, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të vitit 2016 të miratuar nga këshilli i bashkisë.

Në total numri taksapaguesve është parashikuar rreth 35,966 (familje, biznese dhe institucione). Peshën më të rëndësishme të taksapaguesve e përbëjnë familjet (87% ndaj totalit)

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e kapacitetit të taksapaguesve sipas kategorive dhe njësive administrative.

Tabela 9 Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupimeve


KAPACITETI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE (Numri)					
Nr	Bashkia Shkodër	Familjet	Biznesi i Vogël	Biznesi i madh	Institucione
I	NjA Shkodër	18,010	2,960	793	30
	Lagjia nr.1	3,950	780	207	5
	Lagjia nr.2	3,750	570	154	7
	Lagjia nr.3	3,490	700	175	7
	Lagjia nr.4	3,730	670	176	6
	Lagjia nr.5	3,090	240	81	5
II	NjA të tjera	13,220	701	232	20
	NjA Pult	289	5	-	2
	NjA Shosh	69	5	-	2
	NjA Shalë	386	13	-	2
	NjA Postribë	1,390	23	8	2
	NjA Guri i Zi	1,648	64	10	2
	NjA Bërdicë	1,230	87	4	2
	NjA Velipojë	2,100	337	150	2
	NjA Dajc	995	45	9	2
	NjA Ana e Malit	879	42	10	2
	NjA Rrethinat	4,234	80	41	2
	TOTALI	31,230	3,661	1,025	50



Grafiku 8 Taksapaguesit

### A.1 Taksapaguesit familjarë

Në total numri i familjeve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Shkodër është 31,230. Numri i familjeve në njësinë administrative Shkodër zë peshën kryesore me 18,010 familje ose 58% të numrin të përgjithshëm të familjeve në Bashkinë Shkodër.



Grafiku 9 Numri i familjeve taksapaguese


Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke ju përafëruar kapaciteteve reale të familjeve rezidente dhe duke mesatarizuar numrin e arkëtimeve në vitet e kaluara sipas zonave me numrin e familjeve sipas censusit.

Në planin e të ardhurave janë parashikuar lehtësi fiskale për familjet me probleme sociale, si për familjet që janë përfitues të ndihmës ekonomike, për pensionistët, për invalidët etj. , të cilët përbëjnë rreth 8,810 familje ose 28% të familjeve taksapaguese.

Më poshtë tabela përmbledhëse për familjet sipas kategorive/lehtësive fiskale dhe sipas Njësive Administrative:

**Tabela 10 Kapaciteti i familjeve taksapaguese**

KAPACITETI I FAMILJEVE TAKSAPAGUESE					
Nr	Bashkia Shkodër	Totali i familjeve	Familje me tarifa/taksa të plota	Familje me lehtësi fiskale	
				Pensionistë, invalidë, etj.	Përfitues të ndihmës ekonomike
I	NjA Shkodër	18,010	14,260	2,090	1,660
	Lagjia nr.1	3,950	3,130	460	360
	Lagjia nr.2	3,750	2,970	430	350
	Lagjia nr.3	3,490	2,760	410	320
	Lagjia nr.4	3,730	2,950	430	350
	Lagjia nr.5	3,090	2,450	360	280
II	NjA të tjera	13,220	8,232	2,228	2,760
	NjA Pult	289	60	29	200
	NjA Shosh	69	19	20	30
	NjA Shalë	386	67	19	300
	NjA Postribë	1,390	290	560	540
	NjA Guri i Zi	1,648	768	440	440
	NjA Bërdicë	1,230	820	180	230
	NjA Velipojë	2,100	1,960	80	60
	NjA Dajc	995	875	30	90
	NjA Ana e Malit	879	569	130	180
	NjA Rrethinat	4,234	2,804	740	690
	TOTALI	31,230	22,492	4,318	4,420



**Grafiku 10 Familje me lehtësi fiskale**

## A.2 Taksapaguesit biznese dhe institucione

Bazuar në regjistrat aktual, në total, numri i bizneseve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Shkodër është 4,686. Biznesi i vogël zë 78% të numrit total të bizneseve.

Numri i institucioneve që përfshihen në detyrimet fiskale janë rreth 50, ndër të cilat rreth 60% e tyre ndodhen në Njësinë Administrative Shkodër.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për bizneset sipas xhiros, sipas institucioneve dhe Njësi Administrative:

**Tabela 11 Kapaciteti i bizneseve dhe institucioneve taksapaguese**

KAPACITETI I BIZNESEVE DHE INSTITUCIONEVE TAKSAPAGUESE						
Nr	Bashkia Shkodër	Totali	Totali I bizneseve	Nga kjo		Institucione
				Biznesi i vogel	Biznesi i madh	
I	NjA Shkodër	3,783	3,753	2,960	793	30
	Lagjia nr.1	992	987	780	207	5
	Lagjia nr.2	731	724	570	154	7
	Lagjia nr.3	882	875	700	175	7
	Lagjia nr.4	852	846	670	176	6
	Lagjia nr.5	326	321	240	81	5
II	NjA të tjera	953	933	701	232	20
	Pult	7	5	5	-	2
	Shosh	7	5	5	-	2
	Shalë	15	13	13	-	2
	Postribë	33	31	23	8	2
	Guri i Zi	76	74	64	10	2
	Bërdicë	93	91	87	4	2
	Velipojë	489	487	337	150	2
	Dajc	56	54	45	9	2
	Ana e Malit	54	52	42	10	2
	Rrethinat	123	121	80	41	2
	<b>TOTALI</b>	<b>4,736</b>	<b>4,686</b>	<b>3,661</b>	<b>1,025</b>	<b>50</b>



Grafiku 11 Numri i bizneseve

Në tabelën e mëposhtme, për bizneset e vogla vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregtar dhe shërbime me 84% ndaj totalit të bizneseve të vegjël.


Tabela 12 Kapaciteti i bizneseve të vegjël sipas natyres

KAPACITETI I BIZNESEVE TE VEGJEL SIPAS NATYRES SE TYRE						
Nr	Bashkia Shkodër	Biznesi i vogël	Nga kjo :			
			Njësi tregëtare dhe shërbimi	Njësi prodhimi	Profesione të lira	Ambulantë
I	NjA Shkodër	2,960	2,470	170	200	120
	Lagjia nr.1	780	670	50	50	10
	Lagjia nr.2	570	490	30	40	10
	Lagjia nr.3	700	540	40	40	80
	Lagjia nr.4	670	570	40	50	10
	Lagjia nr.5	240	200	10	20	10
II	NjA të tjera	701	615	56	30	-
	Pult	5	5	-	-	-
	Shosh	5	5	-	-	-
	Shalë	13	13	-	-	-
	Postribë	23	18	-	5	-
	Guri i Zi	64	59	-	5	-
	Bërdicë	87	74	10	3	-
	Velipojë	337	302	30	5	-
	Dajc	45	34	6	5	-
	Ana e Malit	42	37	3	2	-
	Rrethinat	80	68	7	5	-
	<b>TOTALI</b>	<b>3,661</b>	<b>3,085</b>	<b>226</b>	<b>230</b>	<b>120</b>

Në tabelën e mëposhtme, për bizneset e mëdha, vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregtar dhe shërbime me 76% ndaj totalit të bizneseve të mëdhenj.

Tabela 13 Kapaciteti i bizneseve të mëdha sipas natyrës së tyre

KAPACITETI I BIZNESEVE TE MEDHA SIPAS NATYRES SE TYRE							
N r	Bashkia Shkodër	Biznesi i madh	Nga kjo :				
			Njësi tregëtare dhe shërbimi	Njësi tregtare për tregëtim karburanti	Njësi prodhimi	Subjekte ndërtimi	Ente shtetërore, OJF, etj.
I	NjA Shkodër	793	590	20	80	33	70
	Lagjia nr.1	207	160	5	20	8	14
	Lagjia nr.2	154	120	4	10	6	14
	Lagjia nr.3	175	130	4	20	7	14
	Lagjia nr.4	176	130	5	20	7	14
	Lagjia nr.5	81	50	2	10	5	14
II	NjA të tjera	232	184	24	20	4	-
	Pult	-	-	-	-	-	-
	Shosh	-	-	-	-	-	-
	Shalë	-	-	-	-	-	-
	Postribë	8	4	4	-	-	-
	Guri i Zi	10	5	2	2	1	-
	Bërdicë	4	-	2	2	-	-
	Velipojë	150	145	2	2	1	-
	Dajc Ana e Malit	9	5	2	2	-	-
	Malit	10	5	3	2	-	-
	Rrethinat	41	20	9	10	2	-
	<b>TOTALI</b>	<b>1,025</b>	<b>774</b>	<b>44</b>	<b>100</b>	<b>37</b>	<b>70</b>



Grafiku 12 Kapaciteti i bizneseve të vogël sipas natyrës

## B. Analiza e të ardhurave të veta vendore dhe ndikimet e tyre në të ardhurat e bashkisë

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, nga tarifat për shërbimet publike dhe të ardhurat e tjera vendore.

Sipas ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve e sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

Llogaritja e të ardhurave të kësaj kategorie mbështetet në:

1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar ;
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër nr 1 date 22.01.2016 "Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Shkodër";

### B.1 Te ardhurat nga taksat vendore

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njëjësive të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre.

Paketa fiskale e bashkisë Shkodër për këtë kategori e hartuar dhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh (juridik) dhe të vogël (fizik), banorëve të




njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe këshilltarë, pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj. sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

- Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi deri ne 30% nga referenca ligjore
- Taksë 0 (zero) ndërtesë për qëllime banimi për invalidët
- Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime biznesi etj. deri ne 30% nga referenca ligjore
- Ulje në nivelin maksimal të lejuar prej 30% të taksës së tokës bujqësore

Në vitin 2016 të ardhurat nga taksat përbëjnë rreth 61% të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë.

Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të taksave vendore janë të ardhurat nga taksë e ndikimit në infrastrukturë, e cila zë mbi 43% te totalit dhe më pas vijnë të ardhurat nga taksë mbi pasurinë e paluajtshme (31%) dhe më pas të ardhurat nga taksë e mjeteve të përdorura (14%).



Grafiku 13 Të ardhurat vendore nga taksat vendore

### ***B.1.1 Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël***

Sipas ligjit 142/2015 dt 17.12.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, date 30/08/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 11 ndryshon dhe:

- shkalla tatimore për subjektet me xhiro nga 0 deri në 5 milion është 0 Lekë,

- ndërsa shkalla tatimore për subjektet me xhiro nga 5 milion deri në 8 milion është 5 % e fitimit.

Tatimi i thjeshtuar për biznesin e vogël administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila në rolin e agentit tatimor mban një komision prej 1% të vlerës së grumbulluar, ndërsa 99% kalon në favor të bashkisë Shkodër.

Referuar legjislacionit të mëparparshëm, subjektet me xhiro 0 deri 2 milion Lekë i nënshtroheshin tatimit fiks prej 25,000 Lekësh në vit, ndërsa ato nga 2 deri në 8 milion Lekë xhiro i nënshtroheshin tatimit prej 7.5 % të fitimit në vit, por jo më pak se 25,000 Lekë.

Pra, efekti negativ në të ardhurat e Bashkisë nga heqja me ligj e kësaj takse, vetëm për biznesin me xhiro 0-5 milion lek, është rreth 85,500 mije lekë.

Më poshtë tabela analitike e efektit negativ në të ardhurat e Bashkisë Shkodër:

**Tabela 14 Efekti negativ ne taksat vendore nga heqja e tatimit mbi biznesin**

NJA Shkodër		NJA Velipojë		NJA të tjera		Totali
Nr. Bizneseve me xhiro 0-5 milion	Të ardhura të munguara	Nr. Bizneseve me xhiro 0-5 milion	Të ardhura të munguara	Nr. Bizneseve me xhiro 0-5 milion	Të ardhura të munguara	
2,760	69,000	310	7,750	350	8,750	85,500
	81%		9%		10%	

Këtë vit parashikohet që nga 3,661 biznese të vogla që ka bashkia Shkodër në juridiksionin e saj, rreth 260 ose vetëm 7% prej tyre rezultojnë të kenë xhiron vjetore 5-8 milion lekë.

Të ardhurat nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për vitin 2016 parashikohen 7,275 mije lekë.

**Tabela 15 Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar**

**Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël 000/lekë**

Numri i biznesit	Nj.A. Shkodër		Nj.A. të tjera		Totali	
	Me xhiro vjetore nga 0 - 5.000.000 lekë		Me xhiro vjetore nga 5.000.001 – 8.000.000 lekë			
	Niveli i tatimit	Te ardhurat	Numri i biznesit	Niveli i tatimit		Te ardhurat
	0	0	260	5% e fitimit	7,275	7,275

### ***B.1.2 Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme***

Këto të ardhura përfshijnë te ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesat e banimit dhe mbi ndërtesat e tjera)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

#### **a) Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat**

##### ***Taksa mbi ndërtesat e banimit***

Baza e taksës është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat.

Gjatë vitit parashikohet zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- saktësimin dhe vlerësimin të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim.
- rritjes së efikasitetit të agentit tatimor duke implementuar një program modern të kompjuterizuar,
- ndarjes në këste të pagesave,
- krijimit të arkave funksionale të agentit tatimor më pranë zonave të banuara në njësitë administrative.

Bashkia Shkodër parashikon që të gjejë mbështetje edhe tek institucionet e tjera si Zyra vendore e regjistrimit të pasurisë për saktësimin dhe përpilimin e një regjistri sa më të saktë të banesave në territorin e saj.

Duke u krahasuar me referencën ligjore, niveli i taksës së ndërtesave të banimit sipas paketës fiskale ka një lehtësim deri në 30% në zonat urbane, dhe deri në 17% në zonat rurale.

Planifikimi i të ardhurave prej 24,791 mije Lekë për vitin 2016 është bërë duke u bazuar tek të dhënat e Censurit, si dhe duke iu referuar tendencës në rritje të kapacitetit të realizimit të të ardhurave ndër vite. Sipërfaqja e ndërtesave të banimit që taksohet parashikohet rreth 2,916,420 m<sup>2</sup>, ku 74% zë sipërfaqja e taksueshme në Nj.A. Shkodër.

Më poshtë paraqitet tabela e të ardhurave nga taksa mbi ndërtesat e banimit, sipas dy grupeve të njësive administrative:


Tabela 16 Të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat e banimit

/000 lekë

I.2.1.1	Kategorite e Ndertesave te Banimit	NjA Shkodër			NjA Velipojë			NjA të tjera			Total e ardhur	Totali I Siperfaqes (m2)
		Sipërfaqja m2	Niveli i taksës l/m2	Të ardhura	Sipërfaqja m2	Niveli i taksës l/m2	Të ardhura	Sipërfaqja m2	Niveli i taksës l/m2	Të ardhura		
a)	Ndërtuar para vitit 1993	1,502,550	9	13,523	90,000	5	450	533,764	5	2,669	16,642	2,126,314
b)	Ndërtuar gjatë dhe pas vitit 1993	643,950	9	5,796	210,000	5	1,050	228,756	5	1,144	7,989	1,082,706
c)	Ndërtesa të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi	2,500	12	30	500	12	6	-	-	-	36	3,000
d)	Ndërtesa të dyta banimi	4,000	18	72	2,000	18	36	900	18	16	124	6,900
	<b>Totali</b>	<b>2,153,000</b>		<b>19,421</b>	<b>302,500</b>		<b>1,542</b>	<b>763,420</b>		<b>3,829</b>	<b>24,791</b>	<b>3,218,920</b>
	<b>Ne % ndaj totali</b>	<b>67%</b>		<b>78%</b>	<b>9%</b>		<b>6%</b>	<b>24%</b>		<b>15%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

Detyrimi për ndërtesën e banimit për të gjithë familjarët parashikohet të shlyhet në bazë mujore së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë të Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Sh.A. Shkodër, në cilësinë e agentit tatimor. Për shërbimin, agjenti do të mbajë përkatësisht 2% të shumës së arkëtuar, dhe do të kalojë çdo muaj në llogari të bashkisë Shkodër pjesën prej 98% te saj.

### Te ardhurat nga taksa e ndërtësive të banimit



Grafiku 14 Të ardhurat nga taksa e ndërtësive të banimit

Persa i përket peshës së të ardhurave nga kjo taksë, është bashkia Shkodër që do të përballojë rreth 78% të totalit të të ardhurave, ndërsa nëse i referohemi kategorisë së banesave, pjesa më e madhe e të ardhurave nga taksa mbi ndërtësat e banimit vjen nga banesat e ndërtuara para vitit 1993.

### Të ardhura nga Taksa e ndërtësës për biznese

Kjo taksë administrohet nga Bashkia Shkodër. Baza e taksës është sipas rastit sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtësës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat.

Duke u krahasuar me referencën ligjore, taksa për ndërtësat ka një lehtësim që shkon deri në maksimumin e lejuar prej 30% për gjitha llojet e bizneseve si në zonat urbane, ashtu edhe në zonat rurale.

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2016 me vlerë 61,475 mijë lekë është bërë mbi bazën e sipërfaqes aktuale të bizneseve në juridiksionin e bashkisë.

Më poshtë paraqitet tabela e të ardhurave nga taksa mbi ndërtësat e banimit, sipas dy grupeve të njësisive administrative:


Tabela 17 Të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat e tjera/biznesi

/000 lekë

1.2. 1.2	Kategorite e Ndertesave te tjera/biznesi	NJA Shkodër			NJA Velipojë			NJA të tjera			Totali (000/lekë)	Totali I Sipërfaqes (m2)
		Sipërfaqja m2	Nive li i taksës /m2	Të ardhura 000/lekë	Sipërfaqja m2	Nive li i taksës /m2	Të ardhura 000/lekë	Sipërfaqja m2	Nive li i taksës /m2	Të ardhura 000/lekë		
a)	Për tregti dhe shërbime.	93,600	270	25,272	148,000	120	17,760	38,960	120	4,675	47,707	280,560
b)	Per OJF, aktivitet artizanat, profesione te lira,ej	16,400	54	886	22,000	24	528	5,800	24	139	1,553	44,200
c)	Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese.	97,200	105	10,206	30,000	53	1,590	7,900	53	419	12,215	135,100
d)	Ndërtesa të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesë biznesi.	-	210	-	-	105	-	-	105	-	-	-
<b>Totali</b>		<b>207,200</b>	<b>36,364</b>	<b>200,000</b>	<b>19,878</b>	<b>52,660</b>	<b>5,233</b>	<b>61,475</b>	<b>459,860</b>			
<b>Ne % ndaj totali</b>		<b>45%</b>	<b>59%</b>	<b>43%</b>	<b>32%</b>	<b>11%</b>	<b>9%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>			



Ne planifikimin e kësaj takse është parashikuar gjithashtu një shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, si dhe bashkëpunimit të pritsëm me institucione si ZRRPP, ALUIZNI etj



Grafiku 15 Të ardhurat nga taksa e ndërtesës për biznesin

Kapaciteti totali i sipërfaqes së taksueshme për qëllime biznesi është 459,860 m<sup>2</sup>. Ndër to bizneset e Nj.A. Shkodër disponojnë 59% të kësaj sipërfaqeje. Ndërsa, nëse i referohemi kategorive të banesave, pjesa më e madhe e te ardhurave nga taksa mbi ndërtesat e tjera të biznesit vjen nga ndërtesat e biznesit për tregti e shërbime (rreth 78%).

#### **b) Të ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore**

Kjo taksë administrohet nga Bashkia Shkodër. Baza e taksës është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose në përdorim të taksapaguesit.

Duke u krahasuar me referencën ligjore, taksa e çdo kategorie e tokës bujqësore ka një lehtësim që shkon në maksimumin e lejuar prej 30%.

Më poshtë paraqitet tabela e të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore, sipas kategorive të tokës dhe njësive administrative:

Tabela 18 Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore

/000 leë


1.2.2	Kategorite e tokes bujqesore	NjA Shkodër			NjA Velipojë			NjA të tjera			Totali (000/lekë)	Totali I Siperfaqes (m2)	
		Sipërfaqja m2	Niveli i taksës lekë/m2	Të ardhura 000/lekë	Sipërfaqja m2	Niveli i taksës lekë/m2	Të ardhura 000/lekë	Sipërfaqja m2	Niveli i taksës lekë/m2	Të ardhura 000/lekë			
1.2.2.1	I	-	2,940	-	-	2,940	-	400	2,940	0	1,176	1,176	400
1.2.2.2	II	-	2,450	-	-	2,450	-	1,200	2,450	0	2,940	2,940	1,200
1.2.2.3	III	-	1,960	-	350	1,960	686	3,390	1,960	0	6,644	7,330	3,740
1.2.2.4	IV	-	1,610	-	290	1,610	467	2,120	1,610	0	3,413	3,880	2,410
1.2.2.5	V	-	1,330	-	260	1,330	346	1,417	1,330	0	1,885	2,230	1,677
1.2.2.6	VI	-	1,120	-	-	1,120	-	760	1,120	0	851	851	760
1.2.2.7	VII – X	-	980	-	-	980	-	180	980	176	176	176	180
	<b>Totali</b>	-	-	-	<b>900</b>	-	<b>1,499</b>	<b>9,467</b>	-	<b>17,086</b>	<b>18,585</b>	<b>18,585</b>	<b>10,367</b>
	<b>Ne % ndaj totali</b>	<b>0%</b>		<b>0%</b>	<b>9%</b>		<b>8%</b>	<b>91%</b>		<b>92%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>





Planifikimi i të ardhurave me vlerë 18,585 mije Lekë për vitin 2016 është bërë duke u bazuar ne kapacitetin aktual të njësive administrative dhe bazuar në parashikimin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve nga grupeve e punës, nëpërmjet saktësimit të sipërfaqeve reale dhe kategorizimit të saktë dhe aktual të tokës bujqësore.

### Te ardhurat nga taksa mbi token bujqesore sipas kategorive



Grafiku 16 Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore sipas kategorive

Kapaciteti totali i sipërfaqes së taksueshme të tokës bujqësore është 10,367 m2. Nëse i referohemi kategorive të tokës, pjesa më e madhe e të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore vjen nga tokat bujqësore të kategorisë së III dhe IV (rreth 60%).

#### c) Të ardhura nga Taksa mbi truallin

Taksa mbi truallin është një taksë e re që implementohet për herë të parë pas ndryshimeve ligjore fiskale për vitin 2016 dhe administrohet nga bashkia. Me “Truall” kuptohet një sipërfaqe toke, jo tokë bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, të miratuar për të ndërtuar mbi të.

Baza e taksës është sipërfaqja në metër katror.

Për bizneset kjo taksë administrohet nga Bashkia Shkodër. Për familjet detyrimi llogaritet dhe shlyhet në bazë mujore së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë të Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Sh.A. Shkodër, në cilësinë e agentit tatimor.


Planifikimi prej 9,924 mije lekë është bërë duke u bazuar në sipërfaqet aktuale të banesave dhe ndërtesave të tjera

Më poshtë tabela e te ardhurave nga taksa mbi truallin, sipas kategorive të truallit dhe njësive administrative:

Tabela 19 Të ardhurat nga taksa mbi truallin

I.2. 3	Kategorite e truallit	NjA Shkodër			NjA Velipojë			NjA të tjera			Totali (000/lekë)	Totali I Siperfaqes (m2)
		Sipërfaqja m2	Niveli i taksës lekë/m2	Të ardhura 000/lekë	Sipërfaqja m2	Niveli i taksës lekë/m2	Të ardhura 000/lekë	Sipërfaqja m2	Niveli i taksës lekë/m2	Të ardhura 000/lekë		
a)	Për qëllime banimi nga individët	2,153,000	0.42	904	302,500	0.42	127	763,420	0.42	321	1,352	3,218,920
b)	Për qëllime biznesi	223,600	18	4,025	200,000	18	3,600	52,660	18	948	8,573	476,260
	<b>Totali</b>	<b>2,376,600</b>		<b>4,929</b>	<b>502,500</b>		<b>3,727</b>	<b>816,080</b>		<b>1,269</b>	<b>9,925</b>	<b>3,695,180</b>
	<b>Ne % ndaj totali</b>	<b>64%</b>		<b>50%</b>	<b>14%</b>		<b>38%</b>	<b>22%</b>		<b>13%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

### Te ardhurat nga taksa mbi truallin sipas kategorive



Grafiku 17 Të ardhurat nga taksa mbi truallin sipas kategorive

Kapaciteti total i sipërfaqes së taksueshme te truallit është 3,722,980 m<sup>2</sup>, nga të cilat 47% e sipërfaqes i takon Nj.A. Shkodër. Ndërsa nëse i referohemi kategorive te truallit, pjesa më e madhe e te ardhurave nga kjo takse vjen nga trojet për qëllime biznesi (rreth 87%).

#### ***B.1.3 Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel***

Kjo taksë administrohet nga Bashkia Shkodër.

Me "Hotel" kuptohet çdo subjekt tregtar që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, dhe përcaktohet me ligj.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes, dhe mbi të vlera e taksës.

Tabela 20 Të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel

Zonat	Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel	Hotel me 4-5 yje	Bujtinë, fjetinë, motel etj. 000/lekë
Lagje nr. 1	60	0	60
Lagje nr. 2	30	0	30
Lagje nr. 3	320	170	150
Lagje nr. 4	970	520	450
Lagje nr. 5	220	0	220
Velipojë	7,000	1,000	6,000
Rrethina	100		100
<b>Totali</b>	<b>8,700</b>	<b>1,690</b>	<b>7,010</b>

Planifikimi i të ardhurave prej 8,700 mijë lekë për vitin 2016 është bërë duke parashikuar kapacitetet, numrin e njësive dhe periudhat e shfrytëzimit.

#### *B.1.4 Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë*

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja administrohet nga Bashkia Shkodër. Bazuar në ligjin 9632, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja përcaktohet në kufijtë 4-8% e çmimit të shitjes për ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik.

Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve të udhëzimit e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë te ndryshme nga ato të përmendura më lart është 3 % të vlerës së investimit që kërkohet të kryhet.

Bazuar në Ligjin Nr. 9482 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, taksa për ndërtesat në proces legalizimi llogaritet 0,5% e vlerës së investimit.

Planit për vitin 2016 për taksën e ndikimit në infrastrukturë prej 155.824 mijë lekë bazohet mbi parashikimin e lejeve për ndërtime të reja dhe shlyerjen e detyrimeve për objektet në proces legalizimi .

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet në proces legalizimi administrohet nga Bashkia Shkodër.

Vjelja e kësaj takse paraqet vështirësi për bashkinë Shkodër, pasi subjektet dhe familjarët pasi kryejnë procedurat e legalizimit pranë ALUIZNI-it, kryejnë regjistrimin e pronës pa shlyer detyrimin përkatës. Realizimi i ardhurave nga kjo taksë lidhet dhe bazohet në zbatimin e masave shtrënguese, bllokimin e shërbimit të debitorëve nga bashkia Shkodër, si dhe në mbështetjen nga ZRRPP-ja.

**Tabela 21 Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë**

<b>/000 lekë</b>	
<b>Lloji i taksës</b>	<b>Të ardhura në /000 lekë</b>
Taksa për ndërtimet e reja (përveç sektorit e turizmit, industrisë apo publik)	106,260
Taksa për ndërtimet e reja në sektorin e turizmit, industrisë apo publik	22,000
Taksa për ndërtimet të cilat janë në proces legalizimi	27,564
<b>Totali</b>	<b>155,824</b>

### ***B.1.5 Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme***

Kjo taksë administrohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Taksa me nivelet sipas Ligjit Nr.9632 paguhet para kryerjes së regjistrimit nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agentit tatimor përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Shkodër, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Planifikimi prej 10,500 mije lekë bëhet nga agjenti tatimor, i cili është bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara të numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga vetë ato.

### ***B.1.6 Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura***

Bazuar ne ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, ku pas arkëtimit nga

institucione shtetërore në rolin e agjentëve tatimorë, një pjesë e këtyre të ardhurave transferohen në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore sipas përkatësisë nga burojnë.

Referuar pikës 3, të Nenit 4 të Ligjit 9975, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara, 18% e të ardhurave nga kjo taksë kalon për llogari të Bashkinë Shkodër.

Planifikimi prej 51,000 mije lekë bëhet nga agjenti tatimor, i cili bazohet në të dhënat e regjistruara për nivelet e taksave dhe numrin e automjeteve.

### *B.1.7 Te ardhura nga Taksa e Tabelës*

Bazuar në Ligjin Nr. 9632, dt.30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

**Tabela për qëllime identifikimi**, të cilat nëse janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m<sup>2</sup> nuk taksohen.

**Tabela për qëllime reklamimi**, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike.

**Tabela për qëllime ekspozimi**, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

E ardhura nga kjo taksë për vitin 2016 parashikohet të jetë 16,808 mije lekë, ku 51% parashikohet të realizohet nga taksa e tabelës së identifikimit mbi 2 metra katror, dhe 47% parashikohet të realizohet nga taksa e tabelës për qëllime reklamimi.

Tabela 22 Të ardhura nga taksa e tabelave, sipas llojit dhe zonave

në /000 lekë						
Zonat	Të ardhura nga taksa e tabelës	Tabelë identifikimi, mbi 2 metra katror	Tabela identifikimi jashtë territorit	Tabelë reklamimi, e thjeshtë	Tabelë reklamimi, elektronike	Ekspozime, stenda banderola, etj
Lagje nr. 1	3740	1905	38	1591	177	29
Lagje nr. 2	3577	1822	37	1522	169	27
Lagje nr. 3	3415	1740	35	1453	161	26
Lagje nr. 4	3740	1905	38	1591	177	29
Lagje nr. 5	1462	745	15	622	69	11
Pult	17	9	0	7	1	0
Shosh	17	9	0	7	1	0
Shalë	17	9	0	7	1	0
Postribë	84	44	0	36	4	0
Guri i Zi	84	44	0	36	4	0
Bërdicë	84	44	0	36	4	0
Velipojë	320	148	3	124	14	31
Dajc	84	44	0	36	4	0
Ana e Malit	84	44	0	36	4	0
Rrethina	84	44	0	36	4	0
<b>Total</b>	<b>16,809</b>	<b>8,556</b>	<b>166</b>	<b>7,140</b>	<b>794</b>	<b>153</b>

## II.2.2 Te ardhurat nga Tarifat Vendore

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj;

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.

Paketa fiskale e Bashkisë Shkodër për vitin 2016 e hartuar dhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit dhe të biznesit, pasqyron disa politika të rëndësishme lehtësuese, apo ulje të niveleve nga ajo e llogaritur referuar kostos së shërbimit të ofruar. Disa prej tyre janë:

- Tarifa zero për shërbimin e ndriçimit publik dhe gjelbërimit për zonat rurale
- Tarifa zero për familjet me ndihmë ekonomike.
- Tarifa të reduktuara 50% sipas kriterëve për pensionistë, invalidë, etj.
- Tarifa 0 (zero) për Fermerët që janë regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore

Tabela e mëposhtme pasqyron të ardhurat nga tarifatat për vitin 2016, sipas llojit të shërbimeve që Bashkia do të ofrojë për qytetaret, bizneset apo institucionet:

Tabela 23 Të ardhurat nga tarifatat

		në /000 lekë
II	Të ardhurat nga Tarifatat vendore	199,096
<b>II.1</b>	<b>Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave</b>	124,009
II.1.1	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga familjet	59,844
II.1.2	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga institucione	250
II.1.3	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga biznesi	63,915
<b>II.2</b>	<b>Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik</b>	<b>28,163</b>
II.2.1	Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga familje	18,372
II.2.2	Te ardhura nga tarifë ndricimi nga institucione	75
II.2.3	Të ardhura nga tarifë ndricimi nga biznesi	9,716
<b>II.3</b>	<b>Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin</b>	<b>19,166</b>
II.3.1	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga familjet	9,186
II.3.2	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga institucionet	75
II.3.3	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga biznesi	9,905
<b>II.4</b>	<b>Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë</b>	<b>27,758</b>
II.4.1	Nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	100






II.4.2	Nga tarifa për vulosje veterinerë të bagëtive të therura	280
II.4.3	Nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit	1,375
II.4.4	Nga tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike	2,493
II.4.5	Nga tarifë për dhënie liçensa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	400
II.4.6	Nga tarifatat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	-
II.4.7	Nga tarifatat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ	1,925
II.4.8	Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	19,685
II.4.9	Nga tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille	-
II.4.10	Nga linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	1,500

Për vitin 2016 janë parashikuar 199,096 mijë Lekë, dhe ato përbëjnë rreth 33 % të ardhurave nga burimet e veta vendore.

Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të të ardhurave nga tarifatat janë të ardhurat nga tarifatat për ofrimin e shërbimeve publike, si pastrimi e largimi i mbetjeve (62%), gjelbërimi (10%) dhe ndriçimi publik (14%), të cilat së bashku zënë 86% të totalit të të ardhurave nga tarifatat vendore.



Grafiku 18 Të ardhurat nga tarifatat sipas shërbimeve

Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, dhe paguhet nga familjet apo bizneset të cilët kontribuojnë dhe e përfitojnë këtë shërbim.

Ngarkesa e tarifimit është shpërndarë duke u bazuar në:

- vendndodhjen (zonë urbane apo zonës rurale),
- në llojin e aktivitetit (tregti, shërbim, prodhim, profesion i lirë, fermer, aktivitet transporti, ndërtimi, karburanti, institucion, ojf, etj)
- dhe në statusin e subjektit (familjar, biznes i madh, biznes i vogël, institucion shtetëror, ambulant etj).

Parashikimi i të ardhurave nga biznesi bëhet duke u bazuar në kapacitete, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

**Te ardhura nga Tarifatat e shërbimeve publike për pastrimin e largimin e mbetjeve, gjelbërimin dhe ndriçimin publik**

Tarifatat familjare për pastrim, ndriçim, gjelbërim për të gjithë taksapaguesit do të shlyhen në bazë mujore së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë tek Ndërmarrja Ujësjetillës Kanalizime Sh.A. Shkodër, në cilësinë e agjentit tatimor. Për shërbimin, agjenti do të mbajë përkatësisht 2% të shumës së arkëtuar, dhe do të kalojë çdo muaj në llogari të bashkisë Shkodër pjesën prej 98% të saj.

Tabela 24 Të ardhurat nga tarifa e pastrimit sipas njësive administrative

Zonat	në /000 lekë			
	Te ardhura nga tarifa e pastrimit	Tarifa nga familjet	Tarifa nga institucione	Tarifa nga biznesi
Lagje nr. 1	24,180	10,080	25	14,280
Lagje nr. 2	19,665	9,555	35	10,255
Lagje nr. 3	20,724	8,895	35	11,990
Lagje nr. 4	21,566	9,495	30	12,220
Lagje nr. 5	12,539	7,890	25	4,785
Pult	386	75	10	25
Shosh	119	29	10	25
Shalë	544	76	10	65
Postribë	2,114	855	10	415
Guri i Zi	2,702	1,482	10	690
Bërdicë	2,091	1,365	10	585
Velipojë	7,599	3,000	10	6,255
Dajc	1,745	1,335	10	525
Ana e Malit	1,633	951	10	555
Rrethina	6,401	4,761	10	1,245
<b>Total</b>	<b>124,009</b>	<b>59,844</b>	<b>250</b>	<b>63,915</b>

Tabela 25 Të ardhurat nga tarifa e ndriçimi publik, sipas llojit dhe zonave

Zonat	në /000 lekë			
	Te ardhura nga tarifa për ndriçimin	Tarifa nga familjet	Tarifa nga institucione	Tarifa nga biznesi
Lagje nr. 1	6,554	4,032	12.5	2,509
Lagje nr. 2	5,672	3,822	17.5	1,826
Lagje nr. 3	5,616	3,558	17.5	2,046
Lagje nr. 4	5,958	3,804	15	2,139
Lagje nr. 5	3,959	3,156	12.5	790
Velipojë	406	-	0	406
<b>Total</b>	<b>28,163</b>	<b>18,372</b>	<b>75</b>	<b>9,716</b>

Tabela 26 të ardhurat nga tarifa e Gjellbërimit publik, sipas llojit dhe zonave

Zonat	në /000 lekë			
	Te ardhura nga tarifa për gjelbrimin	Tarifa nga familjet	Tarifa nga institucione	Tarifa nga biznesi
Lagje nr. 1	4,583	2,016	13	2,554
Lagje nr. 2	3,794	1,911	18	1,862
Lagje nr. 3	3,876	1,779	18	2,082
Lagje nr. 4	4,101	1,902	15	2,184
Lagje nr. 5	2,399	1,578	13	808
Velipojë	415	-	-	415
<b>Total</b>	<b>19,166</b>	<b>9,186</b>	<b>75</b>	<b>9,905</b>

#### Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë

##### *Të ardhura nga Tarifa e kontrollit të zhvillimit të territorit*

Nga ky zë parashikohen 100 mijë lekë nga tarifat që mbulojnë kostot administrative të drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të territorit për shërbimin që i ofron subjekteve.

##### *Të ardhura nga Tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura*

Zëri tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura parashikon të ardhura me vlerë 280 mijë lekë nga tarifimi për vendosje vule nga veterineri i autorizuar pas verifikimit të mishit të bagëtive të therura ne vende të aprovuara.

##### *Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit*

Plani i të ardhurave prej 1,375 mijë lekë të parashikuara për vitin 2016 bazohet tek tarifat e miratuara nga Ministria e Financave për subjekte që pajiset me liçensën dhe çertifikatë përkatëse për transport udhëtarësh ose mallrash.

##### *Të ardhura nga Tarifa e parkimit për mjetet e licencuara dhe për vendparkime publike*

Të ardhurat prej 1,311 mijë lekë të planifikuara nga tarifa e parkingut për mjetet që janë pajisur me një liçensë transporti, kur një pjesë e tyre kanë vende të caktuara me sinjalistikë të veçante rrugore si taksi, autobusë etj. zënë 53% të planit nga tarifat e parkingut.

Të ardhurat prej 1,182 Mijë Lekë nga tarifa për vendparkime të dedikuara dhe të rezervuara për një subjekt ose institucion të veçantë zënë 47% të planit nga tarifa e parkingut. Tarifa në këtë rast administrohet bazuar në lejen dhe marrëveshjen kontraktuale ndërmjet subjektit dhe bashkisë.

Tabela 27 Të ardhura nga tarifa e parkimit për mjetet e licënuara, dhe parkingjet e rezervuara

në /000 lekë

Zona	Të ardhura nga Tarifat e parkimit	Tarifë për parkimin Taksi 4+1	Mikrobuz pasagjeri dhe malli	Autobuzë	Kamionë	Vende të rezervuara
Lagje nr. 1	1	577	10.5	152	80	383
Lagje nr. 2	2	471	7	120	64	258
Lagje nr. 3	3	330	7	88	48	191
Lagje nr. 4	4	577	10.5	152	80	383
Lagje nr. 5	5	330	7	88	48	191
Pult	6	16	0	16	0	0
Shosh	7	16	0	16	0	0
Shalë	8	16	0	16	0	0
Postribë	9	22	0	22	0	0
Gui i Zi	10	22	0	22	0	0
Bërdicë	11	22	0	22	0	0
Velipojë	28	0	28	0	0	0
Dajc	22	0	22	0	0	0
Ana e Malit	22	0	22	0	0	0
Rrethina	22	0	22	0	0	0
<b>Total</b>	<b>2,492</b>	<b>42</b>	<b>808</b>	<b>320</b>	<b>140</b>	<b>1,182</b>

**Të ardhura nga Tarifa për dhënie licënsë për tregtimin të naftës bruto e n/produkteve**

Bazuar në VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licëncave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", ky zë parashikon të ardhurat vjetore prej 400 Mije Lekë nga subjekte me aktivitet karburant, që pajisen me licënsë karburanti.

**Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)**

Ky zë parashikon të ardhurat vjetore prej 1,500 Mije Lekë.

**Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri**

Të ardhurat e parashikuara për vitin 2016 me vlerë 1,925 Mije lekë bazohen në nivelin e tarifave të shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj, si dhe në realizimin e të ardhurave vitet e kaluara nga kjo strukturë.

### Të ardhura nga Tarifa për zënien e hapësirave publike

Baza e taksës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m2, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kapaciteteve të hapësirave publike brenda juridiksionit të Bashkisë.

Tabela 28 Të ardhurat nga tarifa e zënies së hapësirave publike, sipas llojit dhe zonave

Zona	në /000 lekë		
	Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike	Zënie e hapësirës publike zona I	Zënie e hapësirës publike zona II
Lagje nr. 1	319	319	
Lagje nr. 2	319	319	
Lagje nr. 3	286	286	
Lagje nr. 4	319	319	
Lagje nr. 5	269	269	
Pult	0		0
Shosh	0		0
Shalë	0		0
Postribë	8		8
Guri i Zi	0		0
Bërdicë	0		0
Velipojë	17,997		17,997
Dajç	42		42
Ana e Malit	42		42
Rrethina	84		84
<b>Total tarife</b>	<b>19,685</b>	<b>1,512</b>	<b>18,173</b>

### II.2.3 Te ardhura nga burime te tjera

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 36, te ardhura nga burime te tjera janë: të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë; të ardhurat nga investimet mbi kapitalet; të ardhurat nga titujt dhe të drejtat e tjera të blera nga bashkia; të ardhurat nga fitimi i ndërmarrjeve publike në pronësi; të ardhurat nga partneritetet privat-publik.


Bashkitë krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, dhuratat, interesat, gjobat, ndihmat ose donacionet. Gjithashtu Bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.

Tabela 29 Te ardhurat nga burime të tjera për vitin 2016 :

		në /000 lekë
<b>A.III</b>	<b>TË ARDHURA TË TJERA</b>	<b>34,746</b>
<b>III.1</b>	<b>Tarifa nga institucione të arsimit, kultures, sportit, etj</b>	<b>15,160</b>
III.1.1	Biblioteka "Marin Barleti"	100
III.1.2	Muzeumet	2,100
III.1.3	Teatri "Migjeni"	600
III.1.4	Qendra Kulturore e fëmijëve	250
III.1.5	Pallati sportit " Qazim Dervishi"	1,000
III.1.6	Qendra Komunitare	-
III.1.7	Nga Marka "ZAHOTEX" nga artizanet e zonës	-
III.1.8	Nga dokumentat për tender ose ankand	-
III.1.9	Nga kopshtet	7,920
III.1.10	Nga çerdhet	3,190
<b>III.2</b>	<b>Të ardhura nga kundravajtjet ad ministrative (Gjobat)</b>	<b>8,850</b>
<b>III.3</b>	<b>Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve në pronësi të Bashkisë</b>	<b>5,520</b>
<b>III.4</b>	<b>Të ardhura nga sekuestime dhe zhëmtime</b>	<b>100</b>
<b>III.5</b>	<b>Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve</b>	<b>1,500</b>
<b>III.6</b>	<b>Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të Trupëzuara</b>	<b>-</b>
<b>III.7</b>	<b>Të ardhura nga privatizimi</b>	<b>-</b>
<b>III.8</b>	<b>Të ardhura nga sponsorizimet</b>	<b>3,616</b>

Te ardhurat nga burime të tjera janë parashikuar në shumën 34,746 mije Lekë, dhe përbëjnë 6% të të ardhurave nga burimet e veta vendore.

Programe	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvensioni	Transferta	Investime	Totali
P3.	0	21,554	0	0	122,486	144,040



Grafiku 20 Buxheti i programit të infrastrukturës rrugore

Tabela 39 Aktivitete e projekte të programit të infrastrukturës rrugore

							/000 lekë
Aktivitete/Projekte	2016						
	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvensioni	Transferta	Investime	Total	
P3.F1.O1.A1 Mirembajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës		3,697				3,697	
P3.F1.O2.A1. Rikonstruksion rruge Degëzim "Isuf Sokoli"					2,648	2,648	
P3.F1.O2.A2. Rikonstruksion rruge "Qazim Llazani";					4,420	4,420	
P3.F1.O2.A3. Rikonstruksion degezim rruge "Draçin"					15,649	15,649	
P3.F1.O2.A4. Rikonstruksion i rruges varrezave "Beltoje"					9,249	9,249	

P3.F1.O2.A5. Rikualifikim Urban blloqe banimi "Qemal Draçini" ; (Pallati me hark)					14,382	14,382
P3.F1.O2.A6 Rikualifikim Urban blloqe banimi "Bardeleve"(Pogej)					7,105	7,105
P3.F1.O2. A7. Rikualifikim Urban blloqe banimi "Tepe-te fusha e druve"					35,548	35,548
P3.F1.O2. A8. Rikualifikim urban i rrugicave ne Qendren Historike, (Rikonstruksion sistemit Ujesjelles kanalizime)					18,259	18,259
P3.F1.O2.A9. Projekt zbatimi i plote Rehabilitimi i sheshit " Gjon Pali"					667	667
P3.F1.O2. A10. Projekt zbatimi i plote Rikualifikim urban i rrugicave ne Qendren Historike.					1,445	1,445
P3.F1.O2. A11 Sistemim sheshe plazhi Velipoje					4370	4370
P3.F1.O2. A12 Mbikqyrje kolaudim rikonstruksion I bllokut te pallateve "Xhabije"					697	697
P3.F1.O3.A1. "Sistemimi i perroit kufiri Muriqan"					8,048	8,048
P3.F1.O3.A2. Mirembajtja e rrugeve rurale.		17,857				17,857
<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>21,554</b>			<b>122,486</b>	<b>144,040</b>

#### P4. Programi i Shërbimeve Publike

##### Pershkrimi i programit

Programi i ofrimit të shërbimeve publike qytetarëve, bizneseve dhe të gjithë komunitetit në të gjithë territorin administrative të bashkisë përbën një nga kolonat kryesore të programit buxhetor.

Ky program përmbledh disa nga funksionet e veta të bashkise, të cilat përmbajnë shërbimet më jetike për komunitetin siç janë: mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane, prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimin me ujë të pijshëm, mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura, mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmytjet në zonat e banuara, ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike, shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike.

Shërbimet publike, për nga rëndësia e tyre, ndikojnë direkt në cilësinë e jetesës së qytetarëve dhe janë një parakusht për zhvillimin social ekonomik për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.

### Politikat e programit

Bashkia e Shkodrës është e angazhuar të garantojë për të gjithë qytetarët e saj shërbime publike cilësore në të gjithë territorin e saj pamvarësisht vendodhjes së tyre.

Permirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve publike, modernizimi i tyre nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë, si dhe përmirësimi i performancës së menaxhimit të shpenzimeve, duke garantuar të gjitha standartet ligjore, do të jetë një politikë kostante në ofrimin e të gjitha shërbimeve publike nga ana e saj.

Bashkia Shkodër do të garantojë rritjen e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, do të sigurojë pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe ta orientojë atë sipas nevojave të qytetarëve.

Tabela 40 Kuadri i programit të shërbimeve sociale

/000 lekë					
Funksioni	Objektivat Specifik	Treguesi/Indikator	Situata aktuale	Situata e synuar	Aktiviteti/Projekti
P4.F1.Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane;	P4.F1.O1:Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane dhe ofrimi i tij në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër	Njesitë administrative që mbulohen me shërbim	Qyteti, Velipoja, Dajçi, Bërdica, Ana Malit, Guri i Zi, rrethinat, Postriba	Qyteti, Velipoja, Dajçi, Bërdica, Ana Malit, Guri i Zi, Rrethinat, Postriba, Shala	P4.F1.O1.A1. Shërbimi i pastrimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane për NjA qytet Shkodër.
		Numri i familjeve dhe numri i bizneseve dhe institucioneve publike që mbulohen me shërbim	Numri i familjeve dhe numri i bizneseve dhe institucioneve publike që mbulohen me shërbim	Numri i familjeve përfituese të shërbimit të pastrimit në të gjithë bashkinë është 34650 (tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë).Ndërsa numri i bizneseve dhe institucioneve	P4.F1.O1.A2.Sherbimi i pastrimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Nj.A. Velipojë (Kontrate në vijim deri me 31 maj 2016)
		Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve	Numri i mbeturinave	Numri i	P4.F1.O1.A3.Sherbimi i pastrimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Nj.A. Velipojë dhe Dajç.

		urbane qytet;  Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane ne Nj.Admin te tjera;  Ton mbetje urbane të grumbulluara dhe të transportuara	familjeve perfituese të sherbimit të Pastrimit në te gjithë bashkinë është 30 130.Ndersa numri i bisnezeve dhe institucione ve perfitues të sherbimit eshte 3 718  Sherbimi i Pastrimit ne 90 % te territorit të qytetit Shkoder kryhet nje here ne dite, ndersa ne akset kryesore qe perben 10 % te territorit sherbimi kryhet dy here ne dite  Ne Velipojë sherbimi kryhet dy herë në javë gjatë vitit ndersa në periudhën e sezonit në zonën turistike një herë në ditë –kjo referuar kontratës ekzistuese.  Në njesitë e tjera sherbimi kryhet një herë në javë	perfitues te sherbimit eshte 3 919  Shërbimi i Pastrimit në 80 % te territorit kryhet një here në ditë, ndersa sherbimi dy here në dite do të rritet në masën 20 % të territorit.  Në Velipojë sherbimi kryhet dy herë ne javë gjate vitit ndërsa ne periudhen e sezonit në zonen turistike do të kryhet dy herë në ditë.  Në njesitë e tjera shërbimi do të kryhet dy herë ne dite, ndërsa në Nj.A e Shalës shërbimi do të kryhet një herë në javë në periudhën e sezonit turistik;  Sasia e mbetjeve të grumbulluara në të gjitha Nj.A e Bashkisë Shkodër dhe të transportuara në landfill do të jetë (tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) 38760 ton.	P4.F1.O1.A4.Shërbi mi i pastrimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Nj.A. Rrethina, Postrisë dhe Shalë.  P4.F1.O1.A5.Shërbi mi i pastrimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Nj.A. Guri i Zi, Bërdicë dhe Ana e Malit.  P4.F1.O1.A6 Sherbimi i largimit dhe depozitimit të mbetjeve ndërtimore.  P4.F1.O1.A7 Blerje kontinierë për shërbimin e pastrimit
--	--	--	---	---	--



			<p>Sasia e mbetjeve të grumbulluara në të gjitha Nj.A e Bashkisë Shkodër dhe të transportuara në landfill është 24700 (njëzet e katër mijë e shtatëqind mijë) ton.</p>		
<p>P4.F2. Parqet, lulishtet dhe hapësirat gjelbra publike;</p>	<p>P4.F2.O1:Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes së lulishteve në NjA Shkodër</p>	<p>Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta - Lulishte Drure dekorativ Sipërfaqe ujore Stola</p>	<p>Shërbimi i gjelbërimit aktualisht realizohet në dy njesi administrative.</p> <p>Ne qytetin e Shkodres ky shërbim kryhet me të trete.</p> <p>Ne Nj.A. Velipojë është mirëmbajtur lulishtja qendrore në plazh vetëm për tre muaj.</p>	<p>Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta:</p> <p>- Nj. Administrative Shkodër : sipërfaqe gjithsejt 72600 m2, drurë dekorativë 5118, mbjellje drurësh të rinj 174 copë, mirëmbajtje stolash 319 copë, sipërfaqe ujore 650 m2.</p> <p>- Nj.A Velipojë sipërfaqe gjithsejt 15175 m2, drurë dekorative 76, stola 69, sip. ujore 491 m2</p>	<p>P4.F2.O1.A1: Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta</p>
<p>P4.F3. Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm</p>	<p>P4.F3.O1: Furnizimi me ujë të pijshëm i njesive administrative të Bashkisë Shkodër</p>	<p>Furnizimi me ujë të pijshëm sipas treguesve të monitorimit miratuar pranë DPUK</p>	<p>Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm për territore të pjeshme në Nj.A. mbulohet nga</p>	<p>Përmirësimi i treguesve të monitorimit të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm të popullatës.</p> <p>Realizimi i</p>	<p>P4.F3.O1:A1: Furnizimi me ujë i qytetit dhe njesive administrative</p>

			<p>Nd.Ujesjellës Fshat.</p> <p>Bashkia Shkoder ka trashëguar detyrimet për energji elektrike për furnizimin me ujë të pijshëm dhe detyrime të tjera për: Nj.A. Ana a Malit-ujësjellësi Obot i Ri, në Nj.A Guri i Zi dhe Nj.A Velipojë-furnizimin me ujë i shatërvanit në plazh.</p> <p>Aktualisht Bashkia Shkodër është në procesin e bashkimit të ndërmarrjeve për menaxhimin e SHA-ve ujësjellës kanalizime.</p>	<p>pagesës së detyrimeve të Njësive Administrative për energjinë e shpenzuar për furnizimin me ujë nga Sh.A UK Fshat, dhe nga ish Komunat.</p> <p>Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm realizohet përmes një Shoqërie aksionere të vetme publike në varësinë e Bashkisë së Shkodrës.</p>	
		Sasia e prodhimit të ujit në Bashkinë Qendër l/sek	Sasia e prodhimit të ujit mesatarisht 750 l/sek	Sasia e prodhimit të ujit mesatarisht 750 l/sek	P4.F3.O1:A2 Mbështetja për mbulimin e shpenzimeve për energjinë elektrike SH.A Ujësjetllës qytet.
		% e banoreve të furnizuar me uje të pijshëm në Bashkinë Qendër	87% banoreve të furnizuar me uje të pijshëm	87% banoreve të furnizuar me uje të pijshëm	

<p>P4.F4:Mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura;</p>	<p>P4.F4.O1: Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në të gjithë zonat urbane të Nj.A të bashkisë</p>	<p>Numri i abonentëve të lidhur me rrjetin KUZ dhe funksionimi normal i sistemit</p> <p>Trajtimi i ujërave të ndotura</p>	<p>Rreth 70 % e numrit të përgjithshëm të banorëve të qytetit Shkodër janë të lidhur me rrjetin KUZ.</p> <p>Kryesisht janë të pa lidhur me rrjetin KUZ zonat periferike të qytetit, të cilat funksionojnë me gropa septike.</p> <p>Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Velipojë është në fazën e fundit të punimeve dhe pritet të funksionojë për largimin e ujërave të ndotura për zonën e Pulaj dhe Reçit (zona bregdetare).</p> <p>Sistemi i ujërave të ndotura të qytetit nuk ka impiant të trajtimit me përjashtim të zonës së Shirokes. Imjanti i Trajtimit të Ujërave të përdorura</p>	<p>Përmirësimi i funksionimit normal të sistemit të ujërave të përdorura për qytetin dhe njësitë administrative që kanë rrjete kanalizimesh.</p> <p>Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Velipojë do të jetë funksional për rreth 15 000 banorë për vitin 2016</p> <p>Përmirësimi i funksionimit normal të impiantit për zonën e Shirokës dhe vënia në funksion e impiantit të pastrimit në Velipojë.</p>	<p>P4. F4. O1. A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të zeza</p>
---	---	---	--	---	--

			Shirokë bën trajtimin e këtyre ujërave dhe i shkarkon në liqen konform normativave ligjore.  Impianti i Trajtimit të Ujërave të Përdorura për Velipojën është në fazën perfundimtare të punimeve.		
P4.F5: Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara;	P4.F5.O1. Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut në të gjithë zonat urbane të Nj.A të bashkisë.	Sistemi i kanalizimeve të ujërave të bardha	Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha i qytetit të Shkodrës (për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut) funksionon i ndarë nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza. Sistemi kryesor i drenazimit mbulon rreth 70% të zonave formale të qytetit, ndërsa në zonat informale zë një mbulim shumë më të ulët.	Përmirësimi i funksionimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha (shiut) në qytet dhe grykëderdhjeve kryesore për të evituar problematikat e ndryshme..	P4.F5.O1. A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të shiut
P4.F6: Ndërtimi, rehabilitimi dhe	P4.F6.O1: Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes së	Hartimi i një plani të integruar për vendosjen dhe	Nuk ka plan të integruar për administrimi	Hartimi i një plani të integruar për funksionimin e	P4.F6.O1.A1: Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të

mirëmbajtja e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit;	varrezave publike	administrimin e varrezave publike	n e varrezave publike	varrezave publike	dëshmorëve.
		Mirembajtja e varrezave publike në Bashkinë Qendër.	Mirembajtja e varrezave publike kryhet nga operatorë ekonomik. Situata e mirëmbajtjes së varrezave publike në Bashkinë Qendër është e përmirësuar .	Vazhdimi i mirëmbajtjes së varrezave publike me të tretë. Përmirësimi i shërbimit dhe i mjediseve në varreza publike nëpërmjet shmangies së rrugës lidhëse të fshatit Golem që kalon përmes varrezave dhe ndërtimit të murit rrethues.	
		Mirembajtja e varrezave publike në NJ.A	Varrezat publike në Njësitë Administrative nuk administrohen njëllë dhe sipas të njëjtit standart. Ka shumë aktorë që kryejnë këtë shërbim edhe pse me vullnetin e mirë por jo konform kuadrit ligjor.	Ofrimi i shërbimit nga punonjësit e shërbimeve publike pranë Njësive Administrative.	
P4.F7: Shërbimi i dekorit publik;	P4.F7.O1: Përmirësimi i peisazhit dhe dekorit urban në të gjithë territorin e Bashkisë Shkoder	Dekorimi i shesheve, rrugëve dhe ndërtesave publike kryesore urbane.	Në përgjithësi egziston një dekor urban për rrugët dhe sheshet kryesore të qytetit. Për Nj.A e tjera dekorimi urban është në gjendje jo të	Krijimi i dekorit në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore në zonat urbane për të gjitha Nj.A.	P4.F7.O1.A1 Dekorimi i mjediseve publike


			mire ose nuk ekziston.		
P4.F8: Ndrçimi i mjediseve publike	P4.F8.O1:Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit	Qytet:			
		Ndrçimi i rrugëve dhe shesheve urbane.	Sipërfaqja totale e rrugëve dhe e shesheve arrin afërsisht në 1,200,000 m2, nga të cilat 1,080,000 m2 janë të ndriçuara	Ndrçimi i 1,080,000 m2 Rrugë dhe sheshe	P4.F8.O1.A1: Mirëmbajtja e Sistemit të Ndrçimit Publik të qytetit dhe njësie administrative
		Ndrçimi i lulishteve	Sipërfaqet e lulishteve dhe brezit të gjelbërt të ndriçuara janë 34,581 m2.	Ndrçimi i 34581 m2 lulishte.	
		Periudha mesatare e ndriçimit në ditë.	Ndrçimi realizohet në një mesatare vjetore 10.5 orë në ditë gjatë gjithë vitit.	Realizimi i ofrimit të shërbimit të ndriçimit me një mesatare prej 10.5 ore ne dite.	
		Ndërtim dhe Rehabilitim i rrjetit të ndriçimit publik.		Rehabilitimi i 3400 ml ndriçim publik dhe ndërtim i ndriçimit publik në 2500 ml rrugë dytësore	
Njesite Administrative:					



		Ofrimi i shërbimit të ndriçimit në Njesitë Administrative të Bashkisë.	Ofrohet shërbimi i ndriçimit publik pjesërisht në 6 prej Nj.A (Rrethina, Berdice, Guri i Zi, Postribë, Dajç, Velipojë)	Ofrimi i shërbimit të ndriçimit në Nj.A dhe rehabilitimi i 8 linjave ekzistuese.	
P4.F9: Shërbime publike vendore në NJ.A.	P4.F9.O1:Përmbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera për objektet dhe hapësirat publike.			Ofrimi i shërmeve të rojës, pastrimit të objekteve, mirëmbajtjes së objekteve dhe të tjera sipas nevojës në Njësi administrative.	P4.F8.O1.A1:Shpenzime per pagat dhe sigurime shoqerore per punonjesit e Shërbimeve Publike

### Buxhetimi i Programit të Shërbimeve Publike

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Programit të Shërbimeve Publike planifikohet buxheti me vlerë totale 313,801 mijë lekë, ndër të cilat më kryesoret janë 81% shpenzimet operative, 9% shpenzimet për paga dhe sigurime, 8% investime.



Grafiku 21 Buxhetimi i programit të shërbimeve publike

Tabela 41 Buxhetimi programit të shërbimeve publike

/000 lekë						
Programe	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencioni	Transferta	Investime	Totali
P4.	28,238	253,496	5,000	360	26,707	313,801

Tabela 42 Aktivitete e projekte të programit të shërbimeve publike

/000 lekë						
Aktivitete/Projekte	2016					
	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencione	Transferta	Investime	Total
P4.F1.O1.A1. Shërbimi i pastrimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane për NjA qytet Shkodër.		112,086				112,086
P4.F1.O1.A2.Shërbimi i pastrimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane për NjA Velipojë (Kontrate në vijim deri me 31 maj 2016)		7,500				7,500
P4.F1.O1.A3.Shërbimi i pastrimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane për NjA Velipojë dhe Dajç		18,204				18,204
P4.F1.O1.A4.Shërbimi i pastrimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane për NjA Rrethina, Postribë dhe Shalë.		9,479				9,479
P4.F1.O1.A5.Shërbimi i pastrimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane për NjA Guri i Zi, Bërdice dhe Ana e Malit.		1,838				1,838
P4.F1.O1.A6 Shërbimi i largimit dhe depozitimit të mbetjeve ndërtimore.		600				600
P4.F1.O1.A7 Blerje kontëniere për shërbimin e pastrimit					16,950	16,950
P4.F2.O1.A1: Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta		35,000				35,000
P4.F3.O1:A1: Furnizimi me ujë i qytetit dhe njësisve administrative.		1,040				1,040
P4.F3.O1:A2 Mbështetja për mbulimin e shpenzimeve për energjinë elektrike SH.A Ujësjellës qytet.			5,000			5,000



P4. F4. O1. A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të zeza						0
P4.F5.O1. A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të shiut						0
P4.F6.O1.A1: Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve.		8,090			3,207	11,297
P4.F7.O1.A1 Dekorimi i mjediseve publike		1,121				1,121
P4.F8.O1.A1: Mirëmbajtja e Sistemit të Ndrçimit Publik të qytetit dhe njësive administrative		58,538			6,550	65,088
P4.F8.O1.A2:Shpenzime për pagat dhe sigurime shoqërore për punonjësit e Shërbimeve Publike	28,238			360		28,598
<b>Total</b>	<b>28,238</b>	<b>253,496</b>	<b>5,000</b>	<b>360</b>	<b>26,707</b>	<b>313,801</b>

## P5. Transporti publik dhe lëvizshmëria

### Përshkrimi i programit

Mobiliteti ose lëvizshmëria ka të bëjë me përdorimin më të mirë të infrastrukturës rrugore, duke i dhënë përparësi mënyrave aktive dhe të qëndrueshme të lëvizjes (ecje, pedalim, transport publik, etj.). Duke pasur parasysh traditën e pedalimit me biçikletë të qytetit të Shkodrës, por edhe gjithë fushës së Nënshkodrës dhe Mbishkodrës, ruajtja dhe promovimi i mëtejshëm merr një kuptim më të plotë në rastin e Bashkisë së Shkodrës.

Me rëndësi rrënjësore është konsolidimi i linjave të transportit publik që lidhin zonat bujqësore, malore dhe bregdetare me qendrën urbane.

### Përshkrimi i politikave

Për të favorizuar përdorimin e rrugës nga këmbësorët dhe biçikletat, si dhe për të promovuar një kulturë të re për përdorimin e mjeteve të transportit publik. ne do të përcaktojmë zonat me shpejtësi të limituar 30 km /orë.

Bashkia e Shkodrës do të përgatisë një plan të qëndrueshëm mobiliteti, i cili: Krijon hapësira më miqësore dhe më të sigurta për kalimtarët dhe pedalesit në zonën urbane; shton linjat urbane, suburbane dhe rajonale; krijon jo vetëm rrugë pedonale, por zona pedonale; rishikon planin e parkingjeve në të gjithë qytetin.

Shërbimi i transportit publik do të mbulojë të gjithë zonën urbane. Përmirësimi dhe vënia në efikasitet të transportit publik rrethqytetës është një nga prioritetet tona në mbështetje të një skeme policentrike të zhvillimit të të gjithë territorit administrativ të bashkisë.


Tabela 43 Kuadri i programit të transportit publik dhe lëvizshmërisë

					/000 lekë
Funksioni	Objektivat Specifik	Treguesi/Indikator	Situata aktuale	Situata e synuar	Ativiteti/Projekti
P5.F1. Transporti publik vendor	P5.F1.O1. Permirësimi i lëvizshmërisë urbane për një cilësi jetese më të mirë dhe ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor për qytetarët e Bashkisë Shkodër.	Rritja e sigurisë në rrugë për këmbësorët dhe pedalesit.	Ekziston sinjalistika vertikale dhe horizontale, në disa zona janë marrë masa për parandalimin e rreziqeve nëpërmjet ndërtimit të bumpeve në afërsi të shkollave dhe nyjeve me qarkullim të lartë këmbësorësh.	Mirëmbajtja dhe permirësimi i sinjalistikës horizontale nëpërmjet vijëzimit si dhe permirësimi i sinjalistikës vertikale. Krijimi i linjave të dedikuara për pedalesit.	P5.F1.O1.A1: Mobiliteti dhe shërbimi i transportit urban
		Ofrimi i shërbimit të transportit publik urban.	Kemi dy linja të transportit publik qytetas të udhëtareve Fermentim-Bahçallëk dhe Shkodër-Zogaj.	Linja e transportit të udhëtareve qytetas Fermentim-Bahçallëk me 50 cikle, me frekuencë 15 min paradite dhe 25 min pasdite. Linja e transportit të udhëtareve qytetas Shkodër-Zogaj katër herë në ditë.	
		Mbeshtetja e kategorive të veçanta në nevojë për mbulimin e shpenzimeve të transportit publik.	Bashkia Shkodër ka mbështetur kategori të veçanta sociale për transportin qytetas të udhëtareve.	Mbeshtetja e nxënësve dhe studentëve për subvencionimin e çmimit të biletës.	

### Buxhetimi i Programit të Transportit publik dhe lëvizshmëria

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Programit **transportit publik dhe lëvizshmërisë** planifikohet buxheti me vlerë totale 14,376 mijë lekë, ndër të cilat më kryesoret janë 49% subvencion transporti urban për nxënësit dhe studentët, 27% shpenzimet operative dhe 24% investime.

### Transporti publik dhe lëvizshmëria



Grafiku 22 Buxheti i programit të transportit publik

Tabela 44 Buxheti i programit të transportit publik dhe lëvizshmërisë

/000 lekë						
Programe	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvensioni	Transferta	Investime	Totali
P.5	0	3,876	7,000	0	3,500	14,376

Tabela 45 Aktivitetet e projektet e programit të transportit publik dhe lëvizshmërisë

/000 lekë						
Aktivitete/Projekte	Viti 2016					
	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencion	Transferta	Investime	Total
P5.F1.O1.A1. Mobiliteti dhe Shërbimi i Transportit Urban		3,876.00	7,000.00		3,500.00	14,376.00
<b>Totali</b>		<b>3,876.00</b>	<b>7,000.00</b>		<b>3,500.00</b>	<b>14,376.00</b>

## P6. Programi i Zhvillimit Ekonomik lokal dhe i Turizmit

### Pershkrimi i programit zhvillimit ekonomik

Bazuar në përvojat më të mira të nismave të financuara nga Bashkimi Evropian, për zbatimin e politikave zhvillimore në Bashkinë e Shkodrës, ndërmjet të tjerave, do të përdorim në mënyrë të kombinuar dy mjete të sprovuara për efikasitetin e tyre:

- Zhvillimin Lokal të Udhëhequr nga Komuniteti
- Investimet e Integruara Territoriale.

Synojmë që zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti të mobilizojë dhe të përfshijë komunitetet dhe organizatat lokale për të kontribuar në arritjen e qëllimeve për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke nxitur kohezionin territorial.

### Pershkrimi i politikave të zhvillimit ekonomik

Tre janë politikat në të cilat Bashkia do të fokusojë përpjekjet e saj:

Mbështetje për përmirësimin e kushteve për fillimin dhe zhvillimin e biznesit. Synimi është që strukturat e ngritura – administrata e bashkisë, apo agjenci/qendra biznesi të mbështetura nga Bashkia – të jenë të specializuara dhe të ofrojnë shërbime të cilësisë së lartë (dhënie informacioni ligjor, fiskal, orientim bazuar në studimet zhvillimore të Bashkisë).

Në Bashkinë e Shkodrës është në përfundim zbatimi i programit të kompjuterizuar për regjistrimin dhe administrimin e biznesit. Ne do vazhdojmë me shtrirjen e tij në gjithë juridiksionin e Bashkisë së re dhe vënien në funksion të biznesit të shërbimit on-line për deklarimin dhe pagesën e taksave, duke synuar përfshirjen e këtij projekti në realizimin e projektit madhor të një qeverisjeje elektronike;

Thjeshtim dhe reduktim të procedurave administrative:

- Nëpërmjet politikave fiskale dhe shpërndarjes së drejtë të ngarkesës tatimore;
- Uljen deri në 30% të taksës së pronës (ndërtesës, truallit dhe tokës bujqësore);
- Mundësimin e shlyerjes së detyrimit me këste;
- Përcaktimi i nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit;
- Përcaktimi i nivelit të tarifës sipas vendndodhjes gjeografike, duke lehtësuar bizneset në zonat më pak të zhvilluara;

Rritja e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve. Synimi është që ndërmarrjet në territorin e Bashkisë të bëhen më konkurruese në tregjet vendore dhe ndërkombëtare nëpërmjet inovacionit, zhvillimit dhe përkrahjes së markave rajonale, zhvillimit të zinxhirëve të vlerës dhe përmirësimit të sistemeve të shpërndarjes;

Zhvillimi i fuqisë punëtore të kualifikuar sipas kërkesave aktuale dhe të ardhshme të tregut përmes arsimit, trajnimit dhe ritrajnimit. Synimi është që disponueshmëria e punësimit të rritet. Përmes përmirësimit të trajnimit të ofruar (qendrat të punësimit, programet e reja mësimore në arsimin profesional) fuqia punëtore do të jetë më konkurruese dhe e trajnuar më mirë.

Turizmi, si aktivitet ndërsektoral, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike dhe ka një ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lirë dhe me udhëtimet e biznesit. Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban.

### **Pershkrimi i politikave te programit te turizmit**

Dy politika kryesore në të cilat do të fokusohet Bashkia do të jenë:

Synojmë që industria e turizmit të kthehet në burimin kryesor të rritjes ekonomike të Bashkisë sonë. Nëpërmjet promovimit aktiv të politikave, turizmi do të kthehet në një mjet për integrimin e territoreve më pak të zhvilluara dhe për përmirësimin e ruajtjen e zonave të trashëgimisë.

Synimi kryesor do të jetë nxitja e zhvillimit të ekuilibruar dhe endogjen të turizmit të zonës dhe rritja e vlerës së territorit që do të mbulojë Bashkia e Shkodrës si destinacion turistik, duke forcuar identitetin e saj unik kulturor, social, mjedisor e ekonomik dhe burimet njerëzore.

Tabela 46 Kuadri i programit të zhvillimit ekonomik lokal dhe turizmit

Funksioni	Objektivat Specifik	Treguesi/Indikator ori	Situata aktuale	Situata e synuar	Aktiviteti/ Projekti
P6.F1.Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal;	P6.F1.O1.Mbështetja për përmirësimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve ekonomike zhvillimore lokale.	Ngritja e bordit të zhvillimit lokal	Nuk ka bord të zhvillimit Ekonomik	Ngritja e Bordit të Zhvillimit Ekonomik	P6.F1.O1.A1. Hartimi i Planit të Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë së Shkodrës (krijimi i një bordi lokal të zhvillimit ekonomik me perfaqësues të sektoreve bazë dhe hartimi i një plani vjetor)
		Hartimi i dokumentave strategjik për zhvillimin e biznesit	Ka një strategji të zhvillimit ekonomik të bashkisë qendër 2005-2015.	Një strategji dhe dy studime	P6.F1.O1.A2. Studim për klasterat e biznesit që operojnë në Bashkinë e Shkodrës.
			Ka strategji lokale të disa njësive administrativ e. Nuk ka një strategji të integruar për territorin e ri të Bashkisë Shkodër		P6.F1.O1.A3. Hartimi i studimit për marketingun dhe brandimin për bizneset dhe sektorët që mund të eksportojnë jashtë Shkodrës
P6.F2.Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë;	P6.F2.O1. Sistemimi dhe ngritja e tregjeve industriale të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Bashkisë Shkodër	Hartimi i studimit të fizibilitetit për tregjet	Nuk ka një studim specifik për tregjet	Hartimi i studimit të fizibilitetit për ngritjen e tregjeve	P6.F2.O1.A1.Studimi i ngritjes së tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakice të produkteve industriale.
P6.F3.Mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike;	P6.F3.O1. Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar	Numri i panareve të organizuara në Bashkinë Shkodër	Një panair	Dy panaire	P6.F3.O1.A1. Organizimi i një panairi pune në bashkëpunim me universitetin dhe shkollat profesionale.
					P6.F3.O1.A2. Panairi i produkteve të bizneseve prodhuese në



					Bashkinë e Shkodrës
P6.F4.Publikim i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik etj.	P6.F4.O1. Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale per nxitjen e investimeve vendase dhe te huaja	Numri i materialeve informative të botuara për zhvillimin ekonomik	Ka botime të cilat kanë nevojë të përditsohen	Tre publikime: 2 botime dhe informacion digjital i përditësuar në faqen web të Bashkisë së Shkodrës	P6.F4.O1.A1. Hartimi dhe botimi i profil të Bashkisë
					P6.F4.O1.A2. Ristrukturimi dhe pasurimi i faqes web të Bashkisë për sektorin e zhvillimit ekonomik
					P6.F4.O1.A3. Botim i broshurës informative për tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja në Bashkinë Shkodër
P6.F5.Dhënie e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.	P6.F5.O1. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nepërmjet incentivave financiare, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre	Numri i iniciativave të mbështetura dhe numri i bizneseve përfituese	Një iniciativë dhe 58 biznese përfituese	Një iniciativë dhe 120 biznese përfituese	P6.F5.O1.A1. Zgjerimi i zonës së përmirësimit të biznesit në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nentori.
P6.F6.Zhvillimi i Turizmit	P6.F6.O1 Promovim i territorit të Bashkisë nëpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promocionale-informative.	Prodhimi i materialeve promocionale-informative për territorin e ri të Bashkisë së Shkodrës.	Mungojnë botimet e materialeve të promocionit dhe informacionit të përditësuar për territorin e ri të Bashkisë.	Prodhimi i tre botimeve: guida turistike 2000 copë, hartë turistike 2000 dhe kalendar i ngjarjeve kulturore 1000 copë. Publikimi i një portali web për turizmin	P6.F6.O1.A1. Krijimi i faqes web për turizmin e rajonit të Shkodrës
					P6.F6.O1.A2. Përgatitja dhe publikimi i guidës turistike të Bashkisë së Shkodrës.
					P6.F6.O1.A3. Publikimi i hartës turistike së territorit të Bashkisë së Shkodrës.
					P6.F6.O1.A4. Publikimi i kalendarit vjetor

					të aktiviteteve kulturore të Bashkisë.
P6.F6.O2 Organizim dhe pjesëmarrje në panaire lokale, kombëtare dhe ndërkombetare	Organizimi panaireve të atraksioneve dhe bizneseve turistike të rajonit në Bashkinë e Shkodrës	Nuk ka një organizim periodik të panireve të turizmit në Shkodër.	Organizimi i një panairi.	P6.F6.O2.A1. Panairi i atraksioneve dhe bizneseve turistike i integruar me produktet artizanale, bujqësore dhe ushqimore.	
	Pjesëmarrje në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare	Bashkia Shkodër në vitet e kaluara ka marrë pjesë në disa panaire kombëtare dhe ndërkombëtare	Pjesëmarrje në dy panaire kombëtare dhe ndërkombëtare	P6.F6.O2.A2. Pjesëmarrje në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës	
P6.F6.O3 Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë së Shkodrës.	Organizim i aktiviteteve që i shërbejnë gjallërimit të jetës social-kulturore dhe sportive të territorit të Bashkisë së Shkodër	Në Bashkinë Shkodër organizohen 18 aktivitete social-kulturore dhe sportive	Organizimi i 21 aktiviteteve social kulturore dhe sportive	P6.F6.O3.A1. Festa e Liqenit	
				P6.F6.O3.A2. Dita e turizmit	
				P6.F6.O3.A3. Hapja e sezonit turistik Velipojë	
				P6.F6.O3.A4. Feste e Thethit	
				P6.F6.O3.A5. Dita e biçikletave	
				P6.F6.O3.A6. Triathlon	
P6.F6.O4 Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara për përmirësimin e shërbimit ndaj vizitorit.	Ngritja, paisja dhe vënia në funksionim e drejtorisë së turizmit.	Aktualisht ka një sektor të promovimit në Bashkinë Shkodër me 2 nëpunës.	Krijimi i Drejtorisë së Turizmit me 8 nëpunës.	P6.F6.O4:A1. Krijimi i drejtorisë së turizmit	
	Ngritja dhe vënia në funksionim e rrjetit të zyrave të informacionit turistik.	Në territorin aktual të Bashkisë së Shkodrës nuk ekzistojnë zyra të informacionit turistik.	Ngritja e tre Zyrave të Informacionit Turistik në tre Njësi administrative të territorit të Bashkisë së Shkodrës.	P6.F6.O4.A2. Ngritja dhe paisja e Zyrës së Informacionit Turistik në territorin administrativ të qytetit Shkodër	





					P6.F6.O4:A3. Ngritja dhe paisja e Zyrës së Informacionit Turistik në njësinë administrative Velipojë
					P6.F6.O4:A4. Ngritja dhe paisja e Zyrës së Informacionit Turistik në Theth.
P6.F6.O5 Zhvillim i produkteve të reja dhe përmirësimi i infrastrukturës së produkteve turistike ekzistuese.	Përmirësimi i infrastrukturës turistike	Ka mangësi për sa i përket sinjalistikës informative turistike për objektet e interesit.	Përmirësimi i sinjalistikës nëpërmjet vendosjes së 40 tabelave treguese - sinjalizuese.	P6.F6.O5.A1. Vendosja e tabelave informative turistike për objekte të interesit për vizitorët	
				P6.F6.O5.A2. Identifikimi dhe paisja me sinjalistikën e përshtatshme të shtigjeve për ecje në malin e Taraboshit.	
				P6.F6.O5.A3. Identifikimi dhe paisja me sinjalistikën e përshtatshme të shtigjeve për ecje në Theth.	
				P6.F6.O5.A4 Krijimi i 7 shtigjeve të reja për bicikleta në lumin Buna, Velipojë, Baks dhe Rrjoll	
Konceptimi i produkteve të reja turistike.	Krahasimisht me potencialet që ofron zona ka mangësi në produktet turistike të gatshme për tregun turistik.	Pasurimi i ofertës turistike nëpërmjet konceptimit të 2 produkteve të reja turistike.	P6.F6.O5.A5. Hartimi i paketave të integruara me produkte të ndryshme turistike		
			P6.F6.O5.A6. Integrimi i marketingut të produkteve		



					bujqesore ne oferten e turizmit rural ne Theth
					P6.F6.O5.A7. Organizimi i ofertës per turizmin e konferencave në bashkëpunim me bizneset dhe universitetin.



## Buxhetimi i programit të zhvillimit ekonomik

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Programit të zhvillimit ekonomik planifikohet buxheti me vlerë totale 7,120 mijë lekë.

Tabela 47 Buxhetimi i programit të zhvillimit ekonomik lokal dhe turizmit

/000 lekë						
Programe	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvensioni	Transferta	Investime	Totali
P.6	0	5,520	0	1,600	0	7,120

Tabela 48 Aktivitete e projekte të programit të zhvillimit ekonomik lokal dhe turizmit

/000 lekë						
Aktivitete/Projekte	Viti 2016					
	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencion	Transferte	Investime	Total
P6.F1.O1.A1. Hartimi i Planit të Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë së Shkodrës (krijimi i një bordi lokal të zhvillimit ekonomik me perfaqësues të sektoreve bazë dhe hartimi i një plani vjetor )						0
P6.F1.O1.A2. Studim per klusterat e biznesit që operojnë në Bashkinë e Shkodrës.						0
P6.F1.O1.A3. Hartimi i studimit për marketingun dhe brandimin për bizneset dhe sektorët që mund të eksportojnë jashtë Shkodrës		150				150
P6.F2.O1.A1.Studimi i ngritjes se tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakice te produkteve industriale.						0
P6.F3.O1.A1. Organizimi i një panairi pune në bashkëpunim me universitetin dhe shkollat profesionale.		100				100
P6.F3.O1.A2. Panairi i produkteve te bizneseve prodhuese në Bashkinë e Shkodrës		100				100
P6.F4.O1.A1. Hartimi dhe botimi i profilit të Bashkisë		200				200
P6.F4.O1.A2. Ristrukturimi dhe pasurimi i faqes web të Bashkisë për sektorin e zhvillimit ekonomik						0

P6.F4.O1.A3. Botim i broshurës informative për tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja në Bashkinë Shkodër		200				200
P6.F5.O1.A1. Zgjerimi i zonës së përmirësimit të biznesit në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nentori.				1,600		<b>1,600</b>
P6.F6.O1.A1. Krijimi i faqes web për turizmin e rajonit të Shkodrës		150				150
P6.F6.O1.A2. Përgatitja dhe publikimi i guidës turistike të Bashkisë së Shkodrës.		500				500
P6.F6.O1.A3. Publikimi i hartës turistike së territorit të Bashkisë së Shkodrës.		300				300
P6.F6.O1.A4. Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë.		150				150
P6.F6.O2.A1. Panairi i atraksioneve dhe bizneseve turistike i integruar me produktet artizanale, bujqësore dhe ushqimore.		250				250
P6.F6.O2.A2. Pjesëmarrje në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës		250				250
P6.F6.O3.A1. Festa e Liqenit		300				300
P6.F6.O3.A2. Dita e turizmit		250				250
P6.F6.O3.A3. Hapja e sezonit turistik Velipojë		350				350
P6.F6.O3.A4. Feste e Thethit		350				350
P6.F6.O3.A5. Dita e biçikletave		150				150
P6:F6:O3:A6. Triathlon		150				150
P6.F6.O4.A1. Krijimi i drejtorisë së turizmit						0
P6.F6.O4.A2. Ngritja dhe paisja e Zyrës së Informacionit Turistik në territorin administrativ të qytetit Shkodër		250				250
P6.F6.O4.A3. Ngritja dhe paisja e Zyrës së Informacionit Turistik në njësinë administrative Velipojë		250				250



P6.F6.O4:A4. Ngritja dhe paisja e Zyrës së Informacionit Turistik në Theth.		250				250
P6.F6.O5.A1. Vendosja e tabelave informative turistike për objekte të interesit për vizitorët		150				150
P6.F6.O5.A2. Identifikimi dhe paisja me sinjalistikën e përshtatshme të shtigjeve për ecje në malin e Taraboshit.		200				200
P6.F6.O5.A3. Identifikimi dhe paisja me sinjalistikën e përshtatshme të shtigjeve për ecje në Theth.		400				400
P6.F6.O5.A4 Krijimi i 7 shtigjeve të reja për bicikleta në lumin Buna, Velipojë, Baks dhe Rrjoll						0
P6.F6.O5.A5. Hartimi i paketave të integruara me produkte të ndryshme turistike		120				120
P6.F6.O5.A6. Integrimi i marketingut të produkteve bujqesore në oferten e turizmit rural në Theth		0				0
P6.F6.O5.A7. Organizimi i ofertës për turizmin e konferencave në bashkëpunim me bizneset dhe universitetin.		0				0
<b>Total</b>		<b>5,520</b>		<b>1,600</b>		<b>7,120</b>

## P7. Programi i Bujqësisë dhe zhvillimit rural

### Pershkrimi i programit

Zhvillimi i Zonave Rurale bazohet në politikën që sjellë popullsinë dhe ekonominë në një barazpeshë. Synimi afatgjatë kryesor do të jetë racionalizimi i modelit të fshatrave përsa i përket përdorimit të tokës, infrastrukturës rrugore e nëntokësore dhe shërbimeve komunale në lidhje me burimet ekonomike të shfrytëzueshme.

Rreth 43% të popullsisë së Bashkisë së Shkodrës jeton në zonat rurale që mbulojnë rreth 98% të territorit. Zhvillimi rural është një fushë shumë e rëndësishme e zhvillimit. Bujqësia dhe pylltaria janë sektorët kyç për përdorimin e tokës dhe menaxhimin e burimeve natyrore në zonat tona rurale, si dhe një platformë për diversifikimin ekonomik në komunitetet rurale.

### Pershkrimi i politikave

Ne kemi si prioritet që për këto zona të:

Mbrojmë tokat bujqësore nga ndërtimet kaotike, duke nxitur dhe duke vënë rregulla të qarta për përqendrimin e ndërtimeve drejt qendrave përkatëse për secilën zonë. Në këtë mënyrë synojmë të ofrojmë shërbime cilësore me një kosto minimale;

Rehabilitojmë rrjetin e drenazhimit dhe ujitjes, si parakusht për zhvillimin bujqësor.

Investime në infrastrukturën bujqësore e kryesisht në sistemet e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja.

Mbrojtjen e tokës nga dëmtimet, erozioni, moçalizimi, etj.;

Saktësimi dhe regjistrimi i të drejtave të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe kategorive të tjera në hapësirën rurale.

Ndërthurje e investimeve në sektorin bujqësor me ato të karakterit turistik.

Promovimi dhe marketingu i produkteve bujqësore duke nxitur dhe mbështetur kultivimin e kulturave dhe specieve tradicionale për çdo zonë.

Tabela 49 Kuadri i programit të bujqësisë dhe zhvillimit rural

Funksioni	Objektivat Specifik	Treguesi/Indikator	Situata aktuale	Situata e synuar	Aktiviteti/Projekti
P7.F1.Administri mi i infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave si dhe menaxhimi i institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;	P7.F1.O1 Ngritja e strukturës menaxhuese për çeshtjet e zhvillimit rural dhe administrimin dhe përdorimin e tokës bujqësore	Ngritja e strukturave menaxhuese	Funksion i ri në institucionin e Bashkise.	Krijimi i drejtorisë Bujqësisë me sektoret e saj perkatës dhe Drejtorisë së Menaxhimit, sistemit të kullimit dhe ujitjes	P7.F1.O1.A1 Krijimi i drejtorisë së Bujqësisë në Bashkinë Shkoder
		Shërbimi i ekstensionit që konsiston në harmonizimin e veprimtarisë të Drejtorisë së Bujqësisë me Institucionet që ofrojnë këtë shërbim	Eshtë një shërbim i ri	Bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë (shërbimi këshillimor) ; Qendra e Transferimit të Teknologjive ;	P7.F1.O1.A2 Krijimi i Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore dhe pyjore (institucion varesie)
	P7.F1.O2 Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit	Përmirësim sistemi në:kanale ujites në km ; kanale kullues në km	Situatë e rënduar e funksionimit të sistemeve të kanaleve ujitës dhe kullues nga mos investimi në shume vite.	Sistem kullimi dhe ujitje ( Kanale ujites në 10km ; kanale kullues në 15 km )	P7.F1.O2.A1 Pastrim kanalesh ujitëse dhe kulluese për NjA P7.F1.O2.A2 Rehabilitimi i pjesëshëm i skemës ujitëse Gur i Zi- Juban P7.F1.O2.A3 Hartimi i projekteve teknike prioritare për sistemin e ujitjes,kullimit dhe mbrojtjes nga erozioni.
P7.F2.Administri mi i sistemit të informacionit dhe kadastrës së tokave bujqësore.	P7.F2.F3.O1 Krijimi i sektorit për administrimin , përdorimin dhe mbrojtjen e tokës	Regjistri kadastral për të gjithë territorin.	ka regjister me të dhena të paplota.	Regjister me të dhena të plota që perditësohet.	P7.F2.F3.O1.A1 Krijimi i kadastrës rurale
		Rregjistri i pronave bujqësore në të gjithë territorin sipas zërave kadastral	Nuk ka	Krijimi,plotësimi , përditësimi i rregjistrit të pronave bujqësore	
P7.F3.Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit	P7.F2.F3.O2 Perfundimi i plotësimit me AMTP e gjithë familjeve	Numri i Nj A dhe fshatrave që do të përfundojnë plotësimin me AMTP	Janë pa u plotësuar tre NJA të zonës malore. Dy	Plotësimi i të gjitha Nj A-ve me AMTP	P7.F2.F3.O2.A1 Krijimi i grupeve të punës në NJA për zbatimin e procedurave për


bujqësor dhe rural, përfshirë statistikat bujqësore vendore, sipas legjislacionit në fuqi.	përfituese të tokës bujqësore		fshatra në NJA Velipojë dhe 1 (Një) në NJA Dajç		plotësimin e AMTP
--	-------------------------------	--	---	--	-------------------

### Buxhetimi i programit të Bujqësisë dhe zhvillimit rural

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Programit Bujqësisë dhe zhvillimit rural planifikohet buxheti me vlerë totale 37,030 mijë lekë: 22% paga dhe sigurime, 38% shpenzime operative dhe 40% investime

Tabela 50 Buxhetimi i programit të bujqësisë dhe zhvillimit rural

/000 lekë						
Programe	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencioni	Transferta	Investime	Totali
P7	8,035	13,995	0	0	15,000	37,030



Grafiku 23 Buxhetimi i programit të bujqësisë dhe zhvillimit rural

Tabela 51 Aktivitete e projekte të programit të bujqësisë dhe zhvillimit rural

/000 lekë						
Aktivitete/Projekte	Viti 2016					
	Paga+Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencion	Transferte	Investime	Total
P7.F1.O1.A1 Krijimi i drejtorisë së Bujqësisë në Bashkinë Shkoder						
P7.F1.O1.A2 Krijimi i Drejtorisë së	8,035	7,995				16,030



Sherbimeve Bujqesore dhe pyjore						
P7.F1.O2.A1 Pastrim kanalesh ujitëse dhe kulluese per NJA		6,000				6,000
P7.F1.O2.A2 Rehabilitimi i pjeshëm i skemës ujitëse Gur i Zi- Juban					10,000	10,000
P7.F1.O2.A3 Hartimi i projekteve teknike prioritare për sistemin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga erozioni.					5,000	5,000
P7.F2.F3.O1.A1 Krijimi i kadastrës rurale						0
P7.F2.F3.O2.A1 Krijimi i grupeve të punës në NJA për zbatimin e procedurave për plotësimin e AMTP						0
<b>Totali</b>	<b>8,035</b>	<b>13,995</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>15,000</b>	<b>37,030</b>

## P8. Programi i Mjedisit dhe mbrojtjes së pyjeve e kullotave.

### Pershkrimi i programit

Programi i Mbrojtjes së Mjedisit mbulon sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë dhe reduktimit të ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe ndotjes akustike.

Ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullimore, që të sigurojnë ekuilibrin biologjik të ekosistemeve, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore, rritjen e prodhimtarisë dhe afësisë ripërthitëse të tyre, parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tokës.

Një komponente e rëndësishme e programit është dhe mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit ujor, të ujrave sipërfaqësore, lumenjve dhe liqenit dhe ujrave nëntokesore.

### Pershkrimi i politikave të programit

Politika e Programit të Mbrojtjes së Mjedisit synon mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetareve, përmes bashkëpunimit me komunitetin e Bashkisë e shoqërinë civile.

Për hartimin dhe zbatimin e planeve nëpërmjet forcimit të zbatimit të kushteve të lejes mjedisore që synon parandalimin e krijimit të hotspotëve të reja, ndërmarrjes së veprimeve për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit gjithpërfshirës. Në fushën e mbrojtjes së natyrës bashkëpunim me të gjitha institucionet rajonale për të bashkëpunuar për ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimi i statusit të ruajtjes për llojet dhe habitatet që janë pjesë e mbrojtur me ligje dhe konventa të veçanta.

Politikat e këtij programi kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullimore, që të sigurojnë ekuilibrin biologjik të ekosistemeve pyjore, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore, rritjen e prodhimtarisë dhe afësisë ripërthitëse të pyjeve, parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tokës.

Një politikë shumë e rëndësishme e programit është shfrytëzimi racional i burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qëllimeve të përdorimit, si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.

Tabela 52 Kuadri i programit të mjedisit dhe mbrojtjes së pyjeve e kullotave

Funksioni	Objektivat Specifik	Treguesi/Indikator	Situata aktuale	Situata e synuar	Aktiviteti/Projekt i
P8.F1.Zbatimi i dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit dhe	P8.F1.O1.Hartimi dhe zbatimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Zbatimi i Planeve të Menaxhimit me bashkëpunim me zyrat dhe institucionet qendrore	Hartimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis/ PPV Bashkia Shkodër	Ka vlerësim të ndikimit në mjedis vetëm për Qytetin e Shkodrës në kuadër të IPV	Hartimi i Vlerësimit të ndikimit në mjedis për Bashkinë Shkodër	P8.F1.O1.A1. Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit të përgjithshëm vendor.

të përbërsve të tij.					
P8.F2.Ndërgjegjësimi i banorëve nëpërmjet promovimit të politikave edukuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.	P8.F2.O1.Forcimi i pjesëmarrjes publike në takimet për Vleresimet e Ndikimit në Mjedis dhe aktivitetet në mbrojtje të tij.	Takime me grupet e interesit dhe të publikut; hartimi i grafikëve të organizimit.	Në fazën përgatitore për organizimin e takimeve	Realizimi i 4 takimeve	P8.F2.O1.A1. Organizimi i takimeve sensibilizuese me komunitetin (4 takime)
P8.F3.Mbrojtja dhe permiresimi i mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, lumenjve dhe liqenit, ujrave nëntokësore etj. nëpërmjet shfrytëzimit racional të burimeve ujore, shpërndarjen e drejte të tyre sipas qëllimeve të përdorimit si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja	P8.F3.O1.Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe institucionet e tjera për të pasur pranë Bashkisë kadastrën elektronike të burimeve ujore	Krijimi i databazës për hartimin e kadastrës ujore	Nuk ka një kadastrë ujore	Realizimi i Kadastrës të ujërave /2016	P8.F3.O1.A1. Mbledhja e informacionit për hartimin e kadastrës ujore.
	P8.F3.O2.Pjesëmarrje në hartimin e planit të menaxhimit të burimeve ujore për basenin Drin-Bunë	Mbledhje e materialeve për përdorimin e ujërave në Bashkinë Shkodër	Nuk ka, plan të menaxhimit të ujërave	Hartimi i planit të menaxhimit të ujërave/2016	P8.F3.O2.A1. Mbledhja e informacionit për përdorimin e ujërave në Bashkinë e Shkodrës
P8.F4.Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	P8.F4.O1. Realizimi i planeve dhe shërbimeve të mbarështimit për të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullosor. Azhurnimi i Regjistrit të Pyjeve dhe Kullotave, Përgatitja e hartave tematike në GIS.	Siperfaqet e pyjeve dhe kullotave të mirembajtura			P8.F4.O1.A1. Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë e Shkodrës
		Mbrojtja nga demtimi i siperfaqeve pyjore kullimore	Ekziston Plani i Menaxhimit të Pyjeve/Kullotave për Qytetin e Shkodrës, NjA Velipojë, NjA Dajç.	2016 Mbrojtja e siperfaqeve pyjore /kullimore nga demtimi (zjarret) për qytetin Shkoder, NjA Postribë, Guri I Zi dhe NjA Pult.	P8.F4.O1.A2. Mbrojtja e siperfaqeve pyjore /kullimore

P8.F4.O2.Registrimin e fondit pyjor dhe kullorosor ne ZRPP. Rehabilitimi, yllezimi dhe rpyllezim te siperfaqeve, te degraduara, djegura dhe rehabilitimin e kullotave nepermjet praktikave silvo-pastorale.Parandalimit te gerryerjes se metejsheme te tokes pyjore dhe kullosore	Pergatitja e rlevimeve topografike per pyje/kullota .	Jane te regjistruara prane ZVRPP Shkoder , te gjitha puje/kullota te Qytetit Shkoder, pjeserisht NjA Velipoje si edhe NjA Rrethina.	2016 , do te pergatitet dokumentacioni I plote per regjistrim prane ZVRPP Shkoder per NjA Velipoje dhe NjA Rrethina.	P8.F4.O2.A1. Hartimi i rlevimeve topografike /harta per regjistrim ne ZVRPP per NjA Velipoje dhe NjA Rrethina.
	Pyllëzimi	Mali I Taraboshit eshte nje mal relativisht I cveshur. Ne te ka kryesisht pishe te zeze. Ka pasur nje nderhyrje me mbjellje pishe te zeze ne kete zone te kryer ne vitin 2014.	Nisur nga fakti qe mali I Taraboshit eshte pjese e kurores se qytetit te Shkodres , parashikojme nje nderhyrje ne pyllezim te njesasi prej rreth 100 mije fidane pishe eger dhe selvi	P8.F4.O2.A2. Zbatimi i Projektit " Pyllezimi i Malit të Taraboshit".
	Pastrime dhe permiresime ne siperfaqe pyjore.	Aktualisht ka nevojte per permiresime/pastrime ne zonen pyjore te Taraboshit, kjo nisur edhe nga situata e zjarreve te rena ku druret e djegur nuk jane pastruar por edhe nga vete zhvillimi I pyllit apo nenpyllit.	Pastrimi/permiresimi I parcelave pyjore nr 21 a dhe 27 a ne malin e Taraboshit me nje siperfaqe rreth 18.5 ha	P8.F4.O2.A3.Per miresim pyllezimi Mali I Taraboshit.
	Ndertim lere ujit ne kullota fshati Zogaj	Aktualisht ne zonen e Zogajve nuk ka nje lere uji e cila eshte e domosdoshme per bagetite e zones.	Ndertim lere uji ne Zogaj me nje kapacitet prej 205 m3 per pirje uji per te gjitha ditet e vitit	P8.F4.O2.A4. Zbatimi i projektit per ndertimin e leres se ujit kullota -Zogaj

### Buxhetimi i programit të Mjedisit dhe Mbrojtjes së Pyjeve e Kullotave

<b>Nr.21</b>	<b>Projekti: P1.F1.O2.A18</b> Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake	<b>Llojet e programit: P1</b> Planifikim, Manaxhim, Administrim <b>Funksioni: P1.F1</b> Administrata Vendore
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
i. Situata		
Bazuar në ligjin 8224 ,datë 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës,ndryshuar dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 333 datë 02.06.1998 për "Miratimin e normës së veshmbathjes për policinë",i ndryshuar, dhe gjitha vendimet dhe urdherat në zbatim të këtij ligji përcaktohen qartë standartet dhe kriteret për normat e uniformave të policise bashkiake. Bazuar në numrin ekzistues të efektivave të policisë bashkiake janë llogaritur sasi të dhe nevojat për uniforma.		
ii. Synimi i projektit		
Të përmirësohet qeverisja lokale në funksion të ofrimit të shërbimeve sipas standarteve të parashikuara, ndaj komunitetit Rritja e imazhit përballë komunitetit për një prezantim sa më dinjtoz, përmirësimi i performancës së Policisë së Bashkisë dhe zbatimit të ligjit në shërbim të qytetareve.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
Identifikimi i kërkesave për për uniforma Përgatitja e dokumentacionit për prokurim në zbatim të ligjit Zbatimi procesit ( blerja e uniformave)		
<b>b) Rezultatet e pritshme</b>		
Përmirësimi i mazhit të Policisë së Bashkisë		
c) Aktoret e mundshem  1. Drejtoria e Burimeve Njrerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse 2. Policia Bashkiake	d) Kontributet e mundshme në projekt  Bashkia Shkoder	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lek 500
		Nga kjo: Paga, sig operative kapitale
A.1	Identifikimi i kërkesave për për uniforma	
A.2	Procedurat administrative të tenderimit etj.	
A.3	Blerje uniforma	500 500
TOTALI		500 500
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Gjatë vitit 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Drejtoria e Burimeve Njrerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse  Policia Bashkiake

<b>Nr. 22</b>	<b>Projekti: P1.F1.O2.A19</b> Shërbimi për regjistrimin e pronave të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër	<b>Llojet e programit: P1</b> Planifikim, Manaxhim, Administrim <b>Funksioni: P1.F1</b> Administrata Vendore
<b>Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
i. Situata		
<p>Ky projekt synon përmbushjen e detyrimeve që Bashkia Shkodër ka për regjistrimin e pronave të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave me Nr.421, datë 02.06.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Shkodër, në Qarkun e Shkodrës".</p> <p>Territori i ri administrativ i Bashkisë Shkodër, si rezultat i zbatimit dhe hyrjes në fuqi të Reformës Territoriale, na vendos përpara detyrimit tonë ligjor për regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe shtetërore të cilat janë transferuar në pronësi të 10 Njësie Administrative (ish-Komunave). Gjithashtu pjesë shumë e rëndësishme e zbatimit të këtij projekti janë edhe prona të tjera që fitohen nga shpronësimet si rezultat i investimeve të kryera apo që do të kryhen në rrugë. Në total do të jenë rreth 250 prona për regjistrim. Fushat e përdorimit të pronave dhe lloji i transferimit të tyre janë të ndryshme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Prona që përdoren në fushën administrative</li> <li>Prona që përdoren në realizimin e programeve arsimore</li> <li>Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik</li> <li>Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore</li> <li>Prona që përdoren në fushën e shërbimit social</li> <li>Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik</li> <li>Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile</li> <li>Prona që përdoren në fushën e ndriçimit publik</li> <li>Prona që përdoren infrastrukturën vendore</li> <li>Prona që përdoren shërbimin funeral</li> </ul> <p>Aktualisht Bashkia Shkodër ka të depozituara pranë Zyrës vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Shkodër dokumentacionin e plotë në zbatim të VKM Nr.421 për 109 prona të paluajtshme publike, shtetërore të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër, të ndara sipas zonave kadastrale si: 13 prona në Zonën Kadastrale 8591, 9 prona në Zonën Kadastrale 8592, 65 në Zonën Kadastrale 8593, 15 prona në Zonën Kadastrale 8594, 4 prona në Zonën Kadastrale 8595 dhe 2 prona në Zonën Kadastrale 8596. Gjithashtu Bashkia Shkodër ka të depozituara dokumentacionet përkatëse për pronat e përfituara nga shpronësimet si efekt i investimeve publike në rrugë. Keto prona janë të dërguar pranë ZVRPP Shkodër që në vitin 2010 e në vazhdim, dhe rezultojnë të paregjistruara.</p> <p>Për shkak të kalimi të disa zonave kadastrale në sistemin e ri të informacionit të regjistrimit të pronave të paluajtshme, rezultoni i domosdoshëm ridërgimi i dokumentacionit për aplikim për të gjitha pronat, përfshi 109 pronat e sipërcituara dhe për të tjerat të reja të nevojshme për regjistrim.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Të përmirësohet qeverisja lokale në funksion të ofrimit të shërbimeve sipas standarteve të parashikuara, ndaj komunitetit Regjistrimi i 250 pronave të paluajtshme publike, shtetërore që i janë transferuar në pronësi apo në përdorim Bashkisë Shkodër dhe Njësie të saj Administrative.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përgatitja e dokumentacion për regjistrim për secilën pronë.</li> <li>2. Dërgimi i dokumentacionit për aplikim në ZVRPP Shkodër për regjistrim.</li> <li>3. Rregjistrimi i pronave</li> <li>4. Përgatitja e dokumentacion për regjistrim për secilën pronë.</li> </ol>		
<b>b) Rezultatet e pritshme</b>		
Çertifikata e pronësisë për secilën pronë të regjistruar dhe përmbushja e detyrimeve ligjore të institucionit tonë.		
c) Aktorët e mundshëm Drejtoria e Finances/ Sektori i Aseteve Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	d) Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Shkodër	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>		
<b>Shpenzimet sipas aktiviteteve</b>	Totali(000/lek)	Nga kjo :
		Paga sigurime      Operative      Kapitale
A.1	Përgatitja e dokumentacion për regjistrim për secilën pronë	
A.2	Rregjistrimi i pronave	2 500      2 500
A.3	Përgatitja e dokumentacion për regjistrim	
<b>TOTALI</b>		<b>2 500      2 500</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>
Gjatë vitit 2016		Drejtoria e Financës/ Sektori i Aseteve Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse



<b>Nr. 23</b>	<b>Projekti: P1.F1.O2.A20</b> Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës	<b>Llojet e programit: P1</b> Planifikim, Manaxhim, Administrim <b>Funksioni: P1.F1</b> Administrata Vendore			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
<p>Bashkia Shkodër prej disa vitesh i siguron administratës dhe punës së përditshme të institucionit aksesin në internet 24/7 pa kufizim trafiku. Shërbimi prokurohet një herë në vit dhe kontrata me ofruesin e shërbimit shtrihet nga fillimi i kalendarik i vitit deri në përfundimin e tij, duke u faturuar prej këtij të fundit një herë në muaj, gjithmonë në datën e fundit të muajit respektiv. Shërbimi i Internetit është i dedikuar me fibër optike nga Backbone i ofruesit të shërbimit (ISP) deri në routerin qendror të Bashkisë Shkodër. Shpejtësia është 30Mbps – 50Mbps (full duplex) për Bashkinë Shkodër dhe Sektorin e Prokurimeve Publike. Shërbimi i internetit ka backup me antenë satelitore Tooeay (Eutelsat KA-SAT) (download speed 20 Mbps, upload 6 Mbps) si dhe 7 (Shtate) IP Publike të rutueshme. Gjerësia e brezit të lidhjes (bandëidh) e garantuar në Router-in qendror është 100Mb/s. Ndërkohë që situata pas Reformës Territoriale ndryshon, pasi Bashkia Qendër duhet ti ofrojë shërbimin e internetit edhe Njësitë Administrative, të cilat deri më 31 Dhjetor 2015 e marrin shërbimin nga ofrues të tjerë me karakteristika teknike të tjera sipas nevojave që kanë konstatuar në fillim të këtij viti. Me fillim vitin e ardhshëm Bashkia Shkodër duhet të ofrojë internetin në të gjitha Njësitë e saj Administrative duke iu shtuar edhe 15 pika tjera për furnizim të këtij shërbimi (10 ish-komuna + 5 rajone). Kjo duhet të realizohet përmes të njëjtit ofrues shërbimi sipas specifikimeve teknike të pranueshme dhe të duhura për komunikimin elektronik të përcaktuar nga AKSHI, dhe për sigurimin e mirëfunksionimit të sistemeve të informacionit të bazuar në platforma web që bashkia ka projektuar për të implementuar.</p>					
ii. Synimi i projektit ( me një fjali cfare do te zgjidhni per ate që është problemi kryesor, përfitim i grupit të synuar)					
Projekti synon ofrimin e shërbimit të internetit në Bashkinë Qendër dhe Njësitë Administrative të saj pavarësisht vendndodhjes gjeografike të tyre, konform standarteve të përcaktuara për komunikimin elektronik.					
iii. Aktivitetet kryesore te projektit					
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Instalimi dhe ofrimi i shërbimit në Bashkinë Qendër, pikë kryesore e shërbimit nga e cila duhet të menaxhohen të gjitha njësitë dhe përdoruesit përkatës.</li> <li>2. Instalimi dhe ofrimi i shërbimit në Njësitë Administrative, konsiderohen pika të reja ofrimi shërbimi për Bashkinë Shkodër.</li> <li>3. Menaxhim i rrjetit dhe mirëmbajtje e sitemit</li> </ol>					
<b>b) Rezultatet e pritshme</b>					
<p>Rezultat i pritshëm është që bashkia Shkodër të marrë shërbimin e internetit sipas dispozitave ligjore në fuqi të komunikimit elektronik të përcaktuara nga AKSHI. Duhet të implementojmë një system të qendëruar në të cilin përdoruesit e zyrave vendore lidhen tek serverët qendrorë të aplikimit dhe të të dhënave të cilët janë të vendosur tek Qendra e të Dhënave të vendosur në Zyrën e Serverit në Bashkinë Qendrore. Zgjidhja e implementuar duhet të ofrojë 99.99% shërbimin në çdo kohë në çdo pikë të tij. Paketa nuk duhet të shfaqë nje vonese me te madhe se 110 ms bazuar ne madhësinë minimale te një pakete standarde prej 32 bytes. Numri i paketeve të humbura (ne %) që nuk arrijnë në destinacion me e vogël se 3 (tre). Arkitektura e komunikimit duhet të sigurojë një linjë back up emergjentë për të gjitha linjat e komunikimit. Sistemi do të sigurojë konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit që trasmetohet në linjat e komunikimit. Ofruesi i shërbimit nuk duhet të shohë, përdorë ose bëjë publike tek palë të treta informacionin e transmetuar në linjat e komunikimit. Të gjithë njësitë e bashkisë Shkodër do të kenë akses në internet 24/7 pa kufizim në komunikim. Ky shërbim rrit shpejtësinë në komunikim të të dhënave, ul kostot operative dhe rrit transparencën dhe gjurmon informacionin. Ky shërbim garanton mirëfunksionimin e sistemeve të bazuara në platforma web që bashkia ka nisur të implementojë, siç është Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë, si dhe të sistemeve të tjera që do të implementohen në të ardhmen, siç janë sistemi i taksave vendore, asetëve, AMTP, Arkivës Dixhitale, etj.</p>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit / Sektori i Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit</li> <li>2. Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë host-imin dhe asistencën teknike (sipas kushteve paraprake të vendosura në procedurat e prokurimit) si dhe trajnimet e stafeve përkatëse.</li> </ol>			Bashkia Shkodër		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo: Paga, sig      operative      kapitale		
A.1	Shërbimi Internetit Bashkia Qendër				

A.2	Shërbimi Internetit në Njësitë Administrative			1 967	
A.3	4 Specialistë Drejtoria TIK & SI (1 Drejtor, 1 Përgjegjës, 2 Specialistë) 2-4 orë në ditë me mirëmbajtjen sistemit elektronik të komunikimit				
<b>TOTALI</b>		<b>1 967</b>		<b>1 967</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur perfundon)</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			
<b>Gjatë vitit 2016 (Projekti zbatohet në një kohëzgjatje 1-vjeçare)</b>		Drejtorja e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit / Sektori i Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit			



<b>Nr. 24</b>	<b>Projekti: P1.F1.O2.A21</b> Ristrukturim fizik dhe teknik i Dhomës së Server-ave	<b>Llojet e programit: P1</b> Planifikim, Manaxhim, Administrim <b>Funksioni: P1.F1</b> Administrata Vendore			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Në vitin 2013, pas një ndërhyrjeje që Bashkia Shkodër bëri për të ndëtuar një pjesë të intranet-it, i cili u cilësua si funksional në kushte emergjente për funksionimin e sistemeve të informacionit në atë kohë, një dhomë në pikën qendrore të godinës u dedikua vendosjes së Server-ave të atëhershëm. Po në atë dhomë vazhdon të jetë pozicionuar rack-u qendror dhe serverat aktual, por në të njëjtën kohë ajo dhomë përdoret edhe si magazinë për të tjera sende të institucionit. Kjo situatë nuk është aspak normale dhe ajo dhomë nuk plotëson as kushtet minimale për një dhomë të dedikuar për serverat siç është e dokumentuar në Rregulloren e Ndërtimit të Dhomës së Serverave e publikuar nga AKSHI. Por e parë me syrin teknik ajo dhomë është teknikisht vendi më i përshtatshëm për ta krijuar siç duhet një ambientin për serverat qendrorë, e domosdoshme për implementimin dhe mirëfunksionimin e sistemeve të informacionit që bashkia po dhe do të implementojë. Në këto kushte, duhet theksuar se është pika fillestare e cila duhet të plotësohet patjetër sipas kushteve të përcaktuara qartë në rregulloren e sipërpërmendur, në mënyrë që të sigurohet qeverisja elektronike.					
ii. Synimi I projektit					
Të garantojmë transparencë, ofrim të shërbimit pranë qytetarit, profesionalizëm, cilësi e korrektesë, luftë kundër korrupsionit Projekti synon përmirësimin e kushteve fizike dhe teknike të dhomës aktuale të serverave, duke krijuar një bazë të fortë për implementim të sistemeve të informacionit që aktualisht po implementohen dhe që do të implementohen në të ardhmen, në kuadër të programit qeverisjes vendore elektronike të Bashkisë Shkodër.					
iii. Aktivitetet kryesore te projektit					
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Projekti Teknik i ristrukturimit</li> <li>2. Implementimi i Projektit Teknik për ristrukturim, preventivimi dhe prokurimi i punimeve dhe artikujve të nevojshëm furnizim vendosje.</li> <li>3. Kapitalizimi i Projektit</li> </ol>					
<b>b) Rezultatet e pritshme</b>					
Në fazën e kapitalizimit të projektit, ambienti i Dhomës së Serverave duhet të plotësojë kushtet teknike dhe fizike të përcaktuara në pikën 4.1 të kapitullit 4 "Standarte – Karakteristika të Përgjithshme", pikës 4.4 për "Sistemin e Ftohjes" dhe pikës 4.5 për "Sistemin Elektrik" të Rregullores së Ndërtimit të Dhomës së Serverave në fuqi të publikuar nga AKSHI me datë 02/12/2008. Kushtet e mirëkrijuara për këtë dhomë garantojnë mirëfunksionimin e të gjithë Sistemeve të Informacioneve si dhe Komunikimin Elektronik on-line 24/7 pa kufizime, në bashkinë qendër dhe në të gjitha njësitë administrative.					
<b>c) Aktoret e mundshem</b>	<b>d) Kontributet e mundshme ne projekt</b>				
<ol style="list-style-type: none"> <li>3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse</li> <li>4. Drejtoria e Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve</li> <li>5. Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit</li> <li>6. Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të implementojë Projektin Teknik në varësi të specifikimeve teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit elektronik</li> </ol>	Bashkia Shkodër				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Realizimi iprojektit teknik				
A.2	Realizimi i projektit				
	A.2.1	5			5
	A.2.2	21			21
	A.2.3	14			14
	A.2.4	43			43
	A.2.5	51			51

	A.2.6	Instalime elektrike	10			10
	A.2.7	Togëzim	100			100
A.3		Kapitalizim il projektit, fuqizim I burimeve njerzore, monitorim				
<b>TOTALI</b>			<b>244</b>			<b>244</b>
<b>f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2016</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			
			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit</li> <li>• Drejtoria e Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve</li> <li>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse</li> </ul>			



<b>Nr. 25</b>	<b>Projekti: P1.F1.O2.A22</b> Mirëmbajtje pajisje informatike	<b>Llojet e programit: P1</b> Planifikim, Manaxhim, Administrim <b>Funksioni: P1.F1</b> Administrata Vendore		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
Bashkia Shkodër, pas reformës administrativo-territoriale ka në juridiksion të saj 10 Njësi Administrative (Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh , Velipojë). Secila prej Njësive Administrative ka në inventarin e saj Pajisje Informatike ndësr të cilat disa janë në gjendje të mirë pune e disa të tjera nuk janë konsideruar në gjendje të mirë pune por të mundhsmë për t'u mirëmbajtur dhe për t'u përdorur në vazhdim. Bashkia Shkodër në programin e saj ka një ndër pikat kyçe mbi të cilën mbështetet qeverisja e saj në këto 4 vite, pikërisht Dixhitalizimi i Administratës Publike. Kjo pikë kyçe mund të funksionojë ashtu siç dhet nëse ka një mbështetje të mirë në infrastrukturë fizike TIK				
ii. Synimi i projektit				
Të garantojmë transparencë, ofrim të shërbimit pranë qytetarit, profesionalizëm, cilësi e korrektesë, luftë kundër korrupsionit Bashkia Shkodër synon Dixhitalizimin e Administratës Publike dhe kjo mundësohet në mbështetje të një infrastrukture shumë të mirë pajisjesh informatike (pajisjesh TIK).				
iii. Aktivitetet kryesore te projektit				
Implementimi i Projektit Teknik, preventivimi i mirëmbajtjes për pajisjet TIK të parazgjedhura për një mundësi riparimi të tyre Prokurimi i mirëmbajtjes me furnizim vendosje sipas grafikut të shpërndarjes të miratuara paraprakisht. Asistimi Teknik				
<b>b) Rezultatet e pritshme</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Pajisje informatike me specifikime teknike më të mira</li> <li>✓ Sistem komunikimi elektronik më të qëndrueshëm</li> <li>✓ Ofrim i shërbimeve elektronike më të sigurta</li> <li>✓ Profesionalizëm, Cilësi dhe Korrektësi</li> </ul>				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbështetëse</li> <li>2. Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit / Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Menaxhimit të Zyrës së Integruar me Një Ndalesë</li> <li>3. Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë mirëmbajtjen e pajisjeve TIK (sipas kushteve paraprake të vendosura në procedurat e prokurimit)</li> </ol>			Bashkia Shkoder	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo:
A.1	Implementimi i Projektit Teknik, preventivimi i mirëmbajtjes për pajisjet TIK të parazgjedhura për një mundësi riparimi të tyre	800	Paga, sig	operati ve
A.2	Prokurimi i mirëmbajtjes me furnizim vendosje sipas grafikut të shpërndarjes të miratuara paraprakisht.			kapitale
A.3	Asistenca teknike			
<b>TOTALI</b>			<b>800</b>	<b>800</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> <b>Gjatë vitit 2016</b>		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbështetëse Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit / Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Menaxhimit të Zyrës së Integruar me Një Ndalesë		

<b>Nr. 26</b>	<b>Projekti: P1.F1.O2.A23</b> Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	<b>Llojet e programit: P1</b> Planifikim, Manaxhim, Administrim  <b>Funksioni:P1.F1</b> Administrata Vendore			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Bashkia Shkodër, pas reformës administrativo-territoriale ka në juridiksion të saj 10 Njësi Administrative (Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh , Velipojë). Secila prej Njësive Administrative ka në inventarin e saj Pajisje Informatike ndër të cilat disa janë në gjendje të mirë pune e disa të tjera nuk janë konsideruar jashtë funksionit. Bashkia Shkodër në programin e saj ka një ndër pikat kyçe mbi të cilën mbështetet qeverisja e saj në këto 4 vite, pikërisht Dixhitalizimi i Administratës Publike. Kjo pikë kyçe mund të funksionojë ashtu siç dhet nëse ka një mbështetje të mirë në infrastrukturë fizike TIK e përkthyer në pajisje informatike të reja me specifikime teknike shumë të mira.					
ii. Synimi i projektit					
Të garantojmë transparencë, ofrim të shërbimit pranë qytetarit, profesionalizëm, cilësi e korrektesë, luftë kundër korrupsionit Bashkia Shkodër synon Dixhitalizimin e Administratës Publike dhe kjo mundësohet në mbështetje të një infrastrukture shumë të mirë pajisjesh informatike (pajisjesh TIK).					
iii. Aktivitetet kryesore te projektit					
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Implementimi i Projektit Teknik, preventivimi dhe prokurimi i pajisjeve TIK (hardëare) të nevojshme sipas pozicioneve të punës, detyrave dhe të drejtave të përdoruesve.</li> <li>2. Prokurimi dhe Instalimi i pajisjeve sipas grafikut të shpërndarjes të miratuara paraprakisht.</li> <li>3. Asistimi Teknik</li> </ol>					
<b>b) Rezultatet e pritshme</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Pajisje informatike me specifikime teknike më të mira</li> <li>✓ Sistem komunikimi elektronik më të qëndrueshëm</li> <li>✓ Ofrim i shërbimeve elektronike më të sigurta</li> <li>✓ Profesionalizëm, Cilësi dhe Korrektesi</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme ne projekt</b>		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse</li> <li>2. Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit / Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Menaxhimit të Zyrës së Integruar me Një Ndalesë</li> <li>3. Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë pajisjet TIK(sipas kushteve paraprake të vendosura në procedurat e prokurimit).</li> </ol>			Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>			Tot ali (000 lek)	Nga kjo: Pa ga, sig oper ative kapi tale	
A. 1	Implementimi i Projektit Teknik, preventivimi dhe prokurimi i pajisjeve TIK (hardëare) të nevojshme sipas pozicioneve të punës, detyrave dhe të drejtave të përdoruesve.		8 000		8 000
A. 2	Prokurimi dhe Instalimi i pajisjeve sipas grafikut të shpërndarjes të miratuara paraprakisht.				
A. 5	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Drejtoria TIK & SI				
<b>TOTALI</b>			<b>8 000</b>		<b>8 000</b>
<b>f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2016</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse</li> <li>• Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit / Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Menaxhimit të Zyrës së Integruar me Një Ndalesë</li> </ul>			

<b>Nr. 27</b>	<b>Projekti: P1.F1.O2.A24</b> Mirëmbajtje e faqes zyrtare web dhe www.bashkiashkoder.gov.al moduleve të integruara të saj	<b>Llojet e programit: P1</b> Planifikim, Manaxhim, Administrim <b>Funksioni: P1.F1</b> Administrata Vendore
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
i. Situata		
<p>Bashkia Shkodër prej disa vitesh zotëron një faqe zyrtare interneti nën domain-in www.bashkiashkoder.gov.al. Kjo faqe është 24/7 on-line me një ndërfaqe të rikonfiguruar në janar në vitin 2014 të investuar nga dldp (Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal), në kuadër të ndërtimit dhe implementimit për herë të parë në institucionin tonë të Zyrës me Një Ndalesë (sportelet me një ndalesë të ofrimit të shërbimeve vendore ndaj qytetarit). Kjo faqe është e ndërtuar konform standarteve të përcaktuara nga AKSHI, dhe aktualisht menaxhueshëm në web nga Sekretaria e Këshillit të Bashkisë. Moduli e-Pjesëmarrje i implementuar dhe i integruar në faqe, mundëson është një faqe e nivelit të III<sup>ib</sup>. Gjithashtu është ndërtuar edhe në përputhje me standartet ndërkombëtare për ofrimin e informacionit ndaj qytetarit, duke iu referuar disa modeleve të faqeve zyrtare web të disa bashkive nëpër botë, siç është faqja zyrtare e City of London. Kjo faqe është e ndërtuar mbi një platforme web e quajtur <b>easyweb 2.0</b>, një sistem i menaxhueshëm nga përdoruesit e bashkisë në nivel përmbajtjeje (content). Ofruesi i këtij shërbimi është kompania ArkIT në Tiranë, e cila është përgjegjëse edhe për host-imin, mirëmbajtjen teknike të saj dhe ofrimin e shërbimit të adresave e-mail të stafit nën domain-in zyrtar. Në faqe janë të integruar edhe disa module për pjesëmarrjen e qytetarëve. Moduli i Librarisë Ligjore i implementuar dhe i integruar në faqe, bën të mundur që bashkia të ndajë më qytatët të gjithë vendimet e Këshillit të Bashkisë përmes një moduli të krijimin e vazhdueshëm të sondazheve me tematika të ndryshme dhe marrjen e feedback-ut nga qytetari, lehtësisht i menaxhueshëm nga punonjësit e bashkisë. Moduli i Sistemit Kërkesë/Ankesë, i integrueshëm në faqen web, bën të mundur gjurmimin e kërkesave/ankesave që aplikohen në Zyrën e Integruar me Një Ndalesë të qytetarit direkt nga portali on-line. Shkarkimi i formularëve on-line në kuadër të programit të transparencës janë një tjetër mjet i përfshirjes së qytetarit përmes këtij portali web. Aktualisht është i pasuruar me këta shërbime, por është shumë i rëndësishëm ristrukturimi i vazhdueshëm i tij deri në përfitim të një portali web model on-line, gjithnjë në shërbim të qytetarit dhe vizitorit tonë.</p>		
ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarëdo të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitim i grupit të synuar)		
Të garantojmë transparencë, ofrim të shërbimit pranë qytetarit, profesionalizëm, cilësi e korrektesë, luftë kundër korrupsionit Projekti synon ofrimin e qeverisjes elektronike duke forcuar një komunikim virtual dhe transparent Bashki – Qytetar dhe anasjelltas (G2C / C2G).		
iii. Aktivitetet kryesore te projektit		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hostimi i Aplikimit, shërbim i cili paguhet për hapsirën që faqja zyrtare e bashkisë shkodër zë në web (në server-in e ofruesit të shërbimit ArkIT i cili zotëron një Web Server, pasi aktualisht për Bashkinë Shkodër gjykohe e vështirë ngritja e një Web Server-i në pronësi të saj për shkak të mungesës së infrastrukturës fizike dhe sigurisë që duhet të ketë informacioni i faqs tonë zyrtare).</li> <li>2. Suport Teknik, shërbim i cili paguhet për ndërhyrje teknike të ndryshme të nivelit të lartë sipas nevojave dhe kërkesave të institucionit konform informacionit apo mjeteve që kërkohet të publikohen</li> <li>3. Moduli i Librarisë Ligjore, shërbim i cili siguron mirëmbajtjen teknike të këtij moduli në kuadër të transparencës së vendimarrjes së insitucionit tonë ndaj qytetarit.</li> <li>4. Moduli e-Pjesëmarrje, shërbim i cili siguron mirëmbajtjen teknike të këtij moduli në kuadër të transparencës dhe cilësisë së shërbimeve të insitucionit tonë ndaj qytetarit, përmes sondazheve të ndryshme të publikuara herë pas here nga për qytetarin, tregues shumë i rëndësishëm për matjen e performancës së institucionit tonë.</li> <li>5. Moduli Kërkesë/Ankesë, shërbim i cili siguron njoftimin on-line të qytetarit për gjendjen e shërbimit të aplikuar prej tij në Zyrën e Integruar me Një Ndalesë.</li> <li>6. Trajnim i Stafit TIK për suport teknik dhe stafit të drejtorive të tjera përkatëse për azhornimin e vazhdueshëm përmbajtjes së faqes web.</li> </ol>		
<b>b) Rezultatet që prisni ( shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)</b>		
Rezultat i pritshëm është që bashkia Shkodër të zotërojë një faqe sa më ndërvpruese me vizitorin (user-friendly) të strukturuar në mënyrën e duhur dhe e informacioni i kërkuar të jetë i kapshëm në të shumtën 3 klikime. Të arrihet gradualisht në gjendjen e ofrimit të qeverisjes së hapur ndaj qytetarit, duke bërë publike çdo vendim të institucionit dhe çdo informacion të tij. Të mepërfthohet në mënyrë elektronike mendimi i qytetarit ndërmjet sondazheve on-line dhe librarisë ligjore, si dhe ti ofrohet informacioni për shërbimet e kërkuara prej tyre përmes sistemit të integruar në web të Zyrës me Një Ndalesë. Si rrëjlllojë, ky mjet rrit transparencën, lufton korrupsionin dhe rrit korrektesinë & cilësinë e institucionit dhe administratës vendore.		
<b>c) Aktoret e mundshem</b>	<b>d) Kontributet e mundshme ne projekt</b>	
1. Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit / Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Menaxhimit të Zyrës së Integruar me Një	Bashkia e Shkodrës	

Ndalesë 2. Drejtoritë përgjegjëse për përpunimin e informacionit për publikim në web sipas specifikave përkatëse. 3. Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë host-imin dhe asistencën teknike (sipas kushteve paraprake të vendosura në procedurat e prokurimit) si dhe trajnimet e stafëve përkatëse.					
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Hostimi i Aplikimit	36		36	
A.2	Suport Teknik	36		36	
A.3	Integrim i Moduleve - Librari Ligjore, e-Pjesëmarrje, SIZ1N	20		20	
A.4	Trajnime - Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimet	80		80	
A.5/6	4 Specialistë Drejtoria TIK & SI ( 1 Drejtor, 1 Përgjegjës, 2 Specialistë) të angazhuar mesatarisht 2 orë në ditë me SIZ1N sipas nevojave 15 Specialiste të Drejtorive Prodhuese të Shërbimeve të angazhuar 1-4 orë në ditë sipas informacionit të nevojshëm për publikim/azhornim.				
<b>TOTALI</b>		<b>172</b>		<b>172</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			
Gjatë vitit 2016 (Projekti zbatohet në një kohëzgjatje 1-vjeçare)		<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit / Sektori i Administrimit të Sistemeve dhe Menaxhimit të Zyrës së Integruar me Një Ndalesë</li> <li>Drejtoritë përgjegjëse për përpunimin e informacionit për publikim në web sipas specifikave përkatëse.</li> </ul>			



<b>Nr. 28</b>	<b>Projekti: P1.F1.O2.A25</b> Zgjerimi i rrjetit kompjuterik (Intranet) për komunikimin elektronik të brendshëm, implementimi i Sistemit të Kontrollit të Aksesit dhe Sistemit të Vëzhgimit	<b>Llojet e programit: P1</b> Planifikim, Manaxhim, Administrim <b>Funksioni: P1.F1</b> Administrata Vendore
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
i. Situata		
<p>Në vitin 2013, pas një ndërhyrjeje që Bashkia Shkodër bëri për të ndëtur një pjesë të intranet-it, i cili u cilësua si funksional në kushte emergjente për funksionimin e sistemeve të informacionit në atë kohë. I njëjti intranet me të njëjtat kushte fizike e teknike, si para 2 vitesh, vazhdon të përdoret edhe sot në bashkinë qendër. Ndërkohë duhet theksuar që ky rrjet është ndërtuar vetëm në zyrat që deri tani ka mbuluar Bashkia Shkodër, ndërkohë që në ambientet e godinës janë të akomoduar edhe zyra institucionesh të tjera apo shoqatash dhe organizatash jo fitim prurëse. Zgjerimi i Bashkisë Shkodër, si rrjedhojë e Reformës Territoriale, detyrimisht ndryshon strukturën organizative të institucionit duke e zgjeruar atë. Si rezultat shumë shpejt të gjitha zyrat e godinës do të jenë në dispozicion të administratës së zgjeruar dhe në këtë mënyrë shumë poste punë do të shtoheshin zyrat aktuale ku ka rrjet të shtruar e në zyrat e tjera në të cilat do të jetë e nevojshme që të shtrihet rrjeti kompjuterik fizikisht. Për sa i përket Sistemit të Kontrollit të Aksesit, nuk ka akoma të implementuar një të tillë të bashkinë qendër e as në njësitë administrative. Ndërkohë që Sistemi i Vëzhgimit i brendshëm ka probleme fizike prej kohësh dhe pajisjet monitoruese (kamerat) janë të vjetra e nuk kanë cilësinë e duhur teknike për të mbuluar qartë të gjithë ambientet e brendshme të godinës qendrore. Për sa i përket pajisjeve monitoruese të jashtme janë po në të njëjtat kushte fizike e teknike, me probleme dhe me specifikime teknike të dobëta për mbulimin e ambienteve të jashtme të godinës. Për njësitë administrative, sipas inventarëve fizik TIK të dorëzuar, rezultoni se nuk kanë sisteme vëzhgimi. Por zgjerimi i Sistemit të Kontrollit të Aksesit dhe i Vëzhgimit në 15 njësitë administrative, i menaxhueshëm nga sistemi qendror në bashkinë qendër, është shumë i rëndësishëm në këtë fazë dhe lehtësisht i integrueshëm përmes internetit.</p>		
ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitim i grupit të synuar)		
Të garantojmë transparencë, ofrim të shërbimit pranë qytetarit, profesionalizëm, cilësi e korrektesë, luftë kundër korrupsionit Projekti synon përmirësimin dhe zgjerimin Intranetit në të gjithë ambientet e godinës qendrore të Bashkisë Shkodër, implementimin e Sistemit të Integruar të Kontrollit të Aksesit dhe të Vëzhgimit në të gjitha njësitë administrative, për më shumë siguri dhe transparencë në punën e përditshme të qeverisjes vendore.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Projekti Teknik Intranet, Access Control, Monitoring System</li> <li>2. Implementimi i Projektit Teknik, preventivimi dhe prokurimi i punimeve dhe artikujve të nevojshëm furnizim vendosje (Kabinete rrjeti, Sëitch-e gigabit të menaxhueshëm, Patch Pannel-e, Kablllo, Kanalina, MikroTik, Access Controller, Communication Interface, RCP Master Software për menaxhimin e hyrje/daljeve, Bateri, Kamera te jashtme/brendshme, Software për menaxhimin e monitorimit, etj.)</li> <li>3. Kapitalizimi i Projektit</li> </ol>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<p>Në fazën e kapitalizimit të projektit, në të gjithë ambientet e godinës qendrore të bashkisë do të ketë të shtrire fizikisht rrjet komunikimi kompjuterik (intranet) sipas rregullores së komunikimit elektronik e cila do të sigurojë që çdo kompjuter dhe pajisje rrjeti në gjendje pune në përdorim nga nëpunësit e bashkisë do të jetë i integruar në rrjetin e brendshëm sipas konfigurimeve përkatëse. Kjo infrastrukturë fizike më kushte optimale siguron mirëfunksionimin 24/7 pa kufizime të të gjithë sistemeve të informacionit të implementuara dhe që do të implementohen në të ardhmen në Bashkinë Shkodër. Gjithashtu do të implementohet Sistemi i Kontrollit të Aksesit për të gjithë punonjësit e institucionit pavarësisht pozicionimit të tyre në bashkinë qendrore apo në njësitë administrative. Ky sistem do të jetë i shtrirë edhe në të gjithë njësitë administrative dhe i menaxhueshëm nga qendra në mënyrë të integruar. Sistemi i Vëzhgimit, gjithashtu do të jetë pjesë e këtij projekti, i integruar në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jashtme të godinës qendrore dhe të njësisve administrative i menaxhueshëm nga bashkia qendër. Ky sistem do të ofrojë më shumë siguri dhe transparencë në punën e përditshme të administratës vendore.</p>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse</li> <li>2. Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit</li> <li>3. Ofuesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të implementojë Projektin Teknik në varësi të specifikimeve teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit elektronik</li> <li>4. Trajnimi i stafit të Drejtorisë TIK &amp; SI për menaxhimin e sistemeve përmes software-eve përkatës</li> </ol>	Bashkia e Shkodrës	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>		
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>	Totali (000)	Nga kjo:

		lek)	Paga, sig	operativ e	kapitale
A.1	Projektimi				
A.2	Implementimi I projektit				
A.2.1	<b>Intranet</b> - Furnizim/vendosje e të gjitha pajisjeve fizike të nevojshme për ndërtimin fizik të intranetit në të gjithë ambientet e godinës qendrore të bashkisë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në rregulloren e komunikimit elektronik	3 588			3 588
A.2.2	<b>Kontrolli i Aksesit</b> - Furnizim/vendosje e të gjitha pajisjeve fizike të nevojshme për ndërtimin fizik të sistemit të kontrollit të aksesit dhe konfigurimi i software-it për menaxhimin e tij nga stafi i drejtorisë TIK	884			884
A.2.3	<b>Sistemi i Vëzhgimit</b> - Furnizim/vendosje e të gjitha pajisjeve fizike të nevojshme për ndërtimin fizik të sistemit të vëzhgimit dhe konfigurimi i software-it për menaxhimin e tij nga stafi i drejtorisë TIK	1 578			1 578
A.4	3 Specialistë të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të angazhuar me mbarëvajtjen e implementimit të projektit teknik.  3 Specialistë Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit, si mirëmbajtësit në mënyrë të vazhdueshme të sistemit.				
<b>TOTALI</b>		<b>6 050</b>			<b>6 050</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  <b>Gjatë vitit 2016 (Projekti konsolidohet në një kohëzgjatje 1- mujore )</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse</li> <li>• Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit</li> </ul>			

<b>Nr. 29</b>	<b>Projekti: P1.F1.O2.A2</b> Implementimi i Sistemit të Menaxhimit të Dokumentave në një Bazë të Dhënash Qendrore të Qendëruar dhe të Integruar (Integrated Active Directory System)	<b>Llojet e programit: P1</b> Planifikim, Manaxhim, Administrim <b>Funksioni: P1.F1</b> Administrata Vendore
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
i. Situata		
<p>Në muajin Gusht të vitit 2014 Bashkia Shkodër ka implemetnuar një sistem menaxhimi dokumentacioni të brendshëm të qendëruar në një Server qendror skedarësh (File Server) i cili është i pozicionuar në Dhomën e Serverave. Gjithashtu është implemetnuar dhe konfiguruar edhe një server qendror për manaxhimin e përdoruesve të bashkisë sipas pozicioneve të punës, detyrave dhe të drehtave në akses që ato duhet të kenë (Primary Domain Server) si dhe një server sekondar për back up (Secondary Server). Po në të njëjtën kohë është ngritur dhe implementuar edhe një mail server i brendshëm në të cilin mund të kenë akses përdorues pa limit për komunikimin me e-mail në rrjetin kompjuterik të brendshëm (intranet) si dhe është konfiguruar një Fireëball për mbrojtjen e këtij sistemi elektronik komunikimi. Të gjithë këto server-a të konfiguruar e kanë burimin në Dhomën e Serverave dhe më pas shpërndahen me intranet në të gjithë përdoruesit e institucionit. Ndërkohë ky sistem për shkaqe të mungesës së vullnetit të zbatimit të komunikimit elektronik sipas udhëzimeve në fuqi të paracaktuara nga AKSHI për çdo institucion shtetëror, nuk është zbatuar në praktikë ashtu siç duhet nga punonjësit e bashkisë. Ndërkohë aktualisht ky sistem po zgjerohet në një shkallë më tej, pasi po ngrihet dhe po implementohet një Sistem SMS dhe Mail për komunikim e bashkisë me qytetarët apo insitucione te tjera për njoftimin e tyre me sms për të gjithë statuset e shërbimeve që ato kërkojne nga bashkia dhe për zgjerimin e e-mailit zyrtar për të përfutur një komunikim zyrtar elektronik më të zgjeruar. Megjithatë, situata është e pambuluar plotësisht për shkak të Reformës Territoriale. Në këtë sistem të qendëruar të manaxhimit të dokumentacionit dhe krijimit të bazes së të dhënave qendrore të bashkisë duhet të përfshihen të gjitha Njësitë Administrative. Tashmë gjendemi të vënë para përgjegjësisë së krijimit të sistemit të integruar dhe të qendëruar të manaxhimit të dokumentave përmes një baze të dhënash qendrore për të gjithë bashkinë. Ky sistem siguron dixhitalizimin e administratës vendore, rezultat i të cilës do të jetë prodhimi i dokumentacionit korrekt dhe cilësor i bashkisë.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Të garantojmë transparencë, ofrim të shërbimit pranë qytetarit, profesionalizëm, cilësi e korrektesë, luftë kundër korrupsionit Projekti synon imlementimin e një sistemi të integruar për menaxhimin e një baze të dhënash qendrore të dokumentacionit vendor, një administratë vendore dixhitale si dhe një qeverisje elektronike transparente.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet qëe do të ndërmerri për të prodhuar rezultate)		
<ol style="list-style-type: none"> <li>4. Implementimi i Projektit Teknik, preventivimi dhe prokurimi i pajisjeve TIK (hardëare) të nevojshme (9 server, 9 VPN (Virtual Private Network) Router)</li> <li>5. Konfigurimi i Sistemit të Integruar të Qendëruar i liçensuar (Licensed Integrated Active Directory)</li> <li>6. Ngritja e kapaciteteve dhe asistimi teknik ( trajnimi i stafit TIK në Advanced Active Directory (Drejtoria e Teknologjisë dhe Sisteme të Informacionit, 7 Specialistë)</li> <li>7. Kapitalizimi i Projektit ( mirëmbajtja, monitorimi dhe konsolidimi i Sistemit)</li> </ol>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<p>Në fazën e kapitalizimit të sistemit, duhet të kemi të konfiguruar një sistem të integruar të menaxhimit të të drejtave për akses për të gjithë përdoruesit e bashkisë sipas pozicioneve të punës që ato mbulojnë, strukturës hierarkike dhe organizative të cilave u përkasin, detyrave funksionale që kanë në punë, në një Server Domain Controller qendror. Duhet të kemi të konfiguruar një bazë të dhënash qendrore dixhitale për menaxhimin e dokumentacionit (File Server të integruar) që Bashkia Shkodër prodhon çdo ditë sipas nevojave dhe detyrave funksionale pavarësisht pozicionimit të punonjësve me detyrë në bashkinë qendër apo në njësi administrative. Të gjithë kompjuterat do të jenë të konfiguruar sipas pozicionit të punës që mbulon punonjësi që e përdor, në funksion vetëm të punës së përditshme me të drejta aksesit të kufizuar në menaxhim të sistemit të shfrytëzimit që kanë të instaluar, në përdorim të programeve aplikative, të memorieve masive të jashtme, të shfletimit në internet, të përdorimit të burimeve input/output të përbashkëta (printerat/skaner të përbashkët), të pikave të shpërndarjes së dokumentacionit në rrjet (Share Point i përbashkët) sipas strukturës hierarkike organizative të vendeve të punës që mbulojnë. Për të siguruar komunikimin on-line 24/7 nga bashkia qendër në të gjitha njësitë administrative, duhet të kemi të vedosur atje fizikisht dhe të konfiguruar një server të konfiguruar sipas rregullave të përcaktuar nga Serveri Qendror në bashkinë qendër, si dhe do të sigurohet komunikimi elektronik përmes aksesit më VPN Router. Implementimi i këtij sistemi rrit shpejtësinë e komunikimit të brendshëm ndërmjet një administrate vendore, e cila në këtë fazë quhet dixhitale, ul kostot për kancelari, letër dhe bojë për printerat/fotokopje, rrit transparencën, korrektesinë dhe cilësinë e punës së institucionit si dhe gjurmon çdo procedurë pune nga krijimi, azhurnimi dhe deri tek eliminimi përfundimtar i saj.</p>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>7. Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit në nivel të menaxhimit të vazhdueshëm të këtij sistemi si dhe në nivel trajnimi për nëpunësit e bashkisë.</li> <li>8. Të gjithë nëpunësit e institucionit në nivel të përdorimit të</li> </ol>	Bashkia Shkoder	

përditshëm të këtij sistemi.					
9. Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë pajisjet TIK sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në fazën e prokurimit.					
10. Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i licensuar, i cili do të konfigurimin dhe implementimin e sistemit si dhe te trajnimin të stafit TIK, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në fazën e prokurimit.					
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Blerje Pajisje TIK - 9 Server, 9 VPN Router (të përfshira tek Blerje Pajisje TIK)				
A.2	Konfigurim Sistemi - Active Directory e Integruar e Licensuar	56			56
A.3	Konfigurim, Trajnim teknik i Stafit TIK - Ngritja e kapaciteteve për stafin TIK	588			588
A.4	4 Specialistë Drejtoria TIK & SI ( 1 Drejtor, 2 Përgjegjës, 4 Specialistë) të angazhuar mesatarisht 2-4 orë në ditë me mirëmbajtjen e sistemit sipas nevojave  Të gjithë nëpunësit e insitucionit pavarësisht pozicionit do të punojnë 8 orë në ditë në këtë sistem				
<b>TOTALI</b>		<b>644</b>			<b>644</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b>		<b>g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			
<b>Gjate vitit 2016 (Projekti konsolidohet në një kohëzgjatje 3-mujore)</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit</li> <li>Të gjithë nëpunësit e institucionit në nivel të përdorimit të përditshëm të këtij sistemi.</li> </ul>			



<b>Nr.30</b>	<b>Projekti : P1.F1.O2.A27</b> Mirëmbajtje e ambienteve fizike shtesë të rikonstruara dhe digjitalizimi i arkives	<b>Llojet e programit: P1</b> Planifikim, Manaxhim, Administrim <b>Funksioni: P1.F1</b> Administrata Vendore
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
i. Situata		
<p>Bashkia Shkodër ka nën administrimin e saj një ambient dedikuar arkivës së institucionit në kushte fizike jashtë standartit të duhur për sigurinë e dokumentacionit të saj. Bazuar në Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", Bashkia Shkodër duhet ti sigurojë ambiente fizike të përshtatshme arkivit të dokumentacionit të saj të 10 viteve të fundit. Gjithashtu, në zbatim të Udhëzimit Nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", Bashkia Shkodër tashmë ka në ngarkim të gjithë arkivat e ish-Komunave, sot Njësitë Administrative të saj. Kjo e vështirëson edhe më shumë situatën dhe e vendos Bashkinë Shkodër përpara një gjendje emergjente për të ndërhyrë në mirëmbajtjen fizike të ambienteve aktuale të arkivës së saj dhe në shtimin e ambienteve të nevojshme, me kushte fizike të përshtatshme, për vendosjen dhe sistemimin e dokumentacionit të arkivave të Bashkisë Qendër dhe Njësive Administrative.</p> <p>Në këto kushte, Këshilli i Bashkisë Shkodër përmes VKB Nr. 47, datë 04.12.2015 "Për miratimin e fondit për mirëmbajtje të jashtëzakonshme të ambienteve të arkivës së Bashkisë Shkodër" miratoi shumën prej 2,652,284 lekë për mirëmbajtjen fizike të ambienteve ekzistuese të arkivës së Bashkisë Shkodër, mbështetur në një projekt propozim teknik dhe financiar konkret. Ky burim financiar është marrë nga fondi grant tranzitor i akorduar Bashkisë Shkodër në zbatim të VKM NR. 664, datë 29.07.2015 "Për shpërndarjen e fondit tranzitor për zbatimin e reformës së re administrativo-territoriale". Aktualisht, po përgatiten dokumentat e nevojshme për të vijuar me procedurën e prokurimit të mirëmbajtjes konform specifikimeve teknike dhe financiare të parashikuara.</p> <p>Megjithatë, ambienti ekzistues i arkivës është i pamjaftueshëm në hapsirë dhe kapacitet për të sistemuar të gjithë kapacitetin e dokumentacionit në ngarkim. Sot arkivi i Bashkisë Shkodër ka 200 metër linear dokumenta të papërpunuara të Bashkisë Qendër dhe 249 metër linear dokumeta të papërpunuara të Njësive Administrative. Kushtet aktuale fizike të pafavorshme ndikojnë në mos sistemimin, organizimin, klasifikimin dhe marrjen e të dhënave të dokumentuara në kohën e duhur. Kjo situatë shkakton vonesa dhe kosto shtesë për këtë sektor. Nisur nga kjo situatë, është e domosdoshme shtesa e ambienteve të reja për Arkivën e Bashkisë Shkodër me të paktën 100 m<sup>2</sup>.</p> <p>Nga ana tjetër, dokumentat dhe arkiva në përgjithësi në Bashkinë Shkodër, nuk ruhen në formë dixhitale, por përpunohen dhe ruhen manualisht vetëm fizikisht. Kushtet aktuale ndikojnë në mos sistemimin, organizimin, klasifikimin dhe marrjen e të dhënave të dokumentuara në kohën e duhur. Kjo situatë shkakton vonesa dhe kosto shtesë për këtë sektor. Në këto kushte është e domosdoshëm procesi i dixhitalizimit të dokumentacionit të kësaj arkive. Ky është një proces i parashikuar për tu financuar nga Qeveria Shqiptare për të gjithë bashkitë e vendit tonë, në kuadër të përmblimit të detyrimeve dhe zbatimit të Reformës Territoriale. Ky proces do të zbatohet gjatë vitit 2016, pjesë e të cilit do të jetë edhe Bashkia Shkodër duke ofruar angazhimin e plotë të saj në zbatim me korrektësinë dhe transparencën maksimale kësaj faze kaq të rëndësishme të Reformës Territoriale. Dixhitalizimi i arkivës do të risë sigurinë e informacionit, do të reduktojë nevojën për hapsira fizike për arkivën dhe do të reduktojë kohën e përpunimit të dokumentacionit arkivor.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<p>Zgjerimi i ambienteve dhe përmirësimi i kushteve fizike të tyre për Arkivën qendrore të Bashkisë Shkodër konform standarteve të nevojshme.</p> <p>Automatizimi i proceseve të arkivimit të dokumentacionit të përditshëm dhe historik të Bashkisë Shkodër, përmes një programi (software) në kuadër të dixhitalizimit dhe krijimit të një baze të dhënash qendrore për Protokol-Arkivin e Njësive të Qeverisjes Vendore.</p>		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
Qëllimet dhe objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen	<p>"Mobilitet për jetesë më të mirë, krijimi i hapësirave më miqësore për një cilësi dhe siguri më të lartë" është qëllimi i përgjithshëm i programit të bashkisë së re.</p> <p>Rikualifikimi i mjediseve të përbashkëta dhe rikonstruksioni i rrugëve dhe rrugicave ( karakteristike e qytetit ) mbetet objektiv i punës edhe për vitet në vazhdim.</p> <p>Konkretisht ky investim në degëzimin e Rrugës "Bardeleve" me Rrugën "Pogej" konsiston në përmirësimin e mjedisit urban dhe në mënyrë të veçantë të kthimit në një rrugë me standarde në shërbim të komunitetit. Ndërhyrja në rrjetin nëntokësor, rivlerësim i ndriçimit si dhe krijimi i hapësirave të gjelbërta rrit cilësinë dhe sigurinë e jetës së banorëve.</p>

## 0.3. Kostot e Projektit të Investimi

	TOTALI	Investimi	Projektim
Kosto e zbatimit	6 885.0	6 885.0	
Kosto kolaudim supervizim	207.0	207.0	
Kosto e projektimit	344.0		344.0
Kosto për leje mjedisi + VNM	13.5	13.5	
Kosto Totale e Projektit 000/lekë	7 449.5	7 105.5	344.0

## 04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit Statusi i Projektit Idesë
Drejtuesi i Programit në Institucionin Buxhetor (IB)				
Komente nga Drejtuesi i Programit				
Sekretari i Përgjithshëm				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idese
Komente nga Sekretari i Përgjithshëm				

## RIKUALIFIKIM URBAN BLOQE BANIMI "TEPE-TEK FUSHA E DRUREVE"

Kodi në matricë : P3.F1.O2. A7.

## 01. Personat e Kontaktit

<b>Emri i propozuesit të projektit</b>	Bashkia Shkodër	<b>Firma e propozuesit të Projektit</b>	
<b>Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit</b>	Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve		
<b>Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori</b>	Bashkia e Shkodrës	<b>Vendodhja e Projektit</b>	Bashkia e Shkodrës Rajoni 2

## 02. Identifikimi i Idesë së Investimit

<b>Projekt Idea</b>	
<b>Problemet për tu adresuar</b>	<p>Sheshi publik ndërmjet blloqeve të pallateve " Tepe- tek Fusha e drureve" ka një sipërfaqe 5000 m<sup>2</sup>. Ai kufizohet me rrugën "7 Shaljanët" në anën perendimore që është pjesë e unazes Lindore të qytetit. Sheshi është i rrethuar nga të gjitha anët me pallate 4 – 5 kateshe. Afër zonës ndodhet shkolla "Mark Lula" aktualisht e ndërtuar sipas standarteve bashkëkohore.</p> <p>Në këtë bllok banimi jetojnë afërsisht 800 banorë. Në këtë shesh ka mungesë të sistemit K.U.B, K.U.Z., ujësjellësit dhe ndriçimit.</p> <p>Prej shumë vitesh ky shesh nuk ka pasur ndërhyrje në infrastrukturën rrugore dhe kjo ka bërë që gjendja e tij të jetë aq kritike sa që të vështirësohet kalimi i qytetarëve sidomos në kohë rreshjesh.</p> <p>Përfituesit direkt të projektit janë 800 banorët e zonës, nga të cilët ka nxënës që frekuentojnë kopshtet dhe shkollat afër zonës</p>
<b>Emri i Programit</b>	Infrastrukturë rrugore
<b>Qëllimet dhe objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen</b>	<p>"Mobilitet për jetesë më të mirë, krijimi i hapësirave më miqësore për një cilësi dhe siguri më të lartë" është qëllimi i përgjithshëm i programit të bashkisë së re.</p> <p>Rikualifikimi i mjediseve të përbashkëta dhe rikonstruksioni i rrugëve dhe rrugicave, i sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, apo ndërtimin e sistemeve të reja, shërbimi i ndriçimit rrugor dhe përmirësimi i tij mbetet objektiv i punës edhe për vitet në vazhdim.</p> <p>Konkretisht ndërhyrja në sheshin mes blloqeve të " Tepe- tek Fusha e drureve" konsiston në përmirësimin e mjedisit urban dhe në mënyrë të veçantë të kthimit në një shesh me standarte në shërbim të komunitetit. Ndërhyrja në rrjetin nëntokësor, në ndriçim, në gjelbërim, rrit cilësinë dhe sigurinë e jetës së banorëve.</p>

## 0.3. Kostot e Projektit të Investimit

	TOTALI	Investimi	Projektim
<b>Kosto e zbatimit</b>	34 500.0	34 500.0	
<b>Kosto kolaudim supervizim</b>	1 035.0	1 035.0	
<b>Kosto e projektimit</b>	1 725.0		1 725.0
<b>Kosto për leje mjedisi + VNM</b>	13.5	13.5	
<b>Kosto Totale e Projektit 000/lekë</b>	<b>37 273.5</b>	<b>35 548.5</b>	<b>1 725.0</b>

## 04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt idese

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit Statusi i Projektit Idesë
<b>Drejtuesi i Programit në Institucionin Buxhetor (IB)</b>				
<b>Komente nga Drejtuesi i Programit</b>				
<b>Sekretari i Përgjithshëm</b>				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt idese
<b>Komente nga Sekretari i Përgjithshëm</b>				

RIKUALIFIKIM URBAN I RRUGICAVE NË QËNDREN HISTORIKE, (RIKONSTRUKSION SISTEMIT UJËSSELLES KANALIZIME)

Kodi në matricë P3.F1.O2. A8

**01. Personat e Kontaktit**

<b>Emri i propozuesit te projektit</b>	Bashkia Shkodër	<b>Firma propozuesit te Projektit</b>	
<b>Te dhena te detajuara per propozuesin e projektit</b>	Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve		
<b>Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori</b>	Bashkia Shkodër	<b>Vendodhja e Projektit</b>	Bashkia Shkodër Rajoni 2, 3

**02. Identifikimi i Idese se Investimit**

<b>Projekt Idea</b>	
<b>Problemet per tu adresuar</b>	<p>Ne vitin 2015 kanë filluar punimet për objektin "Rikualifikimin urban të rrugicave ne Qendren Historike", me financim te F.ZH.R., ku perfshihet sistemimi i kanalizimeve të ujërave të bardha, ndriçimit dhe shtrimi i siperfaqes me gurë dekorativë i 13 rrugicave (Rr.Ndoc Çoba, Rr.Fran Baron Nopça, Rr.Bërdicej, Rr.e Murgeshave, Rr.Gurazezeve, Rr.Gurakuqëve, 2 degëzime te Rr.Gjuhadol, 5 degëzime të Rr.Kol Idromeno).</p> <p>Prej shumë vitesh këto rrugica nuk kanë pasur ndërhyrje në infrastrukturën nëntokësore (K.U.Z. dhe ujësjellës) dhe kjo ka bërë që gjëndja e tyre të jetë tepër e amortizuar.</p> <p>Përfituesit direkt të projektit janë rreth 650 banorë të këtyre 13 rrugicave. Gjithashtu këto rrugica kanë vlerë të madhe historike.</p>
<b>Emri i Programit</b>	Infrastrukturë rrugore
<b>Qellimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen</b>	<p>"Mobilitet për jetesë më të mirë, krijimi i hapësirave më miqësore për një cilësi dhe siguri më të lartë" është qëllimi i përgjithshëm i programit të bashkisë së re.</p> <p>Rikualifikimi i mjediseve të përbashkëta dhe rikonstruksioni i rrugëve, blloqeve të pallateve dhe rrugicave (karakteristikë e qytetit) mbetet objektiv i punës edhe për vitet në vazhdim. Konkretisht, rikualifikimi urban i rrugicave në Qëndren Historike, (Rikonstruksion sistemit Ujësjeselles kanalizime) sjell përmirësimin e mjedisit urban dhe në mënyrë të veçantë të kthimit në një rrugë me standarte në shërbim të komunitetit. Ndërhyrja në sistemimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve te ujërave të zeza, rrisin cilësinë dhe sigurinë e jetës së banorëve.</p>

**0.3. Kostot e Projektit te Investimit**

<b>Kosto e zbatimit</b>	<b>17 714 462</b>
<b>Kosto kolaudim supervizim</b>	<b>531 434</b>
<b>Kosto për leje mjedisi + VNM</b>	<b>14 000</b>
<b>Kosto Totale e Projektit leke</b>	<b>18 259 896</b>

**04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idese**

	Emri	Nenshkrimi	Data	Qellimi i rishikimit <i>Statusi i Projektit Idese</i>
<b>Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)</b>				
<b>Komente nga Drejtuesi i Programit</b>				
<b>Sekretari i Pergjithshem</b>				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idese
<b>Komente nga Sekretari i Pergjithshem</b>				

## REHABILITIMI I SHESHIT " GJON PALI"

Kodi në matricë : P3.F1.O2.A9.

## 01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit te projektit	BASHKIA SHKODER	Firma propozuesit te Projektit	
Te dhena te detajuara per propozuesin e projektit	DREJTORIA E STUDIMEVE PLANIFIKIMIT KOORDINIMIT DHE MONITORIMIT TE INVESTIMEVE.		
Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori	FZHR/FSHZH	Vendodhja e Projektit	Qyteti Shkoder/Bashkia Shkoder

## 02. Identifikimi i Idese se Investimit : Rehabilitimi i sheshit " Gjon Pali"

Projekt Idea	Projekt zbatimi i plote
Problemet per tu adresuar	Projekt ne vazhdim .
Emri i Programit	<b>Infrastruktura vendore</b>
Qellimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen	Objektivat e projektit konsistojne Rivleresimin e Qendres Historike sheshit te krijuar para Katedrales se Shesh Shtjefnit . Rivleresimin e arkitektures tradicionale dhe elementeve karakteristike te saj.

## 0.3. Kostot e Projektit te Investimit

Kosto Totale e Projektit leke	<b>1.333.124</b> Sipas marreveshjes me FSHZH planifikohet pagesa prej 666.562 leke
-------------------------------	---

## 04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idese

	Emri	Nenshkrimi	Data	Qellimi i rishikimit Statusi i Projektit Idese
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi per tu shqyrtuar me tej
Komente nga Drejtuesi i Programit				
Sekretari Pergjithshem				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idese
Komente nga Sekretari i Pergjithshem				

Rikualifikim urban i rrugicave ne Qendren Historike  
Kodi në matricë P3.F1.O2. A10

**01. Personat e Kontaktit**

Emri i propozuesit të projektit	BASHKIA SHKODËR	Firma e propozuesit të Projektit	
Te dhena te detajuara per propozuesin e projektit	DREJTORIA E STUDIMEVE PLANIFIKIMIT KOORDINIMIT DHE MONITORIMIT TË INVESTIMEVE.		
Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori	FZHR/FSHZH	Vendodhja e Projektit	Bashkia e Shkodrës

**02. Identifikimi i Idesë së Investimit :** Rikualifikim urban i rrugicave ne Qendren Historike ( kthimi i tyre me kalldrëm dhe ndriçim dekorativ) shoqëruar me ndërhyrje në dyert e objekteve – kthim i tyre në dyer druri karakteristike

Projekt Idea	Projekt zbatimi i plotë
Problemet per tu adresuar	Projekt ne vazhdim
Emri i Programit	<b>Infrastrukturë vendore</b>
Qëllimet dhe objektivat e Programit të cilat projekti do te ndihmoje te arrihen	Objektivat e projektit konsistojne Rivleresimin e Qendres Historike, kthimin e rrugicave me gure ne pershtatje me akset kryesore, në ofrimin e një infrastrukture sipas standarteve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj. Rivleresimin e arkitektures tradicionale dhe elementeve karakteristike te saj, sic jane edhe dyert shkodrane.

**0.3. Kostot e Projektit te Investimit**

Kosto Totale e Projektit leke	<b>2.883.796</b> Sipas marreveshjes me FSHZH planifikohet pagesa prej <b>1,444,891 leke</b>
-------------------------------	--

**04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idese**

	Emri	Nenshkrimi	Data	Qellimi i rishikimit Statusi i Projektit Idese
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi per tu shqyrtuar me tej
Komente nga Drejtuesi i Programit				
Sekretari Pergjithshem				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idese
Komente nga Sekretari i Pergjithshem				

Nr. 12	<b>P3.F1.O2. A11</b> Sistemim sheshe plazhi Velipoje	<b>Llojet e programit: P3:</b> Infrastruktura rrugore <b>Funksioni: P3.F1.</b> Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;
a) Pershkrimi i shkurter i projektit		
i. Situata		



Pozita e favorshme gjeografike ku ndërthuren harmonishëm deti, lumi, pyjet, laguna dhe malet, i japin një siguri zhvillimit të turizmit në Velipojë. Plazhi me gjatësi 14 km me gjërësi prej 70 deri 200 m, rëra e pashfrytëzuar dhe me aftësi shëruese si dhe uji i pastër po bëjnë që Velipojë të frekuentohet çdo vit e më tepër nga pushues të vendit dhe të huaj. Numri i pushuesve llogaritet rreth 70 mijë pushues në ditë në sezonin veror Qershor-Gusht.

Kapaciteti akomodues i hoteleve është më shumë se 7 mijë dhoma ose rreth 27 mijë shtretër. Por në Velipojë përveç turizmit detar mund të zhvillohet dhe ai lumor, malor si dhe gjuetia e shpendëve të egër dhe e lepujve. Lumi Buna dhe territoret ligatinore rreth tij, i shpallur në 2005 "Peisazh ujor/tokësor i mbrojtur" ku hynë dhe ishulli i Franc Jozefit, rezervati i Velipojës, laguna e Vilunit, plazhi i Baks – Rrjollit dhe kënetat e Domnit është një tjetër avantazh për zhvillimin e turizmit në Velipojë.

Megjithë mundësitë për një zhvillim të qëndrueshëm që zona e Velipojës ofron, ajo vazhdon të përballet me problematika të shumta që kanë të bëjnë kryesisht me infrastrukturën e pazhvilluar dhe aftësinë e kufizuar për të pranuar rritjen e turistëve dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij destinacioni turistik në të ardhmen. Ndërprerja e furnizimit me ujë, mungesa e sistemit të kanalizimit të ujrave të zeza, të energjisë elektrike, të vendeve të parkimit, të sipërfaqeve me rrugë të asfaltuar, ndriçimit, sistemit të kullimit, zbulimit të hapësirave publike, të sinjalistikës rrugore dhe asaj turistike, vazhdon të mbetet gjithashtu një problem.

Ky projekt propozim synon të përmirësojë infrastrukturën ekzistuese, përmes sistemit të rrugëve të brendshme dhe rrjetit rrugor të komunikimit në territorin e plazhit me vendosjen e sinjalistikës së nevojshme, ndërtimin e trotuareve dhe parkingjeve publike rreth zonave me ndërtime të përqendruara ekzistuese, përmirësimin e shërbimeve publike, përmes ndërhyrjeve në rrjetin e ndriçimit publik, krijimin e ambjenteve argëtuese fuqizimin e sistemit të shërbimit për vizitorin duke përmirësuar infrastrukturën dhe rritur mjetet e informimit, përmes përmirësimit të sinjalistikës.

ii. Synimi i projektit

Fuqizimi i sistemit të shërbimit për vizitorin duke përmirësuar infrastrukturën dhe rritur mjetet e informimit  
Rritja e cilësisë së shërbimeve publike

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Vendosja e tabelave informuese për destinacionin;
- Sistemimi i rrugëve të brendshme në plazhin e Velipojës dhe vendosja e sinjalistikës së nevojshme;
- Riparime i trotuareve;
- Sistemim i parkingjeve publike;
- Rehabilitim në rrjetin e ndriçimit publik ekzistues
- Përmirësimi i ambjenteve shlodhëse dhe argëtuese

#### b) Rezultatet që prisni

- Sinjalistikë e përmirësuar
- Rruge të brendshme dhe trotuare të rehabilituara me sinjalistikë përkatëse;
- Parkingje publike funksionale
- Rrjeti i ndriçimit publik i përmirësuar;
- Ambiente rekreative

#### c) Aktoret e mundshme

- Bashkia Shkoder
- Bizneset përfituese të turizmit.
- Dhoma e Tregtisë dhe industrisë
- Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Turizmit.

#### d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia e Shkodrës.

#### e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Vendosja e tabelave informuese për destinacionin;				
A.2	Sistemimi i rrugëve të brendshme në plazhin e Velipojës				
A.3	Riparime i trotuareve;				
A.4	Sistemim i parkingjeve publike				
A.5	Mirëmbajta dhe ndërhyrje në rrjetin e ndriçimit publik				
A.6	Përmirësimi i ambjenteve shlodhëse, argëtuese				
	Shuma	<b>5,067</b>			<b>5,067</b>

#### f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur perfundon)

1 Mars 2016 – 15 Qershor 2016

#### g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:

Drejtorja e Shërbimit dhe Infrastruktura

## SISTEMIMI I PERROIT KUFIRI MURIQAN

Kodi në matricë : P3.F1.O3.A1

## 01. Personat e Kontaktit

<b>Institucioni Buxhetor</b>	Bashkia e Shkodrës	<b>Departamenti</b>	Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve
<b>Emri dhe pozicioni i propozuesit të projektit</b>	Voltana Ademi	<b>Detajet e kontaktit të propozuesin e projektit (tel, email)</b>	
<b>Personi i kontaktit Buxhet &amp; Finance</b>		<b>Detajet e kontaktit të Buxhet &amp; Finance</b>	

## 02. Identifikimi i Investimit

<b>Ministria/group/sektori (Institucioni buxhetor)</b>	Bashkia e Shkodrës/ Ministria e Zhvillimit Urban	<b>Kodi i Grupit</b>	
<b>Emri i Programit</b>	Infrastrukturë Vendore	<b>Kodi i Programit</b>	
<b>Emri i Projektit</b>	SISTEMIMI I PERROIT KUFIRI MURIQAN	<b>Kodi i Projektit</b>	
		<b>Numri i identifikimit nga DMIP</b>	
		<b>Vendodhja e Projektit</b>	Bashkia e Shkodrës/ Njesia Administrative Ana e Malit
<b>Statusi i Projektit</b>	I ri	<input checked="" type="checkbox"/>	<b>Financimi nga Donatori</b>
	Në vazhdim	<input type="checkbox"/>	
<b>Data e Fillimit</b>	2016	<b>Data e Perfundimit</b>	2016

## 03. Justifikimi i Investimit

<p><b>Problemet e gjendjes aktuale që duhen adresuar/ Justifikimi i nevojës për investime</b></p> <p>Perroi i kufirit (Bardaivelit), është vija kufitare me Malin e Zi. Ky perrua me gjatësi afërsisht 7 km me burim nga pellgu ujembledhës i Taraboshit, përkohësisht në kufi toka bujqësore të fshatit Shtuf, Muriqan, Gorice dhe Vidhgare.</p> <p>Perroi mëqëse është vijë kufitare, nuk është pastruar, sistemuar dhe mirembajtur asnjëherë dhe për pasojë shtrati i tij është mbushur me bime, shkurre, pemë e material inerte dhe për pasojë uji del nga shtrati duke shkaktuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmbajtjen të sip. 200 ha toke bujqësore dhe demtimin e kulturave bujqësore të katër fshatrave.</li> <li>• Ka bërë erodimin e tokës bujqësore, duke e bërë atë joproduktive.</li> <li>• Ka bërë zhavorizimin të sipërfaqeve të konsiderueshme.</li> <li>• Ka bërë demtimin e rrugëve rurale.</li> </ul> <p><b>Perputhja e projektit me Qëllimet dhe Objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të realizohen</b></p> <p>Perroi i Bardaivelit me gjatësi prej 7 km, parashikohen të pastrohet 4 km, në pjesën e poshtme të tij, pasi pjesa tjetër ndodhet në zonën malore.</p> <p>Segmenti që do të reabilitohet fillon nga kuota 12.7 m dhe mbaron në kuotën 5.3 m, në bashkimin me kanalën kullues në Gorice, me gjatësi 4 km.</p> <p>Pellgu ujembledhës i këtij perroi ka një sip. rreth 4.2 km<sup>2</sup>, të shtrirë në shpatin e malit të Taraboshit. Furnizimi me ujë ky perrua e merr nga rreshjet dhe disa burime të vogla në këtë pellg ujembledhës.</p>
--

## 07. Specifikimi i Projektit &amp; Analiza e Alternativave të Investimit

<p><b>Objektivi i Investimit</b></p> <p>Pastrimi i perroit të Bardaivelit është i rëndësishëm, pasi parandalon përmbajtjen e sip. 200 ha tokës bujqësore, si dhe demtimin e kulturave bujqësore të katër fshatrave.</p> <p>Parandalohet demtimi i rrugëve rurale. Parandalohet zhavorizimi i sip. të konsiderueshme bujqësore.</p> <p>Gjithashtu parandalohet erodimi i tokës bujqësore.</p>
<p><b>Pershkrimi i Projektit</b></p> <p>Pastrimi i perroit nga vegetacioni, germimi i depozitimeve aluvionale në seksionin e kanalit, për ta seksionuar këtë perrua, si dhe sistemimi dhe rrafshimi i materialit të gërmuar në bankinën e perroit, janë masat që parashikohen të merren.</p>

<p>Ne piketat te percaktuara ne projekt, do behet seksionimi i perroit ne menyre te tille, qe perroi te kete nje kapacitet prej 25 m<sup>3</sup>/s dhe te perballoje rreshje me itensitet i=20 mm.  Punimet parashikohen te kryhen me makineri te renda, eskavator me zingjir me krah te gjate 15 m dhe me kove 0.5 m<sup>3</sup>.  Kryerja e punimeve duhet te behet ne periudhen pa reshie, pasi ne raste rreshjesh eshte e pamundur pastrami i ketij kanali, nga grumbullimi i ujrave malore, si dhe rendimenti i punes do te ishte i ulet.</p>			
<b>Alternativa 1 -</b>		<b>Pershkrimi i alternativës së investimit 1</b> Realizimi i projektit	
<b>Alternativa e Investimit (e perzgjedhur)</b>		<b>Arsyet per zgjedhjen e alternativës së investimit</b>	
<b>Produktet-et qe do te realizoj ky investim (dhe sipas rastit perfitimet te tjera qe rezultojne nga investimi)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Do te parandalohen permytjet ne tokat bujqesore</li> <li>Do te parandalohen demtimi i kulturave bujqesore</li> <li>Do prandalohet demtimi i rrugeve rurale</li> </ul>			
	<b>Sasia e Produktit</b>	<b>Njesia Matese</b>	<b>Kosto per njesi</b>
<b>Produkti 1</b> Siperfaqe e gjelber			
<b>Produkti 2</b> Asfalt			
<b>Produkti 3</b> Ndricues			

#### 12. Kostot (shpenzimet kapitale) e meparshme te projektit

<b>Kosto e investimit deri ne fund te 2013 , 000/leke</b>		<b>Kosto e investimit deri ne fund te 2014 , 000/leke</b>	
---	--	---	--

#### 13. Kostot e Investimit / Te Ardhurat nga Investimi

Kostot e Projektit te Investimit	2016 (000/Leke)	2017 (000/Leke)	2018 (000/Leke)	Kostoja e mbetur e investimit (000/Leke)	Kosto totale e Investimit 000/Leke
(a) Kosto e investimit	8 438				8 438
(b) Kosto periodike (shpenzimet korente) si rezultat i investimit					
(c) Totali (a+b)					
(d) Te ardhurat si rezultat i investimit					
(e) Financimi nga donoret					
(f) Kostoja Neto					
<b>Supozimet e bera ne vleresimin e kostove dhe te ardhurave te investimit</b>	a) Kosto e investimit b) Kosto e kolaudim supervizim c) Kosto e projektimit ( 390 ) d) Kosto për leje mjedisi + VNM				

#### 14. Menaxhimi i Projektit, parakushtet & rreziqet

<b>Parakushtet dhe Rreziqet ne zbatimin e projektit; dhe veprimet e planifikuara per eliminimin e efektit te tyre</b>			
-Nuk Ka			
<b>Permbledhje e menyres dhe rolit te institucioneve qe do te menaxhojne projektin.</b>			
Bashkia e Shkodrës			
<b>(Dokumentet e meposhteme kerkohen vetem per vleresimin e "nivelit te mesem ose te "plote")</b>			
<b>Plani i Projektit i zhvilluar</b>	Po /Jo	<b>Plani i Projektit bashkengjitur</b>	Po /Jo
<b>Studimi i fizibilitetit i zhvilluar</b>	Po /Jo	<b>Studimi i fizibilitetit bashkengjitur</b>	Po /Jo

#### 15. Vleresime te tjera per projektin


<b>(Dokumentet e meposhteme kerkohen vetem per vleresimin e "nivelit mesem ose te plote")</b>	
Vlersimi i ipaktit mjedisor	<b>dokumente bashkengjitur</b>
Vlersimi i ipaktit social	Po / Jo / Te panevojshme
Te tjera - (specifiko)	Po / Jo / Te panevojshme

#### 16. Informacione te tjera

<b>Lista e dokumentacionit mbeshtetes derguar ne MF</b>
Buxheti i Bashkisë Shkodër
<b>Komente te tjera</b>

**17. Autorizuesit / Hapat dhe statusi i vleresimit projektit**

	Emri	Nenshkrimi	Data	Qellimi i rishikimit <i>Statusi i Aprovimit te Projektit</i>
<b>Drejtuesi i Programit te Institucionit Buxhetor (IB)</b>	Voltana Ademi			Aprovuar/refuzuar per tu analizuar me tej <i>Prioriteti i projektit te propozuar</i>
<b>Komente nga Drejtuesi i Programit</b>				
<b>Drejtuesi i Finances/Buxhetit se Institucionit buxhetor</b>				Aprovimi / refuzimi i kosos se projektit
<b>Komente nga Departamenti i Buxhetit / Finances i IB</b>				
<b>Drejtuesi i Institucionit Buxhetor (Sekretari i Pergjithshem)</b>	Voltana Ademi			Konfirmimi i prioritetit te projektit <i>Aprovuar/Refuzuar nga IB</i>
<b>Komente nga Drejtuesi i Instutucionit Buxhetor, Sekretari i Pergjithshem</b>				
<b>Ministria e Financave/ Drejtoria e Manaxhimit te Investimeve Publike (DMIP)</b>				Shqyrtim i propozimit <i>Vleresimi i MF</i>
<b>Komente nga DMIP/MF per projektin e paraqitur</b>				



Nr	Projekti : P3.F1.O3.A2 Mirëmbajtje e rrugëve Rurale	Llojet e programit P3: Infrastruktura rrugore Funksioni P3F1:Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;																								
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>																										
i. Situata																										
<p>Bashkia e Shkodrës është përgjegjëse në territorin e juridiksionit të saj në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bazuar në ligjin Nr. 139/2015 dt. 17. 12. 2015, <b>“PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”</b>, Neni 23, <b>Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike</b>, pika 4: Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.</p> <p>Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 915, datë 11.11.2015, <b>“Për transferimin në pronësi, nga Këshillat e Qarqeve të Bashkitë, të rjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve”</b>, neni 1, kalon në administrim të Bashkisë së Shkodrës fondin e rrugëve rurale sipas tabelës:</p>																										
<table border="1" data-bbox="488 718 1130 1066"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Emërtimi i rrugës</th> <th>km</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Fermentim – Ura e Mesit – Muri i Turkut</td> <td>19</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Ura e Mesit – Prekal – Kir – Bregu i Lumit – Theth</td> <td>76</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Guri i Mathes – Komuna Pog</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Degëzim Ndreaj – Komuna Shosh</td> <td>2,5</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Degëzim asfalt Velipojë – Komuna Dajç</td> <td>7,5</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>Qafë Thore – Theth</td> <td>16</td> </tr> <tr> <td colspan="2" style="text-align: center;"><b>TOTALI</b></td> <td>125</td> </tr> </tbody> </table>			Nr	Emërtimi i rrugës	km	1	Fermentim – Ura e Mesit – Muri i Turkut	19	2	Ura e Mesit – Prekal – Kir – Bregu i Lumit – Theth	76	3	Guri i Mathes – Komuna Pog	4	4	Degëzim Ndreaj – Komuna Shosh	2,5	5	Degëzim asfalt Velipojë – Komuna Dajç	7,5	6	Qafë Thore – Theth	16	<b>TOTALI</b>		125
Nr	Emërtimi i rrugës	km																								
1	Fermentim – Ura e Mesit – Muri i Turkut	19																								
2	Ura e Mesit – Prekal – Kir – Bregu i Lumit – Theth	76																								
3	Guri i Mathes – Komuna Pog	4																								
4	Degëzim Ndreaj – Komuna Shosh	2,5																								
5	Degëzim asfalt Velipojë – Komuna Dajç	7,5																								
6	Qafë Thore – Theth	16																								
<b>TOTALI</b>		125																								
<p>Ky fond i shtohet fondit të inventarit të rrugëve që kanë qënë në funksion për mirëmbajtje të ish komunave ( Njësi administrative sot ) km _____</p>																										
<p>Për vitin 2016 në Ligjin nr 147/2015 “ Për buxhetin e vitit 2016”, Neni 15: Transfertat e pakushtëzuara, që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transfertat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet njësi të pushtetit vendor, sipas formulës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar dhe specifike për çdo njësi të pushtetit vendor paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij ligji. Kjo transfertë për Bashkinë e Shkodrës është 17,857,000 lekë.</p>																										
<p>Për vitin 2016 prioritetet për riparime në të gjithë territorin e bashkisë janë ndërhyrjet në axet e mësipërme, riparimi i :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ura e Gimajve mbi lumin Shalë. Kjo urë ndodhet mbi lumin Shalë dhe është mirëmbajtur ndër vite. Ajo bën lidhjen e Fshatrave Gimaj dhe Nenmavriq me qëndren e njësisë administrative, ku kalojnë makina dhe këmbësore. Shtresa e dërrasës është tepër e amortizuar në disa vende.</li> <li>• Ura e Breglumi mbi lumin Shalë. Kjo urë ndodhet mbi lumin Shalë dhe është mirëmbajtur ndër vite. Ajo bën lidhjen e Fshatrave Camaj dhe Nenmavriq me qëndren e komunës, ku kalojnë makina dhe këmbësore. Shtresa e dërrasës është tepër e amortizuar në disa vende.</li> <li>• Riparimii i rrugës Sheldi, 3.8 km. Eshtë e domosdoshme riparimi i trupit të rrugës, si dhe ndërtimi i shtresave të rrugës, së bashku me sinjalistikën, sipas parametrave. Ndërtimi i rrugës në këtë zonë është me rëndësi për komunitetin. Rruga lidh fshatrat me njeri tjetrin. Në projekt parashikohen mbushje dhe gërmim, sipas profilit gjatësor dhe terthor, të realizuar nga topografi.</li> </ul>																										
<ul style="list-style-type: none"> <li>• ii. Synimi i projektit</li> <li>• Të sigurojë administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrugëve, në pronësi të bashkisë, sipas legjisllacionit në fuqi. (VKM Nr.1108, datë 30.12.2015)</li> <li>• Të sigurojë akses më të mirë për qytetarët në shërbimet</li> <li>• Të rrisë sigurinë e lëvizjes në rrugë të automjeteve</li> <li>• Të sigurojë nivelet optimale të lëvizshmërisë në funksion të bizneseve sipas zonave.</li> </ul>																										
<ul style="list-style-type: none"> <li>• iii. Aktivitetet kryesore të projektit</li> <li>• Parashikimi në buxhetin e Bashkisë për vitin 2016</li> </ul>																										

<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Hartimi i kalendarit të ndërhyrjeve</li> <li>○ Përcaktimi i volumeve të punës</li> <li>○ Alokimi i fondeve</li> <li>• Riparim ura Gimaj</li> <li>• Riparim ura Breglumi</li> <li>• Riparim rruga Sheldi</li> <li>• Shërbime në axet rrugore</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Funkionim i mirë i strukturës</li> <li>• Kryerje sipas kërkesave të shërbimit</li> <li>• Ujitja kryhet në kohë dhe me sasinë dhe cilësinë e kërkuar</li> <li>• Parcelat e mbjella me kultura nuk përmblyten</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Bujqësisë pranë Bashkisë së Shkodrës</li> <li>• Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore</li> </ul>			Bashkia e Shkodrës			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo:		
				Paga, sig	operativ e	kapitale
A.1	Procedura administrative dhe të përgatitjeve					
A.2	Riparim ura Gimaj			460		
A.3	Riparim ura Breglumi			460		
A.4	Riparim rruga Sheldi			2,500		
A.5	Shërbime Riparimi axeve te rrugeve			14,437		
	A5.1	Blerje baze materiale .	1800			
	A5.2	Mjete Transporti	563			
		A.5.2.1		Karburant		204
		A.5.2.2		Pjesë këmbimi		100
		A.5.2.3		Mirëmbajtje		159
		A.5.2.4		Siguracion		100
	A.5.3	Riparime akseve rrugore	12.074		12 074	
<b>Shuma TOTALE</b>			<b>17 857</b>		<b>17 857</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit Janar- Dhjetor 2016</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e shërbimeve publike</b>			

## MBIKQYRJE+KOLAUDIM RIKONSTRUKSION I BLOKUT TE PALLATEVE "XHABIJE"

Kodi në matricë: P3.F1.O2. A12

### 01. Personat e Kontaktit

<b>Emri i propozuesit te projektit</b>	Bashkia Shkoder	<b>Firma propozuesit te Projektit</b>	
<b>Te dhena te detajuara per propozuesin e projektit</b>	Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve		
<b>Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori</b>	Bashkia e Shkodrës	<b>Vendodhja e Projektit</b>	Bashkia e Shkodrës Rajoni 4

### 02. Identifikimi i Idese se Investimit

<b>Projekt Idea</b>	
<b>Problemet për tu adresuar</b>	<p>Ky bllok paallatesh me një sipërfaqe prej 58940 m2, aktualisht është i degraduar, me mangësi të sistemit K.U.B., K.U.Z. të rrjetit të ndriçimit dhe rrjeti të ujësjellësit. Duhet të rivlerësohen gjelbërimi dhe hapësirat rekreative të zonës.</p> <p>Prej shumë vitesh ky bllok pallatesh nuk ka pasur ndërhyrje në infrastrukturën rrugore dhe kjo ka bërë që gjëndja e tij të jetë aq kritike sa që të vështirësohet kalimi i qytetarëve sidomos në kohë rreshjesh.</p> <p>Përfituesit direkt të projektit janë rreth 5000 banorë në total.</p> <p>Ky bllok ka një rëndësi të veçantë për shkak të pozicionimit që ka në hyrje të qytetit dhe afërsisë që ka me institucione të ndryshme shkollore si psh. me Shkollën "Kolë Idromeno", me Shkollën "Ndre Mjeda", me Shkollën "3 Dhjetori" etj.</p>
<b>Emri i Programit</b>	Infrastrukturë rrugore
<b>Qellimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen</b>	<p>"Mobilitet për jetesë më të mirë, krijimi i hapësirave më miqësore për një cilësi dhe siguri më të lartë" është qëllimi i përgjithshëm i programit të bashkisë së re.</p> <p>Rikualifikimi i mjediseve të përbashkëta dhe rikonstruksioni i rrugëve dhe rrugicave, mbetet objektiv i punës edhe për vitet në vazhdim.</p> <p>Përmirësimi i kushteve të kësaj rruge konsiston në përmirësimin e mjedisit urban dhe në mënyrë të veçantë në kthimi në një rrugë me standarte në shërbim të komunitetit. Ndërhyrja në rrjetin nëntokësor, rivlerësim i ndriçimit rrit cilësinë dhe sigurinë e jetës së banorëve.</p>

### 0.3. Kostot e Projektit te Investimit

	<b>Totali</b>	<b>Viti 2016</b>	<b>Viti 2017</b>
<b>Kosto e mbikqyrjes</b>	1 394 218	<b>697 000</b>	697 218
<b>Kosto e kolaudimit</b>	137 300		137 300
<b>000/leke</b>			

### 04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idese

	<b>Emri</b>	<b>Nënshkrimi</b>	<b>Data</b>	<b>Qëllimi i rishikimit Statusi i Projektit Idese</b>
<b>Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)</b>				
<b>Komente nga Drejtuesi i Programit</b>				
<b>Sekretari i Pergjithshem</b>				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idese
<b>Komente nga Sekretari i Pergjithshem</b>				

Nr.1-7	<b>Projekti : P4.F1.01.A1/A2/A3/A4/A5/A6/A7</b> Shërbimi i pastrimit	<b>Llojet e programit :</b> P4. Shërbimet Publike <b>Funksioni :</b> P4.F1. Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane;
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p><b>Shërbimi i Pastrimit në qytet</b> kryhet me sipërmarrje private nëpërmjet kontratës 5 – vjeçare të nënshkruar me datë 1.10.2013 dhe shtrihet në të gjithë qytetin. Proceset kryesore që kryhen janë;</p>		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1- Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane në landfill, në sasi rreth 70 ton mbeturina në ditë, e përlogaritur me një normativë prej 0.64 kg mbeturina për frymë në ditë. Grumbullimi i mbetjeve realizohet nga përdorimi i 560 kazaneve metalike 1 100 litër. Këto kazanë janë të vendosur sipas një plani të parapërcaktuar. Normativa e vendosjes së këtyre kazaneve është maksimumi 200 m distancë.</li> <li>2- Fshirje mekanike dhe manuale e rrugëve. Rrugët janë të përcaktuara me m<sup>2</sup> dhe fshirja e tyre bëhet sipas një grafiku për sasinë totale të preventiuar dhe për frekuencën e punës. Rrugët kryesore sipas grafikut fshihen çdo ditë, ndërsa rrugët dytësore tre deri katër herë në javë. Shërbimi i fshirjes kryhet gjatë natës. Ndërsa mirëmbajtja e rrugëve kryhet gjatë ditës , ku një punonjes mbulon 7 km rrugë.</li> <li>3- Larja e rrugëve është e përcaktuar në sasi dhe frekuencë në kontratën baze. Ky shërbim kryhet në 200 ditë të vitit, nga 1 Prilli deri me 31 Tetor. Frekuenca e lagjes është dy herë në ditë.</li> <li>4- Mirëmbajtja e kazaneve , është një shërbim që konsiston në riparimin, lyerjen dhe larjen e këtyre 560 kazaneve që janë në përdorim. Këto kazane riparohen nga deformime të trupit të tyre, dëmtim rotash, dëmtime mbulesash apo të dorezave të kapjes.</li> </ol>		
<p><b>Problemet kryesore që paraqiten</b></p>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kemi ndryshimi të volumeve në sasinë e mbetjeve të grumbullura si rezultat i ndryshimeve të llojit aktiviteve tregtare apo bisneseve si dhe të rritjes së numrit të familjeve në një zonë të caktuar (pallate të reja).</li> <li>• Kemi një dëmtim të vazhdueshëm të kazaneve të grumbullimit të mbetjeve urbane, si rezultat i ndërhyrjes abusive nga persona të ndryshëm.</li> <li>• Kazanet në ndryshim nga koha e amortizimit prej 3 % në vit, nuk përdoren më shume se katër – pesë vite, pra me një normë amortizimi 20 – 25 %, gjë që në terren shprehet me një paraqitje të kazaneve jo si duhet, (nga amortizimi)</li> <li>• Parkimet i parregullt i makinave pranë vendodhjes së kazaneve pengon evadimin e mbetjeve.</li> <li>• Depozitimi i mbetjeve ndërtimore dhe të përziera në vende të pamiratuara ose pranë kazaneve .</li> <li>• Pengesa për realizimin e shërbimit të fshirjes në vend – parkimet e mjetëve.</li> </ul>		
<p><b>Shërbimi i pastrimit në Njësitë administrative.</b></p>		
<p>Në njësitë e reja administrative kemi patur dy lloje shërbimi për pastrimin.</p>		
<p>Në njesite administrative të Velipojës, Dajçit, Postribës ky shërbim është kryer me sipërmarrje private, ndërsa në njësitë e tjera si Guri Zi dhe Rrethina është kryer nga vetë njësia. Njesitë administrative të Bërdicës dhe Anës së Malit deri në Maj 2015 kanë patur sipërmarrje private , më tej nuk ka funksionuar.</p>		
<p>Sipas marrëdhënies kontraktuale shërbimi i pastrimit të Velipojës dhe Dajçit ka mbuluar 100 % të territorit, ndërsa për Postribën 80 % të territorit.</p>		
<p>Guri i Zi ka kryer shërbimin në 80 % të teritorit, Ana e Malit 80 % të territorit, Rrethinat në 100% të territorit , Bërdica 100 % të territorit.</p>		
<p>Shërbimi i pastrimit në të gjitha njësitë administrative përveç Velipojës ka përgjithsuar grumbullim dhe transport të mbeturinave urbane, ndërsa Velipoja ka patur dhe proceset e fshirjes, lagjes për plazhin në periudhën e sezonit.</p>		
<p>Situata e Njësiëve administrative për funksionimin e këtij shërbimi sic duhet me kazane ka qenë si më poshtë: Velipoja ka në gjëndje 205 copë, Dajçi 40 copë, Ana e Malit ka 45 copë, Guri Zi ka 78 copë, ndërsa njësitë Rrethina dhe Bërdica kanë vetëm nga 10 copë të furnizuar tani kohët e fundit nëpër shkolla dhe qendra shëndetësore.</p>		
<p><b>Problemet kryesore që paraqiten</b></p>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shërbimi i pastrimit nuk ka një grafik dhe frekuencë shërbimi të përcaktuar, gjë që krijon mundësi neglizhimi dhe shmangie detyrimi.</li> <li>• Shërbimi edhe kur kryhet nuk ka cilësinë e duhur, nuk evadohen të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve si dhe jo e gjithë sasia e grumbulluar është dërguar në Landfill.</li> <li>• Mungesa e kazaneve të grumbullimit të mbetjeve sjell shumë probleme, si në cilësinë e kryerjes së këtij shërbimi dhe probleme të ndotjes ambientale.</li> <li>• Ka zona nëpër njësi që nuk kryhet shërbimi edhe pse nga ana e infrastrukturës rrugore është e mundur një gje e tillë.</li> <li>• Mungesa të theksuar të supervizimit të kryerjes së këtij shërbimi.</li> </ul>		
<p><b>ii. Synimi i projektit</b></p>		
<p>Rritja e performancës së shërbimit të pastrimit. Rritja e numrit të banoreve që përfitojnë këtë shërbim duke e shtrirë këtë në të gjithë zonat që është e mundur nga ana infrastrukturës rrugore. Plotësimi me kazane metalike për grumbullimin e mbeturinave urbane. Grafik i përmrësuar i shërbimit për menyrën dhe kohën e nxjerrjes dhe evadimit të mbeturinave urbane duke synuar diferencimin e mbetjeve në burim. Nxitjen e interesit për biznesin për fillimin e aktivitetit të riciklimit të mbetjeve urbane.</p>		



### iii. Aktivitetet kryesore të projektit

#### Për shërbimin e pastrimit të qytetit.

- Zevëndësimi dhe shtimi i kazanëve të mbetjeve, për të përballuar fluksin e mbetjeve. Ky shtim kazanesh do të bëhet nga vetë operatori i cili sipas kontratës duhet të blejë 90 cop në vit, ashtu dhe me një investim tonin si Bashki që do blejmë për qytetin 100 copë kazane. Kjo rritje e numrit të kazanëve kërkohej për të rritur numrin e pikave të grumbullimit për të shërbyer më mirë qytetarëve ashtu dhe për të zëvendësuar kazanet e amortizuara apo dëmtuar.
- Për fshirjen mekanike, sipas sasive të parashikuara në preventiv dhe sipas grafikut do përdoret mjet me kompetitiv dhe do rrisim bashkëpunimin me policinë e trafikut për lirin e rrugëve nga mjetet eparkuara për të kryer normalkëtë shërbim në bazë të një grafiku të parapërcaktuar.
- Shërbimi i largjes së rrugëve do të kryhet sipas një grafiku dhe frekuencë të ripërcaktuar nga ana jonë mbrenda sasive të kontraktuara. Lagja do realizohet për një periudhë prej 200 ditësh, kohe e domosdoshme për këtë shërbim. Njehkohesisht do të kërkohej operatorit një mjet teknologjik për lagjen të pershtatshëm për infrastrukturën tone.
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me komunitetin dhe ndergjegjësimi i tyre për diferencimin e mbetjeve që në burim.
- Rritjen e bashkëpunimit me shkollat, institucionet dhe biznesin për rritjen e interesit për riciklimin e mbetjeve urbane duke vazhduar eksperiencën e krijuar në marrëdhënie me to, ku kemi vënë në dispozicion kazane për ndarjen e diferencuar të mbetjeve.
- Do investojmë për ndërtimin e xhëpave të vendosjes së kazanëve në hapësirat trotuarëve. Do spositojmë të gjithë kazanet që janë në pika të rrezikshme për qytetarët, nga automjetet si dhe ato pika problematike për vetë automjetet.
- Do tenderojmë dhe për grumbullim - transportin e mbeturinave ndetimore që njëzë të papërgjegjshëm hedhin tek kazanet e plehrave apo në afersi të tyre.
- Depozitimi i të gjitha mbetjeve në landfill.
- Monitorimi do kryhet nga dy supervisorë për të gjithë territorin. Qyteti është i ndarë në dy zona, gjeografikisht, në pjesën veriore dhe jugore të qytetit. – Supervisorët janë në strukturën e drejtorisë së shërbimit dhe infrastrukturës me kohe të plote. Krahas supervisorëve ky shërbim do të monitorohet edhe nga specialistët e drejtorisë së shërbimit dhe infrastrukturës dhe përfaqësuesit e njesive administrative në qytet. Këto janë pjesë e kontrollit të zbatimit të kontratës, ndjekjes së grafikeve të kryerjes së shërbimit sipas proceseve dhe në fund të çdo muaji përgjegjës për raportim mujor të vëllimeve të punës për likuidim.

#### Per shërbimin e pastrimit të Njesive administrative

##### A- Shërbimi i pastrimit me kontratë ekzistuese për Velipojen

Ky shërbim është në bazë të kontratës themelore është deri më 31 maj 2016, pra do të vazhdojë meqenëse sipërmarrrje private. Gjatë kësaj periudhe do të kryehen proceset e punës sipas preventivit. Pas kësaj periudhe ky shërbim do të ritenderohet

##### B- Shërbimi i pastrimit që do prokurohet.

Shërbimi i pastrimit për Njesitë e Reja Administrative do të prokurohet si më poshtë:

- Shërbimin e pastrimit për Njesitë administrative të Velipojes, Dajcit, do të prokurojmë si shërbim që do kryhet nga operatore private.
- Shërbimin e pastrimit për Njesitë administrative Rrethinave, Postribes dhe të Shales do të prokurojmë si shërbim që do kryhet nga operatore private.

Për njesitë e Rrethinave, Postribes, Dajcit dhe Shales do kryhet vetëm shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve urbane nga njesitë për në landfill. Kostoja e këtij shërbimi është kalkuluar duke patur në konsideratë eksperiencën, kontratat fillestare si dhe sipas studimit dhe analizës të Plani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane, që prodhimi i mbetjeve për frymë për njesitë është 0,5 kg. Shërbimi në këto njesi është llogaritur të kryhet çdo ditë, ndërsa në njesinë e Shales është llogaritur që për periudhën e verës të ketë një frekuencë evadimi të mbetjeve një herë në javë, ndërsa në periudhën tjetër një ose dy herë në muaj sipas kushteve.

Do bëjmë një investim për blerje kazanesh, ku për njesitë administrative të mesiperme do të kemi: Për Rrethinat do blejmë 100 cop, Postribes 90 cop, Dajcit 100 cop dhe Shales 10 cop. Në këto të fundit këto kazane do vendosen në vend qendrimet turistike. Ndërsa për njesitë e tjera këto kazane do shpërndahen sipas një grafiku të miratuar.

Për njesinë administrative të Velipojes do kemi përveç grumbullimit dhe transportit të mbetjeve gjatë gjithë vitit edhe shërbime të tjera, për periudhën e sezonit të plazhit:

Fshirje mekanike dhe manuale të komplet rrugëve të plazhit dhe të qendres së saj, Ky shërbim do kryhet çdo ditë për të gjithë sezonin.

Gjatë sezonit do të ketë puntoret sezonale që do grumbullpjnë me qese plastike mbeturinat gjatë gjithë vijës së bregut, që do bëhet dy herë në ditë.

Do të ketë punonjës për mirëmbajtjen e kater tualeteve publike, për të mbajtur në kushte higjieno-sanitare të pershtatshme. Shërbim që do kryhet gjatë gjithë ditës.

Për të gjitha njesitë do të behet transporti dhe depozitimi i mbetjeve në Landfillin Bushat.

Afati i kontratës me firmën fituese do të jetë deri më 01.10.2018, afat ky që i mbaron kontratën operatorit të shërbimit që është në vazhdim kontratë për këto lloj shërbimi. ( qyteti )

##### C- Shërbimi i pastrimit që do mbulohet me mundësitë tona.

Shërbimi i pastrimit në njesitë administrative të Gurit të Zi, Berdices dhe Ana Malit mendojmë ta kryejmë me mundësitë tona, meqenëse në njesinë administrative të Gurit të Zi kemi në inventar një mjet teknologjik pastrimi, i cili ka mundësinë dhe kapacitetin e mjaftueshëm për të përballuar vëllimin e punës për të tre këto njesi administrative. Për këto do të ingranojmë si grup pune shoferin e mjetit dhe tre punonjës shërbimi.

Procesi i punës që do kryhet edhe në këto njesi do të jetë grumbullim, transport dhe depozitim i mbetjeve në Landfillin Bushat. Edhe për këto njesi koston e vëllimeve të mbetjeve janë realizuar sipas normativave të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve.

Gjithashtu do bëjmë një investim për blerje kazanesh ku respektivisht i kemi si më poshtë: Për Gurin e Zi që ka 78 cop do blejmë dhe 40 cop të tjera. Kjo për të zgjeruar territorin e shërbimit edhe në fshatin Kuc dhe Sheldi, ku me përpara nuk është kryer ky shërbim.

Për Berdicen do blejmë 70 kazane, kjo njesi nuk ka patur asnjë kazan, vetëm 10 cop që i kemi dërguar tani në këto periudhë. Pra nuk do të kemi më pika të hapura të grumbullimit të mbetjeve, të cilat kanë krijuar probleme, ambientale, estetike dhe të veshitura në menaxhim grumbullim të mbetjeve.

Për njesinë e Anës së Malit përveç 45 kazanëve që ka në gjendje do të blejmë dhe 55 cop, të rinj, këto për të zëvendësuar ato kazane të dëmtuar, gjithashtu dhe për të shtrirë territorin e shërbimit, aty ku nuk ka patur, si në Obot, Alimetaj dhe Velinaj.

<p>Keto kazane do te vendosen ne bashkepunim me administrtoret ne pikat me te domosdoshme te grumbullimit. Sherbimi ne keto njesi do te grafikohet per sasite dhe do percaktohen dhe frekuencat. Per fillimin normal te ketij aktiviteti , mjetit teknologjik ,do te shlyejme te gjitha debitet per dokumentat , do ti behet nje sherbim qe te jete ne gjendje normale pune. Do rregullojme mekanizmin e kapjes se kazaneve te mjetit , meqenese nuk e ka ne funksion , kjo e domosdoshme meqense gjitha pikat tona do te jene me kazan metalike.</p>					
<b>b) Rezultatet qe prisni</b>					
<p><b>Per sherbimin e pastrimit te qytetit .</b>          -Sherbim me parametra dhe sipas standarteve per te gjithë territorin.          -Shtimi i pikave te vendeve te grumbullimit te mbeturina per ti sherbyer me mire familjarit me rritjen e numrit te kazaneve.          -Eliminimi i pikave te rrezikshme te vend-depozitimeve , duke ndertuar xhepat ne trotuare.          -Eliminimi i dergimit te mbetjeve ndertimore ne landfillin Bushat.          -Kryerjen e ketyre sherbimeve sipas grafikeve dhe frekuencave te percaktuara nga investitori.          -Fillimi i diferencimit te mbetjeve urbane qe ne burim dhe grumbullimi tyre ne orare te percaktuar sipas nje grafiku paraprak.          -Fillimi i interesimit nga biznesi per procesin e riciklimit.</p> <p><b>Per sherbimin e Pastrimit ne Njesite Administrative.</b>          -Kryerja e sherbimit te grumbullim transportit te mbeturinave ne te njejtat standarte si ne qytet.          -Kazane metalike ne pikat e grumbullimit te mbeturina duke rritur rendimentin e punes, duke eliminuar problemet mjedisore si dhe sherbim me standarte.          Rritja e numrit te perfitueseve te sherbimit ne pjesen me te madhe te njesive administrative.          Depozitimi i te gjitha mbetjeve urbane ne landfillin Bushat.</p>					
<b>c) Aktoret e mundshem</b>		<b>d) Kontributet e mundshme ne projekt</b>			
<p>Operatori qe kryen kete sherbim per qytetin.          Operatori qe do marre sipermarrjen e re.          Grupi yne i punes qe do kryejë sherbimin e pastrimit.          Sipermarresi per ndertimin e xhepave dhe te transportit te mbeturinave ndertimore.          Monitoruesit , rajonet dhe komuniteti.</p>		Buxheti i Bashkise			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet sipas aktiviteteve</b>		Totali(ooo/lekë)	Nga kjo :		
			Paga.sigurime	Operative	Kapitale
A1	Kontratat ekzistuese Shkoder	112 086		112 086	
A2	Kontratat ekzistuese Velipoje (deri 31 maj 2016	7 500		7 500	
A3	Kontrata e re Velipoje, Dajc	17 232		17 232	
A4	Kontrate Landfilli Rrethina Postribe	208		208	
A5	Kontrate Landfilli Gur i Zi, Ana e Malit dhe Berdica	764		764	
A6	Kontrata e re Rrethina, Postribe dhe Shale	9 479		9 479	
A7	Transport mbeturinash ndertimore	17 550		600	16 950
	Transport mbeturinash ndertimore				
A8	Blerje kazanesh	1 838			
	Mjete Transporti ( 2 mjete )				
	1 Karburant			1 020	
	2 Pjese kembimi			300	
	3 Mirembajtje			318	
	4 Siguracion		200		
<b>TOTALI</b>		<b>166 657</b>		<b>149 707</b>	<b>16 950</b>
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur perfundon Gjate gjithë vitit.</b>		<b>g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Sherbimet Publike</b>			

<b>Nr.8</b>	<b>Projekti: P4.F2.O1.A1</b> Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta	<b>Llojet e programit: P4.</b> Shërbimet Publike <b>Funksioni: F2 .</b> Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike;
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
<b>I. Situata</b>		
<p><b>A.</b> Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta në qytet realizohet me sipërmarrje private, me kontrate 5-vjeçare, e lidhur më datë 24.01.2013 .per mirembajtjen e 72600 m2 ne 38 lulishte te qytetit.</p> <p><u>Problemet kryesore që paraqiten</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mirëmbajtja dhe shërbimi në kohe e gjelberimit të larte (krasitje dhe shërbime të tjera)</li> <li>• Pjesa më e madhe e sipërfaqeve të kompozuar për mbjedhje lulesh sezonale janë dëmtuar.</li> <li>• Dëmtimi i stolave nga amortizimi, por edhe dëmtimet e qëllimshme nga persona te papërgjegjshem.</li> <li>• Ndotja e shatërvaneve shpesh nga papërgjegjshmeria e qytetarëve që hedhin mbeturina në to.</li> <li>• Planifikimi i ndërhyrjes sipas një modelimi dhe projekti bashkohor të hapësirave të gjelbërta.</li> </ul> <p><b>B.</b> Vetëm në Nj.A te Velipojës ka sipërfaqe të gjelbërt (lulishte) për të cilën është realizuar shërbim mirëmbajtje sezonale. Ky shërbim është realizuar nga punonjësit e Njësisë Administrative Velipojë. Shërbimi është realizuar në një sipërfaqe prej 15,175 m2 lulishte dhe 491 m2 sipërfaqe ujore (shatërvanet). Brenda kësaj sipërfaqeje ka dhe elementë të tjerë si stola dekorativ 69 copë dhe drurë dekorativ 40 copë.</p> <p><u>Problemet e paraqitura:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjëndja e këtyre lulishteve lë për të dëshiruar pasi ky shërbim nuk kryhet rregullisht gjatë gjithë vitit, siç e kërkon shërbimi i pemëve dhe i luleve, por bëhet vetëm në periudhen e sezonit të plazhit.</li> <li>• Problematika që krijohet nga mungesa e shërbimit të vazhdueshëm po çon drejt degradimit të plotë të këtyre sipërfaqeve të gjelbërta (lulishte).</li> </ul> <p><b>C.</b> Në shumë njësi administrative gjelbërimi rrugor (pemët) është i mangët. Në veçanti, zonat më të frekuentuara nga qytetarët dhe vizitorët vendas dhe të huaj, si Velipoja apo dhe pika doganore Muriqan deri tek Ura e Bunës kërkohet të ndërhyhet për të ndryshuar situatën.</p>		
<b>II. Synimi i projektit</b>		
<p>Të rritet cilësia e jetës së qytetarëve dhe rritja e konkurrenshmërisë së territorit të bashkisë. Rritja e cilësisë së shërbimit për sipërfaqet e gjelbërta, nëpërmjet përmirësimit dhe rikompozimit të sipërfaqeve të gjelbërta ekzistuese dhe zgjerimit të tyre.</p>		
<b>III. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<b>I-Për sipërfaqet e gjelbërta të qytetit.</b>		
<p>Proçeset kryesore që kryhen janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1- Mirëmbajtja e lulishteve ekzistuese me sipërfaqe: 72600 m2.</li> <li>2- Mbjellje e luleve sezonale: 500 m2</li> <li>3- Mirëmbajtje dhe mbjellje drurë dekorativ, ku parashikohet mirëmbajtja e 5118 copë pemëve dhe mbjellje të 174 copë pemëve të tjera për zëvendësimin e drurëve të dëmtuar.</li> <li>4- Mirëmbajtje të 800 copë shkurre dekorative dhe mbjellje e 100 copë shkurre dekorative të reja.</li> <li>5- Mirëmbajtje stolash dekorativ; ky shërbim konsiston në riparimin dhe lyerjen e 319 stolave në lulishtet dhe parqet e qytetit.</li> <li>6- Sipërfaqe ujore. Shërbimi realizohet në mirëmbajtjen e 650 m2 sipërfaqe ujore që përfaqësojnë dy shatërvanet e qytetit.</li> </ol> <p>Monitorimi dhe ndërgjegjësimi komuntar në kuadër të qëndrueshmërisë së këtij shërbimi. Monitorimi do të realizohet nga supervizori, i cili është pjesë e strukturës së drejtorisë së shërbimit dhe infrastrukturës, me kohë të plotë, dhe mbulon, gjithashtu, edhe supervizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të Dëshmorëve. Krahas supervizorit ky shërbim do të monitorohet edhe nga specialistet e Drejtorisë së Shërbimit dhe Infrastrukturës dhe përfaqesit e njësisë administrative në qytet. Këto janë pjesë e kontrollit të zbatimit të kontratës, ndjekjes së grafikëve të zbatimit të shërbimit sipas proçeseve dhe në fund të çdo muaji, përgjegjës për raportim mujor të volumeve të punës për likuidim.</p> <p><b>II- Sipërfaqja e gjelbërt Nj.A. Velipojë, plazhi.</b> Ky shërbim do të realizohet me sipërmarrje private. Proçeset kryesore që do të realizohen janë : Mirëmbajtja e një sipërfaqeje prej 15'175 m2 lulishte në plazh, e cila do të realizohet me të njëjtin standart si për qytetin, në të gjitha proçeset e parashikuara. Gjithashtu brenda të gjitha kushteve dhe kërkesave, do të mirëmbahen edhe 76 copë drurë dekorativ, 40 copë shkurre dekorative dhe 69 stola dekorativ.</p>		

<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<p><b>Për qytetin</b>          Shërbim me parametra cilesorë për 72600 m2 ne 38 lulishtet ku realizohet ky shërbim.          Mirembajtja e 5118 drure dhe mbjellja e 174 copë drurë dekorativ dhe 100 cope shkurre dekorative          Stolat do të jenë funksional dhe brenda parametrave të shërbimit.          Funksionimi i dy shatërvaneve sipas kërkesave dhe parametrave.</p> <p><b>Velipoja</b>          Mirembajtja e 15175 m2 lulishte          Mirembajtja e 76 pemeve dhe 40 shkurreve dekorative.          Shatërvanet, në gjëndje pune dhe brenda standartit.          Mundësimi i ambienteve funksionale për pushim për banorët dhe pushuesit.</p>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Operatori që kryen këtë shërbim për qytetin. Operatori që do realizojë shërbimin në Nj.A Velipojë. Monitoruesit nga Drejtoria e SHërbimit dhe Infrastrukturës dhe Përfaqesuesit e Nj. A.			Buxheti i Bashkisë		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërme (pika iii))</b>					
<b>Shpenzimet sipas aktiviteteve</b>		Totali (000/lek)	Nga kjo :		
			Paga.sig urime	Operative	Kapitale
A1	Kontrata ekzistuese Shkodër	30 770		30 770	
A2	Kontrata e re Velipojë	4 230		4 230	
	<b>Shuma</b>	<b>35 000</b>		<b>35 000</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë gjithë vitit 2016.			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës		

Nr.9	<b>Projekti P4.F3.O1:A1</b> Furnizimi me ujë i qytetit dhe njërive administrative	<b>Llojet e programit P4.:</b> Shërbimet Publike <b>Funksioni P4.F3 :</b> Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
<ul style="list-style-type: none"> <li>Furnizimi me ujë i qytetit të Shkodrës kryhet me ngritje mekanike nga 10 pusë-shpimet që janë në funksion dhe nga 2 stacione pompimi që ndodhen në Dobraq. Zonat që mbulohen nga ky shërbim janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>Qyteti Shkodër</li> <li>Një pjesë e Komunës Rrethina që merr furnizim me ujë nga linjat kryesore të transmetimit të ujit që shtrihen nga Stacioni Pompave në Dobraq direkt për në sistemin shpërndarës</li> <li>Lagjen Bahçallëk me një pjesë të Komunës Bërdicë (zona e Harkut të Bërdicës)</li> </ul> </li> </ul> <p>Nga stacioni ujësjellës i Dobraqit furnizohen me ujë rreth 120 000 banorë, ndërsa nga stacioni i Bahçallekut furnizohen rreth 3000 banorë.</p> <p>Norma standarte e furnizimit me ujë është 150 litër/për një frymë/në dit. Prodhimi në stinët dimërore është rreth 650 l/s, ndërsa në stinët verore shkon rreth 850 l/s. Konsumi i energjisë për prodhimin e ujit është 1450-1700 kë/orë me kosto 20 000 lek/orë. Mungesa të shumta për furnizim me ujë nga sistemi ujësjelles shkaktohen nga humbjet për shkak të amortizimit të rrjetit, dëmtimet nga ndërtimet, shtrirja e pjesës më të madhe të rrjetit shpërndarës nëpër prona private në qytet, ndërhyrjet e shumta jo profesionale nga banorët e Komunës Rrethina në linjat kryesore, zgjatja e tyre nëpër zona të banuara që arrijnë deri në Vrakë në shumë zona të qytetit, etj. Zgjatja pa kriter e linjave të hapura private në zonat periferike shkakton prishjen e rregjimit të furnizimit me ujë të qytetit me presionin normal. Nga presioni ulët, klientët detyrohen të instalojnë elektropompa individuale për ngritjen e ujit në katet e sipërme të objekteve duke rritur koston për m<sup>3</sup> të konsumuar.</p> <p>Me investimin e realizuar gjatë periudhës 2011-2015 nga Projekti KFË është rehabilituar rreth 11% e linjave të sistemit ujësjellës të qytetit Shkodër.</p> <p>Nevojat për ndërhyrje me investime për përmirësimin e sistemit ujësjellës janë shumë të mëdha si në rrjetin shpërndarës të qytetit, ashtu edhe në ndërtimin e rrjetit për zonat informale dhe në linjat kryesore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm për Nj.A. mbulohet nga Nd.Ujesjelles Fshat. Bashkia Shkoder ka trashëguar detyrimet për energji elektrike për furnizimin me ujë të pijshëm për: Nj.A. Ana e Malit-ujësjellësi Obot i Ri, në Nj.A Guri i Zi dhe Nj.A Velipojë-furnizimin me ujë i shatërvanit në plazh.</li> </ul>				
ii. Synimi i projektit				
Garanimi i furnizimit me ujë të pijshëm të popullatës pa ndërprerje. Realizimi i detyrimeve të Njërive Administrative për pagesën e energjisë së shpenzuar për furnizimin me ujë nga Sh.A UK Fshat.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
Furnizimi pa ndërprerje i popullatës me ujë të pijshëm. Pagesa për konsumin e energjisë elektrike për 3 kontratat në Nj.A. Guri i Zi, Ana e Malit dhe Velipojë. Parashikimi është bërë bazuar në shërbimin e ofruar në vitin 2015 nga vetë Nj.A. Këto pagesa mbulojnë konsumin e energjisë elektrike të 2 ujësjellësve që furnizojnë popullatën me ujë të pijshëm si dhe furnizimin me ujë të shatërvanit në qendër të plazhit Velipojë gjatë sezonit të plazhit.				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
Përballimi i shpenzimeve për energji elektrike për të siguruar furnizimin me ujë të popullatës në fshatin Guri i Zi dhe Obot i Ri Përballimi i shpenzimeve për energji elektrike për të siguruar furnizimin me ujë të shatërvanit në qendër të plazhit Velipojë gjatë sezonit të verës.				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Drejtorja e shërbimit publike dhe Infrastrukturas (Sektori i ndriçimit) Drejtorja e finances		Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura ( për cdo aktivitet të mësipërme (pika iii)</b>				
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
A.1	Pagesa energji elektrike për furnizim me ujë Nj.A Guri i Zi	240		240
A.2	Pagesa energji elektrike për furnizim me ujë Nj.A Obot i Ri	400		400
A.3	Pagesa energji elektrike për furnizim me ujë Nj.A Velipojë	400		400
<b>Shuma</b>		<b>1 040</b>		<b>1 040</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë gjithë vitit 2016.		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Shërbimit dhe Infrastrukturas		

Nr. 10	<b>Projekti P4.F3.O1:A2</b> Mbështetja për mbulimin e shpenzimeve për energjinë elektrike SH.A Ujësjellës qytet.	<b>Llojet e programit P4.:</b> Shërbimet Publike  <b>Funksioni P4.F3 :</b> Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm
<b>a) Peshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
i. Situata		
<p>Kostoja e energjisë elektrike është një ndër zërat kryesor të kostos për Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër dhe lidhet me konsumin e energjisë elektrike nga objektet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Stacioni kryesor i pompimit Dobraq</li> <li>➤ Stacioni i pompimit Bahçallëk</li> <li>➤ Rezervuari Tepe</li> <li>➤ Stacioni Kryesor i Pompimit të Ujërave të Ndotura</li> <li>➤ Stacioni i Ujërave të Ndotura Shirokë</li> <li>➤ Impianti i Trajtitit të Ujërave të Ndotura Shirokë</li> <li>➤ Zyrat Qendrore</li> <li>➤ Qendra e Marrëdhënieve me Klientin</li> </ul> <p>Furnizimi me energji elektrike i të gjitha objekteve për të cilat ka kontratë Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër sigurohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE). Stacioni kryesor i pompimit Dobraq, stacioni i pompimit Bahçallëk, rezervuari Tepe, Stacioni kryesor i pompimit të Ujërave të Ndotura dhe Impianti i Trajtitit të Ujërave të Ndotura Shirokë, furnizohen me tension të mesëm, ndërsa stacioni i ujërave të ndotura Shirokë, Zyrat Qendrore dhe Qendra e Marrëdhënieve me Klientin furnizohen me tension të ulët.</p> <p>Tendenca e rritjes së kostove të energjisë elektrike si rrjedhojë e shtimit të objekteve dhe natyrës së operimit, të gjitha këto investime të realizuara nga zbatimi i projektit "Furnizimi me Ujë dhe Mbrojtja Mjedisore e Liqenit të Shkodrës" kanë rritur dhe pritet që të rrisin në të ardhmen koston operative për UK Shkodër, sidomos për zërin e "Energjisë Elektrike"</p> <p>Pavarësisht vështirësive financiare, Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër arrin të likuidojë me të ardhurat e veta detyrimet e pjesës më të madhe të kontratave me përjashtim të kontratës së stacionit kryesor të pompimit Dobraq. Në Stacionin kryesor të pompimit prodhohet uji që furnizon me ujë popullsinë, bizneset dhe institucionet e qytetit të Shkodrës.</p> <p>Aktualisht furnizohen me ujë dhe kanë kontratë aktive me Ujësjellësin e qytetit 20.579 abonentë të kategorisë familjarë, 1.749 abonentë Ente Private dhe 126 abonentë Institucione Buxhetore. Mungesa e energjisë elektrike në stacionin kryesor të pompimit do të shkaktojë mos-funksionimin e të gjitha pompave, makinerive dhe agregateve të këtij stacioni dhe si rrjedhojë mungesën e furnizimit me ujë të të gjithë banorëve të qytetit të Shkodrës dhe institucione të rëndësishme të veçantë si Spitali Rajonal Shkodër, Shkolla, Kopshte e Çerdhe.</p> <p>Në fund të vitit 2015 detyrimet e papaguara ndaj OSSHEE janë 50.929.694 lek.</p> <p>Në bazë të nenit 15 të ligjit nr. 160/2014 datë 27.11.2014 "Për buxhetin e vitit 2015", si dhe pika 50 e Udhëzimit Plotësues Nr.2 datë 09.01.2015, kur shoqëritë aksionare të Ujësjellës Kanalizime dhe Njësisë e Qeverisjes Vendore për sistemin e pompimit rezultojnë debitore për furnizimin me energji elektrike ndaj kompanisë së shpërndarjes deri në fund të tremujorit të tretë, transferta e pakushtëzuar e njësisë të qeverisjes vendore e tremujorit të katërt bllokohet me Urdhër të Ministrisë të Financave.</p> <p>Mbulimi i kostove të energjisë elektrike për vitin 2016 nga Bashkia siguron vazhdimësinë e funksionimit normal të ujësjellësit.</p>		
ii. Synimi i projektit (me një fjali cfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)		
Të sigurohet një furnizim i pandërprerë dhe në cilësinë e duhur për konsumatorin, me synim rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
8. Realizimi i procedurave ( marrëveshje, dokumentacione, etj) 9. Subvencionimi i energjisë elektrike ( shuma e parashikuar lëvrohet sipas ligjshmërisë)		

<b>b) Rezultatet e pritshme</b>						
1. Furnizimi pa ndërprerje me energji elektrike i stacionit të pompimit 2. Sigurimi i vazhdimësisë së furnizimit me ujë të banorëve të Bashkisë së Shkodrës 3. Shërbim i përmirësuar i konsumatorit						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme ne projekt (kush do te kontribuojë per kete projekt, financiarisht etj.)</b>			
15. Bashkia Shkodër 16. Ujësjetllësi Shkodër 17. Operatori I Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike			Bashkia Shkodër			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>				Totali (000 lek)	Nga kjo:	
					Paga, sig	subvencio n
A. 1	Procedurat administrative					
A. 2	Subvencion për Energji Elektrike			5 000		5 000
<b>TOTALI</b>				<b>5 000</b>		<b>5 000</b>
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			
Gjatë vitit 2016 (Projekti zbatohet në një kohëzgjatje 1-vjeçare)			<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria Ekonomike, Ujësjetllës Kanalizime Qytet Shkodër</li> </ul>			

Nr.11	<b>Projekti. P4. F4. O1. A1</b> Menaxhimi i sistemit te ujërave të zeza	<b>Llojet e programit : P4. Shërbimet Publike</b> <b>Funksioni F4. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura</b>
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
i. Situata		
<p><i>I – Sistemi i kanalizimeve te ujërave të zeza për qytetin Shkodër</i>          Largimi i ujërave të zeza te qytetit Shkodër bëhet direkt në lumin Drin, pa u bërë trajtimi i tyre, pasi mungon nje impiant i trajtimit të ujërave të zeza, i cili kërkon një investim të konsiderueshëm. Ky sistem përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rrjetin e kanalizimeve të ujërave te zeza te qytetit, i cili përbëhet prej rreth 150 km tubacione të dimensioneve nga Ø 200 mm deri ne Ø 1200 mm, me material betoni dhe plastik, dhe rreth 10 000 puseta. Fillimet e ndërtimit të këtij rrjeti kanë një shtrirje kohore mbi 35 vite. I gjithë rrjeti i KUZ të qytetit funksionon me rrjedhje të lire deri ne stacionin e pompave</li> <li>2. Stacionin e pompave, i cili ndodhet në hyrje te qytetit (Pazar), është ndërtuar rreth viteve 1980. Ky stacion, që aktualisht po rikonstruktohet, bën të mundur pompimin e ujërave të zeza dhe ngritjen e tyre në kuotën e kolektorit shkarkues. Nëpërmjet këtij kolektori shkarkues, me tubacion betoni Ø 1000 mm, i cili përshkon rrugën automobilistike në hyrje të qytetit, rrëzë kalasë, ujërat e zeza derdhen në lumin Drin.</li> <li>3. Pikat e shkarkimit të ujërave të zeza. Pika kryesore e shkarkimit ndodhet në krah të djathtë të hyrjes së urës së Bahçallekut, në lumin Drin. Pika tjetër e shkarkimit (emergjence) e ujërave të zeza ndodhet në lumin Buna, nëpërmjet një kanali me tubacion plastik Ø 800 mm, i cili sapo është rikonstruktuar. Ky kanal fillon nga stacioni i pompave për ne lumin Buna pranë urës se vjetër. Ky kanal emergjence punon vetëm në raste avarie shërbimi te stacionit apo raste të mungesës së energjisë elektrike të tij.</li> </ol> <p>Rreth 70 % e numrit të pergjithshëm të banorëve të qytetit Shkodër janë të lidhur me rrjetin KUZ. Kryesisht janë të pa lidhur me rrjetin e KUZ zonat periferike të qytetit, të cilat funksionojnë me gropa septike.</p> <p>Me financimin e fundit nga KFË, është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rikonstruktuar rreth 15-20 % e rrjetit ekzistues, disa pjesë më të dëmtuara të rrjetit të KUZ.</li> <li>- Rikonstruktuar Stacioni i pompave.</li> <li>- Ndërtuar rrjeti KUZ ne Dobraq, i cili përfshin rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura të banesave që ndodhen ne zonën e dytë dhe të tretë të mbrojtjes hidrosanitare në pellgun ujëmbajtës të fushës së puseve të ujësjellësit të qytetit. Ky rrjet lidhet me rrjetin KUZ të qytetit nëpërmjet stacionit të pompimit në Dobraq.</li> </ul> <p>Me financimin e fundit nga IPA për rikonstrukcionin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza në zonën industriale të qytetit, është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rikonstruktuar rreth 3000 m tubacion pjesë e kolektorit kryesor</li> <li>- Rikonstruktuar rreth 7855 m tubacion i sistemit dytësor dhe tretësor të rrjetit</li> <li>- Realizuar li dhje e 402 objekteve me rrjetin e KUZ</li> <li>- Pastruar linja dytësore dhe tretësore egzistuese në gjatësi prej 3000 m</li> </ul> <p><i>II - Sistemi i kanalizimeve te ujërave të zeza në Shirokë, i cili përfshin:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rrjetin e kanalizimeve te ujërave të zeza të zonës turistike të Shirokës, i cili nëpërmjet një stacioni pompimi, që ndodhet ne qendër të Shirokës, i dërgon ujërat në impiantin e trajtimit të ujërave të përdorura me vendodhje në hyrje të kësaj zone</li> <li>2. Imjanti i Trajtimit të Ujërave të Përdorura Shirokë, i cili pasi bën trajtimin e këtyre ujërave i shkarkon në liqen, duke eliminuar kështu ndotjen e liqenit.</li> </ol> <p><i>III - Sistemi i kanalizimeve te ujërave të zeza në Velipojë</i>          Ky sistem është në fazen e fundit të punimeve dhe do të funksionojë për largimin e ujërave të ndotura për zonën e Pulaj dhe Reçit (zona bregdetare). Me përfundimin e punimeve, ku sipas parashikimeve afati i fundit është mars 2016, ky rrjet do të jetë funksional për rreth 15 000 banorë. Sistemi përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtimin e 30100 m tubacion plastik të brinjëzuar për linjën e ujërave të zeza (Ø 250, Ø 315, Ø 400, Ø 500 mm), ku parcialisht funksionon me rrjedhje të lirë</li> <li>2. Ndërtimin e 6 stacioneve të pompave, që mundësojnë dërgimin e ujërave të zeza në impiant dhe gjithashtu nga impianti në lumin Buna.</li> <li>3. Ndërtimin e impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura, i cili pas trajtimit të këtyre ujërave i shkarkon në lumin Buna</li> </ol>		
ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)		
Rritja e lidhjeve të popullsisë urbane dhe rurale me rrjetet e grumbullimit të ujërave të zeza Rritja e përqindjes së popullsisë të lidhur me rrjetin e grumbullimit të ujërave të zeza, i cili është i lidhur me një impiant përpunimi.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
Mirëmbajtja e vazhdueshme e kanalizimeve të ujërave të ndotura. Pastrimi i pusetave, përfshirë edhe riparimin ose zëvendësimin e kapakëve të dëmtuar ose të vjedhur. Lidhja e abonentëve (familiarë dhe biznes) me kolektorët e rinj të ndërtuara në Velipojë.		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
Rritja e përqindjes së popullsisë të lidhur me rrjetin kryesor të grumbullimit të ujërave të zeza, i cili në rastin e zonës së Shirokës dhe të Velipojës, është i lidhur me një impiant përpunimi të këtyre ujërave të ndotura.		
<b>c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	



Drejtoria e shërbimive publike dhe Infrastrukturës Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër Njësitë Administrative		Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër Abonentët (familjarë dhe biznes) Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operativ e	kapitale
		0		0	
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)</b> Gjatë gjithë vitit 2016.		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Shërbimit dhe Infrastrukturës			

Nr.12	<b>Projekti. P4.F5.O1. A1.</b> Menaxhimi i sistemit të ujërave të shiut	<b>Llojet e programit : P4.</b> Shërbimet Publike <b>Funksioni F5:</b> Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga Përmbytjet në zonat e banuara	
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>			
i. Situata			
<p>Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha i qytetit të Shkodrës (për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut) funksionon i ndarë nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza. Sistemi kryesor i drenazhimit mbulon rreth 70% të zonave formale të qytetit, ndërsa në zonat informale zë një mbulim shumë më të ulët.</p> <p>Ky rrjet ka një gjatësi prej rreth 50 km, nga të cilat rreth 37 km përbëhet prej tubacioneve të mbydhur betoni e plastik dhe pjesa tjetër janë kanale të hapura:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Me tubacion betoni nga Ø 200 ÷ Ø 1500 mm</li> <li>• Me seksione katërkëndëshe betoni të mbyllura, të mbuluara me solet beton arme</li> <li>• Me seksione katërkëndëshe ose trapezoidale të hapura, të veshura me gurë ose beton</li> <li>• Me tuba të brinjëzuar Ø 200 ÷ 400 mm</li> </ul> <p>Grykëderdhjet e Kanalizime të Ujërave të Bardha (K.U.B) janë kanale të mëdhenj të hapur:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pjesa veri - lindore e KUB të qytetit ka derdhje në lumin Kir nëpërmjet kanalit të hapur të industrisë (duke filluar që nga shinat e trenit, rruga Qafa e Bishtkazit)</li> <li>2. Pjesa jug-lindore e KUB të qytetit ka: - derdhje në liqenin e Shkodrës nëpërmjet Kanalit të Fermës - derdhje në lumin Kir nëpërmjet grykëderdhjes së rr.Tepe</li> <li>3. Pjesa perëndimore, me derdhje në livade buzë liqenit të Shkodrës nëpërmjet Kanalit të Zooteknikës dhe Kanalit të QPU-së, si dhe me derdhje në liqenin e Shkodrës nëpërmjet Kanalit të Austriakut</li> <li>4. Pjesa qendrore me derdhje në liqenin e Shkodrës, nëpërmjet kanalit të Austriakut me një gjatësi prej 450m, (pas Prokurorisë së re – Pazar)</li> </ol> <p>Sipas planit të punës realizohet pastrimi i këtyre kanaleve të hapur (grykëderdhje). Kanalet duke qënë të hapur, bëhen burim i mbledhjes së mbetjeve inerte dhe urbane të hedhura nga njerëz të papërgjegjshëm. Gjithashtu në disa raste, kanalet nuk pastrohen pasi nuk ka mundësi hyrjeje, si rezultat i objekteve që janë ndërtuar jashtë çdo standarti afër dhe mbi kanale.</p> <p>Problem në sektorin e KUB janë edhe vjedhjet e herë pas herëshme të gradelave prej gize, duke kaluar kështu edhe kapacitetin e zëvendësimit të tyre nga UK Shkodër. Si rrjedhojë ka mungesë të gradelave nëpër rrugë, duke sjellë kështu mbushjen e KUB me materiale inerte. I. Sin</p>			
ii. Synimi i projektit			
Të rritet cilësia e jetës së qytetarëve. Sigurimi i funksionimit normal të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha (shiut) në qytet dhe grykëderdhjeve kryesore për të evituar problematikat e ndryshme, përfshirë edhe uljen e mundësisë së përmbytjeve të qytetit.			
iii. Aktivitetet kryesore të projektit			
Mirëmbajtja e vazhdueshme e kanalizimeve të ujërave të bardha. Pastrimi i pusetave dhe gradelave shimbajtëse, përfshirë edhe riparimin ose zëvendësimin e kapakëve të dëmtuar ose të vjedhur. Pastrimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e grykëderdhjeve kryesore të qytetit. Evitimi i përmbytjeve të mundshme.			
<b>b) Rezultatet që prisni</b>			
Funksionimi normal i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha (shiut) në qytet dhe grykëderdhjeve kryesore për të evituar problematikat e ndryshme.			
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Drejtoria e shërbimit publike dhe Infrastruktues Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër Njësitë Administrative Inspektoriati i ndërtimit vendor		Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>			
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo: Paga, sig      opera tive      kapit ale
Fondet për këtë projekt mbulohen nga Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Qytet Shkodër përgjatë vitit.		0	0
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë gjithë vitit 2016.		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Shërbimit dhe Infrastruktues	

<b>Nr.13</b>	<b>Projekti : P4.F6.O1.A1</b> Shërbimi Mirembajtjes Varrezave Publike dhe të Dëshmorëve.	<b>Llojet e programit P4 : Shërbimet Publike</b> <b>Funksioni P4.F6.</b> Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit;
<b>a) Pëershkrimi i shkurtëri i projektit</b>		
<b>i. Situata</b> ( Shpjego problemin, aspektet negative, te dhena per zonen)		
<p>Shërbimi i mirëmbajtjes së Varrezave Publike në qytet . Ky shërbim kryhet me sipërmarrje private me kontratë 5-vjeçare e lidhur me date 01.07.2013. Shërbimet që ofrohen janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pastrim parcelash dhe rrugësh të mbrendëshme ndërmjet parcelave me sipërfaqe 52.312 m<sup>2</sup></li> <li>• Mbjedhje druresh dekorativ 41 copë.</li> <li>• Mbjedhje në parcela 250 m<sup>2</sup> .</li> <li>• Gjithashtu kryhet dhe shërbimi i rojes për varrezat publike dhe ato të dëshmorve.</li> </ul> <p><u>Problemet kryesore që paraqiten.</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk administrohen sipas rregullores së funksionimit, pasi nuk ka rrethim të plotë.</li> <li>• Ka lëvizje mjeteve dhe këmbësorësh të pa kontrolluar.</li> <li>• Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave në Njësitë administrative.</li> <li>• Në pjesën më të madhe të njësive, shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave bëhet nga vetë banorët e fshatit apo nga institucione fetare. Por ka dhe njësi që i kanë mirëmbajtur me punonjesit e vete te shërbimeve.</li> </ul> <p><u>Problemet kryesore që paraqiten.</u></p> <p>Nuk administrohen njëllor për nga standarti meqenëse ka shumë aktor që kryejnë këte shërbim</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ka raste dhe të problemeve sociale për varre.</li> <li>- Mungesa e një rregullore funksionimi krijon shumë probleme.</li> </ul>		
<b>ii. Synimi i projektit</b> (me një fjali çfarë do të zgjidhni për ate që është problemi kryesor, perfitimi i grupit te synuar)		
<p>Të rritet cilësia e ofrimit të shërbimit të varrezave</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e performancës së shërbimit të mirëmbajtjes sipas rregullores së funksionimit.</li> <li>• Shërbim dhe komunikim normal me qytetarët</li> <li>• Të qenurit të gatshëm në çdo moment për kryerje të shërbimit funeral.</li> <li>• Rregullimin e marrëdhënie të çdo veprimtarie mbrenda ambienteve te varrezave.</li> <li>• Ruajtja dhe administrimi këtyre ambienteve sipas ligjit .</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<p><b>1. Pëer shërbimin në Qytet.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmisimi i rregullores së shërbimeve në këto ambiente sipas ligjshmërisë .</li> <li>• Rritja e kërkesës së llogarisë për monitorimin e kryerjes së këtij shërbimi nga bashkepunimi i ngushte i supervisorve dhe qytetarve.</li> <li>• Monitorimi do kryhet nga supervisor. Supervisor është në struktura e drejtorisë së shërbimit dhe infrastruktures me kohe të plotë. Krahas supervisorit ky shërbim do të monitorohet edhe nga specialistet e drejtorisë së shërbimit dhe infrastrukturës. Këto janë pjesë e kontrollit të zbatimit të kontratës, ndjekjes së grafikeve të kryerjes së shërbimit sipas proceseve dhe në fund të çdo muaji, pergjegjës për raportim mujor të volumeve të punës për likuidim.</li> </ul> <p><b>2. Për shërbimin në Njësitë administrative.</b></p> <p>Vazhdimi i mirembajtjes se varrezave nga vete njesite aty ku jane mbajtur deri tani , me shërbime te pastrimit nga shkurret , barishtet , kositje bari , lyerje , sistemim varrezash , rrethime me tel gabion etjer.</p> <p>Hartimi i rregullores per te gjitha varrezat e fshatrave per funksionimin dhe administrimin e tyre.</p> <p>Monitorimi i tyre.</p> <p><b>3. Investimi në varrezat e qytetit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërhyrje me investim për të rrethuar komplet ambientin e varrezave, kërkesë kjo sipas legjislacionit në fuqi</li> <li>• Ndërhyrje me investim për shpronësim toke për hapjen e një rruge të re të kalimit të mjeteve duke e spostuar nga territori i varrezave jashtë saj.</li> <li>• Vendosija e tabelave lajmërim e funerale neper pikat kryesore te qytetit</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<p><b>Për qytetin.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrim sipas standarteve duke realizuar rrethimin e territorit.</li> <li>• Spostimi i rrugës së kalimit të mjeteve të fshatrave përreth nga mbrenda varrezave jashtë tyre.</li> <li>• Funksionim sipas rregullores me orare të përcaktuara.</li> <li>• Plotësimi i parcelave të reja me bordure të gjelberata, 250 ml</li> <li>• Mbjedhja e 41 pemëve dekorative</li> <li>• Gadishmëeria për të shërbyer në çdo moment për kryerje të shërbimit funeral</li> <li>• Organizim i ambienteve të varrezave sipas standarteve dhe rregullores .</li> <li>• Vendosija e gjashtë tabelave të lajmerimeve funerale nëper qytet.</li> </ul> <p><b>Për njësitë administrative.</b></p> <p>Vazhdimsinë e kryerjes së këtij shërbimi nga njësitë.</p> <p>Standartizim në funksionim sipas rregullores së shërbimit të varrezave.</p>		

<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Operatori që kryen këtë shërbim për qytetin. Njësia administrative që kryejnë këtë shërbim. Monitoruesit .			Buxheti i Bashkisë			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet sipas aktiviteteve</b>			Totali(ooo/lek	Nga kjo :		
				Paga.sigurime	Operative	Kapitale
A1	Kontrata ekzistuese Shkodër		7 206		7 206	
A2	Dajci		604		604	
	Ana Malit		280		280	
A3	A.3.1	Për shpronësim	644			644
	A.3.2	Për rrugën e re të fshatit	1 372			1 372
	A.3.3	Për rrethim	1 011			1 011
	A.3.4	Tabelat e lajmerimeve funerale	180			180
<b>TOTALI</b>			<b>11 297</b>		<b>8 090</b>	<b>3 207</b>
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon Gjatë gjithë vitit.</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Shërbimet Publike</b>			



Nr.14	<b>Projekti : P4.F7.O1.A1</b> Dekorimi i mjediseve publike	<b>Llojet e programit : P4.</b> Shërbimet Publike <b>Funksioni : P4. F7</b> Shërbimi i dekorit publik																												
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>																														
<b>i. Situata</b>																														
<p>Dekori i mjediseve publike dhe mirëmbajtja e sinjalistikës realizohet nga Buxheti i Bashkisë, me mjetet logjistike e fuqinë punëtore të Drejtorisë së Shërbimit dhe Infrastrukturës. Në strukturën e Drejtorisë janë një specialist për dekorin e një specialist për sinjalistikën që punojnë me kohë të plotë për realizimin e shërbimit dhe specialistat e ndriçimit që punojnë me kohë të pjesshme për dekorin në rastet e festave. Gjithashtu me kohë të pjesshme për dekorimin e mjediseve vihen në dispozicion edhe 2 autovinçat e ndriçimit në varësi të Drejtorisë së Shërbimit dhe Infrastrukturës.</p> <p>Puna që kryehet: Ky shërbim realizohet kryesisht për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit, në rastet e festave të tjera zyrtare si dhe aktivitete të ndryshme të Bashkisë gjatë vitit. Sipërfaqja e shesheve dhe e rrugëve të dekoruara në territorin e Bashkisë së Shkodrës është rritur progresivisht nga viti në vit. Pjesa më e madhe e dekorit realizohet me elementë të investuar në vite, të cilët ruhen dhe mirëmbahen nga punonjësit e sektorit. Çdo vit programohen fonde modeste me të cilat realizohet blerja e elementëve të rinj për dekorimin e shesheve kryesore dhe akset kryesore në qendër të qytetit.</p> <p><b>Problemet e paraqitura</b> Në kontekstin e ri territorial të Bashkisë Shkodër, lind nevoja për shtrirjen e këtij shërbimi në të gjitha njësitë administrative të bashkisë si dhe rritja e cilësisë së dekorit urban në të gjitha qendrat dhe sheshet urbane .</p>																														
<b>ii. Synimi i projektit</b>																														
<p>Të përmirësohet cilësia e jetës së qytetarëve Përmirësimi i dekorit urban në të gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës. Përmirësimi i dekorit për aktivitete dhe krijimi i një atmosfere të gëzueshme gjatë festimeve.</p>																														
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>																														
<p><b>I.Dekorimi i mjediseve publike</b> Për vitin 2016 janë parashikuar shpenzimet sipas preventivave për dekorin e mjediseve publike për festat e fund vitit, festat e tjera zyrtare si dhe aktivitetet e ndryshme të Bashkisë gjatë vitit.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Blerje aksesor dekorori për festat e fund vitit: <ul style="list-style-type: none"> <li>blerja e aksesorëve shtesë, të cilët do të vendosen në sheshe e rrugë kryesore të Bashkisë. Pjesa tjetër e dekorit do të realizohet me rreth 350 aksesor të blerë në vitet e kaluara, të cilët ruhen e mirëmbahen nga punonjësit e sektorit.</li> </ul> </li> <li>Blerje materiale të ndryshme për dekorin: <ul style="list-style-type: none"> <li>Këtu përfshihen materialet e domosdoshme për riparimet e mundshme dhe montimin e aksesorëve të dekorit. Në zërat kryesore të shpenzimeve përfshihen: <ul style="list-style-type: none"> <li>Kordon ndriçues dekorative (Ø 12 mm) gjithsej 1000 ml;</li> <li>Tel perçjelles energjie elektrike me dimension 2x1.5 mm gjithsej 1000 ml;</li> <li>Lidhëse kabllosh plastike gjithsej 50 kuti;</li> <li>Pistole saldimi plastike gjithsej 2 copë dhe elektroda saldimi plastike gjithsej 500 copë;</li> </ul> </li> </ul> </li> <li>Blerje flamuj për dekorin e institucioneve administrative në të gjithë territorin si dhe në sheshe dhe rrugë kryesore.</li> </ol>																														
<b>b) Rezultatet që prisni</b>																														
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimi i dekorit në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore në zonat urbane;</li> <li>- Krijimi i dekorit festiv me rastin e festave zyrtare dhe të fundvitit;</li> </ul>																														
<p><b>c) Aktorët e mundshëm</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Shërbimeve publike dhe infrastrukturës</li> <li>• Drejtoria juridike</li> <li>• Njësia e prokurimit</li> <li>• Administratorët e NjA</li> </ul>	<p><b>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribojë për këtë projekt, financiarisht etj.)</b> Bashkia e Shkodrës Donatorët ;</p>																													
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>																														
<p><b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b></p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2"></th> <th rowspan="2">Totali (000 lek)</th> <th colspan="3">Nga kjo:</th> </tr> <tr> <th>Paga, sig</th> <th>operative</th> <th>kapitale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A.1</td> <td>600</td> <td></td> <td>800</td> <td></td> </tr> <tr> <td>A.2</td> <td>400</td> <td></td> <td>400</td> <td></td> </tr> <tr> <td>A.3</td> <td>121</td> <td></td> <td>121</td> <td></td> </tr> <tr> <td><b>Shuma</b></td> <td><b>1 121</b></td> <td></td> <td><b>1 121</b></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Totali (000 lek)	Nga kjo:			Paga, sig	operative	kapitale	A.1	600		800		A.2	400		400		A.3	121		121		<b>Shuma</b>	<b>1 121</b>		<b>1 121</b>		<p><b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë gjithë vitit 2016</p> <p><b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës</p>	
			Totali (000 lek)	Nga kjo:																										
	Paga, sig	operative		kapitale																										
A.1	600		800																											
A.2	400		400																											
A.3	121		121																											
<b>Shuma</b>	<b>1 121</b>		<b>1 121</b>																											

Nr. 15	<b>Projekti : P4.F8.O1.A1</b> Mirëmbajtja e Sistemit të Ndrëçimit Publik të qytetit dhe njësive administrative	<b>Llojet e programit: P4.</b> Shërbimet Publike <b>Funksioni: F8</b> Ndrëçimi i mjediseve publike																													
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>																															
i. Situata																															
<p>Shërbimi i ndriçimit publik të qytetit.</p> <p>Ndrëçimi publik në Nj.A. Qytet, përfshin rrjetin e ndriçimit të shpërndarë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ndriçimi i rrugëve kryesore dhe dytësore</li> <li>• ndriçimi i shesheve</li> <li>• ndriçimi i parqeve dhe lulishteve</li> </ul> <p>Sipërfaqja totale e rrugëve dhe e shesheve arrin afërsisht në 1'200'000 m<sup>2</sup>, nga të cilat 1'080'000 m<sup>2</sup> janë të ndriçuara. Sipërfaqet e lulishteve dhe brezit të gjelbërt zënë një hapësirë mbi 66'000 m<sup>2</sup>, nga të cilat 34'581 m<sup>2</sup> janë të ndriçuara. Ndrëçimi realizohet në një mesatare vjetore 10.5 orë në ditë gjatë gjithë vitit.</p> <p>Asetet në dispozicion të shërbimit të ndriçimit publik për qytetin janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i pikave të furnizimit të energjisë (kabinave elektrike) që kanë kontratë 205 copë</li> <li>• Numri i ndriçuesve të instaluar 4 200 copë</li> </ul> <p>Në territorin urban të qytetit ka 3 lloje shtyllash:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>dekorative:</b> të cilat gjenden në zonat pedonale dhe disa nga parqet e qytetit;</li> <li>• <b>çeliku:</b> pothuajse të gjitha të zinkuara, përbëjnë pjesën dominuese të shtyllave që shërbejnë për ndriçimin e qytetit;</li> <li>• <b>betoni:</b> shtyllat i përkasin OSHEE, por ndriçuesit janë të Bashkisë.</li> </ul> <p><b>Shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit administrohet nga Drejtoria e Shërbimit dhe Infrastruktues. Sektori i mirëmbajtjes së shërbimit të ndriçimit të qytetit përbëhet nga:</b> Përgjegjës sektori, një ekonomiste, 4 elektriciistë, 2 shoferë manovrator vinçi me kosh. Që nga viti 2005 me gjithë rritjen e ngarkesës për punonjësit e shërbimit, janë shtuar vetëm me 2 elektriciistë dhe një ekonomiste, gjë që tregon nevojën për fuqizimin e kësaj stukture.</p> <p><b>Automjetet me të cilën kryhet shërbimi i ndriçimit dhe dekorit janë 2 autovinca njëri prej të cilëve është blerë në gjysmën e dytë të vitit 2015.</b></p> <p>Mirëmbajtja realizohet me të ardhurat e Bashkisë, që mbulojnë: shpenzimet për blerje materiale të ndryshme për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik të cilat planifikohen çdo vit në bazë të preventivave dhe miratohen në buxhetin e Bashkisë. Këto materiale magazinohen dhe tërhiqen nga punonjësit e shërbimit të ndriçimit sipas nevojave gjatë gjithë vitit.</p> <p>Në njësitë e tjera administrative situata e ndriçimit është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Nj.A. Rrethina:</b> Në Dobraq, s'ka kontratë të lidhur me OSHEE dhe janë të instaluar 34 ndriçues ndër të cilët 24 në gjendje pune, kurse pjesa tjetër është jashtë funksionit për mangësi teknike. Në Grudë të Re ka 12 ndriçues, por pa kontratë. Lagjja Vinotekë ka 8 ndriçues pa kontratë.</li> <li>• <b>Nj.A. Bërdicë:</b> Në Trush hyrja për në qendër të fshatit ka 25 shtylla, nga të cilat 12 janë jashtë funksionit. Në Bërdicë e Sipërme ka 13 shtylla, dhe në Beltojë 5 shtylla, pa kontratë.</li> <li>• <b>Nj.A. Gur i Zi:</b> Ndrëçimi në Gur të Zi është i rregulluar me kontratë por ka 5 ndriçues me defekt. Në Vukatanë gjithashtu ka kontratë dhe rrjeti paraqitet në gjendje të mirë. Në Juban ka kontratë ndërsa në Kuç rrjeti i ndriçimit është funksional, por është ndërprerë furnizimi me energji për mungesë kontrate.</li> <li>• <b>Nj.A. Postribë:</b> Në Mes rrjeti elektrik është jashtë funksionit pasi nuk ka kabëll furnizimi dhe nuk ka kontratë me OSHEE.</li> <li>• <b>Nj.A. Dajç:</b> Në qendren e Dajçit ka 18 ndriçues, nga të cilët 5 janë jashtë funksionit dhe kanë nevojë për riparim. Në Samrish të Ri ka një linjë me 5 ndriçues, e cila nuk funksionon për arsye teknike. Në Mushan ka 11 ndriçues, nga të cilët 2 kanë nevojë për riparim</li> <li>• <b>Nj.A. Velipojë:</b> Në plazhin Velipojë ka 2 linja ndriçimi të cilat janë në funksion të pjesshëm, kurse rruga e Vilunit nuk ka kontratë dhe është jashtë funksionit</li> </ul>																															
<u>Problemet e paraqitura</u>																															
• <b>Vjedhja e kallbove të ndriçimit dhe kuadër komandimi</b>																															
<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Emërtimi</th> <th>Njësia</th> <th>Sasia</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Kabëll 4x10 Unaza Perëndimore</td> <td>ml</td> <td>3000</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Kabëll 4x10 Rruga e Kalasë</td> <td>ml</td> <td>400</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Rruga "Besnik Ceka" (4x10)</td> <td>ml</td> <td>400</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Blv. "Marin Beçikemi" (4x10)</td> <td>ml</td> <td>400</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Rruga "Tepe" (4x10)</td> <td>ml</td> <td>200</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>Kuadër komandimi në kabina të ndryshme</td> <td>copë</td> <td>5</td> </tr> </tbody> </table>	Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	1	Kabëll 4x10 Unaza Perëndimore	ml	3000	2	Kabëll 4x10 Rruga e Kalasë	ml	400	3	Rruga "Besnik Ceka" (4x10)	ml	400	4	Blv. "Marin Beçikemi" (4x10)	ml	400	5	Rruga "Tepe" (4x10)	ml	200	6	Kuadër komandimi në kabina të ndryshme	copë	5			
Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia																												
1	Kabëll 4x10 Unaza Perëndimore	ml	3000																												
2	Kabëll 4x10 Rruga e Kalasë	ml	400																												
3	Rruga "Besnik Ceka" (4x10)	ml	400																												
4	Blv. "Marin Beçikemi" (4x10)	ml	400																												
5	Rruga "Tepe" (4x10)	ml	200																												
6	Kuadër komandimi në kabina të ndryshme	copë	5																												



- **Dëmtimi i shtyllave të ndriçimit dekorativ. Në qytetin e Shkodrës janë të instaluar gjithsej 117 ndriçues dekorativ, nga të cilat një pjesë janë dëmtuar kryesisht nga aksidentet rrugore si më poshtë:**

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Pedonale "13 Dhjetori – 28 Nëntori"	copë	3
2	Pedonale "K. Idromeno" (para xhamisë)	copë	2
3	Rruga "Jeronim De Rada" (para Institutit)	copë	1
4	Pedonale "Gjuhador"	copë	10

- **Zëvendësim ndriçuesish të dalë jashtë përdorimit dhe të thyer**

Nr.	Rruga / Aksi	Njësia	Sasia
1	Bahçallek-Sheshi Balshaj	copë	10
2	Sheshi Balshaj – Shkolla Pyjore	copë	11
3	Rruga "Europa"	copë	3
4	Rruga Bujar Bishanaku	copë	6
5	Unaza Perëndimore	cope	15
6	Bulevardi Skenderbeg	copë	5

- Me rritjen nga viti në vit të sipërfaqeve të ndriçuara ka qenë i pa përballueshëm realizimi i mirëmbajtjes së ndriçimit dhe dekorit. Me blerjen e autovinçit të ri dhe vënien në funksion të tij në 4-mujorin e fundit te vitit qe shkoi, situata është përmirësuar.
- Shtimi i mjeteve kërkon rritjen e kapaciteteve me punonjës shtesë (manovrator dhe elektrikist) për riparimin e defekteve.
- Veglat e punës ekzistuese janë të konsumuara dhe nuk i përgjigjen kushteve dhe sigurimit teknik. Nga kontrolli i Inspektoriatit Qendror Teknik është mbajtur një procesverbal, ku është konstatuar që punonjësit e ndriçimit rrugor janë pa komplete të sigurimit teknik dhe është lënë detyrë paisja e tyre me këto komplete. Këto komplete përmbajnë (galoshe dieletrike, doreza elektrike për tension të ulët, tregues tensioni deri 1000 V, tokëzues portativ, vegla pune me doreza të izoluar, rrip sigurimi për montatorët, kambaleca për ngjitje në shtyllë. etj)

#### **Monitorimi:**

Monitorimi i shërbimit realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike e të Infrastrukturës. Evidentimi i defekteve dhe raportimi i tyre pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës bëhet nga njësite administrative dhe punonjësit e ndriçimit publik sipas njërive që ata mbulojnë. Gjithashtu formë tjetër është informimi nga komuniteti nëpërmjet shkresave apo njoftimeve të ndryshme pranë zyrave të informimit për publikun në çdo Njësi Administrative.

- I. Shpenzimet për pagesat e ndriçimit rrugor për qytetin dhe njësitë administrative

Për sektorin e ndriçimit rrugor janë aktualisht 205 kontrata aktive me rreth 4200 ndriçues në qytet dhe 8 kontrata në njësitë e reja administrative. Në fillim të vitit në buxhet parashikohen shuma për pagesën e energjisë elektrike në bazë të fuqisë së instaluar. OSHEE faturon çdo muaj 205 kontratat e furnizimit me energji. Për çdo problem në lidhje me faturimin bëhet verifikimi në terren. Për leximet që kontestohen, mbahet proces-verbali përkatës dhe pastaj ndiqet në rrugë administrative dhe gjyqësore. Një herë në vit bëhet akt-rakordimi me OSHEE për të gjitha kontratat e ndriçimit rrugor. Plani i parashikuar për vitin 2015 për pagesën e energjisë së ndriçimit rrugor është 36,000,000 lek, ndërsa konsumi i energjisë elektrike për qytetin deri në nëntor te vitit 2015 është 2,081,792 këh dhe 34,974,100 lek. Për vitin 2015 janë likuiduar të gjitha faturat përveç disa që i kemi kontestuar në rrugë administrative për faturime të parregullta me vlerë prej 861,472.8 lek.

Në njësitë e tjera administrative situata e pagesës së ndriçimit për vitin 2015 është si më poshtë:

- **Nj.A. Rrethina:** Nuk ka realizuar asnje pagese pasi nuk ka kontrata per 3 linjat e ndriçimi
- **Nj.A. Bërdicë:** Pagesat e ndriçimit publik deri në nëntor janë 168,489 lekë
- **Nj.A. Gur i Zi:** Pagesat e ndriçimit publik deri në nëntor janë 272,219 lekë
- **Nj.A. Dajç:** Pagesat e ndriçimit publik deri në nëntor janë 425,950 lekë
- **Nj.A. Velipojë:** Pagesat e ndriçimit publik deri në nëntor janë 604,795 lekë

#### **Problemet e paraqitura**

- Faturimet e parregullta ku përfshihen: mbi faturime, lexim jashtë kushteve teknike,
- Përfshirja e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive në faturat e energjisë elektrike deri në maj 2015. Kjo tarifë nuk është paguar asnjëherë nga ana jonë megjithëse është faturuar rregullisht. Për heqjen e kësaj tarifë jemi në proces gjyqësor me OSHEE.

ii. Synimi i projektit
Mbajtjen në efikasitet të rrjetit të ndriçimit publik dhe menaxhimin me efektivitet si dhe pagesën për energjinë e shpenzuar nga rrjeti i ndriçimit publik.
iii. Aktivitetet kryesore të projektit
<p>1. <b>Shpenzimet për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik</b> të ndriçimit publik janë parashikuar në bazë të preventivave të hartuar për ndërhyrje rehabilituese dhe riparimin e defekteve në të gjitha rrugët, sheshet, blloqet e banimit dhe lulishtet. Parashikimi për bazën materiale për mirëmbajtje është bërë duke u bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara, ndërhyrjet rehabilituese për ndriçues të dalë jashtë përdorimi, zëvendësimi i kabllove të vjedhuara në vitet e fundit, amortizimi i ndriçuesve nga orët e punës që kanë 5 vjet garanci , pjesa me e madhe e tyre e kanë kaluar këtë periudhë.</p> <p>1.1 Materiale për ndërhyrje rehabilituese. Këtu përfshihen zëvendësimi i kallbove të vjedhuara në vitet e fundit në rrugët: Unaza Perëndimore 2000 ml, Rruga e Kalasë 400ml, Rruga Besnik Ceka 400ml, Rruga Marin Beçikemi 400ml dhe Rruga Tepe 200ml me dimension 4x10 mm Zëvendësimi i kuadrove të komandimit të dëmtuara (5 copë) Zëvendësimi ndriçuesish të dalë jashtë përdorimi dhe të thyer në rrugët: Bahçallek-Sheshi Balshaj 10 copë, Sheshi Balshaj-Shkolla Pyjore 11 copë, Rruga Europa 3 copë, Rruga Bujar Bishanaku 6 copë, Bulevardi Skenderbeg 5 copë dhe Unaza Perëndimore 15 copë dhe 30 copë krah ndriçuesish</p> <p>1.2 Materiale për mirëmbajtje e rrjetit të ndriçimit publik gjatë vitit</p> <p>Këtu përfshihen shpenzimet për materiale e domosdoshme për riparimin e difekteve të mundshme të ndriçuesve. Në zërat kryesore të shpenzimeve përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Automat të madhësive të ndryshme 10 A deri 63 A gjithsej 520 copë. Këto automate do i përdorim për riparim e difekteve gjatë viti si dhe për dekorimin e qytetit me rastin e festave të fund vitit , ku çdo ndriçues kërkon një automat të veçantë,</li> <li>• Drosel ndriçuesi 250 Ë, 150 Ë dhe neon 36 Ë gjithsej 1040 copë</li> <li>• Kabëll elektrik të madhësive 2x2.5, 2x4, 2x6, 3x6,4x4,4x6, 2x6 koksial mm2 gjithsej 4300 m për eliminimin e difekteve nga dëmtimet gjatë viti</li> <li>• Lëshues të kapacitetit 25 A deri 40A gjithsej 350 copë.</li> <li>• Lampa SAP 150 Ë gjithsej 900 copë dhe 250 Ë gjithsej 130 copë</li> <li>• Lampa 70 Ë gjithsej 130 copë</li> <li>• Lampa fuoriesçente 22 Ë gjithsej 400 copë</li> <li>• Rele krepuskolare modulare 16/30 gjithsej 100 copë</li> <li>• Rele krepuskolare për shtyllë 12/25 gjithsej 100 copë</li> <li>• Portollampa për lampa SAP 150 Ë gjithsej 100 copë</li> <li>• Portollampa porcelani për lampa elektronike 22 Ë gjithsej 250 copë</li> <li>• Kaseta metalike 40x50 gjithsej 13 copë</li> </ul> <p>Evidentimi i difekteve bëhet nga specialistat e punonjësit e sektorit të ndriçimit publik, nga punonjësit e njësive administrative dhe kërkesat e qytetarëve.</p> <p>2. <b>Shpenzimet për pagesat e faturave të ndriçimit publik parashikohen:</b></p> <p>2.1 Pagesa për konsumin e energjisë elektrike për 205 kontratat në qytet. Rritja e shpenzimeve vjen si rezultat i investimeve të reja gjatë vitit 2015: si Unaza Lindore e Qytetit , rruga e Shirokës, rruga Gjovalin Gjadri dhe 15 rrugët dytësore.</p> <p>2.2 Pagesat për konsumin e energjisë elektrike për kontratat e reja që do hapen pas realizimit të investimeve në vitin 2016</p> <p>2.3 Pagesat për konsumin e energjisë elektrike për kontratat ekzistuese, dhe kontratat për investimet e reja gjatë vitit 2016 në njësive e reja administrative</p> <p>2.4 Pagesa tarife pranë OSHEE për hapjen e 7 kontratave të reja në njësive administrative ku ka rrjete të ndriçimit rrugor dhe kontratave të reja të ndriçimit rrugor sipas fuqisë së instaluar për investimet që do të realizohen gjatë vitit</p> <p>2.5 Për pagesën e ekspertit në rast të kundërshtimit të faturave të energjisë të ndriçimit rrugor në rrugë gjyqësore</p> <p>Monitorimi</p> <p>Funksionimi i sistemit të kontrollit të rrjetit të ndriçimit publik dhe evidentimi i difekteve nëpërmjet punonjësit të sektorit të ndriçimit publik, njësive administrative dhe komunitetit</p> <p>Verifikimi në terren i kontratave të ndriçimit rrugor për faturat e kontestueshme</p> <p>Ndekja e procedurave administrative dhe gjyqësore</p> <p>Ndekja e procedurave për lidhjen e kontratave të reja nga specialisti përkatës</p> <p>3. <b>Blerje komplet veglash dhe komplete të sigurimit teknik</b></p> <p>Veglat e punës ekzistuese janë të konsumuara dhe nuk i përgjigjen kushteve teknike dhe sigurimit teknik. Do të parashikohen blerjet si më poshtë: set pincash, set kaçavidash, trakide, dandic, etj. Kompletet e sigurimit teknik përmbajnë (galoshe dieletrike, doreza elektrike për tension të ulët, tregues tensioni deri 1000 V, tokëzues portativ, vegla pune me doreza të izoluar, rrip sigurimi për montatorët, kambaleca për ngjitje në shtyllë. etj)</p> <p>4. <b>Pjesë këmbimi për 2 autovinçat</b></p> <p>Në funksion të mirëmbajtjes së ndriçimit dhe dekorit janë 2 autovinçat tip</p> <p>4.1 IVECO</p> <p>4.2 NISSAN ,</p> <p>për të cilët parashikojmë këto shpenzime për pjesë këmbimi. Në zërat kryesor mund të përmendim: pjesë këmbimi si ndërrim filtra vaj, ajri, naftë, ndërrim vaj motori, ndërrim goma, ndërrim vaj hidraulik si dhe riparime të ndryshme të parashikueshme që mund të ketë gjatë vitit. Për secilin nga këto autovinça është hartuar preventivi përkatës i pjesëve të këmbimit</p>





<p><b>5. Mirëmbajtje për 2 autovinçat</b> Në funksion të mirëmbajtjes së ndriçimit dhe dekorit janë 2 autovinçat tip</p> <p>5.1 IVECO, në zërat kryesor mund të përmendim: mirëmbajtje të zakoshme si ndërrim filtra vaj, ajri, naftë, ndërrim vaj motorri, ndërrim goma, riparim hidraulik i vinçit, riparim pompe naftë, saldimi i koshit si dhe riparime të ndryshme të paparashikueshme që mund të ketë gjatë vitit.</p> <p>5.2 Për autovinçin NISSAN i cili është blerë në vitin 2015 janë parashikuar me pak shpenzime për mirëmbajtje</p> <p>Për secilin nga këto autovinça është hartuar preventivi përkatës i shërbimeve. Për autovinçin IVECO është parashikuar më shumë shpenzime për mirëmbajtje pasi është më i vjetër.</p>					
<p><b>6. Shpenzime për karburant për 2 autovinçat.</b> Në bazë të normativave të llogarituara parashikohen që për secilin mjet konsumi të jetë 3960 litra në vit me një mesatare prej 330 litra në muaj për secilin mjet. Për të dytë autovinçat parashikohen 7 920 litra në vit.</p> <p>6.1 IVECO 3960 litra 6.2 NISSAN 3960 litra</p>					
<p><b>7. Pagesa për dokumentacionin e mjeteve (2 autovinçat)</b> Për secilin mjet parashikojmë shumën që na nevojitet për pagesën e siguracionit, taksave dhe kolaudimit</p> <p>7.1 Siguracion IVECO 7.2 Siguracion NISSAN</p>					
<p><b>8. Investime</b> Investimet në ndriçimin e rrugëve dytësore. Me këtë investim do të realizohet ndriçimi publik me vendosjen e 132 ndriçuesve në rrugë të ndryshme sipas prioriteteve në qytet dhe në njësitë administrative. Ndriçimi do të realizohet duke shfrytëzuar aty ku është e mundur shtyllat ekzistuese dhe linjat ekzistuese, gjë që ul kostot.</p>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<p>Rezultatet për qytetin: Mirembajtja e gjithë rrjeti i ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë Rehabilitimi i 3400 ml ndriçim publik që do të venë në efikencë 136 ndriçues Zevendesimi i 50 ndriçuesve të dalë jashtë përdorimit Realizimi i lidhjes së 20 kontratave të reja në qytet Realizimi i pageses për konsumin e pritsëm të energjisë elektrike për rreth 2,620,000 këh në vit Realizimi i ndriçimit publik në 2500 ml rrugë dytësore Rehabilitimi i 8 linja ekzistuese për njësitë administrative që do të venë në funksionim 93 ndriçues</p>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)</b>		
Punonjësit e sektorit të ndriçimit Banorët e qytetit dhe njësitë të reja administrative			Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërme (pika iii)</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>					
<b>Renditja e aktiviteteve me kostot përkatëse sipas pershkrimit tek aktivitetet me lart.</b>		<b>Totali (000 lek)</b>	<b>Nga kjo:</b>		
			<b>Paga , sig</b>	<b>oper ative</b>	<b>kapit ale</b>
<b>A.1</b>	<b>Ndërhyrje rehabilituese dhe mirëmbajtje</b>	<b>12 500</b>		12 500	
<b>A.2</b>	<b>Pagesa e konsumit të ndriçimit</b>	<b>43 750</b>			
2	A.2.1	Pagesa e konsumit të ndriçimit publik (ekzistues +zgjerim) sipas faturimit OSHEE Nj.A. Shkodër		40 000	
	A.2.2	Pagesa e konsumit të ndriçimit publik (ekzistues +zgjerim) sipas faturimit OSHEE në 5 Njësitë administrative		3 000	
	A.2.3	Kosto për lidhje kontrate me OSHEE qytet e njësitë e tjera		600	
	A.2.4	Shërbim eksperti për procese gjyqësore		150	
<b>A.3</b>	<b>Blerje komplet veglash dhe komplete të sigurimit teknik</b>	<b>330</b>		<b>330</b>	
<b>A.4</b>	<b>Pjesë këmbimi</b>	<b>323</b>			
4	A.4.1	Pjesë këmbimi për autovinçin IVECO		231	
	A.4.2	Pjesë këmbimi për autovinçin NISSAN		92	
<b>A.5</b>	<b>Mirëmbajtje</b>	<b>87</b>			



5	A.5.1	Mirëmbajtje për autovinçin IVECO			77	
	A.5.2	Mirëmbajtje për autovinçin NISSAN			10	
<b>A.6</b>		<b>Shpenzime për karburant</b>	<b>1</b>			
			<b>348</b>			
	A.6.1	Shpenzime për karburant për autovinçin IVECO			674	
	A.6.2	Shpenzime për karburant për autovinçin NISSAN			674	
<b>A.7</b>		<b>Pagesa për dokumentacionin</b>	<b>200</b>			
7	A.7.1	Pagesa për taksa, siguracion e kolaudim për autovinçin IVECO			100	
	A.7.2	Pagesa për taksa, siguracion e kolaudim për autovinçin NISSAN			100	
<b>A.8</b>		<b>Investime</b>	<b>6</b>			
			<b>550</b>			
8	A.8.1	Investime rrugë dytësore				6 000
	A.8.2	Studim projektim				300
	A.8.3	Mbikëqyrje kolaudim				250
		<b>Shuma</b>	<b>65</b>		<b>58</b>	<b>6</b>
			<b>088</b>		<b>538</b>	<b>550</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë gjithë vitit 2016.			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Shërbimit dhe Infrastrukturës			



Nr.16	<b>Projekti: P4.F9.O1.A1</b> Shpenzime per pagat dhe sigurime shoqerore per punonjesit e Sherbimeve Publike	<b>Llojet e programit: P4</b> Shërbimet publike <b>Funksioni : P4.F9 :</b> Shërbime publike vendore në NJ.A.			
<b>e) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Paga dhe shtesat mbi paga për 77 punonjëës mbështetes shërbimi, mirëmbajtje, pastrim, heqje mbeturina urbane, roje</b> Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli, do të bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë , në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve do bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1619, datë 02.07.2008, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive te qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve te pagave te punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, ndryshuar me V.K.M Nr.518, datë 16.08.2012, ndryshuar me VKM Nr. 586, date 17.07.2013.</li> <li>• <b>Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore</b> Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.</li> <li>• <b>Kompensim për kryefamiljarët me ngarkesë me më shumë se tre persona në ngarkim</b> Sipas VKM Nr. 499, dt 13.08.1998, VKM. Nr. 683 dt 28.10.1988 dhe udhëzimit të M.P.Ç.Sociale, nr 3311, dt 24. 12. 1998, të punësuarit në sektorin buxhetor përfitojnë shpërblim sipas rastit</li> </ul>					
ii. Synimi i projektit					
Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqerore dhe shëndetësore të punonjësve të shërbimeve publike					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Sigurimi i shpenzimeve <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Paga,</li> <li>2. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore për administratën vendore</li> <li>3. Kompensime</li> </ol>					
<b>b) Rezultatete pritshme</b>					
Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të administratës vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Drejtoria e Financës		Bashkia Shkodër			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Total (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	transfera
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	24 363	24 363		
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3 875	3 875		
A.3	Kompensime për kryefamiljarët me ngarkesë më shumë se 3 fëmij	360			360
<b>TOTALI</b>		<b>28 598</b>	<b>28 238</b>		<b>360</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Gjatë vitit 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Drejtoria e Financës			

Nr 1	<b>Projekti: P5.F1.O1.A1</b> Mobiliteti dhe Shërbimi i Transportit Urban	<b>Llojet e programit: P5.</b> Transporti publik dhe lëvizshmëria <b>Funksioni: F1.</b> Transportin publik vendor
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>a. Mobiliteti</p> <p>Në kuadër të mobilitetit të qëndrueshëm urban, dhe një trafiku më të sigurtë, si dhe nxitjen e përdorimit të biçikletave, Bashkia e Shkodrës përballlet me disa sfida:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtimi i qarkullimit të automjeteve, i cili shpeshherë paraqet raste të drejtuesve të mjeteve të pandërgjegjshëm, të cilët kalojnë kufijtë e shpejtesisë së lejuar.</li> <li>• Mungesa e një plani studimor për trafikun, lëvizshmerine dhe sinjalistikën, në kushtet e ndryshimeve dinamike të infraskuturës në qytet.</li> <li>• Shërbimi i sinjalistikës përbën sinjalistikën horizontale dhe vertikale. Për sinjalistikën horizontale realizohet vijëzimi i rrugëve kryesore të qytetit, vijëzimi i parkingjeve, korsitë e biçikletave dhe vijëzimet e këmbësorëve në degëzimet kryesore, në afërsi të shkollave dhe në rrugët me densitet të madh popullesie. Gjatë këtij viti janë vijëzuar rreth 16,000 ml rrugë. Ky shërbim realizohet me një makinë vijëzimi me kapacitet 40 litra, e cila është tejet e amortizuar. Për sinjalistikën vertikale në gjithë qytetin janë rreth 1000 tabela të llojeve të ndryshme. Çdo vit me buxhetin e Bashkisë realizohet blerja e materialeve (tuba dhe tabela) sipas nevojave për zëvendësimin e tabelave të dëmtuara, si dhe përmirësimin e sinjalistikës. Ndryshimet për përmirësimin e sinjalistikës bëhen sipas vendimeve të Këshillit të Bashkisë, urdhërave të Kryetarit të Bashkisë, konsultimet dhe sugjerimet me specialistët e policisë.</li> </ul> <p><b>Problemet e paraqitura</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e sigurisë për shkak të drejtuesve të mjeteve të papërgjegjshëm në pika të caktuara.</li> <li>• Konflikti këmbësor – përdorues automjeti, për shkak të investimit të bërë së fundmi nga ana e Bashkisë me bump-et (policët e shtrirë). (Ndërkohë që përdoruesit e automjeteve janë ankuar mbi vendosjen e bumpeve, shumë qytetarë, drejtues shkollash, përfaqësues komunitetesh kanë paraqitur kërkesa për vendosjen e tyre, pasi ngadalëson automjetet, si dhe krijon mundësi për një kalim të sigurtë në vijat e bardha).</li> <li>• Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës për lëvizjen me biçikleta si dhe promovimi i pedalimit.</li> <li>• Përdorimi i mjeteve të transportit publik nuk ka qenë në nivelin optimal. Për rrjedhojë, përdorimi i automjeteve personale nuk ka pësuar rënie.</li> <li>• Nevoja për rishikimin e planit të sinjalistikës</li> <li>• Dëmtimet e qëllimshme të sinjalistikës dhe vjedhja e tyre</li> <li>• Nevoja për një mjet të ri përshtatshëm për vijëzimin e rrugëve</li> </ul> <p>Në njësitë e reja administrative ka mungesë të theksuar të sinjalistikës horizontale e vertikale</p> <p>b. Transporti Urban</p> <p>Ky shërbim paraqitet me 5 linja të miratuara, nga të cilat në funksion janë linjat urbane:</p> <p>Linja 1 (Bahçallek – Fermentim) dhe Linja 2 (Qendër –Shirokë – Zogaj).</p> <p>Ndërkohë, Linja 3 (Stacioni i Trenit – Kiras), Linja 4 (Unaza) dhe Linja 5 (Rus i Madh – Tregu i Shumicës) janë akoma jashtë shërbimit.</p> <p>Linja 1 realizohet me 50 cikle në ditë me frekuencë 15 minuta paradite dhe 25 minuta pasdite. Linja 2 shërbehet 4 herë në ditë sipa orareve të miratuara, 3 nga të cilat me destinacion deri në Zogaj.</p> <p>Për këtë shërbim, Bashkia e Shkodrës subvencionon 800 abone për kategorinë nxënës – student për diferencën e çmimit të biletës.</p> <p>Tarifa mujore e llogaritur është 1800 lekë, nga të cilat 600 lekë paguan abonenti, dhe 1200 lekë Bashkia.</p> <p><b>Problemet e paraqitura</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Trafik i rënduar në akse të ndryshme, i cili redukton shpejtësinë e transportit urban, si dhe ndikon negativisht në respektimin e frekuencave, duke demotivuar rrjedhimisht qytetarët në përdorimin e tij.</li> <li>• Zënia e vendqendrimeve nga parkimi i jashtëligjshëm i automjeteve.</li> <li>• Moseficienta e linjave të tjera.</li> <li>• Dëmtimi i sinjalistës ekzistuese, si dhe nevoja për streha vendqendrimesh cilësore, aty ku mungojnë.</li> <li>• Kërkesa e operatorit për rritjen e çmimit të biletës.</li> </ul>		
ii. Synimi i projektit (me një fjali cfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitim i grupit të synuar)		
<p>Të rritet cilësia dhe siguria e jetës së qytetarëve</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hartimi i studimit të sinjalitikes së lëvizshmërisë urbane për gjithë territorin administrativ të Bashkisë Shkodër si dhe integrimi i rrjetit të shërbimit të transportit urban për njesite administrative të bashkisë.</li> <li>• Rritja e sigurisë në rrugë për këmbësorët dhe pedalesit</li> <li>• Planifikimi i linjave të shërbimit transportit publik urban në kuadër të ndarjes së re administrative</li> </ul>		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		

## 1. Mobiliteti

Lëvizshmëria (Mobiliteti) e qëndrueshme mbetet një sfidë kryesore në përmirësimin e mënyrës së jetesës në qytetet e sotme Europiane. Nxitja e ecjes në këmbë, pedalimit, përdorimit të transportit publik dhe reduktimi i përdorimit të automjeteve personale, mbetet një nga prioritetet kryesore të Mobilitetit. Kjo jo vetëm për një ajër më të pastër, por edhe për një transport më të sigurt, reduktim aksidentesh, dhe rikualifikim hapësirash urbane, dhe qytete më të jetueshme.

Duke qënë se qyteti i Shkodrës si dhe pjesa fushore e Bashkisë dallohen për përdorimin e biçikletës (mjet efikas për një mobilitet të qëndrueshëm dhe cilësor) ruajtja dhe promovimi i mëtejshëm i përdorimit të këtij mjeti mbetet një mision, i cili synon përmirësimin e cilësisë së jetesës, ruajtjen e traditës, por edhe promovimin e kësaj kulture jashtë kufijve të vetë Bashkisë.

- Projekt-studim trafiku i cili parashikon rishikimin e planit të ri të trafikut në përshtatje me ndryshimet infrastrukturore në qytet dhe ndarjen e re territorial si dhe integrimi i rrjetit të shërbimit të transportit urban për njesite administrative të bashkisë.
- Ndërtim bump-e me vija të bardha me sinjalistikën përkatëse (250 metra) në prani të shkollave, në nyjet me qarkullim të lartë këmbësorësh në të gjithë territorin e Bashkisë.
- Promovim me media, banera, fletushka, etj, i cili nxit mënyrat e lëvizjes së qëndrueshme (ecje, pedalim, transport urban), si dhe për sensibilizimin e reduktimit të automjeteve dhe shtimin e sigurisë në rrugë.
- Linjat e dedikuara për biçikleta

- Sinjalistika

Për vitin 2016 janë parashikuar shpenzimet për sinjalistikën horizontale e vertikale në bazë të preventivave përkatës. Parashikimi për bazë materiale për mirëmbajtjen e sinjalistikën horizontale e vertikale është bërë duke u bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara. Në zërat kryesore të shpenzimeve përfshihen: Blerje materiale për sinjalistikë horizontale + vertikale

- ✓ Bojë rrugore e bardhë gjithsej 4000 kg
  - ✓ Bojë rrugore e verdhe gjithsej 1000 kg
  - ✓ Fosfor gjithsej 2080 kg
  - ✓ Shkrirës boje (diluvent) gjithsej 1300 kg
  - ✓ Tabela rrugore të ndryshme gjithsej 140 copë
  - ✓ Jelek fosforeshent gjithsej 4 copë
  - ✓ Kone ndarëse trafiku gjithsej 15 copë
  - ✓ Pulsante gjithsej 6 copë
- Monitorimi  
Monitorimi i shërbimit realizohet nëpërmjet punonjësve të dekorit e të sinjalistikës.
  - Hartimi i një plani për dekorimin e mjediseve publike e mirëmbajtja e sinjalistikës sipas prioritetëve.
  - Pjesë këmbimi për makinën e vijëzimit  
Në funksion të mirëmbajtjes së sinjalistikës horizontale është një makinë vijëzimi, për të cilën parashikojmë këto shpenzime për pjesë këmbimi. Në zërat kryesor mund të përmendim: zëvendësimi gomash, kompresor, pistole boje si dhe riparime të ndryshme të paparashikueshme që mund të ketë gjatë vitit. Për makinën e vijëzimit është hartuar preventivi përkatës i pjesëve të këmbimit.
  - Shpenzime për karburant për makinën e vijëzimit  
Në bazë të normativave të llogarituara parashikohen që për makinën e vijëzimit 800 litra në vit.
  - Investime  
Blerje e një makine të re vijëzimi. Parashikohet blerje e një makine vijëzimi me kapacitet deri 80 litra, me 2 sprucator, njëri për bojë e tjetri për fosfor.

## 2. Transporti Urban

Realizimi i shërbimit në oraret dhe frekuencat e miratuara: Linja 1 (Fermentim – Bahçallek) 50 cikle me frekuencë 15 minuta paradite dhe 25 minuta pasdite) si dhe Linja 2 shërbehet 4 herë në ditë, 3 nga të cilat shërbejnë deri në Zogaj.

Gjatë këtij viti në kuadër të politikave sociale, është parashikuar subvencionimi për 800 nxënës e studentë, ku Bashkia mbulon diferencën e çmimit të biletës prej 1200 lekësh në muaj, dhe abonenti paguan vetëm 600 lekë.

Duke u bazuar nga kërkesat e komunitetit dhe ndarjes së re administrative, do të bëhet studimi i shtrirjes së linjave ekzistuese brenda Bashkisë, dhe në Njësitë Administrative.

Monitorimi për zbatimin e frekuencave, orareve, vendqëndrimeve, etj ne perputhje me kontratat e nënshkuara me operatorët, për realizimin e shërbimit do të bëhet nga sektori përkatës në Drejtinë e Shërbimit dhe Infrastruktūrës, Njësitë Administrative dhe Policisë Bashkiake. Ndërsa dhënia e subvencioneve për diferencën e çmimit të biletës do të monitorohet nga Drejtoria e Shërbimit dhe Infrastruktūrës dhe Drejtoria e Financës.

### b) Rezultatet që prisni

Rritja e sigurisë në rrugë dhe në hapësirat publike.  
Kushte lehtësueve dhe nxitje për përdorimin e biçikletave.  
Demotivim për përdorimin e automjeteve private.  
Krijimi i kushteve për funksionimin normal të linjave ekzistuese, duke kërkuar bashkëpunimin e Policisë Rrugore.  
Shtim të përdoruesve të transportit urban, nëpërmjet respektimit rigoroz të cikleve dhe orareve.  
Zbatimi dhe nxitja e mëtejshme e politikave favorizuese ndaj shtresave në nevojë.

Një qytet me ajër më të pastër, me njerëz më aktivë e më të shëndetshëm, si dhe më të sigurtë nga aksidentet.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme ne projekt (kush do te kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)</b>		
Drejtoria e Shërbimeve publike dhe Infrastrukturës Drejtoria e Financës. Operatori i Transportit Nxenes dhe studentë			Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura ( për cdo aktivitet të mësipërm (pika iii)</b>					
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	subvencion	operative
<b>A.1</b>	<b>Mobiliteti</b>				
1	A.1.1	Projekt-studim trafiku			
	A.1.2	Ndërtim sinjalistike horizontale (bumpe me vija të bardha)			
	A.1.3	Promovim			600
	A.1.4	Linjat e dedikuara për bicikleta			
	A.1.5	Blerje materiale për sinjalistikë horizontale + vertikale			3 000
	A.1.6	Pjesë këmbimi për makinën e vijëzimit			118
	A.1.7	Mirëmbajtje për makinën e vijëzimit			22
	A.1.8	Shpenzime për karburant për makinën e vijëzimit			136
	A.1.9	Investime, Blerje makinë vijëzimi			3 500
<b>A.2</b>	<b>Transporti Urban</b>				
	Subvencione për abonetë e transportit urban		7 000		
<b>Totali</b>		<b>14 376</b>	<b>7 000</b>	<b>3 876</b>	<b>3 500</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë gjithë vitit 2016.			<b>g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Shërbimit dhe Infrastrukturës		



Nr.1	<b>Projekti : P6.F1.O1.A1</b> Hartimi i Planit te Zhvillimit Ekonomik te Bashkise Shkoder (krijimi i nje bordi lokal te zhvillimit ekonomik me perfaqesues te sektoreve baze dhe hartimi i nje plani vjetor )	<b>Llojet e programit : P6.</b> Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit <b>Funksioni F1</b> Hartimin e planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal			
<b>a) Pershkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Ne kuader te reformes territoriale , tashme eshte krijuar nje territor i ri administrativ per bashkine Shkoder e cila perbehet nga 11 njesi administrative. Ne zbatim te ligjit per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore nje nga programet dhe funksionet kryesore te bashkive eshte hartimi i dokumentave te zhvillimit strategjik per komunitet e tyre . Gjate viteve jane hartuar nje sere dokumentash strategjik per sektore te ndryshen si ne nivelin lokal bashki apo komune , apo ne nivel qarku. Shume nga ish komunat , sot pjese te Bashkise Shkoder si njesi administrativeve saj, kane patur te hartuara dokumente strategjike per njesite administrative te tyre. Ndersa disa te tjera nuk kane patur. Situata e mesiperme kerkon hartimin e nje dokumenti strategjik per zhvillimin ekonomik per te gjithë territorin e ri te Bashkise .					
ii. Synimi i projektit					
Hartimi i dokumentit te zhvillimit ekonomik lokal per Bashkine Shkoder me qellim rritjen dhe forcimin e ekonomise vendore per rritjen e numrit te bizneseve , numrit te punesuarve dhe mireqenies se komunitetit.					
iii. Aktivitetet kryesore te projektit					
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijimi i bordit te zhvillimit ekonomik lokal te Bashkise Shkoder Krijimi i grupit kryesor te punes i perbere nga grupi i institucioneve, biznesit, organizatave jo fitimprures dhe grupit qytetar. Meqenese hartimi i Strategjise Zhvillimit Ekonomik perfshin shume fusha, ne grupet e punes do te perfshihen perfaqesues te bizneseve , specialiste te ndryshem si ekonomiste, juriste, inxhiniere, arkitekte, eksperte te mjedisit, te komunikacionit shoqeri civile etj. Nje rendesi te vecante do te jete perfshirja e universitetit. Gjithashtu ne grupet e punes do te perfshihen edhe perfaqesues te partive politike si dhe anetare te Keshillit Bashkiak.</li> <li>2. Analiza e potencialeve dhe berja e vleresimit konkurues te territorit administrativ te Bashkise Shkoder per zhvillimin ekonomik.</li> <li>3. Hartimi i dokumentit te strategjise se zhvillimit ekonomik</li> <li>4. Hartimi i procesit te zbatimit te strategjise se zhvillimit ekonomik</li> <li>5. Hartimi i procesit te monitorimit te strategjise</li> </ol>					
<b>b) Rezultatet qe prisni</b>					
<ol style="list-style-type: none"> <li>3. Ngritja dhe funksionimi i bordit per zhvillimin ekonomik te Bashkise Shkoder</li> <li>4. Hartimi i dokumentit te zhvillimit ekonomik lokal te Bashkise Shkoder</li> </ol>					
<b>c) Aktoret e mundshem</b> Administrata e Bashkise Shkoder,perfaqesues te Keshillit te Bashkise, perfaqesues te biznesit vendor, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, perfaqesues te shoqerise civile, institucione publike		<b>d) Kontributet e mundshme ne projekt</b> Bashkia Shkoder			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Ngritja dhe funksionimi i bordit per zhvillimin ekonomik te Bashkise Shkoder				
A.2	Hartimi i dokumentit te zhvillimit ekonomik lokal te Bashkise Shkoder				
<b>TOTAL</b>		0		0	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Viti 2016		<b>g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit			

Nr.2	<b>P6.F1.O1.A2</b> Studim per klusterat e biznesit qe operojne ne Bashkine Shkoder	<b>Llojet e programit: P6:</b> Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit: <b>Funksioni: P6:F1:</b> Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal.				
<b>a) Peshkrimi i shkurtër i projektit</b>						
i. Situata						
Në territorin e Bashkisë Shkodër operojnë një numër i konsiderueshëm biznesesh të fushave dhe aktiviteteve të ndryshme. Aktualisht, në këtë territor ushtrojnë aktivitetin e tyre 896 biznese të klasifikuara si biznes i madh dhe 3 133 biznese të klasifikuara si biznes i vogël. Bashkëpunimi mes vetë bizneseve që kanë ngjashmëri për nga sektori i aktivitetit apo qoftë edhe nga afërsia gjeografike është i kufizuar. Nuk janë shumë të përhapura shoqatat apo grupimet e bizneseve që ndajnë interesa të përbashkëta. Gjithashtu edhe bashkëpunimi mes sektorit të biznesit dhe njësive të qeverisjes në nivele të ndryshme do të siguronte avantazhe të rëndësishme për aktivitetin e tyre. Një shembull i mirë i organizimit të bizneseve në një shoqatë është ai i bizneseve të rrugës "13 Dhjetori"- "28 Nëntori" të cilët në mënyrë të organizuar mbrojnë interesat e tyre dhe zhvillojnë aktivitetin e biznesit duke siguruar një avantazh të rëndësishëm konkurrues në krahasim me bizneset e tjera. Një studim i thelluar për aktivitetet që zhvillohen në territorin e Bashkisë Shkodër, rekomandimet për krijimin e klusterave të rinj që mund të krijohen dhe gjithashtu edhe i modeleve të ndryshme të bashkëpunimit dhe i operimit të këtyre grupimeve do të ishte një shtytje e rëndësishme për rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve që operojnë në territorin e Bashkisë Shkodër.						
ii. Synimi i projektit (me një fjali cfare do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, perfitimi i grupit të synuar)						
Rritja e konkurrueshmërisë së bizneseve përmes një studimi mbi mundësitë e organizimit të bizneseve dhe aktiviteteve të tyre.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartimi i termave të referencës për studimin e aktivitetit ekonomik të bizneseve në Shkodër.</li> <li>2. Hartimi i studimit.</li> <li>3. Botimi i studimit.</li> <li>4. Zhvillimi i takimeve konsultative me grupet e identifikuar të biznesit për t'iu ofruar modelet e gjetura nga studimi.</li> </ol>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
Hartimi i një studimi i krijimin e klusterave të mundshëm të biznesit.						
<b>c) Aktoret e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bashkia e Shkodrës.</li> <li>2. Universiteti i Shkodrës, Fakulteti Ekonomik.</li> <li>3. Dega Rajonale e Tatim Taksave Shkodër.</li> <li>4. Dhoma e Tregtisë</li> </ol>			<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bashkia e Shkodrës.</li> <li>2. USAID</li> <li>3. GIZ</li> </ol>			
<b>e) Shpenzimet e logaritura</b>						
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>			Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
A.1 Hartimi i termave të referencës për studimin e aktivitetit ekonomik të bizneseve në Shkodër.				Pag a, sig	operat ive	kapit ale
A.2 Hartimi i studimit.						
A.3 Botimi i studimit.						
A.4 Zhvillimi i takimeve konsultative me grupet e identifikuar të biznesit për t'iu ofruar modelet e gjetura nga studimi.						
A.5 Hartimi i termave të referencës për studimin e aktivitetit ekonomik të bizneseve në Shkodër.						
<b>TOTAL</b>			<b>0</b>	<b>0</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur perfundon)</b> Viti 2016			<b>g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit			



Nr.3	<b>P6.F1.O1.A3.</b> Hartimi i studimit për marketingun dhe brandimin për bizneset dhe sektoret që mund të eksportojnë jashtë Shkodrës	<b>Llojet e programit: P6:</b> Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit <b>Funksioni: P6:F1:</b> Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillim ekonomik lokal			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata ( Shpjego problemin, aspektet negative, te dhëna për zonën)					
<p>Qëndrueshmëria e rritjes ekonomike në Bashkinë Shkodër, nuk mund të sigurohet pa një stabilitet të qëndrueshëm të treguesve makroekonomikë dhe një zhvillim të përshpejtuar të sektorit privat, ku përparësi ka zhvillimi i biznesit të vogël dhe të mesëm, rritja e eksporteve etj. Të gjitha keto përkohë me nevojën për rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë, përmirësimin e imazhit të rajonit dhe përmirësimin e klimës së biznesit.</p> <p>Megjithëse sektori i ndërmarrjeve private ka pësuar një eksperiencë të rëndësishme zhvillimi, shumë nga sipërmarrjet e kane pothuajse të pamundur të përballojnë sfidat e konkurrencës në rritje si në nivel lokal dhe rajonal, si pasojë e përpjekjeve të pamjaftueshme në marketing, mungesës së kapaciteteve dhe aftësive menaxheriale për të pozicionuar produktin e tyre në tregjet kombëtare apo rajonale. Këto problematika janë të lidhura me një sërë faktorësh, të tillë si mungesa e aftësive konkurruese të firmave dhe produkteve lokale, mungesa e konsolidimit të organizmave për certifikimin dhe standardet e cilësisë së mallrave dhe shërbimeve; mungesa e marketingut të produkteve për eksport etj.</p> <p>Sistemet dhe mjetet e komunikimit vazhdojnë të dominohen nga teknikat e përgjithshme të marketingut. Fushatat për të kapur tregjet e synuara ende karakterizohen nga mungesa e ekspertizës, orientimi afatshkurtër, mungesa e partneriteteve dhe e qasjes në rrjete. Në ditët e sotme, është çështje strategjike të kuptuarit e procesit që të çon në një markë (<i>brand</i>) të suksesshme të qytetit/rajonit, që ka të bëjë me krijimin e lidhjes ndërmjet imazhit të promovuar, identitetit të vërtetë dhe avantazhit konkurrues ekzistues.</p> <p>Ky projekt ka si qëllim hartimin e një studimi për marketingun dhe brandimin për bizneset dhe sektorët që mund të eksportojnë prodhimet e tyre në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare, përmes një një qasjeje profesionale të bazuar në konceptin e markës territoriale, e cila do të nxjerrë në pah identitetin e vërtetë të territorit dhe potencialin e tij unik; bashkëpunimin dhe partneritetin e sektorit publik-privat, fokusimin në objektiva të qarta në përcimin e mesazhit të identitetit të rajonit që duhet promovuar.</p>					
ii. Synimi i projektit					
Synimi i këtij projekti është që bizneset në territorin e Bashkisë të bëhen më konkurruese në tregjet vendore dhe ndërkombëtare nëpërmjet inovacionit, zhvillimit të markës rajonale, zhvillimit të zinxhirëve të vlerës dhe përmirësimit të sistemeve të shpërndarjes;					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<p>Identifikimi dhe përditësimi i i data basit të bizneseve në territorin e Bashkisë me një pozicionim konkurrues në treg; Ekspertizë në krijimin e profileve të kompanive/ ndërmarrjeve prodhuese;</p> <p>Analizë e tregjeve të synuara për eksporte</p> <p>Zhvillimi i takimeve me grupe të ndryshme të interesit për zhvillimin e konceptit dallues të diferencimit dhe të vlerësimit të produkteve lokale me qëllim pozicionimin në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.</p> <p>Rekomandime për plotësimin e standartizimit të produkteve lokale me destinacion tregjet e huaja.</p>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
<p>Data base i bizneseve në territorin e Bashkisë me një pozicionim konkurrues në treg i përditësuar;</p> <p>Profilet e kompanive/ ndërmarrjeve prodhuese të realizuara</p> <p>Tregjet e synuara për eksporte të identifikuar</p> <p>Diferencimi dhe vlerësimi i produkteve lokale me efekt dallues i realizuar</p> <p>Kuadri për standartizimin e produkteve lokale i përcaktuar</p>			Bashkia e Shkodrës.		
<b>c) Aktoret e mundshëm</b>					
<p>5. Bashkia Shkoder</p> <p>6. Universiteti i Shkodrës</p> <p>7. Ekspertë të jashtëm</p> <p>8. Sipërmarrja private</p>					
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>			Totali (000 lekë)	Nga kjo:	
				Paga, sig	operati ve
					kapitale
A.1	Identifikimi dhe përditësimi i i data basit të bizneseve në territorin e Bashkisë me një pozicionim konkurrues në treg;				
A.2	Ekspertizë në krijimin e profileve të kompanive/ ndërmarrjeve prodhuese;				
A.3	Analizë e tregjeve të synuara për eksporte;				
A.4	Zhvillimi i takimeve me grupe të ndryshme të interesit për zhvillimin e konceptit dallues të diferencimit dhe të vlerësimit të produkteve lokale me qëllim pozicionimin në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.				
A.5	Rekomandime për plotësimin e standartizimit të produkteve lokale me destinacion tregjet e huaja.				
<b>TOTAL</b>			<b>150</b>	<b>150</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur perfundon)</b>			<b>g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>		
Viti 2016			Drejtoria e Turizmit		

Nr.4	<b>P6.F2.O1.A1</b> Studimi ngritjes së tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë.	<b>Llojet e programit: P6:</b> Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit <b>Funksioni: P6:F2:</b> Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)					
<p>Tregjet qytetare, nëse menaxhohen në mënyrën e duhur furnizojnë me prodhime cilësore qytetarët, nxisin një stil të shëndetshëm të jetës, duke siguruar kohezionin social dhe bashkimin e banorëve të lagjeve, nxisin gjithashtu zhvillimin e ekonomisë dhe sigurinë e punësimit, duke rritur kështu mirëqenien për qytetarët.</p> <p>Tregjet mund të trajtohen si Zemër e Qytetit, si Motor Ekonomik si dhe Nxitës së Zhvillimit të Qëndrueshëm.</p> <p>Aktualisht në bashkinë e Shkodrës zhvillohet një aktivitet i konsiderueshëm tregtar me dyqane dhe tregje të shpërndarë në të gjithë territorin e Bashkisë sipas nevojave të komunitetit. Këto njësi tregtimi kanë qenë shpesh të improvizuara, pa respektuar kushtet që duhet të plotësohen për tregtimin e artikuljve të ndryshëm dhe pa marrë parasysh gjithashtu edhe shpërndarjen dhe nevojat e popullsisë.</p> <p>Prandaj lind nevoja për një studim të gjërë fizibiliteti për konceptimin e një rrjeti të ri tregtar të bazuar në standartet më të mira dhe që respekton normat për ushtrimin e aktiviteteve tregtare. Studimi do të shërbejë si bazë për ngritjen e tregjeve të reja duke respektuar konceptet e sipërpërmendura. Gjithashtu studimi do të duhet të ofrojë edhe një model ekonomik të arsyeshëm për funksionimin e këtyre tregjeve si edhe të përcaktojë standarte të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit tregtar në këto tregje.</p>					
ii. Synimi i projektit					
Hartimi i një studimi për ngritjen e rrjetit tregtar në Shkodër.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndermerni për të prodhuar rezultate)					
<p>5. Hartimi i termave të referencës për studimin e aktivitetit ekonomik të bizneseve tregtare në Shkodër.</p> <p>6. Hartimi i studimit.</p>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Hartimi dhe botimi i një studimi fizibiliteti për rrjetin e tregtisë në Bashkinë Shkodër					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)</b>		
Bashkia e Shkodrës Dhoma e Tregtisë Universiteti i Shkodër			Bashkia e Shkodrës.		
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))					
Shpenzimet për çdo aktivitet				Totali (000 lek)	Nga kjo: Pag a, sig
A.1	Hartimi i termave të referencës për studimin e aktivitetit ekonomik të bizneseve tregtare në Shkodër.				operati ve
A.2	Hartimi i studimit.				kapital e
<b>TOTAL</b>					
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016			<b>g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit		

Nr.5	<b>P6.F3.O1.A1</b> Organizimi i nje panaire pune ne bashkepunim me universitetin dhe shkollat profesionale	<b>Llojet e programit :P6</b> Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit <b>Funksioni P6.F3</b> Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Rajoni i Shkodrës, sipas të dhënave të INSTAT ka një numër të lartë të papunëve. Çdo vit, nga universiteti i Shkodrës kryejnë studimet një numër i konsiderueshëm studentësh të cilët kanë vështirësi të integrohen në tregun e punës. Gjithashtu në Shkodër ushtrojnë aktivitet ekonomik një numër relativisht i mirë biznesesh të cilët herë pas here kanë vështirësi në gjetjen e punonjësve e sidomos të atyre të kualifikuar të cilët nuk mungojnë në tregun e punës. Shpesh vihet re një mungesë informacioni si për vendet e punës së disponueshme nga ana e të rinjve po ashtu edhe për mundësitë që kanë bizneset për të punësuar punonjës të kualifikuar. Për këtë arsye është parashikuar organizimi i një panairi pune me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm në këtë proces ku mund të përmendim Universitetin e Shkodrës, shkollat e mesme profesionale dhe bizneset që kanë aktivitet në Shkodër e më gjërë.					
ii. Synimi i projektit					
Ky projekt synon të shkëmbimin e informacionit për mundësitë e tregut të punës si për punëkërkuarit ashtu edhe për punëdhënësit.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përgatitja e programit të panairit të artizanatit</li> <li>2. Përgatitja e materialeve promovionale si postera , banera , ftesa etj.</li> <li>3. Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikes per zhvillimin e panairit</li> <li>4. Njoftimet ne media per zhvillimin e aktivitetit</li> </ol>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Marrja në punë, qoftë edhe për një periudhë prove e të paktën 50 punëkërkuarëve.					
<b>c) Aktoret e mundshme</b>			<b>d) Kontributet e mundshme ne projekt</b>		
Bashkia Shkoder Dhoma e Tregtisë Universiteti i Shkodër Shkollat e mesme teknologjike, industriale, gjuhëve të huaja etj			Bashkia Shkoder		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Përgatitja e programit të panairit të artizanatit				
A.2	Përgatitja e materialeve promovionale si postera , banera , ftesa etj.			30	
A.3	Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikes per zhvillimin e panairit			50	
A.4	Njoftimet ne media per zhvillimin e aktivitetit			20	
A.5	Përgatitja e programit të panairit të artizanatit				
<b>TOTAL</b>		<b>100</b>		<b>100</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Viti 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit		

Nr.6	<b>P6.F3.O1.A2</b> Panairi i produkteve te bizneseve prodhuese ne Bashkine Shkoder	<b>Llojet e programit :P6</b> Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit <b>Funksioni P6.F3:</b> Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Ka një numër të konsiderueshëm të bizneseve që ushtrojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë Shkodër. Këto biznese janë të sektorëve të ndryshëm të aktivitetit ekonomik si ato fason, prodhues, tregtarë, shërbime etj. Këto biznese shpesh hasin vëstitrësi në shitjen e produkteve të tyre dhe kjo sidomos për shkak të mungesës së informacionit për këto biznese, për përparësitë që ofrojnë produktet e tyre apo për çmimet me të cilat ofrohen këto produkte. Shpesh mongon informacioni edhe mes vetë bizneseve për mundësitë për të shitur produkte apo edhe për mundësitë e blerjes së materialeve të nevojshme për prodhim nga bizneset prodhuese dhe tregtare. Kjo ndodh edhe për arsye të mundësive ekonomike të bizneseve për të zhvilluar fushata marketing por shpesh herë edhe nga nënvlerësimi i promovionit si një instrument i fuqishëm për mbarëvajtjen e biznesit. Për këto arsye është parashikuar organizimi i një panairi me bizneset e territorit të Bashkisë Shkodër në përpjekje për të pëmbushur këtë mangësi dhe për t'ju dhënë mundësi bizneseve të njihen dhe potencialisht të lidhin kontrata shit-blerije.					
ii. Synimi i projektit					
Ky projekt synon të shkëmbimin e informacionit mes bizneseve dhe krijimin e mundësisë për prmovimin e produkteve të tyre					
iii. Aktivitetet kryesore te projektit					
<ol style="list-style-type: none"> <li>5. Përgatitja e programit te panairit te artizanatit</li> <li>6. Përgatitja e materialeve promocionale si postera , banera , ftesa etj.</li> <li>7. Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikes per zhvillimin e panairit</li> <li>8. Njoftimet ne media per zhvillimin e aktivitetit</li> </ol>					
<b>b) Rezultatet qe prisni</b>					
Marrja në punë, qoftë edhe për një periudhë prove e të paktën 50 punëkërkuësve.					
<b>c) Aktoret e mundshem</b>			<b>d) Kontributet e mundshme ne projekt</b>		
Bashkia Shkoder Dhoma e Tregtisë			Bashkia Shkoder		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operativ e	kapital e
A.1	Përgatitja e programit te panairit te artizanatit				
A.2	Përgatitja e materialeve promocionale si postera , banera , ftesa etj.			30	
A.3	Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikes per zhvillimin e panairit			50	
A.4	Njoftimet ne media per zhvillimin e aktivitetit			20	
A.5	Përgatitja e programit te panairit te artizanatit				
<b>TOTAL</b>		<b>100</b>		<b>100</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Viti 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit		

Nr.7	<b>Projekti : P6.F4.O1.A1</b> Hartimi dhe botimi i profilit te Bashkise	<b>Llojet e programit : P6:</b> Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit <b>Funksioni P6.F4:</b> Publikim i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik				
<b>a) Peshkrimi i shkurtër i projektit</b>						
i. Situata						
<p>Profili i bashkise eshte nje dokument informativ ne te cilin ne menyre te permbledhur jepen te dhena statistikore dhe informacion pershkrimor ne lidhje me zonen dhe komunitetin e saj.</p> <p>Hartimi i ketij profile do te perfsheje te dhena kryesore gjeografike, historike, demografike dhe social ekonomike. Eshte nje fotografim , nje presentim i permbledhur i te gjithe territorit i cili prezenton potencialet dhe tendencat e zhvillimit te te gjithe zones.</p> <p>Qyteti dhe disa ish Komuna te Shkodres kane patur te botuara profilet e territoreve administrative te tyre. Me krijimin e Bashkise Shkoder te perbere nga 11 njesite administrative lind nevoja per hartimin dhe botimin e nje profili te ri ku jane te perfsheja dhe te integruara i gjithe territori administrativ i bashkise se re.</p>						
ii. Synimi i projektit ( me nje fjali çfare do te zgjidhni per ate qe eshte problemi kryesor, perfitimi i grupit te synuar)						
Hartimi i materialeve promocionale per zhvillimin ekonomik te Bashkise						
iii. Aktivitetet kryesore te projektit						
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijimi i databasit te te dhenave per hartimin e profilit te Bashkise</li> <li>2. Konceptimi dhe shkrimi i profilit te Bashkise</li> <li>3. Perzgjedhja e informacionit fotografik sipas tematikave te percaktuara per ilustrim</li> <li>4. Disenjimi dhe strukturimi i materialit te broshures se profilit</li> <li>5. Botimi i profilit</li> </ol>						
<b>b) Rezultatet qe prisni</b>						
5. Botimi i 2000 kopje te profilit te Bashkise Shkoder						
<b>c) Aktoret e mundshem (grupetqelidhen me projektindheqendikohen)</b>			<b>d) Kontributet e mundshme ne projekt (kush do tekontribuoje per keteprojekt, financiarishtetj.)</b>			
1. Bashkia Shkoder			Bashkia Shkoder			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo:		
				Paga , sig	operativ e	Kapital e
A.1	Krijimi i databasit te te dhenave per hartimin e profilit te Bashkise					
A.2	Konceptimi dhe shkrimi i profilit te Bashkise					
A.3	Perzgjedhja e informacionit fotografik sipas tematikave te percaktuara per ilustrim					
A.4	Disenjimi dhe strukturimi i materialit te broshures se profilit					
A.5	Botimi i profilit					
<b>TOTAL</b>			<b>200</b>		<b>200</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Viti 2016			<b>g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimi të Klimës së Biznesit			

Nr .8	<b>Projekti : P6.F4.O1.A2</b> Ristrukturimi dhe pasurimi i faqes web te Bashkise per sektorin e zhvillimit ekonomik	<b>Llojet e programit : Llojet e programit : P6.</b> Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit <b>Funksioni P6.F4:</b> Hartimin e planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal				
<b>a) Peshkrimi i shkurtër i projektit</b>						
i. Situata						
Bashkia Shkoder , ne kuader te programeve dhe projekteve ,ne vite, ka hartuar materiale te ndryshme promocionale per te promovuar sherbime te ndryshme te ofruara ndaj komunitetit ne te gjitha fushat. Qe ne vitin 2003, Bashkia Shoder nepermjet faqes se saj te internetit ofron informacione te ndryshme per sherbime ndaj qytetareve , biseseseve si dhe informacione te ndryshme informative statistikore dhe social kulturore. Kjo faqe web e Bashkise megjithese ka evoluar duke u permiresuar nga viti ne vit ne lidhje me strukturen e saj dhe informacionin qe ofron, per sa i perket sektorit te bisesit eshte e nevojshme dhe e domosdoshme rristrukturimi i saj ne lidhje me rikonceptimin e struktures se informacionit dhe sherbimeve qe ofron ndaj te berit biznes ne Shkoder.						
ii. Synimi i projektit ( me nje fjali çfare do te zgjidhni per ate qe eshte problemi kryesor, perfitimi i grupit te synuar)						
Thethi konsiderohet sot nga të gjithë tour operatorët si perla e turizmit malor sot në Shqipëri. Vitet e fundit ka njohur zhvillime të rëndësishme për sa i përket zhvillimit të turizmit. Falë vullnetit të banorëve dhe projekteve të ndryshme oferta turistike e Thethit ka ardhur duke u përmirësuar dhe pasuruar dhe sot mund të konsiderohet një destinacion i konsoliduar me mbi 17 000 netë fjetjeje në sezon që mund të konsiderohet një shifër mjaft pozitive duke pasur parasysh që ka një popullsi prej vetëm 150 banorësh. Pjesa dërrmuese e turistëve që vizitojnë Thethin janë turistë nga Evropa Veriore dhe Qëndrore të cilët në shumicën e rasteve vijnë të paorganizuar dhe me fare pak informacion për destinacionin. Informacioni është gjendur kryesisht nga burime të ndryshme në internet dhe duke iu drejtuar banorëve të zonës. Pra informacioni është sporadik, shpesh nga burime të pasigurta dhe i mangët. Për këto arsye shihet e domosdoshme ngritja e një zyre të informacionit turistik që do të ofrojë informacionin e duhur dhe të standartizuar për këto vizitorë.					
ii. Synimi i projektit					
Ofrimi i informacionit cilësor për turistët në Theth.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
53. Rekrutimi i personelit. 54. Paisja e zyrës me materiale zyre dhe promocionale-informative që duhen për një funksionim normal.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Përmirësimi i shërbimit ndaj vizitorit dhe i marketingut të territorit me anë të ngritjes dhe vënies në funksion të Zyres së informacionit turistik në Theth.					
<b>c) Aktoret e mundshme</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
38. Bashkia e Shkodrës. 39. Bizneset lokale përfituese të turizmit. 40. ATA 41. Dhoma e Tregtisë dhe industrisë Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Turizmit.			Bashkia Shkoder		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>				Totali (000 lekë)	Nga kjo: Paga, sig, operative, kapitale
A.1	Rekrutimi i personelit.				
A.2	Paisja e zyrës me infrastrukturen e nevojshme dhe materiale promocionale-informative që duhen për një funksionim normal.			250	250
<b>TOTAL</b>				<b>250</b>	<b>250</b>
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur perfundon)</b> Viti 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Turizmit		



Nr.27	<b>P6.F6.O5.A1:</b> Vendosja e tabelave informative turistike për objekte të interesit për vizitorët	<b>Llojet e programit: P6:</b> Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit <b>Funksioni: P6.F6:</b> Turizëm			
<b>a) Peshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Territori i Shkodrës ka pasur investime të shumta për sa i përket infrastrukturës dhe në veçanti të asaj në funksion të turizmit dhe mund të thuhet se këto investime kanë filluar të japin frutet e tyre në rritjen numrit të vizitorëve. Duhet të themi se shërbimet ndaj vizitorit e sidomos informacioni i ofruar për këto vizitorë nuk kanë qenë me të njëjtin ritëm përmirësimi. Sidomos informacioni nuk ka qenë në cilësinë dhe sasinë që kërkon zhvillimi aktual i turizmit. Është parashikuar ngritja e zyrave të integruara të informacionit turistik të vendosura në qytetin e Shkodrës, në plazhin e Velipojës dhe në Theth. Megjithatë për një shërbim më të mirë ndaj vizitorëve dhe në mënyrë që informacioni të jetë sa më i aksesueshëm dhe sa më lehtësisht i arritshëm është parashikuar vendosja e 10 tabelave informative që do të përmbajnë informacionin bazë për objektet me interes si dhe hartën e Bashkisë.					
ii. Synimi i projektit					
Nëpërmjet këtij projekti synohet përmirësimi i sinjalistikës dhe i informacionit turistik.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<p>55. Për prodhimin e këtyre tabelave fillimisht do konceptohet se çfarë informacioni do të përmbajnë, përcaktohen forma dhe përmbajtja.</p> <p>56. Përcaktohen termat e referencës apo specifikimet teknike për prokurimin publik që do zhvillohet.</p> <p>57. Prodhimi dhe instalimi i tabelave.</p>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Do të pëmirësohet ndjeshëm informacioni i ofruar ndaj vizitorëve si dhe do jetë lehtësisht i arritshëm me anë të <b>vendosjes së 10 tabelave informative.</b>					
<b>c) Aktoret e mundshme</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
1. Bashkia e Shkodrës. 2. Bizneset përfituese të turizmit.			42. Bashkia e Shkodrës.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>				Totali (000 lekë)	Nga kjo: Pag a, sig opera tive kapit ale
A. 1	Për prodhimin e këtyre tabelave fillimisht do konceptohet se çfarë informacioni do të përmbajnë, përcaktohen forma dhe përmbajtja.				
A. 2	Përcaktohen termat e referencës apo specifikimet teknike për prokurimin publik që do zhvillohet.				
A. 3	Prodhimi dhe instalimi i tabelave.				
<b>TOTAL</b>				<b>150</b>	<b>150</b>
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur perfundon)</b> Viti 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Turizmit		

Nr.28	<b>P6.F6.O5.A2:</b> Paisja me sinjalistikën e përshtatshme të shtigjeve për ecje në Tarabosh	<b>Llojet e programit:</b> P6: Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit <b>Funksioni:</b> P6.F6: Turizëm			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
<p>Liçeni i Shkodrës përbën një aset shumë të çmuar të Bashkisë Shkodër me potenciale të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit mjedisor dhe familjar. Historikisht ka qenë pikë pushimi dhe kurimi për njerëzit që vuajnë nga sëmundje të ndryshme të aparatit të frymëmarrjes. Prania e Malit të Taraboshit ia shton edhe më tepër vlerat dhe atraksionin duke ofruar mundësi edhe për diversifikimin e produktit turistik që mund të zhvillohet në brigjet e Liçenit. Aktivitetet e pushuesve në brigjet e Liçenit aktualisht janë të kufizuara dhe sidomos për ato që janë të dhënë pas shëtitjeve malore që janë mjaft të shëndetshme. Ecja në Tarabosh është e shëndetshme për aktivitetin fizik që zhvillohet, ajrin e pastër dhe për aromën e sherbelës që rritet atje. Në malin e Taraboshit ka disa shtigje malore që përdoren nga banorët e fshatrave por që nuk janë lehtësisht të dallueshme dhe të sigurta. Evidentimi i tyre, paisja me sinjalistikën e nevojshme dhe pastrimi i tyre do të krijonte mundësi dhe lehtësi për pushuesit që duan të zhvillojnë shëtitje në Malin e Taraboshit.</p>					
ii. Synimi i projektit					
Pasurimi i ofertës turistike në brigjet e Liçenit të Shkodrës.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<p>58. Mbledhja dhe sistemimi i informacionit për shtigjet ekzistuese. 59. Identifikimi i të paktën tre shtigjeve të ndryshme të përshtatshme për ecje të kategorive të ndryshme. 60. Përgatitja e dokumentacionit tekniko-ligjor për garën e hapur për kryerjen e punimeve. 61. Kryerja e punimeve dhe vënia në funksion të vizitorëve të këtyre shtigjeve. 62. Botimi i një broshure informative.</p>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Identifikimi dhe vënia në gatishmëri e tre shtigjeve të përshtatje për ecje në malin e Taraboshit.					
<b>c) Aktoret e mundshme</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
<p>43. Bashkia e Shkodrës. 44. Dega e Turizmit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës. 45. Banorët e zonës.</p>			Bashkia Shkoder		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>				Total i (000 lekë)	Nga kjo: Pag a, sig operati ve kapita le
A. 1	Mbledhja dhe sistemimi i informacionit për shtigjet ekzistuese.				
A. 2	Identifikimi i të paktën tre shtigjeve të ndryshme të përshtatshme për ecje të kategorive të ndryshme.				
A. 3	Përgatitja e dokumentacionit tekniko-ligjor për garën e hapur për kryerjen e punimeve.				
A. 4	Kryerja e punimeve dhe vënia në funksion të vizitorëve të këtyre shtigjeve.				
A. 5	Botimi i një broshure informative.				
	<b>TOTAL</b>			<b>200</b>	<b>200</b>
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur perfundon)</b> Viti 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Turizmit		

Nr.29	<b>P6.F6.O5.A3:</b> Identifikimi dhe paisja me sinjalistikën e përshtatshme të shtigjeve për ecje në Theth	<b>Llojet e programit: P6:</b> Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit <b>Funksioni: P6.F6:</b> Turizëm			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Zona e Thethit, e gjendur në zemër të Alpeve shqiptare përbën sot një ndër destinacionet më të frekuentuara të turizmit malor në Shqipëri. Ai frekuentohet nga një numër gjithnjë në rritje turistësh kryesisht europiano perëndimor të apasionuar pas ecjes në natyrë, alpinizmit, sporteve të aventurës por edhe thjeshtë kuriozë për mënyrën autentike të jetesës së banorëve të zonës. Ka pasur një seri projektesh të suksesshme të krijimit të paketave turistike të ecjes nëpër shtigjet malore ndër të cilët mund të përmendim si ndër më të rëndësishmit projektin e financuar nga GIZ, Peeks of the Balcans (Majat e Ballkanit). Brenda zonës së Thethit ka mjaft pika tërheqëse me interes për vizitorët të cilat vizitohen duke ecur në këmbë në shtigje që njihen nga guidat turistike të zonës. Këto shtigje kanë nevojë që të tregohen më mirë dhe të paisen me sinjalistikë të përshtatshme pasi ka një numër të madh vizitorësh të cilët vijnë në mënyrë të paorganizuar dhe pa guida turistike për të vizituar Thethin.					
ii. Synimi i projektit					
Përmirësimi i shërbimit dhe informacionit për vizitorët.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
63. Mbledhja dhe sistemimi i informacionit për shtigjet ekzistuese. 64. Identifikimi i nevojave për ndërhyrje në shtigje për markimin e tyre dhe meremetimin e tyre aty ku ka nevojë. 65. Përgatitja e dokumentacionit tekniko-ligjor për garën e hapur për kryerjen e punimeve. 66. Kryerja e punimeve 67. Botimi i një broshure informative.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Markimi i shtigjeve dhe paisja me sinjalistikën përkatëse e shtigjeve në Theth.					
<b>c) Aktoret e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
46. Bashkia e Shkodrës. 47. Dega e Turizmit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës. 48. Banorët e zonës.			Bashkia Shkoder		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>				Total i (000 lekë)	Nga kjo: Pag a, sig
A. 1	Mbledhja dhe sistemimi i informacionit për shtigjet ekzistuese.				
A. 2	Identifikimi i nevojave për ndërhyrje në shtigje për markimin e tyre dhe meremetimin e tyre aty ku ka nevojë.				
A. 3	Përgatitja e dokumentacionit tekniko-ligjor për garën e hapur për kryerjen e punimeve.				
A. 4	Kryerja e punimeve			350	350
A. 5	Botimi i një broshure informative.			50	50
	<b>TOTAL</b>			<b>400</b>	<b>400</b>
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur perfundon)</b> Viti 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Turizmit		

Nr.30	<b>P6.F6.O5.A4:</b> Krijimi i 7 shtigjeve të reja për bicikleta në lumin Buna, Velipojë, Baks dhe Rrjoll	<b>Lojet e programit: P6:</b> Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit <b>Funksioni: P6.F6:</b> Zhvillimi i Turizmit			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
<p>Zona e Velipojës është e pasur në burime natyrore. Sipërfaqet pyjore dhe shkurre, sipërfaqet lagunore, dunat ranore dhe bregdetare, kënetat, rezervati natyror janë një pjesë e burimeve natyrore të saj. Zhvillimi dhe promovimi i llojeve të ndryshme të turizmit që kjo zonë ofron, deri sot nuk i është përgjigjur mjaftueshëm pritshmërive të turistëve dhe vetë komunitetit, përsa i takon përdorimit të potencialeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Në këtë kontekst, një prioritet të vecantë i duhet kushtuar diversifikimit të ofertës turistike dhe zhvillimit të turizmit rural, i cili në mënyrë të pajtueshme me ambientin të ofrojë një mirëpërdorim të terrenit lumor, të kryejë një cikël të integruar të njohjes dhe shijimit të bregut lumor, duke integruar atë me zonen detare dhe liqenore.</p> <p>Ky projekt propozim ka si qëllim zhvillimin e turizmit të bicikletave, përmes krijimit të shtatë shtigjeve të reja përgjatë lumit Buna dhe Velipoje/ Baks Rrjoll dhe vjen si vazhdim i projektit " Living the river" të Komunës Dajc financuar nga Qendra Zvicerjane dhe Austriake për Zhvillim në rehabilitimin e argjaturës dhe krijimin e shtegut të bicikletave Shirq- Pentar (14 km)</p> <p>Realizimi i këtij projekti synon të nxisë zhvillimin e turizmit rural dhe promovimin e vlerave ekologjike, kulturore dhe etnografike të zonës.</p>					
ii. Synimi i projektit					
Të promovojë turizmin e përgjegjshëm me bazë komunitare në rritjen e benefiteve socio-kulturore dhe përmirësimin e mjedisit Krijimi i një zone atraktive për shëtitje me bicikleta në harmoni të plotë me natyrën, larg trafikut, të përshatshëm për të gjitha grup moshat;					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<ol style="list-style-type: none"> <li>Përcaktimi i 7 shtigjeve për shëtitje me bicikleta <ul style="list-style-type: none"> <li>Nderhyrje të vogla në infrastrukturë ( jo ndërtim, por pastrim, sheshim i shtigjeve të propozuara;</li> <li>Krijimi i shtegut 1. të bicikletave: Shkodër - Pentar (23 km)</li> <li>Krijimi i shtegut 2. të bicikletave: Pentar – Velipojë (21 km)</li> <li>Krijimi i shtegut 3: Xhiro me bicikleta përgjatë rezervatit të Velipojës (8 km)</li> <li>Krijimi i shtegut 4: Xhiro me bicikleta Velipojë qendër- Laguna e Vilunit (7 km)</li> <li>Krijimi i shtegut 5: Xhiro me bicikleta përgjatë zonës Velipojë- Baks- Rrjoll- Velipojë qendër (12.5 km)</li> <li>Krijimi i shtegut 6. të bicikletave: Velipojë- Gomsiqe- Kisha Bajramaj- Velipojë (32.5 km)</li> <li>Krijimi i shtegut 7. të bicikletave: Velipojë- Baks/Rrjoll (18 km)</li> </ul> </li> <li>Pastrimi i ambientit ( minimum 3 zona, duke filluar nga Kata-Lina, në mes Cobaj dhe lagjia e re, përgjate lagunës..)</li> <li>Përmirësimi i sinjalistikës ekzistuese dhe vendosja e tabelave të reja informative në zonat e shtigjeve të propozuara;</li> </ol>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ol style="list-style-type: none"> <li>Promovimi i turizmit të bicikletave përmes krijimit të 7 shtigjeve/ itinerareve në lumin Buna, Velipoje &amp; Baks Rrjoll</li> <li>Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për një ambient të pastër</li> <li>Rritja e shkallës së informimit të turistëve përmes sinjalistikës së përmirësuar dhe vendosjes së tabelave informative në destinacionet me interes të lartë mjedisor dhe turistik</li> </ol>					
<b>c) Aktoret e mundshme</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
<ol style="list-style-type: none"> <li>Bashkia Shkoder</li> <li>Bizneset përfituese të turizmit.</li> <li>Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Turizmit.</li> <li>Popullsia e zonës</li> </ol>			IUCN Ride Albania Mountain Biking Bashkia e Shkodrës.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>			Totali (000 lekë)	Nga kjo:	
				Paga, sig	operativ e
					kapitale
A.1	Përcaktimi i 7 shtigjeve për shëtitje me bicikleta				
A.2	Nderhyrje të vogla në infrastrukturë ( jo ndërtim, por pastrim, sheshim i shtigjeve të propozuara				
A.3	Pastrimi i ambientit				
A.4	Përmirësimi i sinjalistikës ekzistuese dhe vendosja e tabelave të reja informative në zonat e shtigjeve të propozuara				
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur perfundon)</b> Viti 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Turizmit		

Nr.31	<b>P6.F6.O5.A5</b> Hartimi i paketave të integruara me produkte të ndryshme turistike	<b>Llojet e programit: P6:</b> Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit <b>Funksioni: P6.F6:</b> Turizëm		
<b>a) Peshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
Zona nën administratimin e Bashkisë Shkodër është një zonë që ofron një varietet të konsiderueshëm atraksionesh turistike me një ofertë të pasur dhe me mundësi për zhvillimin e shumë aktiviteteve rekreative dhe argëtuese për vizitorët. Mundësitë për kombinimin e shumë llojeve aktiviteteve janë të shumta, që nga turizmi kulturor, i diellit dhe rërës, mjdisor, familjar, rural, i aventurës etj. Ka shumë biznese që ofrojnë një shumëllojshmëri shërbimesh në fushën e turizmit si agjensi udhëtimesh hoteleri, restoranti, shitje suveniresh, biçikleta me qera etj. Vihet re një mungesë koordinimi të aktiviteteve mes tyre për krijimin e produkteve të integruara të shërbimeve që ofrojnë këto biznese dhe atraksione turistike të zonës së Shkodrës. Krijimi i produkteve të integruara të paketave turistike të territorit të ri të Bashkisë Shkodër do të rriste atraktivitetin e zonës dhe rrjedhimisht do të rriste edhe numrin e vizitorëve që vijnë në Shkodër. Mundësitë për krijimin e paketave të integruara janë të shumta dhe përpjekjet tona do të fokusohen në hartimin e 5 paketave bazë që do të shërbejnë si model për krijimin edhe të tjera paketave turistike të integruara.				
ii. Synimi i projektit (me një fjali cfare do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, perfitimi i grupit të synuar)				
Krijimin e produkteve të reja dhe të integruara turistike.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
<p>68. Vlerësimi i paketave turistike dhe shërbimeve që ofrohen në territorin e Bashkisë Shkodër.</p> <p>69. Dizajnimi i 5 paketave të integruara turistike me aktivitete të llojeve të ndryshme.</p> <p>70. Publikimi i 1500 broshurave (300 për secilën paketë) për paketat e identifikuar.</p> <p>71. Shpërndarja në tour operatorët dhe agjensitë e udhëtimit.</p>				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
Identifikimin e 5 paketave turistike të integruara dhe botimin e 1500 broshurave promoionale				
<b>c) Aktoret e mundshme</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
12. Bashkia e Shkodrës. 13. DAR 14. Klubi Shumësportësh Vllaznia			6. Bashkia e Shkodrës. 7. Shoqatat Sportive	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:	
			Pag a, sig	operativ e
				kapital e
A.1	Vlerësimi i paketave turistike dhe shërbimeve që ofrohen në territorin e Bashkisë Shkodër.			
A.2	Dizajnimi i 5 paketave të integruara turistike me aktivitete të llojeve të ndryshme.			
A.3	Publikimi i 1500 broshurave (300 për secilën paketë) për paketat e identifikuar.			120
A.4	Shpërndarja në tour operatorët dhe agjensitë e udhëtimit.			
A.5				
A.5				
TOTALI		120		120
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur perfundon)</b>			<b>g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>	
Viti 2016			Drejtorja e Turizmit	

Nr.32	<b>P6.F6.O5.A6.</b> Integrimi i marketingut të produkteve bujqësore në oferten e turizmit rural nëTheth	<b>Llojet e programit: P6:</b> Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit <b>Funksioni: P6.F6:</b> Zhvillimi i Turizmit
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
i. Situata		
<p>Zona e Thethit ka tërhequr ndjeshëm interesin e turistëve të huaj vitet e fundit. Sipas statistikave, numri i turistëve gjatë 2015 ishte rreth 20 000 vizitorë, ndër këta 70% të huaj. Investimet dhe asistenca teknike e ofruar, kryesish nga GTZ dhe GIZ, promovimi i zonës në tregjet ndërkombëtare, përfshirja në projektin "Balkan Peace Park" dhe në itineraret e integruara, kanë ndikuar në mënyrë të ndjeshme në zhvillimin e turizmit dhe rritjen e ekonomisë të kësaj zone.</p> <p>Me gjithë iniciativat e ndërmarra, zhvillimi i sinergjisë përmes turizmit dhe bujqësisë me qëllim krijimin e një "sistemi mikpritjeje", vazhdon të ketë problematika të shumta dhe nuk ofron mundësinë për të diversifikuar aktivitetet rurale dhe siguruar burime të tjera të të ardhurave për prodhuesit lokalë në reduktimin e varfërisë dhe marginalizimit të tyre.</p> <p>Thethi njihet për prodhimin e patates, fasules, perimeve të ndryshme, pemëve frutorë si mollë, kumbull, arra etj; produkteve ushqimore si gjalpi, djathi i deles, mishin e llojeve të ndryshme, bukën e misrit etj. Ai ka një traditë të gjatë në përgatitjen e rakisë, mbledhjen e cajt të Thethit etj. Në mungesë të daljes në treg dhe sigurimit të parasë kesh nga shitja e prodhimeve, fshatarët e zonës, gjithçka që prodhojnë, e kanë me pakicë dhe për përdorim vetjak.</p> <p>Në kuadër të projektit (CABRA) që po implementon GIZ, ne bashkëpunim me pushtetin qendror (Ministria e Mjedisit; Turizmit dhe Bujqësisë) pushtetit vendor (Bashkia e Shkodrës- për zonën e Thethit) dhe grupeve të interesit, synohet <i>nxitja për shtimin e produkteve tipike agro-ushqimore si pjesë themelore e vlerësimit të identitetit dhe kulturës lokale dhe një atraksion i fuqishëm për turistët e huaj duke promovuar prodhuesit/ fermerët e zones.</i></p> <p>Ky projekt ka si qëllim: Komunikimin dhe promovimin e produkteve tipike bujqësore. Përmirësimin e cilësisë së produkteve Nxitjen e politikave të markës dhe stimulimin e pjesëmarrjes së prodhuesve në sistemet e cilësisë së ushqimit</p>		
ii. Synimi i projektit		
Vlerësimi dhe menaxhimi novator i produkteve tipike lokale , t'i japë shtysë zhvillimit të turizmit rural, duke ndihmuar në diversifikimin e ofertës turistike		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikimi i produkteve të zonës dhe hartëzimi i tyre;</li> <li>2. Mbledhja e informacionit të nevojshëm dhe përshkrimi për secilin produkt kultivues me qëllim krijimin e kalendarit vjetor të produkteve;</li> <li>3. Identifikimi dhe mbledhja e informacionit të prodhuesve kryesorë të zonës për katalogizimin e tyre;</li> <li>4. Zhvillimi i takimeve gjithëpërfshirëve për përcaktimin e përbashkët të të gjitha aspekteve që lidhen me krijimin e markës rajonale të Alpeve dhe në vecanti markës lokalë të zonës së Thethit;</li> <li>5. Zhvillimi i aktiviteteve me fokus diversifikimin dhe përpunimin agrar;</li> <li>6. Përgatitja e kalendarit të eventeve në kombinim me rajonet e tjera;</li> <li>7. Aktivitete promovionale (fushata marketingu me botimin e materialeve promovuese, panairë të fermerëve, fushata edukimi për komunitetin, tregje lokale)</li> <li>8. Ofrimi i asistencës teknike/ trajnime të fermerëve për zhvillimin dhe promovimin e produkteve lokale</li> <li>9. Nxitje në shkëmbimin e produkteve lokale dhe fermerëve me restorantet/ guest house të zonës, dyqaneve lokale</li> <li>10. Marketing online të prodhuesve lokale</li> </ol>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hartëzimi i produkteve lokale të zonës;</li> <li>• Krijimi i kalendarit vjetor të produkteve me informacionin e nevojshëm dhe përshkrimin për secilin produkt kultivues;</li> <li>• Krijimi i katalogut të prodhuesve kryesorë;</li> <li>• Krijimi i markës rajonale të Alpeve dhe asaj lokale;</li> <li>• Produktet dhe fermerët lokalë të promovuara përmes fushatave të marketingut</li> <li>• Përmirësimi i aftësive teknike dhe profesionale të fermerëve</li> <li>• Bashkëpunimi midis ofruesve të shërbimit dhe prodhuesve – i përmirësuar;</li> </ul>		
<b>c) Aktoret e mundshme</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>
<ol style="list-style-type: none"> <li>13. GIZ</li> <li>14. Bashkia Shkoder</li> <li>15. Bizneset përfituese të turizmit.</li> <li>16. Komuniteti i zonës</li> </ol>		GIZ Bashkia e Shkodrës.
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>		



Shpenzimet per cdo aktivitet		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operat ive	kapita le
A.1	Studim në identifikimin e produkteve lokale, fermerëve të zonës dhe krijimi i data basës për krijimin e Katalogut të prodhuesve dhe kalendarit të produkteve tipike lokale				
A.2	Pjesëmarrje në panaire dhe fushata marketingu				
A.3	Botimi i materialeve promovuese				
A.4	Shpenzime operative				
	<b>TOTAL</b>	<b>0</b>			
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur perfundon)</b> Viti 2016		<b>g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Turizmit			

Nr.33	<b>P6.F6.O5.A7:</b> Organizim i ofertës për turizmin e konferencave në bashkëpunim me bizneset dhe universitetin	<b>Llojet e programit: P6:</b> Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit <b>Funksioni: P6.F6:</b> Turizëm																													
<b>a) Peshkrimi i shkurtër i projektit</b>																															
i. Situata																															
<p>Në qytetin e Shkodrës zhvillohen një numër i konsiderueshëm konferencash të ndryshme të tipologjive të ndryshme dhe përbëjnë një treg të rëndësishëm potencial për zhvillimin e turizmit. Një pjesë e mirë e tyre janë konferenca shkencore ndërkombëtare të organizuara edhe nga organizata të huaja me aktivitet në Shkodër. Në këto konferenca marrin pjesë vizitorë të huaj por edhe nga qytetet e tjera të Shqipërisë. Organizimi i tyre shpesh është spontan dhe mjaft i vështirë për organizatorët si për anën logjistike të zhvillimit të konferencave ashtu edhe për zënien e kohës së lirë gjatë zhvillimit të tyre. Shumë konferenca nuk zhvillohen në Shkodër pikërisht për shkak të vështirësisë në organizimin e tyre. Integrimi i elementëve të nevojshëm në disa produkte të përshtatshme do të krjonte lehtësi të madhe në organizimin e tyre. Përveç kësaj organizimi i kujdesshëm i tyre përbën një mundësi të mirë për promovimin e qytetit tek pjesëmarrësit në këto konferenca.</p>																															
ii. Synimi i projektit																															
Përmirësimi dhe pasurimi i ofertës turistike të Shkodrës.																															
iii. Aktivitetet kryesore të projektit																															
<p>72. Mbledhja dhe sistemimi i informacionit për potencialet që ka Shkodra për organizimin e konferencave. 73. Organizimi i këtij informacioni në opzione të ndryshme (paketa ose produkte turistike). 74. Botimi i këtyre në një broshurë. 75. Shpërndarja në biznese të ndryshme.</p>																															
<b>b) Rezultatet që prisni</b>																															
Krijimi i paketave turistike të konferencave.																															
<b>c) Aktoret e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>																												
49. Bashkia e Shkodrës. 50. Dega e Turizmit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës.			Bashkia e Shkodrës.																												
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>																															
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>				<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Totali (000 lekë)</th> <th colspan="3">Nga kjo:</th> </tr> <tr> <th>Paga, sig</th> <th>operati ve</th> <th>kapita le</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A.1</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>A.2</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>A.3</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>A.4</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td><b>TOTAL</b></td> <td><b>0</b></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Totali (000 lekë)	Nga kjo:			Paga, sig	operati ve	kapita le	A.1				A.2				A.3				A.4				<b>TOTAL</b>	<b>0</b>		
Totali (000 lekë)	Nga kjo:																														
	Paga, sig	operati ve	kapita le																												
A.1																															
A.2																															
A.3																															
A.4																															
<b>TOTAL</b>	<b>0</b>																														
A.1	Mbledhja dhe sistemimi i informacionit për potencialet që ka Shkodra për organizimin e konferencave.																														
A.2	Organizimi i këtij informacioni në opzione të ndryshme (paketa ose produkte turistike).																														
A.3	Botimi i këtyre në një broshurë.																														
A.4	Shpërndarja në biznese të ndryshme.																														
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>																													
Viti 2016		Drejtoria e Turizmit																													



Nr.1	Projekti : P7.F1.O1.A1 Krijimi i drejtorise se Bujqesise ne Bashkine Shkoder	Llojet e programit : P7. Bujqesia dhe zhvillimi rural Funksioni: P7.F1 Administrimin e infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
i. Situata		
<p>Rreth 43% të popullsisë së Bashkisë së Shkodrës jeton në zonat rurale që mbulojnë rreth 98% të territorit. Zhvillimi rural është një fushë shumë e rëndësishme e zhvillimit. Bujqësia është sektori kyç për përdorimin e tokës dhe menaxhimin e burimeve natyrore në zonat rurale, si dhe një platformë për diversifikimin ekonomik në komunitetet rurale</p> <p>Me gjithë përpjekjet e viteve të fundit për të zhvilluar sektorin bujqësor, nëpërmjet investimeve në infrastrukturën rurale, nismave dhe incentivave rregullatore, ky sektor vazhdon të ketë problematika të shumta. Shumë nga zonat rurale përballen me vështirësi të mëdha. Fermave iu mungon konkurrenshëmëria, çka do të thotë që të ardhurat janë më të vogla se në zonën urbane, ndërkohë që aftësitë janë më të kufizuara dhe sektori i shërbimeve është pak i zhvilluar</p> <p>Perpunimi i produkteve bujqësore dhe tregtimi i tyre, rritja e prodhimit të bimëve dhe kafshëve, prodhimtarisë së punës bujqësore, garantimi i kreditimit për fermerët dhe ngritja e fondeve financiare për investime, zhvillimi i hapësirës rurale, administrimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore, përmirësimi i përdorimit të saj bazuar në kapacitetet agropërpunuese, kontrolli i degradimit të tokës bujqësore dhe identifikimi dhe implementimi i projekteve të konsolidimit të tokës, vazhdojnë të përbëjnë problematikën kryesore, që pengojnë zhvillimin e këtij sektori.</p> <p>Në ligjin Nr. 139/2015 "<b>PËR VETËQEVERISJEN VENDORE</b>", Neni 27, Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, parashikohet që "<b>Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të veta</b>", të tilla si: Administrimin e sistemit të informacionit dhe kadastrës së tokave bujqësore; Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor dhe rural, përfshirë statistikat bujqësore vendore, sipas legjisllacionit në fuqi; Krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë dhe zhvillimit rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët</p> <p>Për realizimin e këtyre funksioneve, do të krijohet si strukturë e brendshme e Bashkisë së Shkodrës edhe Drejtoria e Bujqësisë që do të përbëhet nga dy sektorë:</p> <p><b>1. Sektori i Zhvillimit Rural dhe 2. Sektori i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës.</b></p> <p>Kjo strukturë do të ketë: Drejtör drejtorie; Përgjegjës sektori (2 në secilin sektor); 2 specialistë në sektorin e zhvillimit rural dhe 8 specialistë në sektorin e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës</p> <p><b>Detyrat funksionale të drejtorisë:</b></p> <p>Të planifikojë, drejtojë dhe koordinojë funksionimin e përgjithshëm të drejtorisë në përputhje me programin dhe politikën e miratuara;</p> <p>Të koordinojë drejtpërdrejt dhe të ndjekë punën duke bashkëpunuar në mënyrë efektive për realizimin e detyrave në zbatim të dispozitave ligjore; .</p> <p>Të identifikojë nevojat për zhvillimin e politikave të zhvillimit rural dhe të bëjë rekomandime brenda funksioneve të drejtorisë.</p>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• ii. Synimi i projektit</li> </ul>		
Ngritja e strukturës menaxhuese për çështjet e zhvillimit rural, administrimit dhe përdorimit të tokës bujqësore, pranë Bashkisë Shkodër		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor dhe rural – <b>Sektori i Zhvillimit Rural</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.1 Mbledhja e statistikave bujqësore vendore sipas legjisllacionit në fuqi;</li> <li>1.2 Mbështetje në asistencën teknike dhe teknologji të fermerëve;</li> <li>1.3 Dhënia e garancisë në cilësinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit;</li> <li>1.4 Sigurimi i mbështetjes për agroindustrinë, tregun dhe marketingun</li> <li>1.5 Mbrojtja e shëndetit të kafshëve, bimëve dhe garantimi i shëndetit të njerëzve nga sëmundjet që rrjedhin nga kafshët dhe cilësia e ushqimeve.</li> </ol> </li> <li>2. Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë dhe zhvillimit rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët- <b>Sektori i Zhvillimit Rural</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>2.1 Mbështetja për prodhuesit dhe fermerët për të bërë të mundur përfitimin e subvencioneve për investime në kultura bujqësore të përshtatshme sipas zonave;</li> <li>2.2 Mbështetja e prodhuesve dhe fermerëve për të lehtësuar kredimarrjen;</li> <li>2.3 Nxitje përmes lehtësirave fiskale për punimin dhe përdorimin racional të tokës bujqësore;</li> <li>2.4 Mbështetja e prodhuesve dhe fermerëve për shtimin e llojeve dhe numrit të rrënjëve për kultura të tilla, si: ullinjë, arrorët, agrumet, vreshta e pemë të tjera tipike sipas zonave;</li> </ol> </li> </ol>		

<p>2.5 Mbështetje e fermerëve për shtimin e sipërfaqeve të kultivuara me bimë medicinale, patate, perime të freskëta, si dhe shtimin e sipërfaqeve të serave;</p> <p>2.6 Mbështetje e fermerëve për zhvillimin e fermave blegtorale, rritjen e cilësisë së racave tipike për zonën specifike;</p> <p>2.7 Rritja e fondeve nga buxheti bashkiak, si dhe orientimi i fondeve të programeve nga donatorë apo ato të partneritetit</p> <p>2.8 publik/privat në sektorin bujqësor.</p> <p>2.9 Nxitja e fermerëve për organizimin e tyre ne SHBR</p>					
<p>3. Administrimi i sistemit të informacionit dhe kadastrës së tokave bujqësore- <b>Sektori i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës</b></p> <p>3.1 Menaxhimi dhe mbrojtja e tokës bujqësore, në pronësi shtetërore dhe në pronësi private, si dhe të kategorive të resurseve të tjera, të përcaktuara në nenin 11 të ligjit 8752, datë 26.3.2001</p> <p>3.2 Krijimi i regjistrat kadastral për të gjitha pronat bujqësore</p> <p>3.3 Krijimi i regjistrat të familjeve përfituese të tokës bujqësore.</p> <p>3.4 Inventarizimi i dokumentacionit kadastral ekzistues, që ka për objekt kategoritë e resurseve në juridiksion të saj.</p> <p>3.5 Ndjekja e veprimtarisë për evidentimin e tokave bujqësore të pakultivuara, në juridiksionin e bashkisë, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë këtë veprimtari.</p> <p>3.6 Evidentimi në nivel ngastre (parcele), fshati (zone kadastrale) dhe NJA, ndryshimet dhe kalimet e ndërsjella të kategorive të resurseve, për të cilat janë marrë vendime nga organet shtetërore, që ligji i kangarkuar me kompetenca vendimmarrëse në këtë fushë.</p> <p>3.7 Të përgatisë "evidencën e gjendjes dhe ndryshimit të kategorive të resurseve", që i dërgohet DAMT-së në qark;</p>					
<b>b) Rezultatet qe prisni</b>					
<p>Drejtoria e Bujqësisë e ngritur (e plotësuar me personel të specializuar dhe e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme teknike-GPS, Harta të territorit të bashkisë, Harta kadastrale për të gjitha NJA , baza ligjore dhe dokumente të tjera strategjike ekzistuese për zhvillimin rural në përgjithësi si dhe për at ë bujqësor ne vecanti).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemi vendor i informacionit dhe këshillimit bujqësor dhe rural i mirë administruar;</li> <li>• Regjistri i organizatave, bankave dhe donatorve që operojnë në fushën e bujqësisë përfshirë dhe skemat shtetërore të mbështetjes i hartuar.</li> <li>• Sistemi i informacionit dhe kadastrës së tokave bujqësore i plotësuar</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Bujqësisë pranë Bashkisë së Shkodrës</li> <li>• Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore</li> <li>• Drejtoria Rajonale e Bujqesise</li> <li>• Qendra e Transferimit te Teknologjive</li> </ul>			Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Procedura përgatitore				
A.2	Paga , kontribute sigurime shoqërore ,				
A.3	Shpenzime operative nga transfertat specifike				
	Shpenzime operative nga të ardhurat e Bashkisë				
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Bujqësisë		

Nr.2	<b>Projekti :</b> <b>P7.F1.O 1.A2</b> Krijimi i drejtorisë së shërbimit evë bujqësore	<b>Llojet e programit :</b> P7 Bujqësia dhe zhvillimii rural  <b>Funksioni: P7.F1. Administrimin e infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;</b>
------	---	---

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Në ligjin Nr. 139/2015 **"PËR VETËQEVERISJEN VENDORE"**, Neni 27, Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, parashikohet që "Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, pika 1: Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj".

Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr.1108, datë 30.12.2015, "Transferimi, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit", kalon në administrim të Bashkisë së Shkodrës Bordin e Kullimit.

Ky Vendim shoqërohet dhe me Udhëzimin "Udhëzues për zbatimin e VKM nr.1108 datë 30.12.2015 "Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme", pika 4: Bashkitë planifikojnë në buxhetin e vitit 2016 financat për funksionin e ujitjes dhe kullimit.

Për vitin 2016 në Ligjin nr 147/2015 " Për buxhetin e vitit 2016", Neni 15: *Transfertat e pakushtëzuara, që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transfertat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet njësive të pushtetit vendor, sipas formulës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar dhe specifike për çdo njësi të pushtetit vendor paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij ligji.*

Për realizimin e këtij shërbimi përveç strukturës së brendshme të Bashkisë së Shkodrës, që ndjek politikat vendore për këtë veprimtari, do të funksionojë edhe struktura e Ujitjes dhe Kullimit.

Transferta specifike e parashikuar në Ligjin për Buxhetin e Shtetit të vitit 2016, parashikohet në buxhetin e bashkisë për t'u shpenzuar për këtë funksion (paga, sigurime dhe shpenzime operative).

Për shërbimin e administrimit Bordit të Kullimit parashikon :

Në 000 lekë

Nr	Numri i punonjësve	Paga dhe sigurime	Shpenzime operative	Total
1	12	7 393.258	3 994.470	11 387.728

Gjithashtu nga të ardhurat e Bashkisë i shtohet zërit "shpenzime operative", fondi prej 4,000,000 lekësh dhe 550 000 lekë për pagën e një personi (drejtori)

Fondet e parashikuara në total rezultojnë si në tabelën më poshtë:

Nr		Paga dhe sigurime	Shpenzime operative	Investime	Total
	Vendimi i Buxhetit 2016	7 393.258	9 994.470		17 387.728
	Parashikim nga Bashkia	642.000	4 000.000		4 642.000
	<b>TOTALI</b>	<b>8 035.258</b>	<b>13 994.470</b>		<b>31 029.728</b>

Me kalimin e funksionit të ujitjes dhe kullimit, sipas ligjshmërisë të paraqitur më sipër, duhet të ndërhyhet me pastrime dhe riparime sipas nevojës dhe rast pas rasti në kanale ujitës dhe kullues në të gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës. Ndërhyrja për pastrimin e kanaleve kullues siguron mbajtjen në nivelet optimale të ujërave duke eliminuar si dëmtimin e bimeve të mbjellura nga fermerët ashtu edhe të strukturës së tokës në vetvete.

Ndërhyrja në pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve ujitëse, dhe veprave të artit që sigurojnë mirëfunksionimin e tyre, është e domosdoshme për të bërë të mundur realizimin e rendimenteve të parashikuara nga fermerët për kulturat e ndryshme bujqësore.

Ndërhyrja në mirëmbajtjen e argjinaturave, përveç mbajtjes nën kontroll të tyre, parashikon dhe mirëmbajtje të pjesësme sipas rregullores së mirëmbajtjes së veprave të mbrojtjes nga lumenjtë.

Në të tre rastet duhet të ndërhyhet me puntori dhe me mjete të mekanizuara sipas grafikëve që struktura përkatëse do parashikojë.

Prioritetet për ndërhyrje gjatë vitit 2016, të propozuara nga njësitet administrative, paraqiten në tabelën më poshtë

- ii. Synimi i projektit

Të përmirësohet shërbimi i ujitjes dhe kullimit duke i shërbyer fermerëve për të arritur rendimente sa më të larta dhe siguri nga përmbytjet, me synimin e rritjes ekonomisë familjare dhe përmirësimit të cilësisë së jetës.

<ul style="list-style-type: none"> <li>Të sigurojë administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të bashkisë, sipas legjislacionit në fuqi. (VKM Nr.1108, datë30.12.2015)</li> <li>Të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën për planifikimin e nevojave për ujë për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes e të kullimit me strukturat rajonale të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, që administrojnë infrastrukturën kryesore në këto sisteme.(VKM Nr.1108, datë30.12.2015)</li> <li>Të sigurojë mbarëvajtjen e ujitjes duke bërë të mundur furnizimin me ujë të parcelave të fermerëve</li> <li>Të sigurojë nivelet optimale të ujit në parcelat e mbjellura në kohë rreshjesh</li> </ul>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
4. Ndërtimi i strukturës dhë varësitë e reja sipas ndarjes së re administrative sipas parashikimit ligjor Transferta specifike e parashikuar në Ligjin për Buxhetin e Shtetit të vitit 2016, parashikohet në buxhetin e bashkisë për t'u shpenzuar për këtë funksion (paga, sigurime dhe shpenzime operative ). Për shërbimin e administrimit të Ujitjes dhe Kullimit kjo strukturë ka 12 punonjës					
5. Alokimi i fondit					
<ul style="list-style-type: none"> <li>Siguracion, taksë qarkullimi, kolaudim</li> <li>Shenzime karburanti</li> <li>Blerje lubrifikant</li> <li>Shpenzime pjesë këmbimi</li> <li>Shpenzime për të tretë</li> </ul>					
6. Procedura përgatitore					
<ul style="list-style-type: none"> <li>Hartimi i kalendarëve të ndërhyrjes për KU, KK dhe argjinaturat</li> <li>Përcaktimi i volumeve të punës</li> </ul>					
7. Rehabilitim pjesor i kanalit ujitës Guri i Zi – Juban					
<b>b) Rezultatet qe prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>Funksionim i mirë i strukturës</li> <li>Kryerje sipas kërkesave i shërbimit</li> <li>Ujitja kryhet në kohë dhe me sasinë dhe cilësinë e kërkuar</li> <li>Parcelat e mbjella me kultura nuk përmblyten</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>					<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtorja e Bujqësisë pranë Bashkisë së Shkodrës</li> <li>Drejtorja e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore</li> </ul>					Bashkia e Shkodrës
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		<b>Totali (000 lek)</b>	<b>Nga kjo:</b>		
			<b>Paga, sig</b>	<b>operative</b>	<b>kapitale</b>
A.1	Procedura përgatitore				
A.2	Paga , kontribute sigurime shoqërore ,	8 035.258	8 035.258		
A.3	Shpenzime operative nga transferata specifike	7 994.470		3 994.470	
	Shpenzime operative nga të ardhurat e Bashkisë	4 000.000		4 000.000	
<b>Shuma</b>		<b>16 029.728</b>	<b>8 035.258</b>	<b>7 994.470</b>	
<b>Shpërndarja e shpenzimeve operative</b>					
A.3.1	Siguracion, taksë qarkullimi, kolaudim			330.000	
A.3.2	Shpenzime karburanti			6 229.000	
A.3.3	Shpenzime lubrifikant			453.000	
A.3.4	Shpenzime pjesë këmbimi			453.000	
A.3.5	Shpenzime për të tretë			530.000	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Bujqësisë			

Nr.3	Projekti : P7.F1.O2.A1 Pastrim kanalesh ujitese dhe kulluese per NJA	Llojet e programit : P7. Bujqesia dhe zhvillimi rural Funksioni: P7.F1 Administrimin e infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
<p>Ujitja dhe kullimi janë ndër faktorët kryesorë të rritjes së qëndrueshme të prodhimit bujqësor në vend, por për shkak të mungesës së vazhdueshme të investimeve, ky sektor ka mbetur akoma në gjendje kritike.</p> <p>Në sistemin e kullimit që mbulon Bashkia e Shkodrës, janë gjithsej 1000 km kanale të II dhe të III kulluese &amp; ujitëse. Si rezultat i mungesës së investimeve në sistemin e kullimit dhe ujitjes, situata në KU – II/ III dhe KK – II/III është tejte e rënduar dhe pothuajse jashtë funksionit. Kanalet e III-ta kullues nuk janë pastruar pothuajse asnjëherë dhe janë shtuar aluvionet nga toka, barërat e këqija e lëndë të tjera inerte. Mungesat janë të theksuara në sistemin dhe pastrimin e tyre, në veprat e artit si tumbina, ura, sifona etj, që kanë cuar në mosfunksionimin e tyre. Kjo ka bërë që sipërfaqe të tëra bujqësore të mos kultivohen ose të japin prodhime minimale.</p> <p>Në bazë të igjit Nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore”, Neni 27, Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, parashikohet që “Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, pika1: <i>Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj</i>”.</p> <p>Kalimi i funksionit të ujitjes dhe kullimit në Bashki (VKM nr.1108, datë 30.12.2015; Ligji nr 147/2015 “ Për buxhetin e vitit 2016”, Neni 15), ka sjellë studimin e situatës dhe caktimin e ndërhyrjeve prioritare për të gjitha NJA. Këto ndërhyrje do të konsistojnë në pastrime dhe riparime sipas nevojës dhe rast pas rasti në kanale ujitës dhe kullues në të gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës. Ndërhyrja për pastrimin e kanaleve kullues do të sigurojë mbajtjen në nivelet optimale të ujrave duke eliminuar si dëmtimin e bimeve të mbjellura nga fermerët ashtu edhe të strukturës së tokës në vetvete.</p> <p>Rehabilitimi i tyre kërkon kohë dhe investime, por për vitin në vazhdim janë parashikuar vetëm 6 milion leke transfertë specifike (Ligji 147/2016 për buxhetin e 2016; ligji 129, 17.02.2016) për investime në rehabilitimin e sistemit ujitës dhe kullues në NJA (pastrimi me ekskavatorë të kanaleve ujitëse dhe kulluese, të transferuar në pronësi të bashkive). Ky fond do të prekë pikat me të nxehta dhe të domosdoshme në NJA në sistemin e ujitjes dhe kullimit vetëm për zgjidhje të rasteve emergjente. Do të bëhet i mundur pastrimi i 10 km kanali ujitës II/III dhe 15 km kanali kulluese II/ II</p>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>ii. Synimi i projektit</li> </ul>					
Përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrjetit dytësor dhe terciar të ujitjes dhe kullimit, do të rrisë dukshëm shërbimet në favor të fermerëve dhe zhvillimit rural					
Projekti synon:					
<ul style="list-style-type: none"> <li>Të sigurojë pastrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të bashkisë, sipas legjislacionit në fuqi. (VKM Nr.1108, date 30.12.2015)</li> <li>Të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën për rehabilitimin e sistemeve të ujitjes e të kullimit me strukturat rajonale të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, që administrojnë infrastrukturën kryesore në këto sisteme.</li> <li>Të sigurojë mbarëvajtjen e ujitjes duke bërë të mundur furnizimin me ujë të parcelave të fermerëve</li> </ul>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Hartimi dhe zbatimi i grafikëve të ndërhyrjes për KU – II/ III dhe KK – II/III					
Përcaktimi i volumeve të punës					
Pastrimi dhe ndërhyrja me puntori dhe me mjete të mekanizuara sipas grafikëve që struktura përkatëse do parashikojë.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Sistemi i kanaleve të ujitjes dhe kullimit më problematike të NJA i përmirësuar (10 km kanali ujitës II/III dhe 15 km kanali kulluese II/ II)					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e Bujqësisë pranë Bashkisë së Shkodrës</li> <li>Drejtoria e Kullimit dhe Ujitjes</li> </ul>			Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
A.1	Procedura përgatitore		Paga, sig	operative	kapitale
A.2	Paga , kontribute sigurime shoqërore ,				
A.3	Pastrimi dhe ndërhyrja me puntori		6000		
<b>Shuma</b>		<b>6000</b>	<b>6000</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Dhjetor 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Bujqësisë		

Nr.4	<b>P7.F1.O2.A2 Rehabilitimi i pjesshem i skemes ujitese Gur i Zi- Juban</b>	<b>Llojet e programit : P7. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural</b> <b>Funksioni: P7.F1 Administrimin e infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;</b>		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përgatitja e një liste të të gjithë aktorëve publikë, OJF-ve dhe bizneseve private që veprojnë në sektorin e shërbimeve sociale, shëndetsore, etj.</li> <li>▪ Organizimi i takimit me të gjithë aktorët vendorë.</li> <li>▪ Ndarja dhe organizimi i tryezave tematike, fëmijët, PAN-të, etj.</li> <li>▪ Takime periodike të tryezave tematike; mbledhje e të dhënave mbi nevojat, shërbimet në territor, propozime për projekte, etj.</li> <li>▪ Mbledhja dhe organizimi i të dhënave nga tryezat tematike.</li> <li>▪ Plotësim i skedës së informacionit për secilin institucion publik, OJF dhe biznes privat</li> <li>▪ Përgatitja e draft PSZ-së.</li> <li>▪ Redaktimi, dizenjimi, formatimi dhe botimi i PSZ dhe guidës së shërbimeve sociale.</li> <li>▪ Organizimi i eventit/ceremonisë të prezantimit të PSZ-së dhe guidës së shërbimeve sociale.</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohje e situatës dhe problematikave sociale të komunitetit</li> <li>• Njohje e shërbimeve sociale që ofrohen në territor nga organizatat dhe institucionet publike</li> <li>• Fuqizim i shërbimeve sociale</li> <li>• Koordinim i shërbimeve sociale, shëndetsore, edukative që ofrohen në territor.</li> <li>• Projekt propozime për shërbime të reja sociale.</li> <li>• Mbulimi i territorit me shërbime sociale për shtresat në nevojë.</li> </ul>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Komuniteti (të gjitha kategoritë: fëmijë, të rinj, gra, burra, të moshuar, romë, egjyptianë, LGBTI, PAN) OJF-të (të gjitha organizatat aktive në qytet) Institucionet publike (DSHP, DAR, Spitali, policia, zyra e punës, Qendra formimit profesional, shërbimi provës, shërbimi social rajonal, institucionet e përkujdesit rezidencial, etj.) Biznesi privat	Bashkia e Shkodrës OJF (të gjithë organizatat aktive në qytet) Institucionet publike (DSHP, DAR, Spitali, policia, zyra e punës, Qendra formimit profesional, shërbimi provës, shërbimi social rajonal, institucionet e përkujdesit rezidencial, etj.) Biznesi privat Komuniteti (të gjitha kategoritë: fëmijë, të rinj, gra, burra, të moshuar, romë, egjyptianë, LGBTI, PAN)	

<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Redaktimi, dizenjimi, formatimi dhe botimi i PSZ 200 kopje			400	
A.2	Redaktimi, dizenjimi, formatimi dhe botim i guidës së shërbimeve sociale 200 kopje			200	
	<b>Shuma</b>	<b>600</b>		600	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Prill - Qeshor 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit			

Nr. 4	<b>Projekti: P10.F2.O2.A2.</b> Trajtimi i qenjve të rrugës	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  <b>Funksioni: P10.F2.</b> Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>					
i. Situata					
Aktualisht janë rreth 500 qenj në rrugët e qytetit, të cilët janë pa pronarë e të lirë, jashtë çdo kontrolli. Këto qenj endacake janë prezent kryesisht në të gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës por në mënyrë të vecantë në qytet. Aktualisht në grupe janë prezent në qendër dhe në lagjet periferike të qytetit duke u bërë shqetësim për sigurinë e qytetarëve dhe njëkohësisht rrezik i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse. Aktualisht nuk ekziston një qendër për grumbullimin, trajtimin dhe kujdesjen ndaj tyre. Vitet e kaluara është zhvilluar një projekt në të cilin janë grumbulluar një numër i kufizuar i qenjve të rrugës, për sterilizimin, matrikulimin dhe trajtimin e tyre, por nuk ka sjellë rezultatin e pritur.					
ii. Synimi i projektit					
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Largimi nga rruga dhe grumbullimi i qenjve endacake një ambient të sigurtë dhe të kufizuar,</li> <li>- Sterilizimi dhe matrikulimi i qenjve të rrugës.</li> <li>- Vaksinimi dhe trajtimi i tyre</li> </ul>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerni për të prodhuar rezultate)					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Sigurimi i ambientit të përshtatshëm për grumbullimin dhe trajtimin e qenjve të rrugës.</li> <li>▪ Grumbullimi, largimi nga rruga e qenjve endacakë dhe vendosja e tyre në ambient të përshtatshëm.</li> <li>▪ Sterilizimi dhe trajtimi tyre.</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qenjtë e rrugës të larguar nga rruga dhe të vendosur në një ambient të përshtatshëm për t'u trajtuar.</li> <li>• Qenjtë e rrugës nuk do të jenë shqetësim për qytetarët në rrugë.</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Komuniteti Grupet e interesit OJF-të			Bashkia e Shkodrës OJF-të Grupet e interesit		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Kapjen e qenjve të rrugës, 500 X 100 lekë			50	
A.2	Sterilizimin e qenjve të rrugës 500 x 1000			500	
A3	Matrikulimi dhe trajtimi i qenjve të rrugës 500x110			450	
<b>Shuma</b>		<b>1 000</b>		<b>1 000</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, strehimit dhe shëndetit publik.		

Nr. 5	<b>Projekti: P10.F2.O1.A3</b>  Hartimi dhe zbatimi i Planit lokal të Veprimit për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë ruge"	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  <b>Funksioni:P10.F2.</b> Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
i. Situata		
<p>Në kuadrin e nënshkrimit të Marrëveshjes Bashkëpunimit midis MMSR, MAS dhe MPB "Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë ruge dhe Planit Kombëtar të Veprimit "Ndihmë për Familjet dhe Fëmijët në situatë ruge", është me rëndësi hartimi i planit lokal të veprimit, duke qenë se bashkia (NJMF), ka përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen e fëmijëve dhe koordinimin e punës ndërmjet institucioneve përgjegjëse, brenda territorit të qytetit.</p> <p>Fëmijët në situatë ruge janë ndër grupet më vulnerabël dhe shpesh herë janë subjekt i formave të ndryshme të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit, si nga familja ashtu dhe nga komuniteti.</p> <p>Duke u bazuar tek të dhënat e raportuara në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, nga studimi i parë në nivel kombëtar i hartuar në prill 2014 mbi fëmijët në situatë ruge, në bashkinë e Shkodrës janë 315 fëmijë në situatë ruge. Me synim përmirësimin e gjendjes së këtyre fëmijëve, është i rëndësishëm hartimi i planit lokal të veprimit i cili përmban detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat standarte për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse si dhe organizatat publike apo private të cilat punojnë me fëmijët në rrezik, për ofrimin e shërbimeve lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe përmirësimin e situatës së këtyre fëmijëve në qytetin e Shkodrës.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë identifikimin e fëmijëve në situatë ruge.</li> <li>- Synojmë uljen e numrit të fëmijëve në situatë ruge në bashkinë e Shkodrës.</li> <li>- Synojmë ofrimin e shërbimeve mbrojtëse dhe rehabilituese për fëmijët në situatë ruge.</li> <li>- Synojmë përmirësimin e situatës së fëmijëve dhe familjeve në vështirësi të theksuar social-ekonomike në bashkinë e Shkodrës.</li> <li>- Synojmë parandalimin e fenomenit "fëmijë në situatë ruge".</li> </ul>		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Hartimi i Planit lokal të Veprimit.</li> <li>▪ Bashkëpunim i ngushtë me institucionet/strukturat përgjegjëse.</li> <li>▪ Ngritja e grupeve të terrenit për identifikimin e fëmijëve.</li> <li>▪ Përgatitja e një kalendari për grupet e terrenit, sipas njësive administrative të bashkisë Shkodër.</li> <li>▪ Menaxhimi i rasteve emergjente të fëmijëve në bashkëpunim me policinë, shërbimin social shtetëror, etj.</li> <li>▪ Organizim i punës të drejtpërdrejtë me fëmijët dhe familjen duke përfshirë këshillim dhe mbështetje.</li> <li>▪ Koordinimi dhe lehtësimi i GTM për të diskutuar për çdo fëmijë të konsideruar në rrezik.</li> <li>▪ Zhvillimi dhe shqyrtimi i planeve individuale të mbrojtjes dhe përkujdesjes.</li> <li>▪ Mbajtja dhe ofrimi i të dhënave për hartimin e raporteve mbi situatën e fëmijëve në territorin e bashkisë së Shkodrës.</li> <li>▪ Informimi dhe sensibilizimi i komunitetit.</li> <li>▪ Organizim i aktivitetit ndërgjegjësues në ditën ndërkombëtare kundër shfrytëzimit për punë të fëmijëve (12 qeshor), në bashkëpunim me institucionet publike dhe organizatat.</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fëmijë në situatë ruge të identifikuar.</li> <li>• Numri i fëmijëve në situatë ruge i zvogëluar.</li> <li>• Shërbime mbrojtëse dhe rehabilituese për fëmijët në situatë ruge të ngritura dhe funksionale.</li> <li>• Kushtet e familjeve të fëmijëve në situatë ruge të përmirësuara.</li> <li>• Shërbime parandaluese mbi fenomenin "fëmijë në situatë ruge".</li> </ul>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Fëmijët në situatë ruge Familjet në vështirësi social-ekonomike Institucionet publike Organizatat	Bashkia Organizatat Institucionet publike Komuniteti	

<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		<b>Totali (000 lek)</b>	<b>Nga kjo:</b>		
			<b>Paga, sig</b>	<b>operative</b>	<b>kapitale</b>
A.1	Shërbimi i transportit për fëmijët			36	
A.2	Përgatitja, dizenjimi dhe formatimi i fletëpalosjeve dhe materialeve informuese e ndërgjegjësuese			300	
	Shuma	<b>336</b>		336	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> janar - dhjetor 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Bashkia e Shkodrës Administratorët shoqërorë Kryetarët e njësive administrative Stafi i qendrave komunitare			



Nr. 06	<b>Projekti: P10.F2.O2.A4.</b> Ndhima ekonomike dhe PAK	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  <b>Funksioni:P10.F2.</b> Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
i. Situata						
<p>Në zbatim të legjislacionit në fuqi për ndihmën ekonomike, pagesën për personat me aftësi të kufizuar, ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", VKM-së nr. 618, datë 07. 09. 2006, "Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", Vendimit nr. 277 datë 18.6.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", bashkia e Shkodrës ka trajtuar të gjitha personat dhe familjet, përfitues të ndihmës sociale dhe pagesës së paaftësisë.</p> <p>Kështu, gjatë vitit 2015 nga Bashkia e Shkodrës u trajtuan 4626 familje me ndihmë ekonomike. Fondi total i kësaj ndihme ka qenë 17.833.671 lekë. Gjithashtu për vitin 2015, janë trajtuar 4475 persona me pagesën e paaftësisë me një fond total prej 55.486.512 lekë.</p> <p>Për vitin 2016, Bashkia e Shkodrës ka në dispozicion një fond prej 167 milion lekësh nga fondet e deleguara nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, për trajtimin e familjeve me ndihmë sociale dhe pagesë paaftësie.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë plotësimin e nevojave sociale dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat, familjet në nevojë dhe grupet vulnerabël të territorit të bashkisë së Shkodrës.</li> </ul>						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerni për të prodhuar rezultate)						
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Aplikimet për përfitim të ndihmës ekonomike apo pagesës paaftësisë për çdo muaj, pranë bashkisë së Shkodrës.</li> <li>▪ Vlerësimi i aplikimeve</li> <li>▪ Shpallja e përfituesve të ndihmës sociale dhe pagesës paaftësisë</li> <li>▪ Përditësimi i listave të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe pagesës paaftësisë për çdo muaj nga punonjësit e ndihmës ekonomike dhe administratorët shoqërorë.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave dhe familjeve në vështirësi social, ekonomike.</li> <li>• Ndërgjegjësimi i familjeve për punësim dhe bashkëpunim me institucionin e zyrës rajonale të punësimit dhe qendrën e formimit profesional, si një mundësi më e mirë për përmirësimin e kushteve ekonomike të personave dhe familjeve.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Familjet në situatë ekstreme varfërie Personat me aftësi ndryshe Familjet e personave me aftësi ndryshe			Bashkia Ministria e linjës Shërbimi Social Rajonal			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo:		
A.1				Paga, sig	transferte	kapitale
Fondi për ndihmën sociale dhe pagesën e paaftësisë					167 000	
Shuma			<b>167 000</b>		167 000	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> janar - dhjetor 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> stafi i drejtorisë së shërbimit social, shëndetit publik dhe strehimit stafi i zyrës së ndihmës ekonomike			

Nr. 07	<b>Projekti: P10.F2.O2.A5.</b> Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  <b>Funksioni:P10.F2.</b> Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>					
i. Situata					
Njësitë e qeverisjes vendore, si autoritete përgjegjëse në luftën kundër dhunës në familje, kanë detyrim ligjor ngritjen dhe funksionimin e sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. (ligji nr. 9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar dhe VKM nr. 334, datë 17. 02. 2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit tij”). Në bashkinë e Shkodrës, ky mekanizëm nuk funksionon, pasi akoma nuk është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit midis institucioneve kryesore përgjegjëse në luftën kundër dhunës në familje.					
ii. Synimi i projektit					
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë fuqizimin e partneritetit në drejtim të luftës kundër dhunës në marrëdhëniet familjare.</li> <li>- Synojmë përmirësimin e ndërhyrjes në mënyrë të koordinuar me ekipe ndër-disiplinare, për një trajtim sa më efektiv të rasteve të dhunës në familje.</li> <li>- Synojmë të përmirësojmë ofrimin e shërbimeve kundrejt viktimave të dhunës në familje.</li> </ul>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrin për të prodhuar rezultate)					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përgatitja e draft marrëveshjes midis institucioneve publike dhe organizatave, përgjegjëse për luftën kundër dhunës në familje.</li> <li>▪ Ndarja e draft marrëveshjes me secilin institucion/organizatë për diskutim të përgjegjësive tyre të përshkuara në marrëveshje.</li> <li>▪ Përgatitja e marrëveshjes për sistemin e referimit të rasteve të dhunës në familje</li> <li>▪ Organizimi i aktivitetit për nënshkrimin e marrëveshjes me pjesëmarrjen e secilit institucion/organizatë</li> <li>▪ Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit dhunës në familje</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fuqizimi i sistemit të referimit të rasteve të dhunës në familje, në tërësinë të territorit dhe bashkisë Shkodër.</li> <li>• Përmirësimi i ndërhyrjes së koordinuar në identifikimin, mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje</li> <li>• Përmirësimi i shërbimeve që ofrohen në territorin e bashkisë Shkodër për viktimat e dhunës në familje</li> <li>• Ndërgjegjësim dhe sensibilizim i viktimave të dhunës në familje për denoncimin e dhunës të ushtruar ndaj tyre</li> <li>• Parandalim i fenomenit dhunë në familje</li> </ul>					
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt		
Familjet, viktimat të dhunës Komuniteti Institucionet publike OJF-të			Bashkia Policia, gjykata, përmbartimi, prokuroria, spitali, zyra e punës, drejtoria arsimore, drejtoria shëndetit public, shërbimi social rajonal, mjekësia ligjore, Organizatat		
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet			Totali (000 lekë)	Nga kjo:	
A.1				Paga, sig	operative
f) Periudha e zbatimit janar – dhjetor 2016			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit		



Nr. 08	<b>Projekti: P10.F2.O2.A2.</b> 16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore; 25 nëntor – 10 dhjetor	<b>Lloji i programit; P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale</b>  Funkzioni:P10.F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>					
i. Situata					
<p>Në bashkinë e Shkodrës, ekzistojnë një sërë problematikash, që shpesh zanafilla e tyre është nga mos informimi i komunitetit mbi të drejtat, mundësitë dhe shërbimet që ofrohen në territor. Për këtë është me rëndësi organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe parandaluese në ditë ndërkombëtare për informim, sensibilizim, orientim, e përfitim të shërbimeve të ofruara.</p> <p>Në kuadër të 16 ditëve ndërkombëtare kundër dhunës me bazë gjinore (25 nëntor – 10 dhjetor) bashkia e Shkodrës, si institucioni koordinues në mekanizmin e referimit rasteve të dhunës në familje, si çdo vit, në zbatim të ligjit nr. 9669, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", planifikon aktivitetet që do organizohen për fushatën kundër dhunës në familje. Aktivitetet e organizuara kanë në fokus sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit mbi të drejtat e tyre, mbi mundësitë e shërbimit që ofrohen në territor dhe gjithashtu synojnë rritjen e numrit të denoncimeve të dhunës në familje dhe parandalimin e këtij fenomeni.</p>					
ii. Synimi i projektit					
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë organizimin e aktiviteteve informuese, ndërgjegjësuere, orientuese për komunitetin.</li> <li>- Synojmë rritjen e numrit të denoncimeve për rastet e dhunës në familje në territorin e bashkisë.</li> <li>- Synojmë bashkëpunim të ngushtë me organizatat dhe institucionet.</li> <li>- Synojmë përfshirjen dhe angazhimin e komunitetit në fushatën kundër dhunës në familje.</li> </ul>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Thirrja për bashkëpunim për organizatat, institucionet, median dhe komunitetin.</li> <li>▪ Organizim i takimit të tryezës konsultative për diskutimin dhe përcaktimin e kalendarit të aktiviteteve për 16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.</li> <li>▪ Krijimi i kalendarit të aktiviteteve.</li> <li>▪ Ndrëqimi dhe dekorimi i ndërtesës së bashkisë me ngjyrën e fushatës për vitin 2016.</li> <li>▪ Krijimi i hapësirave reklamuese në zona të ndryshme të qytetit, për të përhapur mesazhin e fushatës.</li> <li>▪ Organizimi i marshimit me biçikleta, përgjatë rrugëve kryesore të qytetit, në 25 nëntor, me pjesëmarrje masive të organizatave-institucioneve-komunitetit.</li> <li>▪ Organizim të takimeve ndërgjegjësuere e informuese me nxënësit e shkollave, studentët e universitetit të Shkodrës të cilët do kenë rol aktiv në këto takime.</li> <li>▪ Përgatitje të materialeve promociionale që do përdoren gjatë fushatës kundër dhunës me bazë gjinore.</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillim i aktiviteteve gjatë gjithë ditëve të aktivizimit me pjesëmarrje aktive të komunitetit, institucioneve publike dhe organizatave.</li> <li>• Ndërgjegjësim i komunitetit.</li> <li>• Rritje e numrit të denoncimeve të rasteve të dhunës në familje.</li> <li>• Bashkëpunim i afërt bashki-institucione publike-organizata-komunitet</li> <li>• Rritje e numrit të përfituesve të shërbimeve që ofrohen në territor për rastet e dhunës në familje.</li> <li>• Përmirësim i situatës së viktimave të dhunës në familje në territorin e bashkisë Shkodër.</li> <li>• Parandalim të fenomenit dhunë në familje në territorin e bashkisë Shkodër.</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Komuniteti Institucionet publike OJF-të Bizneset private			Bashkia Institucionet publike OJF-të Bizneset private Komuniteti		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Ndrëqimi i ndërtesës			100	
A.2	Materiale promociionale (kapele, stilolapsa, stikera, fletëpalosje, postera)			200	
<b>Shuma</b>		<b>300</b>		<b>300</b>	

<b>f) Periudha e zbatimit</b> nëntor – dhjetor 2016	<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit institucionet publike organizatat biznesi privat komuniteti
--	--



Nr. 09	<b>Projekti: P10.F2.O2.A3.</b> Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  Funkzioni:P10.F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>				
i. Situata				
Në territorin e bashkisë së Shkodrës, ekziston një numër i madh familjesh në vështirësi të theksuara sociale e ekonomike. Situata në të cilën ndodhen këto familje vjen si shkak i ndikimit të një sërë faktorësh si; nveli i ulët arsimor, kulturor, ekonomik, etj. Për pasojë të faktorëve të lartpërmendur, këto familje shpesh herë kanë mungesë informacioni, nuk marrin interesim për shërbimet sociale që ofrohen në territor dhe jetojnë në kushte ekstreme varfërie.				
ii. Synimi i projektit				
- Ndërgjegjësimi i komunitetit nëpërmjet takimeve sensibilizuese dhe informuese në kuadër të ditës ndërkombëtare për familjen, në zonat periferike të bashkisë së Shkodrës.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerni për të prodhuar rezultate)				
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Planifikimi i takimeve në bashkëpunim me përfaqësues të institucioneve publike si: DSHP, Policia, Zyra e punës, QFP, SHSSH, etj.</li> <li>▪ Organizimi i takimeve në çdo zonë periferike të qytetit, në qendrat komunitare të bashkisë.</li> <li>▪ Përgatitje e posterave informues e ndërgjegjësuës mbi shërbimet për familjen</li> <li>▪ Shpërndarja e posterave në qendrat komunitare</li> <li>▪ Pjesëmarrje dhe bashkëpunim me median vizive</li> </ul>				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Informimi i komunitetit</li> <li>• Ndërgjegjësimi i komunitetit</li> <li>• Rritje e numrit të përfituesve</li> <li>• Përmirësimi i cilësisë së jetës për familjet në vështirësi social - ekonomike</li> </ul>				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Komuniteti Institucionet publike OJF-të		Bashkia Institucionet publike OJF-të Bizneset private Komuniteti		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
A.1	Përgatitja, dizajimi dhe botimi i posterave dhe borshurave informuese e ndërgjegjësuëse			30
<b>Shuma</b>		<b>30</b>		<b>30</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> maj 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit		

Nr. 10	<b>Projekti: P10.F2.O2.A4.</b> Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  Funkzioni:P10.F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>					
i. Situata					
<p>Vetëm në universitetin e Shkodrës për çdo vit diplomohen rreth 15 studentë përkatësisht në degën e psikologjisë, punës sociale, infermierisë dhe fizioterapisë. Njohuritë që studentët e diplomuar marrin janë të karakterit teorik dhe mungon shumë njohja me situatën reale në qytet dhe ushtrimi i praktikës profesionale në degën që ata studiojnë.</p> <p>Në bashkinë e Shkodrës, ekziston një numër i madh familjesh në vështirësi të theksuara social-ekonomike, dhe nganjëherë, si pasojë e vështirësive në të cilën ata ndodhen dhe si pasojë e nivelit të ulët kulturor e arsimor, nuk arrijnë të jenë përfitues të disa shërbimeve që ofrohen në territor, për këtë, planifikojmë përfshirjen e studentëve, në shërbim të komunitetit.</p>					
ii. Synimi i projektit					
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në partneritetit me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermieri-fizioterapisë, synojmë të bashkërendojmë punën për mbulimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale ndaj familjeve në nevojë.</li> <li>- Synojmë informimin për shërbimet në territor dhe përmirësimin e kushteve sociale të familjeve në nevojë, duke ofruar shërbimin në komunitet, në bashkëpunim me studentët.</li> <li>- Synohet kryerja e detyrimeve të praktikës mësimore të studentëve në mënyrë më efektive.</li> </ul>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerni për të prodhuar rezultate)					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Thirrja për studentët</li> <li>▪ Pranimi i kërkesave nga studentët dhe universiteti</li> <li>▪ Përzgjedhja e studentëve</li> <li>▪ Përgatitje dhe trajnim i studentëve për punën që do zhvillojnë</li> <li>▪ Supervizim i studentëve në komunitet</li> <li>▪ Ndihmë për familjet në vështirësi social-ekonomike</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunim i afërt bashki – universitet - student</li> <li>• Ofrim i shërbimeve në territor</li> <li>• Informim, orientim, këshillim për individët dhe familjet në vështirësi soc-ekonomike</li> <li>• Përmirësim i kushteve social-ekonomike të familjeve në nevojë</li> <li>• Zhvillim i aftësive praktike të studentëve të univeristetit të Shkodrës.</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Studentët Universiteti i Shkodrës Komuniteti Bashkia			Bashkia Universiteti i Shkodrës Studentët		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo:	
A.1				Paga, sig	operative
<b>f) Periudha e zbatimit</b> janar - dhjetor 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimit social dhe strehimit Departamenti i psikologji – punë sociale Departamenti i infermieri - fizioterapisë		

Nr. 11	<b>Projekti: P10.F2.O3.A1.</b> Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në qytetin e Shkodrës	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  <b>Funksioni:P10.F2.</b> Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
i. Situata						
<p>Në qytetin e Shkodrës, ndodhen e funksionojnë shumë organizata sociale që ofrojnë shërbim në mbështetje të grupeve sociale në nevojë. Këto organizata ofrojnë shërbime për fëmijët, të rinjtë, gratë, të moshuarit, famijet në vështirësi social-ekonomike, etj.</p> <p>Aktualisht nuk ka të dhëna statistikore mbi përfituesit e shërbimeve që ofrohen nga këto organizata, shërbimet që ata ofrojnë dhe përputhshmërinë e shërbimeve që marrin me nevojat që kanë.</p> <p>Për këtë mendohet krijimi dhe funksionimi i një tryeze konsultative me këto organizata për njohjen e shërbimeve që ofrohen në territor, për shpërndarjen e shërbimeve sipas nevojave specifike të familjeve, shmangien e mbivendosjeve në shërbime e përfitues dhe gjithashtu krijimi i ideve, projekteve inovative, që janë domosdoshmëri për përmirësimin e vazhdueshëm të situatës së familjeve në vështirësi social-ekonomike në qytetin e Shkodrës.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë krijimin e një tryeze konsultative me pjesëmarrjen e shoqërisë civile.</li> <li>- Synojmë të njohim dhe shpërndajmë informacionin mbi shërbimet sociale që ofrohen në territor.</li> <li>- Synojmë konsolidimin e tryezës konsultative midis OJF-ve që veprojnë në qytetin e Shkodrës.</li> <li>- Synojmë të përmirësojmë situatën e familjeve në vështirësi soc-ek të qytetit të Shkodrës.</li> </ul>						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)						
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përgatitja e një liste të të gjitha OJF-ve që veprojnë në sektorin e shërbimeve sociale në territorin e bashkisë.</li> <li>▪ Organizimi i takimit me të gjithë aktorët.</li> <li>▪ Ndarja e roleve, përgjegjësi dhe detyrave për secilin anëtar të tryezës konsultative.</li> <li>▪ Takime periodike të tryezës.</li> <li>▪ Propozime të reja për ofrimin e shërbimeve sociale sipas nevojave të territorit.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunim i afërt dhe partneritet bashki-OJF; OJF-OJF</li> <li>• Shpërndarje më e mirë e shërbimeve në territor</li> <li>• Informacion mbi projektet dhe shërbimet që zbatohen në qytet</li> <li>• Përmirësim i situatës së familjeve në nevojë në qytetin e Shkodrës</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>				
Komuniteti Institucionet publike Organizatrat		Bashkia Organizatrat Institucionet publike Komuniteti				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:			
			<table border="1"> <tr> <td data-bbox="1062 1560 1166 1602">Paga, sig</td> <td data-bbox="1166 1560 1279 1602">operative</td> <td data-bbox="1279 1560 1386 1602">kapitale</td> </tr> </table>	Paga, sig	operative	kapitale
Paga, sig	operative	kapitale				
A.1						
<b>f) Periudha e zbatimit</b> janar - dhjetor 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimit social, shëndetit publik dhe strehimit				

Nr. 12	<b>Projekti: P10.F2.O3.A2</b> Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  <b>Funksioni:P10.F2.</b> Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
i. Situata						
Në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve do organizohen aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi të drejtat e tyre dhe mundësitë dhe shërbimet që ofrohen në territor. 20 Nëntori, e themeluar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1954, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve synon të promovojë mirëqenien e fëmijëve.						
ii. Synimi i projektit						
- Synojmë organizimin e aktiviteteve informuese, ndërgjegjësuere, orientuese për komunitetin dhe rritjen e numrit të përfituesve të shërbimeve që ofrohen në territorin e bashkisë.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerni për të prodhuar rezultate)						
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Organizim aktiviteti sensibilizues</li> <li>▪ Bashkëpunim me institucionet publike, OJF-të, bizneset private dhe komunitetin</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i aktivitetit</li> <li>• Bashkëpunim i ngushtë me institucionet dhe organizatat dhe komunitetin.</li> <li>• Ndikim në parandalimin e fenomeneve sociale (dhuna në familje, shfrytëzimi, neglizhimi, abuzimi i fëmijëve)</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Komuniteti Institucionet publike OJF-të Bizneset private ASHMDF			Njësia e mbrotjes së fëmijëve Institucionet publike OJF-të ASHMDF Bizneset private			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo:		
				Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Refreshments për pjesëmarrësit i përgatitur nga katering u i organizatave			50		
<b>Shuma</b>			<b>50</b>	<b>50</b>	<b>50</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Tetor - Nëntor 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit			



Nr. 13	<b>Projekti: P10.F2.O3.A3</b> "Shkodra n'fest"	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funkzioni:P10.F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>					
i. Situata					
<p>"Shkodra n'fest", është një aktivitet social-kulturor, i organizuar në bashkëpunim me organizatat dhe bizneset, me rastin e festave të fundvitit. Ky aktivitet do organizohet përgjatë muajit të festave, në qendrën e qytetit të Shkodrës, me qëllim promovimin dhe zhvillimin e jetës social-kulturore në qytetin e Shkodrës.</p> <p>Një aktivitet i tillë është organizuar për herë të parë për festat e fund vitit 2015. Duke qenë se ky aktivitet ka patur impakt pozitiv në komunitet, mendohet të kthehet në traditë për festimin e festave të fundvitit, me qëllim sensibilizimin e komunitetit dhe gjallërimin e jetës social-kulturore nëpërmjet aktiviteteve kulturore, aktiviteteve sociale, duke përfshirë të gjithë komunitetin e Shkodrës.</p> <p>Aktiviteti Shkodra n'fest ka veçantësinë e tij, sepse përveç pjesës argëtuese dhe kulturore ka të përfshirë edhe pjesën sociale, informimin, ndërgjegjësimin e komunitetit për shërbimet sociale që ofrohen në territorin e bashkisë, përgjatë gjithë vitit.</p>					
ii. Synimi i projektit					
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë të ndërgjegjësojmë dhe informojmë komunitetin mbi shërbimet sociale që ofrohen në territor dhe rëndësinë e përfshirjes tyre, në shërbimet që ofrohen, si përfitues direkt apo indirekt, por edhe si kontribues në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve sociale.</li> <li>- Zhvillimi i jetës social-kulturore në Shkodër dhe krijimi i atmosferës festive në qytet, për të gjithë komunitetin.</li> </ul>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Panairi i OJF-ve</li> <li>▪ Aktivitet në kuadër të ditës kombëtare të rinisë</li> <li>▪ Aktivitete kulturore (koncert nga/për fëmijë, koncert me grupe të ndryshme muzikore)</li> <li>▪ Aktivitete social-kulturore në bashkëpunim me organizatat që veprojnë në qytetin e Shkodrës me pjesëmarrje të animatorëve socialë</li> <li>▪ Aktivitete ndërgjegjësuere</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërgjegjësim i komunitetit.</li> <li>• Zhvillimi dhe promovimi i të rinjve, vullnetarizmit, gjithpërfshirjes në aktivitetet që organizohen në territorin e bashkisë së Shkodrës.</li> <li>• Përmirësimi i jetës social-kulturore të komunitetit.</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Komuniteti Institucionet publike Organizatat			Bashkia Organizatat Komuniteti		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Honorare			300	
<b>Shuma</b>		<b>300</b>		300	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> nëntor - dhjetor 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e shërbimit social, shëndetit publik dhe strehimit Drejtoria e kulturës Organizatat Drejtoria e financës		

Nr. 14	<b>Projekti: P10.F2.O3.A4.</b> Dita ndërkombëtare e të moshuarve	<b>Lloji i programit; P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale</b>  Funkzioni:P10.F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
i. Situata						
<p>Në qytetin e Shkodrës trajtohen me pension pleqërie 17.952 të moshuar. Nuk ka të dhëna mbi numrin e saktë të të moshuarve që jetojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës. Një pjesë e madhe e kësaj kategorie jetojnë në shtëpi, vetëm, shpesh pa përkujdesje të veçantë dhe në varfëri e në kushte shumë të papërshtatshme.</p> <p>Gjithashtu, në qytetin e Shkodrës, veprojnë shumë organizata që ofrojnë shërbime sociale për kategoritë në nevojë, por janë të fokusuar në grupmoshën foshnjëri-moshë e mesme, duke lënë kështu, jashtë shërbimeve tyre, moshën e tretë.</p> <p>Të ndodhur para kësaj situatë, mendojmë që të fillojmë të organizojmë aktivitete sensibilizuese në kuadër të ditës ndërkombëtare të të moshuarve.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë organizim dhe zhvillim të aktivitete sensibilizuese, në kuadër të ditës ndërkombëtare të të moshuarve, duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet publike dhe organizatat që veprojnë në qytetin e Shkodrës.</li> </ul>						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Thirrje për bashkëpunim institucioneve publike dhe organizatave.</li> <li>▪ Organizim i aktivitetit të përbashkët me temë "promovimi i ndërgjegjësimit të komunitetit për ditën ndërkombëtare të të moshuarve"</li> <li>▪ Propozimi i mënyrave për përfshirje aktive të të moshuarve në shoqëri.</li> <li>▪ Trajtimi i temave të ndryshme si: plakja e popullsisë dhe ofrimi i kujdesit shëndetsor për personat e kësaj moshe.</li> <li>▪ Përfshirja e vullnetarëve në ndihmë të moshës së tretë.</li> <li>▪ Kujdesi social ndaj moshës së tretë.</li> <li>▪ Diskutimi i mundësive për ofrim të shërbimeve në shtëpi, për të moshuarit që jetojnë vetëm.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitet gjithëpërfshirës, për nga diversiteti i institucioneve, organizatave pjesëmarrëse dhe komunitetit.</li> <li>• Sensibilizim i komunitetit dhe institucioneve.</li> <li>• Përmirësim i cilësisë së jetës për të moshuarit e bashkisë së Shkodrës.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Komuniteti Institucionet publike OJF-të			Bashkia Institucionet publike OJF-të Bizneset private Komuniteti			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo:		
				Paga, sig	operative	kapitale
A.1						
<b>f) Periudha e zbatimit</b> shtator - tetor 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit.			



Nr. 15	<b>Projekti:P10.F2.O3.A5.</b> Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të "1 Dhjetorit", ditës Botërore kundër Hiv Aids.	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  Funksioni:P10.F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>					
i. Situata					
Në qytetin e Shkodrës për vitin 2015 numri i të infektuarve me Hiv Aids është 40. Një tregues jo i vogël, që tregon se duhet një impenjim serioz nga insitucionet dhe organizatat për të informuar sa më shumë komunitetin për rrezikun e përhapjes së kësaj sëmundje.					
ii. Synimi i projektit					
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë informimin dhe përfshirjen e komunitetit në luftën kundër Hiv Aids.</li> <li>- Synojmë organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese/sensibilizuese për/me komunitetin.</li> <li>- Synojmë organizimin e marshimit në qendër të qytetit me mesazhe për luftën kundër Hiv Aids-it me përfshirjen e dhe pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave të qytetit.</li> </ul>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Organizim i një takimi informues me rrjetin e partneritetit lokal kundër Hiv- it në Shkodër.</li> <li>▪ Marshim sensibilizues nga studentët/ nxënës të shkollave të qytetit.</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Informim dhe ndërgjegjsim i qytetarëve mbi rreziqet e Hiv-it dhe për parandalimin e kësaj sëmundje.</li> <li>• Zgjerim dhe forcim i rrjetit "Partneritet lokal kundër Hiv- it" në Shkodër.</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Komuniteti Rrjeti parneritetet lokale kundër Hiv-it DSHP			Bashkia Rrjeti parneritetet lokale kundër Hiv-it DSHP		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo:	
A.1				Paga, sig	operative
					kapitale
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Nëntor - Dhjetor 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit Rrjeti parneritetet lokale kundër Hiv-it DSHP DAR		

Nr. 16	<b>Projekti: P10.F2.O3.A6.</b> Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor.	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  Funksioni:P10.F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
i. Situata						
Në kuadër të “3 Dhjetorit” ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe do organizohen aktivitete për ndërgjegjësimin e institucioneve publike, organizatave, donatorëve, por edhe të përfituesve për t’u bërë pjesë dhe për t’u përfshirë në procesin e integritit të personave me AN në jetën, sociale, ekonomike e kulturore që zhvillohen në territorin e bashkisë së Shkodrës. Në territorin e bashkisë së Shkodrës PAN ndihen të përjashtuar jo vetëm për shkak të aftësive tyre ndryshe, por edhe për shkak të barrierave fizike që ekzistojnë në insitucionet publike dhe private. Për këtë është me rëndësi organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese, sensibilizuese për PAN-të për t’i dhënë mundësinë këtij target grupi të shfaqin aftësitë e tyre në prezantimin e punimeve të realizuara nga vetë ata, në mënyrë që komuniteti t’i vlerësojë dhe t’i konsiderojë si pjesë e rëndësishme e shoqërisë.						
ii. Synimi i projektit						
- Synojmë ndërgjegjësimin e komunitetit, institucioneve publike dhe organizatave por edhe të përfituesve për t’u bërë pjesë dhe për t’u përfshirë në procesin e integritit të personave me aftësi ndryshe në jetën, sociale, ekonomike e kulturore.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Panair me punime nga vetë PAN, në hollin e bashkisë së Shkodrës.</li> <li>▪ Performacë e Bandës muzikore të PAN</li> <li>▪ Organizim i aktivitetit social – kulturor nga fëmijët e qendrës kulturore/nxënësit e shkollave</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërgjegjësimi i komunitetit, institucioneve dhe organizatave</li> <li>• Zhvillimi i aktivitetit social – kulturor me pjesëmarrjen e PAN-ve dhe fëmijëve të qendrës kulturore dhe nxënësve të shkollave.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Personat me aftësi ndryshe Komuniteti Institucionet publike OJF-të			Bashkia Institucionet publike OJF-të Bizneset private Komuniteti			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo:		
				Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Aktivitet sensibilizues (refreshments)		<b>100</b>		100	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Nëntor – Dhjetor 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit Stafi i Qendrës së Zhvillimit Organizatave Qendra kulturore e Fëmijëve DAR			

Nr. 17	<b>Projekti: P10.F2.O3.A7.</b> Dita ndërkombëtare kundër homofobisë	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  Funkzioni:P10.F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>					
i. Situata					
Komuniteti LGBT, në qytetin e Shkodrës, është ndër komunitetet e diskriminuara. Duke qenë se në politikat sociale të bashkisë së Shkodrës, është gjithpërfshirja, krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, orientimit seksual, etj. mendojmë të organizojmë aktivitete ndërgjegjësuese dhe sensibilizuese, në ditën ndërkombëtare kundër homofobisë, më 17 maj.					
ii. Synimi i projektit					
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë koordinimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për sensibilizimin, parandalimin dhe luftën kundër fenomenit të homofobisë.</li> <li>- Synojmë ndërgjegjësimin e komunitetit nëpërmjet organizimit të aktiviteteve në territorin e bashkisë Shkodër.</li> <li>- Synojmë të ndikojmë në ndryshimin e mentalitetit të komunitetit, mbi çështjet LGBTI.</li> <li>- Synojmë mbrojtjen nga diskriminimi për komunitetin LGBTI në partneritet me organizatat, Komisionerin për mbrojtje nga diskriminimi, institucionet publike etj.</li> </ul>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerni për të prodhuar rezultate)					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Krijimi i bashkëpunimit me institucionet publike dhe organizatat për organizim dhe zhvillim të aktiviteteve.</li> <li>▪ Takime ndërgjegjësuese në shkollat e mesme të qytetit.</li> <li>▪ Ekspozitë me fotografi/piktura kundër homofobisë.</li> <li>▪ Trajnim mbi çështjet LGBTI</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërgjegjësim i mbarë komunitetit mbi të drejtat e komunitetit LGBTI</li> <li>• Ndikim në zvogëlimin e paragjyqimeve dhe stereotipeve mbi kom LGBTI</li> <li>• Pjesëmarrje të gjerë në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe krijimi i një rrjeti mbështetjeje për lëvizjen LGBTI</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Komuniteti Institucionet publike OJF-të			Bashkia Institucionet publike OJF-të Bizneset private Komuniteti		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo:	
A.1				Paga, sig	operative
			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit organizatat		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> maj 2016					

Nr. 18	<b>Projekti: P10.F2.O3.A8.</b> Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  Funkzioni:P10.F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>					
i. Situata					
<p>Në qytetin e Shkodrës, dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi është një ditë feste, ku të gjitha gratë planifikojnë aktivitete me ambientin e tyre familjar, shoqëror, staf pune, etj. Organizimet në këtë ditë janë dreka apo darka festive, udhëtime turistike, etj. Por 8 marsi, nuk është një ditë e tillë, nuk është një ditë feste.</p> <p>8 marsi, është dita ndërkombëtare e gruas, e në çdo vend të botës, gratë, organizojnë protesta, dhe aktivitete me karakter ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi për të drejtat e njeriut, për barazinë gjinore, etj.</p>					
ii. Synimi i projektit					
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë të ndërgjegjësojmë komunitetin e Shkodrës, në ditën ndërkombëtare të gruas.</li> <li>- Synojmë të ndikojmë në traditën e krijuar në qytet, mbi 8 marsin, nuk është një ditë feste, por është një ditë ndërkombëtare ku lobohet fuqishëm për të drejtat e gruas dhe jo vetëm.</li> <li>- Synojmë përfshirjen e meshkujve (të rinj, intelektualë) në aktivitetet e kësaj dite.</li> </ul>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Mbledhja e tryezës konsultative pqr të diskutuar mbi organizimin e aktiviteteve në ditën ndërkombëtare të gruas”</li> <li>▪ Protestë paqësore me sloganin “8 marsi, ditë proteste, jo feste”</li> <li>▪ Organizim i një aktiviteti me pjesëmarrje të barabartë gjinore, për të diskutuar mbi të drejtat njerëzore, barazinë, situatën sociale në bashkinë e Shkodrës, etj.</li> <li>▪ Përgatitja dhe transmetimi i një spoti televiziv me mesazhe sensibilizuese</li> <li>▪ Përgatitja dhe shpërndarja e kartolinave Mania Card, për ndërgjegjësimin e mbarë komunitetit, në ditën ndërkombëtare të gruas</li> <li>▪ Përkthimi dhe përshtatja në shqip e këngës “One Eoman”, e realizuar në vitin 2013, me pjesëmarrje të 25 artistëve nga 20 vende të botës, në kuadër të sensibilizimit ndërkombëtar për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore.</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sensibilizimi i komunitetit</li> <li>• Pjesëmarrje aktive e komunitetit (meshkuj dhe femra) në aktivitete ndërgjegjëse.</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Komuniteti Institucionet Organizatat Muzikantët e bashkisë së Shkodrës			Bashkia Organizatat Institucionet Komuniteti		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>				Totali (000 lek)	Nga kjo: Paga, sig      operative      kapitale
A.1	Materiale promocionale (baner, kartolinat mania card, etj)				100
A.2	Spoti televiziv				3
A.3	Përgatitja e këngës në shqip				50
<b>Shuma</b>				<b>153</b>	153
<b>f) Periudha e zbatimit</b> shkurt – mars 2016				<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimit social, strehimit dhe shëndetit publik Stafi i drejtorisë së kulturës	

Nr. 19	<b>Projekti: P10.F2.O3.A9</b> Bashkëpunimi me Save the Children	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale Funkzioni:P10.F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
<b>Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata ( Shpego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)</b>		
<p>Në zbatim të VKM 89 datë 26. 01 2012 në Bashkinë Shkodër është i ngritur dhe funksionon komisioni multidisiplinar i kujdestarisë, i cili shqyrton kërkesat e familjeve kujdestare dhe vendos caktimin e fëmijëve pa kujdes prindëror në familje kujdestare.</p> <p>Qëllimi i këtij shërbimi është zgjerimi i formave alternative në strukturat rezidenciale për fëmijët drejt deinsitucionalizimit të shërbimeve të përkujdesjes. Sistemimi i fëmijëve në familjen kujdestare organizohet dhe mbikqyret nga Bashkia nëpërmjet komisionit multidisiplinar të kujdestarisë.</p> <p>Sigurimi i mbrojtjes shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe i të drejtave të tyre janë sfida për Bashkinë e Shkodrës, por edhe për shoqërinë civile, duke kërkuar një vëmendje më të veçantë për këtë target grup.</p> <p>Gjithashtu dhe numri në rritje i fëmijëve që punojnë ose lypin, i fëmijëve që janë braktisur ose janë lënë përkohësisht nën kujdesin e të afërmeve, nevojitet të trajtohet si një problem serioz si nga Bashkia ashtu dhe shoqëria civile.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe Save the Children për zbatimin e programit të bashkëpunimit në mbështetje të të drejtave të fëmijëve për mbijetesë, mbrojtje e zhvillim.</li> <li>- Synojmë krijimin e mundësive dhe zbatimin e të drejtës themelore të fëmijëve për të jetuar e rritur në një ambient të përshtatshëm familjar, goftë kjo familja biologjike apo familja kujdestare.</li> </ul>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nënshkrimi i një marrëveshje bashkëpunimi midis bashkisë së Shkodrës dhe Save the Children me qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale dhe zbatimin e programit të bashkëpunimit.</li> <li>▪ Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për vlerësimin e nevojave të grupeve dhe ndërtimin e planeve të ndërhyrjes.</li> <li>▪ Ndërtimi i mekanizmave monitorues të cilësisë së shërbimeve duke ngritur kapacitetet e tyre në matjen e indikatorëve të cilësisë.</li> <li>▪ Krijimi i një bazë të dhënash, me qëllim raportimin periodik të gjithë përfituesve të shërbimeve sociale në territorin e bashkisë së Shkodrës.</li> <li>▪ Krijimi i një bazë të dhënash në nivel bashkie për të gjithë ofruesit e shërbimeve, tipologjisë së shërbimeve, kapaciteteve të tyre dhe grupeve të përfituesve.</li> <li>▪ Hartimi i standarteve të shërbimit për fëmijët në situatë rruge, nga një grup multidisiplinar me përfaqësues të bashkisë së Shkodrës, Save the Children dhe institucioneve e organizatave që veprojnë në qytetin e Shkodrës.</li> <li>▪ Organizim të fushatave të ndërgjegjësimit dhe komunikimi me publikun e gjerë për promovimin e shërbimit të kujdestarisë dhe kulturës së solidaritetit ndaj fëmijëve dhe familjeve në nevojë si dhe fëmijëve në kujdes rezidencial.</li> <li>▪ Krijimi i programeve mbështetëse për familjet biologjike me synim parandalim e braktisjes dhe rikthimin e fëmijëve, nga kujdesi rezidencial pranë familjeve të tyre.</li> <li>▪ Mbështetje teknike dhe financiare e specialistëve të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Specialistin për De-institucionalizimin dhe Kujdesin Alternativ në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik që janë identifikuar apo referuar dhe ndjekjes së planit të ndërhyrjes.</li> <li>▪ Identifikimi i familjeve të mundshme kujdestare.</li> <li>▪ Krijimi i regjistrit të kujdestarisë në Bashkinë e Shkodrës për familjet kujdestare.</li> <li>▪ Trajnime mbi zbatimin e programeve të ngritjes së kapaciteteve të prindërimit pozitiv si me prindër të familjeve në situatë krize ashtu dhe me prindër të mundshëm kujdestarë.</li> <li>▪ Menaxhimi i rasteve emergjente të fëmijëve në bashkëpunim me policinë, shërbimin social shtetëror, etj.</li> </ul>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Punonjës socialë për vlerësimin e nevojave të grupeve në nevojë dhe në ndërtimin e planeve të ndërhyrjes, të trajnuar.</li> <li>• Ofrim i shërbimeve sociale cilësore për kategoritë në nevojë.</li> <li>• Të dhëna statistikore për përfituesit e shërbimeve sociale në territorin e bashkisë së Shkodrës.</li> <li>• Hartëzimi i shërbimeve sociale.</li> <li>• Shërbime të përkujdesjes alternative sipas standarteve të përcaktuara në ligj.</li> <li>• Realizim i aktiviteteve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese me publikun e gjerë për promovimin e shërbimit të kujdestarisë dhe kulturës së solidaritetit ndaj fëmijëve dhe familjeve në nevojë si dhe fëmijëve në kujdes rezidencial.</li> <li>• Ulje e numrit të fëmijëve në insitucionet rezidenciale.</li> <li>• Ulje e numrit të fëmijëve në situatë rruge.</li> <li>• Familje të mundshme kujdestare të identifikuar.</li> <li>• Familje kujdestare të trajnuara për të ofruar shërbimin e kujdestarisë.</li> </ul>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	

Fëmijët pa kujdes prindëror Familjet kujdestare Familjet në vështirësi social-ekonomike Institucionet publike Organizatat Familjet dhe fëmijët në situatë rruge					Bashkia Organizatat Institucionet publike Komuniteti						
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>											
	Operativ e	Paga	Sigurim e	Operativ e							
	Kapitale						Burimi i financimit:	Transfer ta	Tarifat	Donato r	Tjera
	Shuma						000/lek				
f) <b>Periudha e zbatimit</b> janar - dhjetor 2016					g) <b>Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimit social, strehimit dhe shëndetit publik Save the children						



Nr. 20	<b>Projekti: P10.F2.O3.A10</b> Bashkëpunimi me Fondacionin "Shpresë për botën", Shtëpinë e foshnjës dhe Shtëpinë e Fëmijës Shkollor".	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  Funkzioni:P10.F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
<b>Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>					
<b>i. Situata ( Shpego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)</b>					
<p>Shtëpia e foshnjës ofron shërbim rezidencial për foshnjët dhe fëmijët e braktisur, jetimë biologjik ose social. Gjithashtu ofron shërbim ditor për foshnjët e fëmijët në nevojë. Shërbimet e ofruara janë nga më të ndryshmet duke filluar nga trajtimi mjekësor, psikosocial për foshnjët, këshillim për nënat, etj.</p> <p>Kapaciteti i këtij institucioni është 35 dhe aktualisht numri i fëmijëve që marrin shërbim në këtë institucion është 11.</p> <p>Ndërsa "Shtëpia e fëmijës Shkollor" ofron shërbim rezidencial për fëmijët e moshës 6 -18 vjeç. Kategoritë e fëmijëve janë kryesisht fëmijë të braktisur, fëmijë që vijnë nga familje të varfra dhe jetimë biologjik. Fëmijët marrin shërbime të tilla siç janë: mirërritja dhe edukimi, shërbimi psikosocial, mjekësor, integrimi në komunitet, rikthim pranë familjeve biologjike, ndjekje të rasteve pas daljes nga insitucioni, veprimtari te tjera edukuese dhe argëtuese.</p> <p>Kapaciteti i shtëpisë së fëmijës është 70 dhe aktualisht numri i fëmijëve që marrin shërbim në këtë institucion është 35.</p> <p>Për ofrimin sa më të mirë të shërbimeve ndaj fëmijëve dhe krijimin e një atmosfere sa më të këndshme dhe sa më të përshtatshme për çdo grup-moshë që jeton në secilin institucion të përkujdesit rezidencial, me mbështetjen e fondacionit "Shpresë për botën", mendohet të organizohen festimet e festave zyrtare, festimet e ditëlindjeve të secilit fëmijë dhe gjithashtu t'i plotësohen nevojat specifike të fëmijëve.</p>					
<b>ii. Synimi i projektit</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë institucionalizimin e bashkëpunimit midis bashkisë së Shkodrës dhe fondacionit "Shpresë për botën".</li> <li>- Synojmë krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për foshnjët dhe fëmijët që janë të sistemuar në institucionet e përkujdesit rezidencial.</li> </ul>					
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Organizime për kremtimin e festave ndër vjetore në Shtëpitë e fëmijëve.</li> <li>▪ Mbështetje me transport për realizimin e takimeve të fëmijëve me familjet biologjike me qëllim përmirësimin dhe forcimin e marrëdhënies prind-fëmijë.</li> <li>▪ Furnizim me veshmbathje sipas nevojave të fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës Shkollor/ furnizim me pampers sipas nevojave që ka Shtëpia e Foshnjës, në mënyrë që të ndihmohet në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar për mirërritjen e fëmijëve të këtyre institucioneve.</li> <li>▪ Organizimi i festave të ditëlindjeve të fëmijëve në dy institucionet dhe blerja e dhuratave të ndryshme për ta.</li> <li>▪ Organizimi i aktiviteteve të ndryshme me fëmijët e Institucioneve.</li> <li>▪ Rikonstruksion i ambjentëve të Shtëpisë së Foshnjës/ Shtëpisë së fëmijës Shkollore.</li> <li>▪ Mbështetje për nevoja emergjente për Shtëpinë e fëmijës.</li> <li>▪ Hartimi i projekteve të veçanta që mund të paraqiten nga Shtëpia e Fëmijës ose projekte që mund të paraqiten nga vetë fondacioni për Shtëpinë e fëmijës.</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i shërbimit të përkujdesjes, mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve të Shtëpisë së Foshnjës dhe Shtëpisë së Fëmijës Shkollor, Shkodër.</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Insitucioni Shtëpia e Foshnjës Insitucioni Shtëpia e fëmijës Shkollor Bashkia Fëmijët e sistemuar në insitucionet e përkujdesit Familjet e fëmijëve të sistemuar në institucione		Fondacioni "Shpresë për botën" Bashkia e Shkodrës			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
Burimi i financimit:		Transferta	Tarifat	Donator	Tjera
000/lekë					
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  janar - dhjetor 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimeve sociale, strehimit dhe shëndetit publik Fondacioni "Shpresë për botën" Stafi i Shtëpisë së Foshnjës Stafi i Shtëpisë së Fëmijës Shkollor			

Nr. 21	<b>Projekti: P10.F2.O4.A1</b> "Lojra Popullore Fest, edicioni 9-të"	<b>Lloji i programit; P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale</b> Funkzioni:P10.F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>					
i. Situata					
"Lojra Popullore Fest" është një aktivitet dy ditor me karakter social-kulturor për të rinjtë. Është viti i nëntë që realizohet ky aktivitet, i cili tashmë mund të themi se është bërë traditë për qytetin e Shkodrës. Këtë vit do ketë pjesëmarrje edhe më të madhe, për shkak të shtrirjes territoriale të bashkisë së re të Shkodrës. Ky aktivitet do realizohet në amfiteatrin natyror Ana e Malit, Oblikë.					
ii. Synimi i projektit					
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë përfshirjen e të gjithë njësive administrative të bashkisë së Shkodrës, nëpërmjet përfaqësimit nga të rinjtë e këtyre njësive.</li> <li>- Aktiviteti synon të pasurojë jetën social kulturore të të rinjve dhe t'i njohë ata me traditat tona kombëtare me anë të performimeve të këngëve, valleve dhe lojrave popullore.</li> </ul>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përcaktimi i kriterëve pjesëmarrëse në këtë aktivitet</li> <li>▪ Përzgjedhja e trupave kandidate për pjesëmarrje</li> <li>▪ Ngritja e bashkëpunimit me trupat e përzgjedhura</li> <li>▪ Përgatitja e ambientit ku do zhvillohet aktiviteti: skena, sigurimi i nevojave bazë.</li> <li>▪ Zhvillimi i aktivitetit</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjithëpërfshirje dhe promovim i të rinjve</li> <li>• Promovimi i vlerave dhe traditave kulturore të njësive administrative të bashkisë së Shkodrës.</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Komuniteti Institucionet publike Organizatet			Bashkia Organizatet Komuniteti		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Honorare për trupat pjesëmarrëse (10x5)	50.0		50	
A.2	Transport	30.0		30	
A.3	Juria (4x5)	20.0		20	
A.4	Kryetar jurie	7.0		7	
A.5	2 konferencierë (2x1)	20.0		20	
A.6	Skenografi	50.0		50	
A.7	Diploma	5.0		5	
A.8	Të tjera	27.3		27.3	
<b>Shuma</b>		<b>209.3</b>		<b>209.3</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Prill 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimit social,shëndetit publik dhe strehimit Stafi i organizatës The Door Drejtorja e financës		



Nr. 22	<b>Projekti: P10.F2.O4,A2.</b>  Qendër multidisiplinare socio - mjekësore	<b>Lloji i programit; P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale</b>  Funkzioni:P10.F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
i. Situata						
<p>Në territorin e bashkisë së Shkodrës ofrohen një sërë shërbimesh për komunitetin rom dhe egjiptian, si një ndër komunitetet me problematika të shumta. Këto shërbime ofrohen nga institucionet publike dhe organizatat. Vendodhja e të gjitha institucioneve dhe organizatave, është larg këtij komuniteti dhe shumë shpesh ky komunitet nuk përfiton nga të gjitha shërbimet e ofruara në territor.</p> <p>Në kuadër të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve, projekti "Qendër multidisiplinare sociale – mjekësore për komunitetin rom dhe egjiptian", do ndërtohet, do funksionojë dhe do ofrojë shërbimet, brenda komunitetit rom dhe egjiptian, me qëllimin kryesor, ofrimin e shërbimeve sa më cilësore dhe ritjen e numrit të përfituesve.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë integrimin e komunitetit rom dhe egjiptian dhe fëmijëve të këtij komuniteti, si një kategori në vështirësi social-ekonomike.</li> <li>- Synojmë sigurimin e shërbimit shëndetsor bazë për fëmijët rom dhe egjiptian.</li> <li>- Synojmë përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit rom dhe egjiptian.</li> <li>- Synojmë krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për ofrimin e shërbimeve për këtë komunitet dhe ofrim të hapësirave për socializim dhe zhvillim aktivitetesh të ndryshme.</li> </ul>						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerri për të prodhuar rezultate) <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shërbime edukuese mjekësore dhe shëndetsore</li> <li>▪ Qendër ditore për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian</li> <li>▪ Aktivitete edukuese si: aktivitete letrare, krijuese, lojra dhe sporte të ndryshëm, etj.</li> <li>▪ Këshillim juridik</li> <li>▪ Kurse kundër analfabetizmit</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Integrimi i komunitetit rom dhe egjiptian</li> <li>• Ofrim të shërbimeve shëndetsore bazë për komunitetin rom dhe egjiptian.</li> <li>• Ulja e numri të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve analfabetë, në këtë komunitet.</li> <li>• Krijimi i hapësirave të përshtatshme për shërbime dhe aktivitete të ndryshme.</li> <li>• Përmirësimi i cilësisë së jetës për komunitetin rom dhe egjiptian.</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Komuniteti rom dhe egjiptian			Bashkia Organizata Malteser			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo:		
				Paga, sig	operative	kapitale
A.1						
	<b>Shuma</b>					
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit Stafi i organizatës Malteser Stafi i drejtorisë së urbanistikës			

Nr. 23	<b>Projekti: P10.F2.O4.A3.</b> Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian	<b>Lloji i programit; P10. Strehimi dhe Shërbimet Sociale</b>  Funksioni: P10.F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, PAN-të, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>					
i. Situata					
Komuniteti rom dhe egjiptian, është ndër grupet më të varfra, më të marginalizuara dhe më të përjashtuara që jetojnë në të gjithë Shqipërinë, përfshi edhe në qytetin e Shkodrës. Romët dhe egjiptianët përballen me pengesa direkte dhe indirekte në qasjen në shërbimet sociale, shëndetësore, publike, etj. Studimet tregojnë se niveli i varfërisë të këtij komuniteti, është dy herë më i lartë sa shumica e popullsisë së vetë komunitetit. Frekuentimi i ulët i shkollës dhe braktisjes shumë herët, pa përfunduar arsimin e detyruar, janë rezultat i nivelit të ulët arsimor, dhe më konkretisht analfabetizmit dhe për pasojë edhe nivelit të ulët ekonomik të këtij komuniteti.					
ii. Synimi i projektit					
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë të promovojmë fuqizimin ekonomik dhe social të komunitetit rom dhe egjiptian nëpërmjet standartizimit të një qasje të re inovative dhe të integruar në nivelin politik dhe programim dhe të ofrojë modele të integruara të përfshirjes sociale në nivel vendor.</li> <li>- Synojmë të përmirësojmë aksesin në shërbime dhe respektimin e të drejtave njerëzore për komunitetet vulnerabël si edhe komuniteti rom dhe egjiptian.</li> <li>- Synojmë të kontribuojmë në fuqizimin ekonomik dhe social të komunitetit rom dhe egjiptian.</li> </ul>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerri për të prodhuar rezultate) <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Krijimi i modeleve të reja dhe iniciativave për rritjen e mundësive për punësim të komunitetit rom dhe egjiptian.</li> <li>▪ Krijimi i lehtësirave për bashkëpunim (horizontal, vertikal) ndërmjet institucioneve publike, organizatave, etj.</li> <li>▪ Fuqizim/ngritje të kapaciteteve.</li> <li>▪ Krijimin e mekanizmave mbështetëse për personat që jetojnë në kushte ekstreme varfërie.</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Integrimi i komunitetit rom dhe egjiptian</li> <li>• Fuqizimi socio-ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian.</li> <li>• Krijimi i aksesit në shërbime për komunitetin rom dhe egjiptian.</li> <li>• Përmirësimi i cilësisë së jetës për komunitetin rom dhe egjiptian.</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Komuniteti rom dhe egjiptian		UNDP Bashkia			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1					
	<b>Shuma</b>				
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë shërbimeve sociale, shëndetit publik dhe strehimit Stafi i UNDP-së			

Nr. 24	<b>Projekti: P10.F3.O1.A1.</b> Ngritja dhe vendosja në funksion e 5 Qendrave Sociale Komunitare "Për Familjen"	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale <b>Funksioni: P10.F3.</b> Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>				
i. Situata				
Në bashki mungojnë qendra sociale komunitare që ofrojnë shërbime sociale si këshillim, informim, orientim, etj. Familjet në nevojë, personat në vështirësi social-ekonomike nuk kanë shërbimet e nevojshme sociale, pranë komuniteteve ku ata jetojnë. Shërbimet komunitare mungojnë jo vetëm në lagjet kryesore apo qendrat e qytetit, por në territorin e bashkisë, ka lagje të reja, periferike të cilat kanë nevojë emergjente për ndërhyrje dhe shërbime sociale në komunitet. Bashkia e Shkodrës, do menaxhojë, asetet në dispozicion për mbulimin sa më të plotë të territorit me shërbime sociale dhe shpërndarjen e këtyre shërbimeve në komunitet, sipas nevojave të komunitetit.				
ii. Synimi i projektit				
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkia synon ngritjen dhe vendosjen në funksion të qendrave sociale komunitare "Për familjen", në çdo rajon të Shkodrës Çdo qendër komunitare do ofrojë informim, monitorim, këshillim, orientim dhe sipas nevojës shërbime të tjera komunitare, për familjet në nevojë.</li> <li>- Krijimi i një forme të re të ofrimit të shërbimeve sociale komunitare në territor.</li> <li>- Mbulimi dhe ofrimi i shërbimeve sociale në komunitet.</li> </ul>				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerni për të prodhuar rezultate)				
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Njoftimi, përgjedhja, dhe punësimi i dy punonjësve (psikolog/punonjës social) për çdo qendër.</li> <li>▪ Përgatitje e një pakete trajnuese dhe ofrimi i trajnimit për punonjësit e qendrave komunitare.</li> <li>▪ Përgatitja e rregullores së funksionimit të qendrave "Për familjen".</li> <li>▪ Ofrimi i shërbimeve të mirëmbajtjes për çdo qendër komunitare.</li> </ul>				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>• 5 Qendra Sociale Komunitare "Për Familjen" që ofrojnë shërbime në komunitet.</li> <li>• Ofrimi i shërbimeve si: informim, orientim, këshillim, etj., për komunitetin.</li> <li>• Përmirësim i shërbimeve sociale dhe si rrjedhim i situatës social-ekonomike të komunitetit.</li> </ul>				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt,financiarisht, etj.)</b>		
Komuniteti Organizatrat që veprojnë në territor Institucionet publike (DSHP, DAR, Zyra e punësimit, Qendra e formimit profesional, SHSSH, etj)		Bashkia Organizatrat Institucionet publike (DSHP, DAR, zyra e punësimit, Qendra e formimit profesional, SHSSH, etj.)Komuniteti		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
A.1 Për cdo qendër komunitare do punësohet një pun.soc dhe një psikolog. Në total 10 specialistë.			4 680	
A.2 Energji				228
A.3 Ujë				198
A.4 Mirëmbajtje				697
A.5 Pc				330
A.6 Printer				100
A.7 Mjete për pajisje zyre				215
<b>Shuma</b>		<b>6 448</b>	<b>4 680</b>	<b>1 123</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar - Dhjetor 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimit social, shëndetit publik dhe strehimit		

Nr. 25	<b>Projekti : P10.F3.O1. A2</b> Çerdhet	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  <b>Funksioni: P10.F3.</b> Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
i. Situata .		
<p>Në qytetin e Shkodrës ka 4 Çerdhe në varësi të Bashkisë së Shkodrës (çerdhja “1 Qershori, ”vendodhja tek Stadiumi, çerdhja”Perash”, vendodhja në Perash, çerdhja “Manush Alimani”, vendodhja Bahçja e Çakajve dhe çerdhja “10 Korriku”, vendodhja Rus). Çerdhja “10 Korriku” është marrë me qera, ndërsa tri çerdhet e tjera janë në pronësi të Bashkisë. Çerdhja “1 Qershori ”nuk është godinë në vete por është në një godinë të përbashkët me kopshtin “Bep Tusha”. Kjo çerdhe ka një kapacitet (nr. vendesh) 55 dhe numri mesatar i frekuentimit të fëmijëve është 53. Për ngrohjen e ambjenteve të çerdhes përdoret kaldaja e cila është e përbashkët me kopshtin, por kjo nuk është e mjaftueshme, prandaj për këtë arsye përdoret edhe gaz. Gazi përdoret edhe për gatim. Personeli i shërbimit në këtë Çerdhe, përbëhet prej 16 personash (1 përgjegjëse, 10 kujdestare, 1 infermiere, 1 guzhiniere, 1 n/guzhinire, 2 sanitare) shumica e të cilëve janë me arsim të mesëm, ndërsa 2 veta janë me arsim të lartë. Çerdhja “Perash” ka një kapacitet (nr. vendesh) për 45 vetë, por numri mesatar i frekuentimit është 43 fëmijë në ditë. Për ngrohjen e ambjenteve të kësaj çerdhe përdoren dru zjarri, ndërsa për gatim përdoret gaz. Personeli i kësaj çerdhe përbëhet prej 19 punonjësish (1 përgjegjëse, 11 kujdestare, 1 infermiere, 1 guzhiniere, 1n/guzhinire, 2 sanitare, 1 rrobalarëse, 1 roje) me një nivel të mesëm arsimimi me përjashtim të 3 punonjësve që janë me arsim të lartë. Çerdhja “Manush Alimani” është në pronësi të Bashkisë, është godinë 2 katëshe ku kati i parë është çerdhja ndërsa kati i dytë i zënë nga familjarë që në fillim të viteve 90. Kjo çerdhe ka një kapacitet prej 30 vendesh por numri mesatar i frekuentimit arrin deri në 25 fëmijë. Për ngrohjen e kësaj çerdhe përdoren dru zjarri. Për gatim përdoret gaz. Personeli i kësaj çerdhe përbëhet prej 10 personash (1 përgjegjëse, 5 kujdestare, 1 infermiere, 1 guzhiniere, 1 sanitare, 1 roje) me një nivel të mesëm arsimimi. Çerdhja “10 Korriku” është objekt i marrë me qera shumë vite përpara dhe për këtë është lidhur një kontratë mes të Administratës Kopshte e Çerdhe dhe familjes Hebovija (Bajri). Drejtoria e Çerdheve e formuar me vendim të K. B e ka gjetur këtë kontratë të firmosur në mes të palëve të lartpërmendur. Kontrata ka si objekt përdorimin e ambjenteve të katit të parë (2 dhoma, guzhine, banjo si dhe korridorin e kësaj hyrje. Kjo çerdhe frekuentohet nga një kontigjent prej 18– 20 fëmijësh. Personeli i kësaj çerdhe përbëhet prej 10 vetash (1 përgjegjëse, 5 kujdestarë, 1 infermiere, 1guzhinire, 1 sanitare, 1 roje). Për ngrohjen e kësaj çerdhe përdoret dru zjari, ndërsa për gatim gaz.</p> <p>Llogaritja e pagave të personelit të çerdheve bazohet tek struktura e vitit 2015 ku nga 59 punonjës 50 vetë e kanë pagën bruto mujore 22 000 lekë. Për të krijuar kushte sa më të përshtatshme në ambjentet e çerdheve për higjienën e tyre është domosdoshme blerja e materialeve të pastrimit, furnizimi me gaz për gatim. Për zyrat është e nevojshme furnizimi me kancelari e materiale të tjera zyre. Furnizimi me ushqime do të bëhet për 4 çerdhe. Çerdhet frekuentohen gjithsej nga 140 fëmijë. Për ushqyerjen e fëmijëve përgatitet menya ditore sipas normativave të caktuara, mbi bazën e të cilës hartohet situacioni dhe sipas ditë ngrënies del dhe kuota ditore. Kjo kuotë ditore është llogaritur mesatarisht 110 lekë në ditë. Për këtë arsye do të bëhet lidhja e kontratave me firmën fituese dhe njëkohësisht do të bëhet ndjekja e zbatimit të “Kontratës të furnizimit me ushqime”. Për krijimin e kushteve sa më të favorshme për qëndrimin e fëmijëve është e domosdoshme blerja e materialeve (inventar i imët) si tavolina, karrige, dyshekë etj.. Do të bëhet likuidimi i faturave të energjisë elektrike sipas kontratave respektive. Rishikimin e kontratave ekzistuese, kolaudimin e matësive si dhe rakordimin sistematik me OSHEE. Do të rishikohen të gjitha kontratat dhe lidhjen e kontratave të reja si dhe vendosjen e matësive të ujit për të gjitha çerdhet. Do të bëhet likuidimi i faturave të ujit sipas kontratave respektive. Lidhjen e kontratës për vendosjen e internetit. Ndjekjen e zbatimit të kontratës të furnizimit me dru nga komisioni që do të ngrihet nga drejtoria. Për krijimin e ambjenteve sa më të përshtatshme është e domosdoshme mirëmbajtja e zakonshme e ndërtesave si bojatisja e tyre, lyerja e ambjenteve të brendshme dhe të jashtme të çerdheve. Riparime të ndryshme do t’i bëhen aparateve dhe pajisjeve teknike për t’i mbajtur në gjendje të mirë pune. Ky shërbim do t’i bëhet në rast nevojë edhe pajisjeve informatike të zyrës. Për çerdhen “10 Korriku” i cili është objekt i marrë me qera do të bëhet rishikimi i kontratës ose lidhja e një kontrate të re me një objekt tjetër, sipas arsyeve të shpjeguara më sipër (tek përshkrimi i projektit). Çerdhja ”Perash” sipas përshkrimit të bërë më sipër (përshkrimi i projektit) e ka të domosdoshme rikonstruksionin e saj për këtë arsye është hartuar preventivi për rregullimin e çatisë dhe të mureve nga lagështira. Po kështu janë hartuar preventivat nga inxhinieri i Bashkisë për rikonstruksionin e 2 çerdheve të tjera (“Manush Alimani” dhe “1 Qershori”. Për të zëvendësuar pajisjet e amortizuara është e domosdoshme blerja e pajisjeve të reja. Pajisjet e blera të jenë brenda standarteve teknike. Do të vendoset interneti, dhe do të blehen pajisje zyre: 1 kompjuter dhe 2 karrige.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirsimin e infrastrukturës për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për qëndrimin e fëmijëve.</li> <li>- Përmirsimin e cilësisë së ushqimit, të kujdesit ndaj fëmijëve.</li> </ul>		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Procedurat per verifikimin e nevojave</li> <li>▪ Tenderimi</li> <li>▪ Shpenzimet sipas zërave</li> <li>▪ Shpenzimet për pagat dhe sigurimet e punonjësve</li> <li>▪ Materiale e shërb. zyre të përgjithshme</li> <li>▪ Furnizime me ushqime</li> <li>▪ Materjale te tjera</li> <li>▪ Energji elektrike, Ujë, Internet</li> <li>▪ Lënde djegese (dru zjarri)</li> <li>▪ Mirëmbajtje e zakonshme (Ndertesa)</li> <li>▪ Mirembajtje te aparateve te paisjeve teknike</li> <li>▪ Mirembajtje te paisjeve te zyrës</li> <li>▪ Qera salle</li> <li>▪ Transferta buxhetore per individe (kompensimet)</li> </ul>		



<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Rikonstruksion te çerdhes "Perash"</li> <li>▪ Rikonstruksion te çerdhes "1 Qershori"</li> <li>▪ Rikonstruksion te çerdhes "1 Manush Alimani"</li> <li>▪ Blerje paisje (orendi)</li> <li>• Blerje paisje zyre dhe vendosje interneti</li> <li>▪ Monitorimi i procesit</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni ( shërbimet apo produktet që u dorezoni perfutuesve te synuar)</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Realizimin e të gjitha shërbimeve për krijimin e kushteve të përshtatshme në të gjitha çerdhet.</li> <li>• Rritjen e numrit te femijeve qe frekuentojne çerdhet.</li> </ul>						
<b>c) Aktoret e mundshem (grupetqelidhen me projektindheqendikohen)</b>			<b>d) Kontributet e mundshme ne projekt (kush do tekontribuoje per keteprojekt, financiarishtetj. )</b>			
Fëmijët në të gjitha çerdhet në Bashkinë Shkodër të kenë kushte sa më të favorshme për qëndrimin e tyre.			Bashkia e Shkodrës			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:			
			Paga, sig	operativ e	kapital e	Transfert e
A. 3.1	Shpenzimet per pagat dhe sigurimet e punonjesve		20 993			
A. 3.2	Materjale e sherb. zyre te pergjithshme			1 130		
A. 3.3	Furnizime me ushqime			4 000		
A.3. 4	Materjale te tjera			400		
A.3. 5	Energji elektrike			650		
A. 3.6	Uje			939		
A. 3.7	Internet			30		
A.3.8	Lende djegese (dru zjarri)			400		
A. 3.9	Mirembajte e zakonshme (Ndertesa)			400		
A. 3.10	Mirembajtje te aparateve te paisjeve teknike			60		
A. 3.11	Mirembajtje te paisjeve te zyres			30		
A. 3.12	Qera salle			360		
A. 3.13	Transferta buxhetore per individe (kompensimet)				84	
A. 3.14	Rikonstruksion te çerdhes "Perash"			400		
A. 3.15	Rikonstruksion të çerdhes "1 Qershori"			200		
A. 3.16	Rikonstruksion të çerdhes "1 Manush Alimani"			200		
A. 3.17	Blerje paisje (orendi)				390	
A. 3.8	Blerje paisje zyre dhe vendosje interneti				140	
	<b>Totali</b>	<b>30 806</b>	<b>20 993</b>	<b>9 199</b>	<b>530</b>	<b>84</b>
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2016			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Çerdheve			



Nr. 26	<b>Projekti: P10.F3.O1.A3</b> Shërbimi i Kujdestarisë Familjare	<b>Lloji i programit; P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet Sociale  <b>Funksioni: P10.F3.</b> Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>				
i. Situata				
Shërbimi i kujdestarisë është një shërbim i ri në të gjithë territorin shqiptar, shërbim i domosdoshëm për mirëritjen dhe zhvillimin e fëmijëve në risk. Duke qenë një eksperiencë akoma e re, ka nevojë për vëmendje dhe asistencë të veçantë për çdo hallkë që është e përfshirë në këtë shërbim; institucioni-fëmija-familja. Në qytetin e Shkodrës, shërbimi i kujdestarisë ka filluar zbatimin në vitin 2013 me rastet e familjeve kujdestare me lidhje gjaku. Ndërsa në vitin 2015, janë zbatuar rastet e para (dy raste) të familjeve kujdestare pa lidhje gjaku. Gjatë zbatimit të procedurave për këto raste janë ndeshur shumë vështirësi. Duke qenë një shërbim i ri, me shumë përgjegjësi, ku në qendër të këtij shërbimi është mirëqenia dhe interesi më i lartë i fëmijës, është e nevojshme vëmendje dhe asistencë e veçantë në zbatimin e këtij shërbimi, nga të gjitha institucionet publike e private.				
ii. Synimi i projektit				
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë zbatimin e shërbimit të kujdestarisë sipas legjislacionit në fuqi, si një mundësi më e mirë për fëmijët në situatë rreziku.</li> <li>- Synojmë të ndërgjegjësojmë komunitetin mbi mundësinë e ofrimit të shërbimit të kujdestarisë, si një nga mënyrat më efektive për mirëritjen e fëmijëve të neglizhuar apo të braktisur.</li> </ul>				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fuqizimin e strukturave të shërbimeve sociale në menaxhimin e gjithë procesit të kujdestarisë që nga identifikimi, selektimi, trajnimi i familjeve kujdestare, ndjekja e vendosjes së fëmijës në kujdestari dhe përshtatja me familjen kujdestare.</li> <li>▪ Krijimin e një grupi ekspertesh që do trajnojnë në vijim gjithë punonjësit socialë të përfshirë në këtë iniciativë</li> <li>▪ Ndërhyrje në fuqizimin e familjeve me qëllim parandalimin apo re-integrimin e fëmijëve nga kujdesi rezidencial</li> <li>▪ Advokim për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe procedurial për shërbimin e kujdestarisë</li> <li>▪ Fushata sensibilizimi</li> <li>▪ Përgatitje të fletëpalosjeve për ndërgjegjësim dhe informim të komunitetit</li> </ul>				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritje e kapaciteteve në ofrimin e shërbimit të kujdestarisë</li> <li>• Rritje e numrit të familjeve të mundshme kujdestare</li> <li>• Përmirësimi i situatës së fëmijëve në rrezik</li> <li>• Fuqizim i familjeve biologjike të fëmijëve</li> <li>• Deinstitutionalizimi</li> </ul>				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Komuniteti Institucionet publike Organizatrat			Bashkia Organizatrat Institucionet publike Komuniteti	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
A.1	Dizenjimi, formatimi dhe botimi i fletëpalosjeve			100
Shuma		<b>100</b>		<b>100</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> janar - dhjetor 2016		<b>g) Përgatitja dhe ndjekja e realizimit të projektit:</b> stafi i drejtorisë së shërbimit social, shëndetit publik dhe strehimit stafi i institucioneve rezidenciale organizatat		

Nr. 27	<p><b>Projekti: P10.F4.O1. A1.</b></p> <p>Projekti "Shpresa" për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe</p>	<p><b>Llojet e programit: P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet sociale</p> <p><b>Funksioni:P10.F4.</b> Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.</p>
<p><b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b></p>		
<p>i. Situata</p>		
<p>Projekti Shpresa, është një organizatë e licencuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAN-të e braktisur nga familja dhe të deinstitutionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1995. Projekti "Shpresa" ka 7 shtëpi-familje, të shpërndara në komunitet dhe aktualisht marrin shërbim 58 persona me aftësi ndryshe.</p> <p>Projekti "Shpresa", duke ofruar shërbime alternative për personat me aftësi ndryshe, të cilët janë pa asnjë përkujdes dhe interesim familjar, dhe me problematika të ndryshme, ka nevojë për mbështetje financiare dhe vëmendje të shtetit. Mbështetja e projektit "Shpresa" është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi ndryshe dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike.</p> <p>Në vitin 2015, Bashkia e Shkodrës, projektit "Shpresa", i ka mbuluar vetëm fondin për paga dhe sigurime shoqërore për 24 punonjës të personelit dhe nuk ka mbuluar kuotën ushqimore për PAN-të rezidenciale, pavarësisht kërkesës së projektit "Shpresa" të miratuar në buxhetin e shtetit, si grant i kushtëzuar për vitin 2015.</p>		
<p>ii. Synimi i projektit</p>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë ofrimin e shërbimeve alternative për PAN-të, si shërbimin e deinstitutionalizimit dhe parandalimin e institucionalizimit për PAN-të në rrezik, në shtëpi – familjet e projektit "Shpresa" sipas standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi ndryshe.</li> <li>- Synojmë t'i japim siguri dhe jetëgjatësi shërbimeve alternative pranë projektit "Shpresa" për PAN-të e braktisur dhe pa përkujdes familjar dhe në vështirësi ekonomiko-sociale.</li> </ul>		
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)</p>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kërkesa nga projekti "Shpresa" për mbështetje me fond për vitin 2016.</li> <li>▪ Parashikimi i fondit për projektin "Shpresa" në buxhetin e shtetit për vitin 2016, nga ministria e linjës.</li> <li>▪ Nënshkrimi i marrëveshjes midis bashkisë Shkodër dhe projektit "Shpresa" për fondin e parashikuar dhe lëvrimin e tij.</li> <li>▪ Përgatitja e dokumentacionit nga projekti "Shpresa" dhe sjellja e dokumentacionit pranë zyrës së shërbimit social, cdo fillim muaji. Paga e punonjësve të projektit "Shpresa" janë të llogaritura sipas sipas Vendimit nr. 690, datë 09.10.2012 "për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.77, datë 23.06.2009 të Këshillit të Ministrave "për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar". Gjithashtu kuota ushqimore e parashikuar për personat që jetojnë në këto shtëpi-familje të projektit "Shpresa", është e llogaritur sipas Udhëzimit nr. 5, datë 01.08.2012 "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror". Aktualisht në shtëpitë-familje të projektit "Shpresa" jetojnë 58 persona me aftësi ndryshe, nga të cilët 33 prej tyre përfitojnë pensionet e invaliditetit, për të cilët nuk kërkohet kuotë ushqimore nga organizata. 25 persona janë pa pensione invaliditeti për shkak të problematikave dhe mungesave të dokumentacionit. Ne baze të udhëzimit Nr.5 datë 1.8.2012 , Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime , duke u mbështetur në pikën 4 të nenit të kushtetutës së Republikës të Shqipërisë në zbatim të nenit 24 të ligjit 9355 , datë 10.3.2005, konkretisht pika d ku përcakton: kuota ushqimore për personat e vendosur në qendrat e zhvillimit është 340 lekë në ditë. ( 365 ditë x 25 persona x 340 leke/ditë = 3102500 leke/vit)</li> <li>▪ Përgatitja e relacionit dhe shkresës përcjellëse për lëvrimin e fondit, për drejtorinë e financës.</li> <li>▪ Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve në projektin "Shpresa".</li> </ul>		
<p><b>b) Rezultatet që prisni</b></p>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësim i shërbimit të ofruar për PAN-të që jetojnë në shtëpi-familjet e projektit "Shpresa".</li> <li>• Parandalimi i institucionalizimit të personave me AN.</li> <li>• Mbështetje afatgjatë e sigurtë për klientët që jetojnë në shtëpi – familjet e projektit "Shpresa".</li> <li>• Bashkëpunim i ngushtë me organizatën projekti "Shpresa".</li> <li>• Përmirësim i situatës së PAN-ve të qytetit të Shkodrës, që janë të braktisur nga familja, duke i sistemuar në projektin "Shpresa".</li> </ul>		
<p><b>c) Aktorët e mundshëm</b></p>	<p><b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b></p>	
<p>PAN-të që jetojnë në shtëpi-familjet e projektit "Shpresa" Komuniteti Institucionet publike Organizatata</p>	<p>MMSR Bashkia Projekti "Shpresa"</p>	

<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		<b>Totali (000 lekë)</b>	<b>Nga kjo:</b>		
			<b>Paga, sig</b>	<b>Operative</b>	<b>Transferte</b>
A.1	Paga për 24 kujdestarë	12 048.552			12 048.552
A.2	Paga për admistratorin, psikologun klinik dhe infermierin	1 892.856			1 892.856
A.3	Fond për orë shtesë				
A.4	Kuota ushqimore	3 102.500			3 102.500
	<b>Shuma</b>	<b>17 043.908</b>			<b>17 043.908</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> janar - dhjetor 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimit social dhe strehimit Stafi i drejtorisë së financës Projekti "Shpresa"			





Nr. 28	<b>Projekti: P10.F4.O1.A2.</b> "Asnjë Fëmijë Jashtë"	<b>Llojet e programit: P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet sociale  <b>Funksioni: P10.F4.</b> Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>					
i. Situata					
<p>"Asnjë fëmijë jashtë" është një aktivitet social-kulturor që organizohet që nga viti 2005, me rastin e festave të fundvitit. Ky aktivitet organizohet nga organizata "The door" me mbështetjen e bashkisë së Shkodrës. Protagonistë të këtij aktiviteti janë fëmijët e familjeve në vështirësi social-ekonomike. Nisur nga eksperiencia e viteve të shkuara, ky aktivitet përfshin të gjitha kategoritë e fëmijëve të familjeve në vështirësi të theksuara social-ekonomike, gjithashtu përfshin aktivisht PAN-të duke i përgatitur në fusha të ndryshme artistike si; muzikë, recitim, vegla muzikore, teatër, etj..</p>					
ii. Synimi i projektit					
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjithpërfshirje e fëmijëve të familjeve në nevojë, në aktivitetet social-kulturore.</li> <li>- Synojmë të ndikojmë në përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve të qytetit të Shkodrës dhe familjeve tyre.</li> <li>- Bashkëpunim dhe mbështetje të organizatave që veprojnë në qytetin e Shkodrës.</li> </ul>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Thirrja për pjesëmarrje në "Asnjë fëmijë jashtë".</li> <li>▪ Përgatitja e fëmijëve për pjesëmarrjen në "Asnjë fëmijë jashtë".</li> <li>▪ Kryerja e procedurave për lëvrimin e fondit.</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i situatës së fëmijëve dhe familjeve në vështirësi soc-ek në qytetin e Shkodrës.</li> <li>• Bashkëpunim i afërt dhe mbështetje e organizatave.</li> <li>• "Asnjë fëmijë jashtë", një aktivitet social – kulturor gjithpërfshirës me pjesëmarrje aktive të fëmijëve të bashkisë Shkodër.</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Komuniteti Institucionet publike Organizatave			Bashkia Organizatave Komuniteti		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		<b>Totali (000 lek)</b>	<b>Nga kjo:</b>		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Honorare per inspektorët e muzikës (10x4)	40		40	
A.2	Transmetim/montazh	50		50	
A.3	Transport	30		30	
A.4	2 Konferencierë (2x7)	14		14	
A.5	Punëtorë skene (10x3)	30		30	
A.6	Diploma (25x0.1)	2.5		2.5	
A.7	Fonia	25		25	
A.8	Materiale promocioni	10		10	
A.9	Dhurata per femije	30		30	
A.10	Të tjera	34.725			
<b>Shuma</b>		<b>266.225</b>		<b>266.225</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> dhjetor 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së shërbimit social,shëndetit public dhe strehimit Stafi i organizatës The Door Drejtorja e financës			

Nr. 29	<b>Projekti: P10.F4.O1. A3.</b> Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe”	<b>Llojet e programit: P10.</b> Strehimi dhe Shërbimet sociale  <b>Funksioni:P10.F4.</b> Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>						
i. Situata						
<p>“Trupa muzikore e PAN-ve” përbëhet nga një grup të rinjsh me aftësi ndryshe, të gjithë ish nxënës të shkollës special “3 Dhjetori”.</p> <p>Kjo trupë muzikore angazhohet angazhohet në aktivitete të ndryshme që realizohen nga organizata The door, por jo vetëm. Lista e aktiviteteve të parashikuara për pjesëmarrje gjatë vitit 2016 është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Festa e karnavaleve, shkurt 2016</li> <li>Festa e Lojra Popullore fest, edicioni nëntë, prill 2016</li> <li>Festimi i 10 vjetorit të koncertit të parë në teatrin Migjeni, qeshor 2016</li> <li>Asnjë fëmijë jashtë, dhjetor 2016.</li> </ul>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Synojmë promovimin dhe gjithpërfshirjen e PAN në aktivitete social-kulturore</li> <li>- Synojmë sensibilizimin e familjeve të PAN-ve dhe komunitetit, për aftësitë e veçanta dhe mundësitë e kësaj kategorie</li> </ul>						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zhvillimi i provave sipas një kalendari të paracatur gjatë gjithë vitit</li> <li>▪ Pjesëmarrja në aktivitetet e lartpërmendura dhe jo vetëm</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Promovimi dhe gjithpërfshirja e PAN-ve në aktivitetet social - kulturore</li> <li>• Sensibilizimi i komunitetit dhe familjeve të PAN-ve</li> <li>• Përmirësimi i cilësisë së jetës social-kulturore të PAN-ve</li> </ul>						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Personat me aftësi ndryshe Familjet e personave me aftësi ndryshe Komuniteti Institucionet publike Organizatat			Bashkia Organizatat Komuniteti			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>			Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
Nr.20	<b>Projekti: P11.F1.O1.A20</b> Përmirësimi i kushteve teknike të ambjenteve të ruajtjes të koleksionit të Galerisë së Arteve Shkodër.	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F1.</b> Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
Një institucion i cili konservon dhe promovon një fond muzeor duhet të garantojë norma ligjore të sigurisë ambientale të lidhura me koleksionet dhe objektet muzeale të vendosura; kushtet ambientale optimale për punonjësit që kryejnë aty funksionet e tyre si dhe për specialistët që shfrytëzojnë fondin muzeal. Ruajtja e veprave të artit në magazinat aktuale të GASH duhet të përmbushë standardet që kërkohet për objekte të kësaj natyre. Është një problem kompleks i lidhur sa me hapsirën e pamjaftueshme, por edhe me mungesën e pajisjeve teknike që do të bënin të mundur nivele të standartizuara të konservimit dhe të ruajtjes të veprave të artit ndaj dëmtimeve fizike, parametrave të temperaturës, lagështirës, ajrosjes etj.				
ii. Synimi i projektit				
Pajisja e magazinave me rafta për depozitimin e veprave të artit, instalimi i sistemit të aspirimit dhe kondicionimit në ambientet ku ruhen ato, synon normalizimin e problemit të standarteve teknike të ruajtjes së fondit muzeor, detyrim ligjor për institucione të kësaj natyre.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
Hartimi i një projekti të detajuar me specialistë të fushës. Ndjekja me rigorozitet e proçesit të zbatimit të projektit të miratuar				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
Krijimi i kushteve normale teknike për ruajtjen e fondit muzeor në aspektin e standarteve të temperaturës, lagështirës, ajrosjes, dëmtimeve fizike etj.				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Institucioni (në funksionin e tij si mbledhës, konservues dhe promovues i trashëgimisë kulturore)			Bashkia e Shkodrës	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:	
A1	Rafta metalike per ruajtjen e koleksionit të veprave të GASH		Paga, sig	operative kapitale
A2	Projekt buxheti për Aspirim-Kondicionimin			120
		<b>541</b>		<b>541</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Zbatuesi, stafi i GASH		



**Shpenzime dhe Specifikime teknike****Rafte metalike për ruajtjen e koleksionit të veprave të GASH**

Mbështetur në Ligjin Nr. 9154 datë 06.11.2003 ( norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, Neni 41), kërkojmë që të prodhohen dhe montohen 6 rafte metalike për arkivën e GASH që do të instalohen në magazinat e godinës aktuale të galerisë.

Raftet duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

Përmasat:

290x280x60cm/200x280x60cm/250x280x60cm/250x280x60cm/135x280x60cm/260x280x60cm.

Lartësia e rafteve do të jetë 280 cm dhe do të kenë 3 plane (nivele) për depozitim pikturash. Thellessia e raftit do të jetë 60 cm.

Seicili nga raftet të jetë i komponueshëm i përbërë nga :4 rafte -në 3 pjesë të barabarta; 1 me dy pjesë të barabarta;1 me 4 pjesë të barabarta.

Pjesët përbërëse do të lidhen mes tyre me anë të bulonave.

Lartësia e niveleve do të jetë e lëvizëshme në lartësi sipas rastit (llojit të formateve të pikturave) pra jo fikse por të lëvizëshme lart-poshtë e të fiksueshme me anë të bulonave Niveli i parë i raftit do të jetë 10 cm mbi dyshemë.

Planet ku depozitohen pikturat do të jenë prej llamarine të zinkuar. Elementet e tjera të strukturës me hekur profil 30x30 mm.

Bulonat do të jenë të zinkuara. Rafti do të jetë i lyer me një dorë boje kundër ndryshkut dhe me dy duar boje zmalto.

Montimi i rafteve: Ato do të fiksohen në dyshemë dhe tavan me anë të stafave të posacme dhe taseleve.

Kosto e realizimit të rafteve metalike për magazinat:

**40 m2 x 3000 lekë/m2 =120.000 lekë**

**Projekt buxheti për Aspirim-Kondicionimin**

*SHENIM: Për përcaktimin e vlerës së detajuar të projektit në fjalë duhet përgatitur një projekt i mëtejshëm nga specialistë të fushës.*

Sipërfaqja e magazinave( 3 ambiente të ndara): 700 x 430 cm/325 x 430 cm/530 x 430 cm

Sip. totale 67 m2 x H 3.2 = 214 m3

1-Dhoma 30m2 x H3.2m= 96 m3

2-Dhoma 14m2 x H3.2m= 44.8 m3

3-Dhoma 23m2 x H3.2m= 73,6 m3

Nr	Përshkrimi	njësia	sasia	cmimi	vlera
1	Pajisje kondicionimi e tipit split mural me fuqi termike 13000 btu me kod : RAS-137SAV-E/ RAS-137SKV-E INVERTER	cope	3	105.560	316.680
2	Llamarinë e patermoizoluar	kg	120	284,8	30.576
3	Aspirator me prurje 2000 m3/h	cope	1	38.220	38.220
4	Reostat	cope	1	4.620	4.620
5	Grila alumini të tipit me 2 rreshta me përmasa 40x20 cm	cope	4	2.800	11.200
6	Tubacione flexibël të patermoizoluar	m	15	238	3.570
7	Grila të tipit tranzit	cope	3	5.460	16.380

Tot: 421.246 lekë

**Vlera totale e projektit: 421.000 + 120.00 lekë= 541.000 lekë**

Nr.21	<b>Projekti: P11.F1.01 .A21</b> Shërbimi i ndriçimit të Galerisë së Arteve.	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative  <b>Funksioni: P11.F1.</b> Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
Galeria e Arteve për vetë specifikën e punës që zhvillon, përdor dhe konsumon materiale ndriçimi të zakonshme në ambientet e punës për personelin (si zyra, magazina, etj), si dhe materiale më specifike siç janë spotet (ndriçues gjuajtës) për sallat e ekspozitave.				
ii. Synimi i projektit				
Sigurimi i kushteve normale në ambientet e punës për personelin si dhe parametra normale ndriçimi në sallat e ekspozimit gjatë zhvillimit të aktiviteteve.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
Testimi i tregut për mundësitë teknologjike që ofron. Ndjekja e hapave të mëtejshëm për procedurat e blerjes (prokurimit) të mallit.				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
Sigurohen kushte normale të punës për personelin dhe cilësi e mirë shërbimi ndaj publikut.				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Publiku, personeli i institucionit.			Bashkia e Shkodrës	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
A.1	Shpenzime për ndriçimin për vitin 2016			30
<b>Totali</b>		<b>30</b>		<b>30</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi GASH	

**Shpenzime për ndriçimin për vitin 2016**

- Lampa ekonomike të zakonshme për ambientet e punës 20 copë x200 4.000
  - Lampa spote-ndriçimi për sallat e ekspozimit 30 copë x 300 9.000
  - Neone+bazament+kabëll elektrik+kanalina+montim (për sallat eksp.)10 copëx 1500 15.000
  - Riparime pajisjesh zyre 2.000
- tot. **30.000 lekë**

Nr. 22	<b>Projekti: P11.F1.O1. A22</b> Shërbim për hostim dhe mirëmbajtje të faqes web	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative  <b>Funksioni: P11.F1.</b> Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
Galeria e Arteve e Shkodrës në përmbushjen me seriozitet profesional të funksioneve të veta promovuese dhe komunikuese ka ndërtuar prej disa vitesh faqen e saj në internet <a href="http://www.gashkoder.com">www.gashkoder.com</a> Hostimi dhe mirëmbajtja e përvitshme e saj është e domosdoshme.				
ii. Synimi i projektit				
Synojmë rritjen e nivelit profesional në administrimin dhe funksionimin e institucionit.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
Bashkërendimi i punës me zyrën e financës për përmbushjen në kohë të procedurës së blerjes së shërbimit.				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
Rritje e efikasitetit dhe përmirësim të cilësisë së punës së institucionit.				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
GASH, bashkëpunëtorët institucionalë me të cilët bashkëvepron, artistët, publiku.			Bashkia e Shkodrës	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo: Paga, sig	
A.1	Shpenzime për hostim dhe mirëmbajtje të faqes Web për vitin 2016		operative	kapitale
	<b>Shuma</b>	<b>15</b>	<b>15</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Gjatë vitit 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Stafi i Galerisë së Arteve, Shkodër	

Nr.23	<b>Projekti: P11.F1.O1.A23</b> Mobilimi me orendi për mjediset e Galerisë së Arteve Shkodër	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative  <b>Funksioni: P11.F1.</b> Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
Një pjesë e orendive të zyrës (rafte, karrige) të Galerisë së Arteve janë të amortizuara, të gjendur para kësaj situatë, është i domosdoshëm zëvendësimi tyre me rafte të rinj, për depozitimin e dosjeve, dokumentacionit, materialeve të tjera të punës administrative.				
ii. Synimi i projektit				
Përmirësimi i kushteve të punës për personelin si dhe kushteve të shërbimit për vizitorët.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
Specifikimi teknik Përbushja e procedurave të nevojshme për realizimin e blerjes së mallit				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
Krijimi i kushteve të përshtatshme të punës për punonjësit në funksion të zhvillimit efektiv të veprimtarisë së tyre.				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Stafi i Institucionit Komuniteti			Bashkia e Shkodrës	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo: Paga, sig	
A.1	Rafte dykapakësh për zyrë x 3 copë		operative	kapitale
A.2	Raft me sirtare			60
	<b>Shuma</b>	<b>80</b>		<b>80</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i GASH	

Nr.24	<b>Projekti: P11.F1.O1.A24</b> Zhvillimi i disa projekteve edukative me gjimnazet e qytetit.	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F1.</b> Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.	
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>			
i. Situata			
Ne mendojmë se në programet mësimore të shkollave të mesme flitet shumë pak për pjesën e historisë që ka të bëjë me diktaturën komuniste.			
Ajo trajtohet në një këndvështrim të caktuar dhe vendosja e nxënësve në kushtet e punës kërkimore, i jep mundësinë atyre të rivlerësojnë drejtë disa aspekte të historisë së dikaturës.			
ii. Synimi i projektit			
Edukimi i të rinjve mbi të shkuarën e regjimit komunist në Shqipëri dhe ndërgjegjësimi i tyre mbi të metat e atij regjimi.			
iii. Aktivitetet kryesore të projektit			
Nxënësit e shkollave të qytetit do të ndahen në grupe sipas klasave dhe do të zhvillojnë punë kërkimore mbi një temë të caktuar e cila ka të bëjë me zhvillimin e regjimit komunist dhe përfshin vitet '44-'91. Punimet e tyre do të prezantohen në sallën audio-vizuale të "Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës" dhe do të botohen në një vëllim përmbledhës.			
<b>b) Rezultatet që prisni</b>			
Nëpërmjet punës së tyre kërkimore të pavarur, nxënësit të jenë të aftë të evidentojnë të metat e regjimit komunist dhe të edukohen që ajo pjesë ishte ndër më të errëtat e historisë sonë dhe të mos përsëritet më.			
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Nxënës shkollash, mësues, prindër, historianë, studentë, qytetarë etj.		Bashkia e Shkodrës	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>			
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:
			Paga, sig
			operative
			kapitale
A.1	Informim i te rinjve		20
		<b>20</b>	<b>20</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit</b> Pjerin Mirdita	





Nr.25	<b>Projekti: P11.F1.O1.A25</b> Ekspozitë fotografike "Shkodra në diktaturën komuniste: personazhe dhe fakte"	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative <b>Funksioni: P11.F1.</b> Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Ndërtimi i një ekspozite të tillë ndihmon për të pasuruar hapësirat e "Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës" dhe gjithashtu rivlerëson aktivitetin anti-komunist të qytetarëve të Shkodrës.					
ii. Synimi i projektit					
Evidentimi i ngjarjeve dhe personazheve të lidhura me persekutimin komunist në qytetin e Shkodrës.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Krijimi i grupit të punës Kërkimi në arkiva Përzgjedhja e materialeve Printimi dhe prodhimi i tyre Përgatitja për shfaqje Prezantimi para publikut.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Rivlerësimi i dëshmimeve dhe fakteve të ndryshme, ndërgjegjësimi i brezave të rinj me të kaluarën, nëpërmjet së cilës synohet edukimi i tyre për të ardhmen.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Dëshmitarë të kohës, ish të burgosur politikë, nxënës shkollash, studentë, të rinj dhe të reja.		Bashkia e Shkodrës			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Stenda për ekspozim			20	
A.2	Fotografi			15	
A.3	Diçitura			12	
A.4	Panele shpjeguese			15	
	<b>Shuma</b>	<b>62</b>		<b>62</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>		<b>g) Përgatitja dhe ndjek realizimin e projektit</b>			
Gjatë vitit 2016		Pjerin Mirdita			

**Specifikime teknike të ekspozitës**

Artikulli	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefëta
Stenda për ekspozim	m <sup>2</sup> /forex	4	5 000	20 000
Fotografi	copë	30	500	15 000
Diçitura	Copë	30	400	12 000
Panele shpjeguese	m <sup>2</sup> /forex	5	3 000	15 000
<b>TOTALI</b>				<b>65 000</b>



Nr.26	<b>Projekti: P11.F1.O1. A26</b> Ekspozitë fotografike "Shkodra në Vitet '90"	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekracionale  <b>Funksioni: P11.F1.</b> Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Për momentin një ekspozitë e tillë në hapësirat e "Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës" mungon. Hapësirat janë të bollshme ku mund të shfrytëzohen mjaft mirë për pasurimin e mëtejshëm.					
ii. Synimi i projektit					
Risjellja në kujtesën e publikut dhe rivlerësimi i momenteve të protestave studentore të fillimit viteve '90 në Shkodër.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Ngritja e një grupi pune Kërkimi dhe përzgjedhja e materialeve në arkiva Printimi dhe prodhimi i tyre Prezantimi i punës për publikun.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Nëpërmjet rivlerësimit të momenteve kyçe të ndodhura gjatë viteve '90, ne synojmë të njohim brezin e ri me një pjesë të rëndësishme të historisë sonë dhe të evidentojmë protestat e popullit shkodran kundër diktaturës komuniste.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Dëshmitarë të kohës, ish të burgosur politikë, qytetarë, studentë, nxënës shkollash, të rinj dhe të reja.		Bashkia e Shkodrës			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Stenda për ekspozim			20	
A.2	Diçitura forex			12	
A.3	Panele shpjeguese			15	
	<b>Shuma</b>	<b>47</b>		<b>47</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit</b>			
Gjatë vitit 2016		Pjerin Mirdita			

**Specifikime teknike për ekspozitën**

Artikulli	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefë
Stenda për ekspozim	m2/forex	4	5 000	20 000
Diçitura forex	Copë	30	400	12 000
Panele shpjeguese	m2/forex	5	3 000	15 000
<b>TOTALI</b>				<b>47 000</b>

Nr. 27	<b>Projekti: P11.F1.O1.A27</b> "Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve"	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative  <b>Funksioni: P11.F1.</b> Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.			
<b>Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
<b>i. Situata ( Shpego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)</b>					
<p>Misioni          Aktiviteti pedagogjiko-edukativ, parashikon përfshirjen e studentëve të shkollave parauniversitare në një aktivitet sensibilizues për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore.          Për muzeun bashkëpunimi me shkollat e qytetit është një traditë e hershme që tenton të sensibilizojë dhe të edukojë kryesisht të rinjtë parauniversitarë me vlerat e së shkuarës. Formati i këtij aktiviteti ndryshon nga llojet e tjera. Në muzeun e Shkodrës ka shumë objekte që ndodhen në prani të faktorëve atmosferikë që rrezikojnë ekzistencën e tyre edhe sepse janë jashtë ndërtesës për arsye të mungesës së hapësirave, por kjo nuk ia zvogëlon aspak vlerën e tyre historike.          Studentët janë të ftuar të koordinojnë punën e tyre së bashku me stafin në kurimin e gjendjes së tyre fizike të jashtme. Këta objekte mund të jenë elementë ndërtimor, si kapitete, harqe, gurë dekorativ, mure, dyer, etj. Studentët pasi mësojnë për historikun dhe rëndësinë e tyre, janë më të motivuar, që duke iu referuar metodave udhëzuese konservative të përcjella nga stafi, të ndërhyjnë në këto objekte për përmirësimin e pamjes së tyre.          Shumë tekste shkollore apo mesazhe klishe nuk ofrojnë të kuptuarit llogjik sa i takon vlerave të trashëgimisë kulturore. Vetëm kontakti direkt, prekja e këtyre objekteve historike nxit shqetësimin për ardhmërinë e vlerave të trashëgimisë dhe do t'i bëjë ato të ndërgjegjshëm për fatin e objekteve dhe të ardhmërisë së tyre kulturore</p>					
<b>ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)</b>					
Përfshirja dhe edukimi i brezit të ri me rëndësinë e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe krijimi i një qëndrimi të ri ndaj këtyre vlerave.					
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do tendermerrni për të prodhuar rezultate)</b>					
Në bashkëpunim me stafin përcaktohet plani i punës dhe zonat e ndërhyrjes. Ndarja e detyrave, hapësirave dhe forcave të punës. Bashkëpunimi me institucionet mbështetëse të Bashkisë dhe me shkollat e sistemit parauniversitar. Prokurimi i materialeve të punës dhe atyre divulgative që përcjellin mesazhin e projektit, kapele, bluza, spatula, doreza, për largimin e likeneve, ujë të distiluar.					
<b>b) Rezultatet që prisni ( shërbimet apo produktet që u dorezoni përfuturësve të synuar)</b>					
Përmirësimi i kushteve të objektit/eve, ndërgjegjësimi, edukimi dhe përfshirja në konceptet e ruajtjes dhe ndërtimit të jetës kulturore.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Stafi i Muzeut, Bashkia e Shkodrës			Stafi i muzeut, Bashkia e Shkodrës, Drejtoria Arsimore Shkodër		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mesiperm (pika iii)</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>			<b>Totali (000 lek)</b>	<b>Nga kjo:</b>	
				<b>Paga, sig</b>	<b>operati ve</b>
A.1	25 bluza me stapim "18 Maj, Dita ndërkombëtare e Muzeumeve" dhe logon e muzeut dhe Bashkisë Shkodër			25	
A.2	25 kapele me të njëjtat karakteristika			12.5	
A.3	10 spatula profesionale metali			2.5	
A.4	10 spatula druri profesionale			2.5	
A.5	25 doreza pune			2.5	
A.6	Ujë i distiluar 10 bidonë dy litërsh			5	
Shuma			<b>50</b>	<b>50</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>		
18 Maj, 2016			Fatmir Juka		

Nr.28	<b>Projekti: P11.F1.O1.A28</b> Ekspozita "Salloni i vjeshtës "	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet reacionale  <b>Funksioni: P11.F1.</b> Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>						
i. Situata						
Ekspozita e arteve pamore "Salloni i vjeshtës" është një aktivitet i përvitshëm që zhvillohet në Galerinë e Arteve të qytetit të Shkodrës në gjysmën e dytë të muajit nëntor. Kjo ekspozitë është një nga aktivitetet më të rëndësishme të kalendarit vjetor të GASH, ashtu si dhe një ngjarje kulmore për të gjithë krijuesit e artit pamor të qytetit të Shkodrës. Numri në rritje i pjesëmarrësve pasqyron më së miri suksesin e një aktiviteti që në 2016 arrin në edicionin e tij të 10-të. Dy vitet e fundit është realizuar, akordimi i çmimeve fituese për krijimet më të spikatura të ekspozitës, duke ndihmuar rritjen e koleksionit të galerisë me vepra cilësore. Ekspozita, duke qenë pjesë e aktiviteteve që organizohen në kuadër të "Javës së Pavarësisë", kontribuon njëkohësisht në pasurimin e atmosferës festive të qytetit.						
ii. Synimi i projektit						
Synojmë evidentimin e arritjeve më të spikatura vjetore në gjinitë e pikturës, skulpturës, vizatimit, grafikës etj. Synojmë realizimin e një ekspozite me nivel cilësor artistik dhe me një pjesëmarrje të gjerë të krijuesve lokal dhe jo vetëm. Synojmë gjallërimin dhe pasurimin e jetës kulturore të qytetit të Shkodrës. Synojmë pasurimin e koleksionit të Galerisë së Arteve me vepra të një niveli të lartë profesional.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Përzgjedhja e kuratorit/ve) që do të bëjnë kurimin e ekspozitës. Komunikimi i njoftimeve, nëpërmjet internetit dhe mediave, për formatin, rregullat dhe kohën e realizimit të aktivitetit. Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promociionale. Ndërmarrja e hapave konkretë për realizimin e ekspozitës (grumbullim i veprave, selektim, montim, etj) Përgatitja e materialit të shtypur (katalog) që shoqëron eventin (fotografim i veprave, sistemim i materialit të shkruar, koordinim dhe kontroll i punës me entin botues). Organizimi i ceremonisë së hapjes së ekspozitës. Angazhimi sistematik i stafit në shërbimin ndaj vizitorëve në periudhën që ekspozita qëndron e hapur për publikun. Ndërtimi i kontakteve me institucionet e edukimit për organizimin e vizitave në galeri. Bashkërendim i punës me drejtorinë dhe zyrën e financës për përmbylljen e procedurave financiare me bashkëpunëtorët.						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
Realizimin e një ekspozite të arteve pamore të një niveli të lartë profesional. Prezantimin para publikut artdashës të risive dhe prurjeve më interesante të kërkimit artistik bashkëkohor lokal dhe jo vetëm. Përfshirjen e artistëve shkodranë në eksperiencën bashkëpunimi dhe konkurrimit. Pasurimin e koleksionit të GASH me vepra artistike cilësore.						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Artistë, specialistë të fushës, institucionet kulturore, spektatorët.			Bashkia e Shkodrës			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo:		
				Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Buxheti i promovimit dhe dokumentimit të aktivitetit			30		
A.2	Akomodim për të ftuarit (artistë dhe kuratorë arti) FJETJE			30		
A.3	Akomodim për të ftuarit (artistë dhe kuratorë arti) USHQIM			25		
A.4	Honorar për kuratorin			100		
A.5	Honoraret e komisionit për çmimet fitues			30		
A.6	Honorar për çmimin fitues			100		
A.7	Katalogu i ekspozitës (shtypi)			60		
A.8	Shërbime të dizajnit grafik për eventin			20		
A.9	Bileta udhëtimi			40		
A.10	Shpenzime për realizimin e ekspozitës			30		



		465		465	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i Galerisë së Arteve Shkodër			

**Pasqyra e shpenzimeve për realizimin e ekspozitës “Salloni i vjeshtës 2016”**

- 1-Buxheti i promocionit dhe dokumentimit të aktivitetit:  
 Prodhim ftesa, poster, poster në baner, njoftim në TV lokale etj. 30.000
- 2- Akomodim për të ftuarit (artiste, komision dhe kurator)  
 (5 dieta ditore të shpërndara gjatë gjithë periudhës përgatitore dhe realizimit)  
 -fjetje 10x 3.000 lekë 30.000  
 -ushqim 10 x 2.500 lekë 25.000
- 3- Honorar për kuratorin 100.000
- 4-Honoraret e komisionit për përcaktimin e çmimit fitues:  
 ( 3 persona x 10.000 ) 30.000
- 5- Honorar për çmimin fitues (vepra fituese kalon në pronësi të GASH) 100.000
- 6- Katalogu i ekspozitës (200 copë) shtypi 60.000
- 7- Shërbime të dizajnit grafik për eventin ( formulim grafik i katalogut, poster, fotografimi i veprave etj.) 20.000
- 8-Bileta udhëtimi (në rastin kur kuratori banon jashtë Shqipërisë) 40.000
- 9- Shpenzime për realizimin e ekspozitës (mure ndarës gipsi, lyerje, kornizime, materiale të ndryshme teknike, printime, etj) 30.000

*a-Shënim sqarues për honoraret:*

*Honoraret per komisionin e cmimeve dhe kuratorin marrin si bazë referimi:*

*- Personel- akademik kategoria prof/prof.as –paga mujore e pozic. 96.000*

*b- Kuratori i eventit mund të përzgjidhet, me aprovim të këshillit artistik, një profesionist i fushës me banim brenda ose jashtë Shqipërisë.*

Totali: 465.000 lekë

Nr.29	<b>Projekti: P11.F1.O1.A.29</b> Ekspozita personale e fituesit të "Çmimit Idromeno 2015", Lek Gjeloshi.	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative  <b>Funksioni: P11.F1.</b> Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
<p>Konkursi kombëtar i artit pamor për artistët e rinj "Çmimi Idromeno" organizohet çdo dy vjet nga Galeria e Arteve. Ai ka për objekt mbështetjen e artistëve të rinj në fushën e arteve pamore në realizimin dhe ekspozimin e kërtimeve të tyre individuale dhe krijimin e një platforme dinamike për të tërhequr vëmendjen e specialistëve dhe vlerësimin e publikut ndaj arritjeve më të mira të artit bashkëkohor shqiptar. Në realizimin e 4 edicioneve të deritanishme të Çmimit Idromeno, në vitet 2008, 2010, 2013, 2015, kanë bashkëpunuar si kuratorë apo anëtarë të komisioneve të vlerësimit studiues, historian arti dhe personalitete të shquara të artit shqiptar. Njëkohësisht një brez i ri artistësh të talentuar janë prezantuar me veprat e tyre para publikut shkodran.</p> <p>Çmimi Idromeno konsiston në një shpërblim financiar për fituesin, vepra e të cilit bëhet pjesë e fondit të GASH, si dhe në mbështetjen që Galeria e Shkodrës i jep atij vitin pasardhës në organizimin e një ekspozite personale.</p> <p>Fitues i Çmimit Idromeno 2015 u shpall artisti Lek Gjeloshi. Ai ka lindur në Shkodër, në vitin 1987. Eshtë diplomuar në Akademinë e Arteve të Firences. Ka ekspozuar në disa institucione të ndryshme si: The Museum of Modern Art në Moskë, Rusi; Casa Masaccio Centro per l'Arte contemporanea, Villa Romana, Palazzo Vecchio, Fondazione Lanfranco Baldi në Itali, Galeria e Arteve të Kosovës, Galeria Kombëtare e Arteve Tiranë dhe në Galerinë e Arteve në Shkodër. Disa nga ekspozitat e tij: A time for dreams: 4th International Biennale for Young Art kuruar nga kuratori britanik David Elliott, Nuovo Cinema Masaccio, Fuori Posto, Proiezioni 2013, Lontano da dove? të kuruara nga kuratori italian Pier Luigi Tazzi dhe Terranauti kuruar nga Ilaria Mariotti e Angelika Stepken.</p>					
ii. Synimi i projektit					
<p>Të ruajë lidhjen mes dy edicioneve të këtij aktivitetit dhe ta promovojë atë në panoramën artistike lokale dhe kombëtare. Të plotësojë dhe të përforcojë vlerën e këtij çmimi duke shtuar interesin për pjesmarrje në konkurrim të artistëve të rinj. Të mbështesë artistët e rinj në përpjekjet e tyre për krijimin e një karriere profesionale.</p>					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<p>Planifikimi i hapave konkretë për realizimin e aktivitetit, së bashku me artistët.</p> <p>Njoftimi nëpërmjet internetit dhe mediave për kohën e realizimit të projektit.</p> <p>Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promocionale.</p> <p>Ndërmarrja e hapave konkretë, në bashkëpunim me artistët, për realizimin e ekspozitës (transportimi i veprave, selektimi, instalimi etj)</p> <p>Përgatitja e materialit të shtypur që shoqëron eventin (fotografim i veprave, sistemim i materialit të shkruar, koordinim dhe kontroll i punës me entin botues)</p> <p>Organizimi i ceremonisë së hapjes së ekspozitës.</p> <p>Angazhimi sistematik i stafit në shërbimin ndaj vizitorëve në periudhën që ekspozita qëndron e hapur për publikun.</p> <p>Planifikimi i vizitave të organizuara nga institucionet e edukimit dhe biseda rreth veprave me autorin.</p> <p>Bashkërendimi i punës me drejtorinë dhe zyrën e financës për përmblylljen e procedurave financiare me bashkëpunëtorët .</p>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<p>Realizimi i një ekspozite të artit bashkëkohor me nivel cilësor.</p> <p>Promovimi i Çmimit Idromeno si një nga aktivitetet më të rëndësishëm që realizon Galeria e Shkodrës.</p> <p>Zgjerimi i kontakteve dhe i bashkëpunimit të Galerisë me artistë të rinj që operojnë në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p>Krijimi i vazhdimësisë mes dy edicioneve të "Çmimit Idromeno"</p>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Artistët Institucionet kulturore Publiku			Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Kosto për realizimin dhe instalimin e ekspozitës			200	
A.2	Shpenzime të promovimit të aktivitetit			30	



A.3	Shërbime të dizajnit grafik për eventin			20	
A.4	Katalogu/shtypi			40	
A.5	Bileta udhëtimi -artisti			25	
	<b>Totali</b>	<b>315</b>		<b>315</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			
Gjatë vitit 2016		Stafi i Galerisë së Arteve Shkodër			

**Pasqyra e shpenzimeve për realizimin e ekspozitës personale të fituesit të “Çmimi Idromeno 2015”**

1-Kosto për instalimin e ekspozitës dhe veprave të artistit (*shtjellohet në bashkëpunim me artistin*):  
 (-printime fotosh, paspartura dhe kornizime, materiale të tjera për realizimin e veprave, montim-çmontim, ndarje karton xhosi 27 m2, pluriball 53 m2, disuazorë çeliku 35 ml, ngjitëse biadeziv, lyerje me bojë plastike 45 m2, silikoni etj)  
*Materiale: karton xhosi 27 m2x1500=40500/lyerje 45m2x 185=8325/pluriball 53 m2x4shtresa= 4 bobinax70euro bobinax62.5m2 bobina=39200+transp/disuazorë celiku*

200.000

2- Shpenzime të promovimit dhe komunikimit të aktivitetit:  
 (printim ftesa; poster; baner; njoftim në TV, printime ne forex statement kuratorial, etj.)

30.000

3- Shërbime të dizajnit grafik për eventin ( formulim grafik i katalogut, poster dhe dokumentimi fotografik i eventit )  
 20.000

4- Katalogu/ shtypi (200 copë)

40.000

5- Bileta udhëtimi -artisti ( Itali- Shqipëri vajtje –ardhje)

25.000

**Totali: 315.000 lekë**



Nr.30	<b>Projekti: P11.F1.O1.A30</b> "Personazh i ftuar"- Ekspozitë personale e një personaliteti të spikatur të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës.	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative  <b>Funksioni: P11.F1.</b> Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Ky projekt përputhet me synimet e GASH për t'u afirmuar si një institucion që ndjek me interesim zhvillimet bashkëkohore të artit pamor shqiptar, si dhe me misionin e saj për të luajtur rolin e ndërmjetësit të kualifikuar mes publikut dhe artistëve cilësorë me një karrierë të suksesshme artistike. Aktiviteti është konceptuar si ftesë që i drejtohet një artisti të spikatur në fushën e arteve pamore në nivel mbarëkombëtar për t'i organizuar një ekspozitë personale në Galerinë e Arteve të Shkodrës. Kjo praktikë është përfshirë në axhendën e GASH vitet e fundit me rezultate pozitive siç e dëshmojnë ekspozitat e artistëve të njohur A.Paci, B.Kaceli, H.Nallbani, E.Gjikopulli, A.Bytyçi, R.Goga etj.					
ii. Synimi i projektit					
Ekspozimi i arritjeve më serioze të fushës së artit pamor në nivel mbarëkombëtar para publikut artdashës shkodran. Promovimi i Galerisë së qytetit të Shkodrës në arenën kombëtare e mbarëkombëtare.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Ndërtimi i kontakteve me artistin për të planifikuar temat, afatet kohore dhe hapat e nevojshëm për realizimin e aktivitetit. Njoftimi nëpërmjet internetit dhe mediave për kohën e realizimit të aktivitetit. Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promocionale. Ndërmarrja e hapave konkretë, në bashkëpunim me artistin, për realizimin e ekspozitës (transportimi i veprave, selektimi, instalimi etj). Përgatitja e materialit të shtypur që shoqëron eventin (fotografim i veprave, sistemim i materialit të shkruar, koordinim dhe kontroll i punës me entin botues) Organizimi i ceremonisë së hapjes së ekspozitës. Angazhimi sistematik i stafit në shërbimin ndaj vizitorëve në periudhën që ekspozita qëndron e hapur për publikun. Planifikimi i vizitave të organizuara nga institucionet e edukimit dhe biseda rreth veprave me autorin.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Realizimin e një ekspozite të arteve pamore të një niveli të lartë artistik. Prezantimin e krijimtarisë artistike të një artisti të spikatur para spektatorit të qytetit. Zgjerimin e bashkëpunimit të institucionit në nivel kombëtar e përtej.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Artistë Institucione kulturore Spektatorë			Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
		Paga, sig	operative	kapitale	
A.1	Promocioni			20	
A.2	Akom odim-fjetje			6	
A.3	Akom odim-ushqim			5	
A.4	Transporti/ambalazhimi			45	
A.5	Shërbime të dizajnit grafik për eventin			20	
A.6	Broshurë e ekspozitës/shtypi			40	
<b>Shuma</b>		<b>136</b>		<b>136</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i Galerisë së Arteve Shkodër			



**Pasqyra e shpenzimeve për realizimin e ekspozitës**

1-	Promocioni e komunikim eventit (ftesa, poster, baner, printime tekstesh)	20.000
2-	Akomodim fjetje (1 person x 2 ditë x 3.000)	6.000
3-	Akomodim ushqim (1 person x 2 ditë x 2.500)	5.000
4-	Transporti (plus ngarkim- shkarkimi) i veprave nga vendodhja për në Shkodër dhe kthimi i tyre në destinacion (Shkodër-vendodhja e parë) në fund të aktivitetit./shpenzime ambalazhimi (kamion taksi 2 ditë + ngarkim-shkarkim+material ambalazhim)	45.000
5-	Broshurë e ekspozitës/shtypi (200 copë)	40.000
6-	Shërbime të dizajnit grafik për eventin ( formulim grafik i katalogut, poster dhe dokumentimi fotografik i eventit )	20.000

Tot: 136.000 lekë

Nr.31	<b>Projekti: P11.F1.O1.A31</b> Takimet publike – bisedat publike mbi artin dhe Ëorkshop me artistë të rinj	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F1.</b> Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Takimet publike, bisedat e hapura për publikun për temat e artit dhe ëorkshopet me artistët e rinj zënë një vend të rëndësishëm në axhendën e GASH. Ata janë pjesë integrale e programeve të galerive publike me synim zgjerimin e komunikimit me spektatorin, informimin shkencor-artistik dhe bashkëpunimin me artistët e rinj. Ky projekt parashikon 3 takime me artistë dhe studjues të artit, të cilët do të trajtojnë tema të rëndësishme për historinë e artit bashkëkohor në biseda të hapura për artistë dhe dashamirës të artit si dhe një ëorkshop me artistë të rinj dhe studentë të specialitetit.					
ii. Synimi i projektit					
Informimi artistik e shkencor i publikut. Krijimi i një atmosfere diskutimi dhe bashkëpunimi konstruktiv me artistët dhe studentët që operojnë në fushën e artit.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Ndërtimi i kontakteve me artistë dhe specialistë përfaqësues të fushave të lartpërmendura që do të përfshihen në projektin e mësipërm. Njoftimi (nëpërmjet internetit dhe mediave) për temat dhe kohën e realizimit të eventit. Realizimi i eventit. Dokumentimi dhe pasqyrimi i eventit në rrjetet sociale dhe faqen web të GASH. Finalizimi i punës me drejtorinë dhe zyrën e financës për përmbylljen e procedurave financiare me bashkëpunëtorët dhe artistët.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Përçim i informacionit shkencor artistik për publikun. Shkëmbim opinionesh dhe rritje të debatit artistik mbi tematika të rëndësishme të artit. Pasurim i aktivitetit të GASH përkrah eventeve të tipit ekspozues.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Artistë, specialistë të fushës, institucionet kulturore, studentë, spektatorë			Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		<b>Totali (000 lekë)</b>	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Materiale për realizimin e aktivitetit			20	
A.2	Honorare			60	
A.3	Akomodim – Fjetje			27	
A.4	Akomodim – Ushqim			22.5	
A.5	Promocion			10	
A.6	Shpenzime për botim			20	
A.7	Shpenzime udhëtimi			30	
<b>Totali</b>		<b>189.5</b>		<b>189.5</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i Galerisë së Arteve Shkodër			

**Bisedave Publike dhe ëorkshop 1 javor**

A-3 takime-lektor i ftuar - Honorare (10.000 për person x3)	=	30.000
B-3 Akomodim për të ftuarit ( studjues arti)		
(3 dieta ditore të shpërndara sipas programit)		
-ushqim 3 x 2500 lekë/dita		7.500
-fjetje 3 x 3.000 lekë/nata		9.000
<i>ëorkshop 1 javor:</i>		
- Promocioni		10.000
- materiale për realizimin e aktivitetit		20.000
-Akomodim për të ftuarit (artisti drejtues i ëorkshopit )		
(6 dieta ditore të shpërndara sipas programit)		
-fjetje 6 x 3.000 lekë/nata		18.000
-ushqim 6 x 2500 lekë/dita		15.000
-botim		20.000
-honorar		30.000
-bileta udhëtimi për të ftuarit		30.000
	<b>Tot:</b>	<b>189.500</b>

Nr.32	<b>Projekti:</b> Aktivitete në partneritet me subjekte kulturore të tretë	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative  <b>Funksioni: P11.F1.</b> Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Historikisht GASH, e kondicionuar nga burimet e kufizuara financiare në dispozicion, nuk është angazhuar në rolin e partnerit financiar në projekte që zhvillohen jashtë hapësirave të saj. Aktivitetet në bashkëpunim me të tretët janë një risi për GASH, duke përjashtuar raste të veçuara si: Simpoziumi i skulpturës i vitit 2011. Kjo praktikë pune është e njohur për institucionet kulturore të ngjashme, të cilët kontribuojnë në projekte, ku përfitues janë si komuniteti artistik lokal, ashtu dhe vetë subjekti bashkëpunues në drejtim të promovimit, kontributit kulturor, përfitimt të aktiviteteve kulturore gjurmëlënës dhe me një impakt pozitiv në kontekstin ku zhvillohen. Deri në këtë moment mund të përmendim kërkesat për bashkëpunim (projekte në zhvillim) nga Galeria Kombëtare e Arteve, Art House, shoqata, individë etj., për organizim ekspozitash, ëorkshope, eventesh artistike etj.					
ii. Synimi i projektit					
Sinergji me faktorë kulturorë lokalë dhe jashtëlokalë në implementimin e eventeve kulturore.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Ndërtimi i kontakteve konstruktive me subjekte kulturore të interesuar. Përcaktimi i qartë i objektivave dhe termave të bashkëpunimit (në kuptimin financiar dhe organizativ) Faza e realizimit konkret të eventit. Promocioni i rezultateve të arritura Përmbyllja e veprimeve standarde me Zyrën e financës dhe Drejtoritë përkatëse.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Përfitimi i aktiviteteve kulturore gjurmëlënës dhe me një impakt pozitiv në kontekstin ku zhvillohen.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Artistë, institucione, shoqata kulturore, komuniteti			Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo:	
A.1 Bileta udhëtimi				Paga, sig	operative kapitale
A.2 Shpenzime akomod.ushqim					100
Totali			109		9
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i GASH për pjesën e institucionit		

**Buxheti i detajuar:***Shënim:*

*Ky projekt mund të mbështetet nga Gash-nëpërmjet buxhetit vjetor të institucionit, ose nga Zyra e Kulturës e Bashkisë Shkodër nëpërmjet buxhetit të aktiviteteve kulturore të kësaj zyre.*

*Shpenzimet e mëposhtme referohen mbështetjes së eventit Biseda Publike që do të zhvillohet në qendrën e artit ArtHouse Shkodër gjatë vitit 2016.*

*(Bileta udhëtimi :Mirjam Varadinis ( kuratore e Kunsthaus Zyrih), James Lingëood ( drejtor i Artangel, Londer), Stefano Boeri (arkitekt ,Milano)*

- Bileta udhëtimi vajtje-ardhje ( /Zyrih-Tiranë/Londër- Tiranë /Milano- Tiranë) 100.000

-Akomodim për të ftuarit 9.000

(3 dieta ditore të shpërndara sipas programit) -ushqim 3 x 3.000 lekë/dita

**Tot: 109.000**



Nr. 33	<b>Projekti: P11.F2.O1.A1</b> "Një Piano për Qytetin e Artit"	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekracionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata ( Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)					
<p>Prej shumë vitesh artistëve dhe instrumentistëve shkodranë u mungon një instrument cilësor, piano koncertore. Ky instrument do të mundësonte organizimin e koncerteve në piano, në nivelin e duhur. Vlera e një instrumenti të tillë cilësor është e lartë, për këtë arsye Bashkia e Shkodrës, në mbështetje të kërkesave të vazhdueshme të artistëve shkodranë për sigurimin e një pianoje "koncertore", për Teatrin "Migjeni", në projekt-buxhetin e vitit 2016 planifikon vënien në dispozicion të një vlere financiare të konsiderueshme për pianon.</p> <p>Një piano koncertore ka një vlerë të konsiderueshme, ndaj për të siguruar vlerën e nevojshme, Bashkia e Shkodrës në mbështetje të artistëve dhe së bashku me to, ka iniciuar një fushatë ngritje fondi, "Një Piano për Qytetin e Artit" me objektin sigurimin e fondit të mjaftueshëm për blerjen e pianos.</p> <p>Për vitin 2015 është arkëtuar shuma prej 109 270 lekë. Bashkia parashikon që gjatë vitit 2016 shuma e dhuruar të arrijë në 3 000 000 lekë.</p> <p>Nga një testim i tregut, një piano cilësore e përshtatshme për aktivitetet kulturore të qytetit tonë vlerësohet të kushtojë 4 000 000. Diferencën prej 1000000 lekësh Bashkia e parashikon në buxhetin e vitit 2016.</p>					
ii. Synimi i projektit					
Të financojë për ngritjen e fondit të nevojshëm për blerjen e Pianos koncertore për artistë dhe muzikantë. Të kontribuojë në pasurimin e jetës artistike dhe kulturore në Shkodër.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Ngritjen e një grupi pune të përbërë prej artistësh e instrumentistësh të mirënjohur. Koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve, kulturore, mediatike etj, me objektin, sigurimin e fondit të nevojshëm për blerjen e pianos. Sigurimin e financimit periodik deri në sigurimin e vlerës së plotë financiare të nevojshme për blerjen e pianos.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Fushatë ngritje fondesh aktive dhe cilësore deri në sigurimin e vlerës së duhur financiare. Rritje progresive e vlerës financiare deri në sigurimin e vlerës së mjaftueshme për sigurimin e pianos.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b> Artistë dhe instrumentistë, Media Teatri "Migjeni", Shkolla e Muzikës "Prenkë Jakova"			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b> Bashkia e Shkodrës, Individë, OJF, Media, Biznese		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura (për cdo aktivitet të mësipërm (pika iii))</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Blerje Piano				4 000
<b>Shuma</b>		<b>4 000</b>			<b>4 000</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë gjithë vitit 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Zyra e Kulturës.		

Nr.34	<b>Projekti:</b> P11.F2.O1.A2 Blerje impiant audio, sistem ndriçimi dhe pod për koncerte live	<b>Llojet e programit:</b> P11. Kultura dhe shërbimet rekreative <b>Funksioni:</b> P11.F2. Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
<b>i. Situata</b> (Shjpego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)					
Bashkia e Shkodrës zhvillon shumë aktivitete gjatë një viti kalendarik dhe në të gjitha këto aktivitete i nevojitet infrastrukturë, foni, ndricim dhe pod, shërbim të cilin e paguan në të gjitha këto aktivitete. Bazuar në këtë situatë, ne kemi analizuar që paisje të tilla duhet të jenë në pronësi të Bashkisë së Shkodrës. Theksojmë se këto paisje do të vihen në dispozicion edhe në cdo event që do të organizojnë të gjitha institucionet e varësisë së kultures dhe jo vetem. Krahas këtyre aktiviteteve kjo njesi infrastrukturore mendojmë se do të shërbejë dhe për zhvillimin e aktiviteteve dhe në njësitë administrative, promovime, koncerte etj.					
<b>ii. Synimi i projektit</b>					
Pasurimi i infrastrukturës për zhvillimin e aktiviteteve social kulturore e artistike në qytet. Bashkia do të ketë nje infrastrukture të levizshme për mundësimin e koncerteve dhe veprimtarive të hapura.					
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>					
Analiza dhe studimi për blerjen e fonisë në fjalë. Mbledhja e një grupi ekspertësh dhe teknikësh. Tenderimi Magazinimi Hartimi i planit të punës për personin përgjegjës për këtë impiant. Mirëmbajtja në vazhdimësi e aparaturave.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b> ( shërbimet apo produktet që u dorëzoni perfituesve të synuar)					
Rritjen e numrit të aktiviteteve të hapura në qytet. Thjeshtimin e zhvillimit të koncerteve dhe cdo veprimtarie tjetër të hapur.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b> (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)		
Institucionet e varësisë Shoqëritë kulturore që do të zbatojnë të gjithë kalendarin e aktiviteteve të Bashkisë Shkodër. Komuniteti i artistëve. Shoqatat e ndryshme që operojnë në qytetin tonë. Artistët e pavarur			Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura ( për cdo aktivitet të mësipërme (pika iii)</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Skena 30 metër katror				300
A.2	Fonia 4 mijë ëat Model Bose L2 / copë2				400
A.3	Mikser profesional				300
A.4	Mikrofona				75
A.5	Stativa				40
A.5	Ndriçim				300
A.6	Amerikaner				140
<b>Shuma</b>		<b>1 555</b>			<b>1 555</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> stafi drejtorisë së kulturës, arsimit, rinisë e sportit		

Nr.35	<b>Projekti: P11.F2.O1.A3</b> Orkestra Frymore, honorare vjetore	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve te institucioneve kulturore dhe artistike te Bashkise se Shkodrës
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unike që ka qyteti ynë me fillimet e saj të hershme që nga viti 1876.</p> <p>Siç dihet ky formacion është vijues i traditave më të mira të formacioneve që kanë debutuar në qytetin e Shkodrës dhe jo vetëm.</p> <p>E mbështetur nga Bashkia e Shkodrës dhe e menaxhuar nga Qendra Kulturore "Pjetër Gaci", është një formacion mjaft i konsoliduar.</p> <p>Në vitin 2009 fitoi çmimin e parë në një festival ndërkombëtar në Xhulia-Nova Itali.</p> <p>Gjithashtu fituese në shumë takime kombëtare të organizuara ndër vite të orkestrave frymore me drejtues, muzikantë të shquar si: Zef Kurti, Prenkë Jakova, Tonin Daija, Abdullah Salabegu dhe së fundi dirigjentin aktual Kujtim Alija.</p> <p>Ky formacion ka realizuar aktivitete të shumta duke filluar nga koncerte-recitale, koncerte me rastin e festave kombëtare, parakalime në qytet, inagurime të ndryshme, përkujtime të figurave historike, pjesmarrje në aktivitete jashtë vendit etj.</p> <p>Të flasësh për historikun e orkestrave frymore të Shkodrës duhet të flasësh për rreth 140 vite histori.</p> <p>Prandaj ky formacion duhet të mbrohet dhe të mbështetet ashtu siç i takon.</p> <p>Bashkia e Shkodrës çdo vit e ka bërë detyrën e saj duke e financuar rregullisht për 11-të muaj të vitit, por edhe duke i siguruar realizimin e aktiviteteve të shumta.</p> <p>Kërkesa jonë është që Orkestra Frymore e qytetit të vazhdojë të financohet edhe për vitin 2016 me të njëjtat honorare dhe kushte që ka aktualisht.</p> <p>Këtë vit Orkestra Frymore do të realizojë këto aktivitete:</p> <p>Karnavalet e Shkodrës.</p> <p>2 Prilli.</p> <p>Dita e Luleve.</p> <p>Dita e Liqenit.</p> <p>Dita Boterore e Turizmit.</p> <p>Dita e Artizanatit dhe Zejeve.</p> <p>Paradë me Maturantët.</p> <p>Kryengritja e Postribës.</p> <p>Koncert-Premiere i Orkestrës Frymore.</p> <p>Koncert-Premiere i Orkestrës Frymore në Tiranë.</p> <p>28 Nëntori.</p> <p>Ndërmendje.</p> <p>Performanca në qytet.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<p>Ruajtja e traditës së këtij formacioni.</p> <p>Realizimi i aktiviteteve me rastin e festave të ndryshme.</p> <p>Gjallërimi i jetës artistike të qytetit.</p> <p>Promovimi i vlerave artistike të kësaj trupe.</p> <p>Nxitja e turizmit kulturor.</p>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<p>Parashikimi në Projekt-Buxhet për financimin e Orkestrës Frymore.</p> <p>Realizimi i kontratës kolektive me instrumentistët, spalën dhe dirigjentin.</p> <p>Realizimi i projekteve të ndryshme artistike për orkestrën dhe konkretizimi i tyre.</p> <p>Përzgjedhja e repertorit për të gjitha aktivitetet.</p> <p>Sigurimi i partiturave.</p> <p>Prova intensive me orkestrën.</p> <p>Përgatitja e materialeve promocionale.</p> <p>Promovimi në media i të gjitha aktiviteteve.</p>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<p>Spektatorët marrin kënaqësinë e dëshiruar gjatë performancave artistike të Orkestrës Frymore.</p> <p>Përfiton qyteti i Shkodrës që ruan traditën e këtij formacioni që njihet në arenën kombëtare e ndërkombëtare.</p>		



<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Komuniteti artistik, instrumentistët dhe muzikantët, por edhe më gjërë.		Bashkia e Shkodrës.			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Dirigjenti i orkestrës(1 person *20 000* 11 muaj)			220	
A.2	Instrumentist/përgjegjës i trupës (1 person *10 000* 11 muaj)			110	
A.3	Instrumentist (38 persona *8 000* 11 muaj)			3 344	
	<b>Totali</b>	<b>3 674</b>		<b>3 674</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" Sidrit Lohja			

Nr. 36	<b>Projekti: P11.F2.O1.A4</b> Mobilim për Qendrën Kulturore "Pjetër Gaci"	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
<b>i. Situata</b>					
<p>Në Qendrën Kulturore "Pjetër Gaci" është e nevojshme ndërhyrja dhe investimi në mobilimin e ambienteve, kryesisht në sistemimin e arkivës, pasi mungojnë raftet që shërbejnë për sistemimin e dokumenteve dhe veprave muzikore. Në këtë institucion mungojnë raftet për sistemimin e veshjeve popullore, veshjeve të orkestrës frymore, mungojnë tavolina dhe karrige zyre që shërbejnë për mbarëvajtjen e punës. Gjithashtu në sallën e provave duhen pasqyra për grupin e valleve. Mbarëvajtja e punës së institucionit lidhet ngushtë me këto investime pasi pajisjet që ne kemi nuk janë të mjaftueshme ose janë të amortizuara.</p>					
<b>ii. Synimi i projektit</b>					
Të krijohet një ambient efikas për mbarëvajtjen e punës dhe sistemimin e materialeve që disponon institucioni ynë.					
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>					
Projekt-Preventiv Specifikimet teknike Shqyrtimi i tregut për të përfutur ofertën më të mirë.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Sistemimi praktik dhe viziv i materialeve arkivore që disponojmë. Ruajtja dhe mirëmbajtja e kostumeve tradicionale dhe të orkestrës frymore. Ruajtja dhe mirëmbajtja e materialeve muzikore. Ekspozimi dhe promovimi i disa kostumeve që përmbajnë vlerat më të pasura etno-kulturore.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Arkitekt Artistët			Bashkia e Shkodrës.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Raftet entjefi për garderobë.				250
A.2	Raftet entjefi për arkivë.				150
A.3	Raftet entjefi për zyrë.				20
A.4	Tavolinë zyre.				28
A.5	Tavolinë kompjuteri.				12
A.6	Kapakë rafti me xhama.				12
A.7	Karrige zyre për vizitorë.				50
A.8	Pasqyra.				23
<b>Totali</b>		<b>545</b>			<b>545</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Gjatë gjithë vitit.		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" Sidrit Lohja			

**Pasqyra e shpenzimeve:**  
**Mobilim për Qendrën Kulturore "Pjetër Gaci"**

Nr.	Përshkrimi	Specifikimi teknik
1.	Rafte entjeji për garderobë.	Permasat 200*80*60 cm Korniqe entjeji Ngjyra : Venge 10 copë
2.	Rafte entjeji per arshive	Permasat 200*80*40 cm Korniqe entjeji me xhama Ngjyra : Venge 5 ndarje të brendshme-serxhinë 6 copë
3.	Raft entjeji për zyre	Permasat 200*80*40 cm Korniqe entjeji me xhama Ngjyra : Venge 5 ndarje të brendshme-serxhinë 1 copë
4.	Tavolinë zyre	Finitura e syprinës: MDF Rovere. Struktura: MDF. Këmbët; MDF Rovere. Gjatësi: 200 cm, Gjeresi: 170 cm, Lartesi : 75cm, Në forme (L) 2 copë
5.	Tavolinë kompjuteri.	1 copë
6.	Kapakë rafti me xhama.	6 copë
7.	Karrige zyre vizitorësh.	Ngjyra : e zezë 20 copë
8.	Pasqyra	

Nr.	Emërtimi	Njësia	Çmimi	Sasi	Vlerë
1.	Rafte entjeji për garderobë.	copë	25.000 lekë	10 copë	250.000 lekë
2.	Rafte entjeji per arshive	copë	25.000 lekë	6 copë	150.000 lekë
3.	Raft entjeji për zyre	copë	20.000 lekë	1 copë	20.000 lekë
4.	Tavolinë zyre	copë	28.000 lekë	1 copë	28.000 lekë
5.	Tavolinë kompjuteri	copë	12.000 lekë	1 copë	12.000 lekë
6.	Kapakë rafti me xhama	copë	2.000 lekë	6 copë	12.000 lekë
7.	Karrige zyre vizitorësh.	copë	2.500 lekë	20 copë	50.000 lekë
8.	Pasqyra	copë			23.000 lekë
<b>Totali lekë me tvsh</b>			<b>545.000 lekë</b>		

Nr. 37	<b>Projekti: P11.F2.O1.A5</b> Pajisje Teknike Zyre për Qendrën Kulturore "Pjetër Gaci" (kompjuter dhe printer)	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
<b>i. Situata</b>				
Në Qendrën Kulturore "Pjetër Gaci" është shumë e rëndësishme që të investohet në pajisjet teknike. Në realitetin e sotëm kërkohet që të gjitha dokumentacionet të jenë të automatizuara dhe të publikuara online dhe të punohet për digjitalizimin e tyre. Për këtë shihet e nevojshme që ky institucion të pajiset me një kompjuter, laptop i parametrave të mira gjithashtu një printer, scanner me ngjyra i formatit A3,A4.				
<b>ii. Synimi i projektit</b>				
Krijimi i një baze teknike të nevojshme për ushtrimin normal të funksioneve të institucionit.				
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>				
Testimi i tregut për mundësitë teknologjike që ofron. Ndjekja e hapave të mëtejshëm për procedurat e blerjes (prokurimit) të pajisjeve.				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
Kushte më të mira teknike në ushtrimin e detyrave funksionale të Qendrës Kulturore "P. Gaci", shërbim më i kualifikuar.				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Personeli i institucionit, artistet.			Bashkia e Shkodrës	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
			kapitale	
A.1	Kompjuter (laptop)			120
A.2	Printer A3, A4			50
<b>Totali</b>		<b>170</b>		<b>170</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Gjatë gjithë vitit.			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" Sidrit Lohja	



**Pajisje teknike zyre  
(kompjuter/laptop dhe printer)**

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Sasi</b>	<b>Vlerë</b>
1.	Kompjuter Laptop	copë	120.000 lekë	1 copë	120.000 lekë
2.	Printer A3,A4	copë	50.000 lekë	1 copë	50.000 lekë
<b>Totali lekë me tvsh</b>			<b>170.000 lekë</b>		

<b>Nr.38</b>	<b>Projekti: P11.F2.O1.A6</b> Krijimi dhe Mirëmbajtja e Faqes Web	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>						
<b>i. Situata</b>						
Një institucion kulturor publik, siç është Qendra Kulturore "Pjetër Gaci", në përmbushjen me seriozitet dhe profesionalizëm të funksioneve të saj, është e nevojshme që të ndërtohet faqja e saj zyrtare e Web-it. Kjo shihet si një domosdoshmëri e kohës që të disponojmë një faqe të tillë në mënyrë që të interesuarit të ndjekin online kalendarin e aktiviteteve, historikun e institucionit, etj. Në të ardhmen mund të kemi regjistrime online për konkurse ose dorëzimin e dosjeve të aplikantëve që mund të kërkojnë bashkëpunime për koncerte, recitale etj.						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
Rritjen e nivelit profesional në administrimin dhe funksionimin e institucionit						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
Bashkërendimi i punës me zyrën e financës për përmbushjen në kohë të procedurës së blerjes së shërbimit.						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
Rritje e efikasitetit dhe përmirësim të cilësisë së punës në pasqyrimin e aktiviteteve të institucionit.						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Qendra Kulturore "Pjetër Gaci", bashkëpunëtorët institucionalë me të cilët bashkëvepron institucioni Artistët vendas dhe të huaj Komuniteti			Bashkia e Shkodrës			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo:		
				Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Hostim dhe mirëmbajtje të faqes Web per vitin 2016				50	
<b>Shuma</b>			<b>50</b>		<b>50</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016.			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" Sidrit Lohja			

Nr 39	<b>Projekti : P11.F2.O1.A7</b> Përmirësim i kushteve të punës për aktorët, për pritjet e të ftuarve dhe blerje paisje teknike	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
i. Situata		
<p>Teatri "Migjeni" është një institucion që ka një ndikim të madh në zhvillimin dhe nxitjen e jetës kulturore artistike në qytetin e Shkodrës. Historia e lëvizjes teatrore në qytetin tonë i ka fillesat me shoqëritë amatore që datojnë rreth 130 vjet më parë. Teatri profesionist ka kontribut të shkëlqyer që në krijimin e tij në vitin 1949. Me ndërtimin e godinës së Teatrit në vitin 1958, u krijua një qendër akoma më e rëndësishme për kulturën e qytetit dhe të mbarë artit teatrore shqiptar. Opera e parë shqiptare "Mrika" ishte aktiviteti i parë i organozuar në teatrin e sapo ndërtuar.</p> <p>Gjatë jetës së vet artistike teatri dhe estrada e Shkodrës kanë përfomuar me qindra shfaqje dhe aktivitete të ndryshme. Tradita dhe eksperimente, prurjet e reja të talenteve, pritshmëria artistike e qytetarëve, janë një shtysë e rëndësishme për organizimin e aktiviteteve të reja dhe përmirësimin cilësor të tyre.</p> <p>Pavarsisht përpjekjeve të stafit të teatrit dhe estradës, kapacitetet e saj janë më të shumta për sa i përket sasisë dhe cilësisë së veprave artistike që mund të vihen në skenë.</p> <p>Aktiviteti i personelit të Teatrit "Migjeni" gjatë 4 – 5 viteve të fundit është kryer në kushte jo të mira. Ne tashmë jemi në momentin kur po bëhet një rikonstruksion pjesor i ambjentëve të Teatrit dhe është shumë e arsyeshme, përveç se një nevojë imediate, plotësimi me mobilje dhe paisje i disa dhomave të aktorëve dhe paisja me disa mjete teknike që plotësojnë më së miri disa kërkesa për realizimin sa më të mirë të aktiviteteve artistike.</p> <p>Gjatë vitit 2016 ne kemi parashikuar të realizojmë këto aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Dhjetë Urdhnimet - nga Roberto Benigni</b></li> <li>• <b>"In memoriam"- Pjerin Ashiku</b></li> <li>• <b>"Kopraci – sipas Molierit" Stefan Capaliku</b></li> <li>• <b>"Kur Nënë Tereza ishte Gonxhe" – nga Bashkim Kozeli</b></li> <li>• <b>Shoë 2016</b></li> </ul> <p>Stafi i Teatrit "Migjeni" është i angazhuar të kontribuojë si përherë, në pasurimin e jetës kulturore dhe artistike të qytetit tonë. Bashkëpunimi me Bashkinë dhe me institucione të tjera që janë afër qytetarit, ka qënë në nivel të kënaqshëm.</p> <p>Ne mendojmë se përveç angazhimit tonë, një shtysë pozitive do të jetë edhe një rritje e vemendjes për përmirësimin e aktiviteteve mbështetëse në institucionin e Teatrit "Migjeni", brenda kornizave ligjore të parashikuara.</p> <p>Si të tilla ne parashikojmë:</p> <p>Mobilimi i 10 dhomave të aktorëve, mobilimi i 2 dhomave për të ftuarit si dhe blerje paisje teknike profesionale</p> <p>Blerjet do bëhen duke patur parasysh nevojat e mobilimit të zyrave të aktoreve pas rikonstruksionit të teatrit. E njëjta gjë do bëhet edhe për mobilimin e 2 dhomave për të ftuarit. ( Mendojmë akomodimin e tyre në kushte të thjeshta por të përshtatshme duke menduar uljen e kostove për aktivitetet me të tretë që mund të ketë teatri).</p> <p>Blerja e paisjeve operationale, do shërbejë për rritjen e efektivitetit në punë dhe paraqitjen sa me dinjitoze në shfaqet e Teatrit.</p> <p>Bashkëngjitur fishes janë preventivat e blerjeve , që i referohen çmimeve të tregut</p>		
ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitim i grupit të synuar)		
Të përmirësojmë punën tonë dhe të rrisim kontributin në pasurimin e jetës artistike të Bashkisë Shkodër		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
1. Procedurat <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i nevojave</li> <li>• Testimi i tregut</li> <li>• Tenderimi</li> </ul> 2. Paisja dhe mobilimi i 10 dhomave të aktoreve 3. Paisja me mjete teknike profesionale 4. Paisja e 2 dhomave për të ftuarit 5. Monitorimi		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitete të kryera në kohë</li> <li>• Përfomancë e përmirësuar</li> <li>• Numër aktivitete të rritur</li> <li>• Numër sepektatorësh i rritur</li> <li>• Të ardhura të rritura për institucionin</li> </ul>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)</b>	

Administrata e teatrit Administratat e bashkisë ( Drejtoria e kulturës)		Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura ( për cdo aktivitet të mësipërme (pika III)</b>				
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
A.1	Procedurat			
A.2	Mobilimi i 10 dhomave të aktorëve	744		360
A.3	Blerje paisje teknike profesionale	624	624	
A.4	Mobilimi i 2 dhomave per te ftuarit	209	209	
A.5	Monitorimi			
<b>Totali</b>		<b>1 577</b>	<b>1 217</b>	<b>360</b>
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon , kur përfundon) Gjatë vitit 2016</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>	

**PREVENTIV****Mobilimi i 10 dhomave të aktorëve**

	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi	Vlera në lekë
1	Divane	copë	10	20000	200 000
2	Pasqyra	copë	10	4000	40 000
3	Rafte	copë	10	10000	100 000
4	Tavolina	copë	10	5000	50 000
5	Karriga	copë	40	2000	80 000
6	Ngrohesa	copë	10	4000	40 000
7	Perde	copë	10	3000	30 000
8	Qilim	copë	10	8000	80 000
<b>Totali lekë pa tvsh</b>					<b>62 000</b>
<b>Tvsh 20%</b>					<b>12 400</b>
<b>Totali lekë me tvsh</b>					<b>744 000</b>

**Blerje paisje teknike profesionale**

	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi	Vlera në lekë
1	Makine qepese	copë	copë	40 000	40 000
2	Lavatrice profesionale me tharje	copë	copë	100 000	100 000
3	Hekur rrobash profesional	copë	copë	30 000	30 000
4	Videoprojektor	copë	copë	150 000	150 000
5	Blerje sharre profesionale	copë	copë	150 000	150 000
6	Makine tymi	copë	copë	50 000	50 000
<b>Totali leke pa tvsh</b>					<b>520 000</b>
<b>Tvsh 20%</b>					<b>104 000</b>
<b>Totali lekë me tvsh</b>					<b>624 000</b>





## Mobilimi i dy dhomave për të ftuarit

	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi	Vlera në lekë
1	Raft 2 kapakësh	copë	2	10 000	20 000
2	Shtereter + dysheke	copë	4	10 000	20 000
3	Tavoline mesi	copë	2	12 000	24 000
4	Perde	copë	2	3 000	6 000
6	Karriga	copë	4	4 000	16 000
7	Televizion	copë	2	32 000	64 000
8	Batanije çarëafë	copë	4	6 000	24 000
<b>Totali lekë pa tvsh</b>					<b>174 000</b>
<b>Tvsh 20%</b>					<b>33 800</b>
<b>Totali lekë me tvsh</b>					<b>208 800</b>

## F1 - Formulari i Identifikimit të Idese se Projektit (FIIP)

Projekt zbatimi i plote Rikonstruksion i godinës së Teatrit "Migjeni".  
Kodi në matricë P11.F2.O1.A8

## 01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit të projektit	BASHKIA E SHKODRËS	Firma e propozuesit të Projektit	
Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit	DREJTORIA E STUDIMEVE PLANIFIKIMIT KOORDINIMIT DHE MONITORIMIT TE INVESTIMEVE.		
Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori	FZHR/FSHZH	Vendodhja e Projektit	Qyteti Shkodër/Bashkia e Shkodrës

## 02. Identifikimi i Idese se Investimit : Rikonstruksion i godines se Teatrit " Migjeni".

Projekt Idea	Projekt zbatimi i plotë
Problemet për tu adresuar	Projekt ne vazhdim
Emri i Programit	Infrastrukturë vendore
Qëllimet dhe objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen	Objektivat e projektit konsistojnë në rivleresimin e objekteve Monument Kulture, krijimi. kushteve optimale, ofrimin e një infrastrukture sipas standarteve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, për ushtrimin e aktiviteteve kulturore. Kthimin e Godinës së Teatrit "Migjeni" në parametrat bashkëkohore.

## 0.3. Kostot e Projektit te Investimit

Kosto Totale e Projektit lekë	3,978,526 Sipas marrëveshjes me FSHZH planifikohet pagesa prej <b>1,989,263 leke</b>
-------------------------------	--

## 04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idese

	Emri	Nenshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit Statusi i Projektit Idese
Drejtuuesi i Programit në Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej
Komente nga Drejtuesi i Programit				
Sekretari i Përgjithshëm				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt idesë
Komente nga Sekretari i Përgjithshëm				

Nr. 41	<b>Projekti :</b> P11.F2.O1.A9 Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit "Migjeni"	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës									
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>											
i. Situata											
<p>Institucioni i Teatrit "Migjeni" është një institucion varësie i Bashkisë Shkodër. Çdo aktivitet artistik që ndërmerret është në bashkëpunim dhe me miratim të administratës së bashkisë. Buxheti, niveli i pagave, nivelet e honorareve, etj me propozimin e stafit të Teatrit miratohen nga Bashkia. Teatri Migjeni ka një strukturë prej 38 personash në të cilën përfshihen drejtori, trupa artistike (që përfshin aktorë, instrumentistë, drejtues muzike dhe solistë) e përberë nga 21 punonjës dhe shërbimet mbështetëse ku përfshihen (fonist, grimier, elektrikistë, punëtor skene, punëtor ndriçimi mixer, pastruese, piktor, marangoz, roje dhe arkivist ) e përbëre nga 13 persona. Niveli i pagave është i bazuar në VKM Nr. 1619, datë 2.7.2008, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", i ndryshuar</p> <p style="text-align: right;">000/lekë</p> <table border="1" data-bbox="451 716 1170 829"> <thead> <tr> <th>Nr. punonjësve</th> <th>Paga ( 600)</th> <th>Kontribute Sig.Shoqërore (601)</th> <th>Total lekë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;">38</td> <td style="text-align: center;">18 810, 960</td> <td style="text-align: center;">3 141, 430</td> <td style="text-align: center;">21 952, 390</td> </tr> </tbody> </table> <p>Pagat totale për 1 muaj janë 1, 567, 580 leke dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për 1 muaj janë 261 785</p>				Nr. punonjësve	Paga ( 600)	Kontribute Sig.Shoqërore (601)	Total lekë	38	18 810, 960	3 141, 430	21 952, 390
Nr. punonjësve	Paga ( 600)	Kontribute Sig.Shoqërore (601)	Total lekë								
38	18 810, 960	3 141, 430	21 952, 390								
ii. Synimi i projektit ( me nje fjali cfare do te zgjidhni per ate qe eshte problemi kryesor, perfitimi i grupit te synuar)											
Të arrihen objektivat e vitit 2016 për organizimin e aktiviteteve artistike, me qëllim rritjen e konkurrencës, cilësisë, promovimit të artistëve të rinj dhe gjallërimin e jetës kulturore artistike në Bashkinë e Shkodrës.											
iii. Aktivitetet kryesore të projektit											
<p>1. Pagesa e punonjësve të Teatrit "Migjeni" ( paga bazë)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Monitorimi i pjesëmarrjes në aktivitetin e përditshëm</li> <li>• Vlerësimi i performancës në sasi dhe cilësi të stafit</li> </ul> <p>2. Llogaritja dhe pagesa e sigurime shoqërore</p>											
<b>b) Rezultatet që prisni</b>											
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitete të kryera në kohë</li> <li>• Performancë e përmirësuar</li> <li>• Numër aktiviteteve të rritur</li> <li>• Numër spektatorësh të rritur</li> <li>• Të ardhura të rritura për institucionin</li> </ul>											
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do tekontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)</b>									
Administrata e Teatrit "Migjeni"		Bashkia e Shkodrës									
<b>e) Shpenzimet e llogaritura ( për cdo aktivitet të msiperme (pika iii)</b>											
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo: Paga, sig operativ e kapitale								
A.1	Paga personeli ( paga bazë 6000)	18 810, 960	18 810, 960								
A.2	Sigurime shoqërore ( 6010 )	2 821, 644	2 821, 644								
<b>SHUMA</b>		<b>21 952, 390</b>	<b>21 952, 390</b>								
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë vitit 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>									

Nr.42	<b>Projekti : P11.F2.O1.A10</b> Shërbime nga të tretë për furnizimin me energji, ujë, etj.	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
<p>Stafi i Teatrit "Migjeni" është i angazhuar të kontribuojë si përherë, në pasurimin e jetës kulturore dhe artistike të qytetit tonë. Gjatë vitit 2016 ne kemi parshikuar të realizojmë këto aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Dhjetë Urdhnetet - nga Roberto Benigni</b></li> <li>• <b>"In memoriam"- Pjerin Ashiku</b></li> <li>• <b>"Kopraci – sipas Molierit" Stefan Capaliku</b></li> <li>• <b>"Kur Nënë Tereza ishte Gonxhe" – nga Bashkim Kozeli</b></li> <li>• <b>Shoë 2016</b></li> </ul> <p>Realizimi i aktiviteteve të parashikuara bëhet i mundur duke marrë shërbime të tjera nga jashtë institucionit të teatrit. Shërbimet që do i ofrohen Teatrit Migjeni nga persona dhe subjekte të tjera jashtë janë :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• energjia elektrike ,</li> <li>• uji,</li> <li>• telefon + internet,</li> <li>• printime + publikime ( për shpalosjen e aktiviteteve të ndryshme të Teatrit )</li> <li>• lëndë djegëse ( naftëe për kaldajën 2 000 litra )</li> </ul>					
ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitim i grupit të synuar)					
Të realizojmëpunën tonë dhe të rrisim kontributin në pasurimin e jetës artistike të Bashkisë Shkodër					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Procedurat <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i nevojave</li> <li>• Testimi i tregut</li> <li>• Tenderimi</li> <li>• Lidhja e kontratave</li> </ul> </li> <li>2. Pagesa e energjisë</li> <li>3. Pagesa e ujit të pijshëm</li> <li>4. Pagesa e telefon + internet</li> <li>5. Pagesa lëndë djegëse</li> <li>6. Pagesa printime dhe publikime</li> <li>7. Monitorimi</li> </ol>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitete të kryera në kohë</li> <li>• Përformancë e përmirësuar</li> <li>• Numër aktivitete të rritur</li> <li>• Numër spektatorësh i rritur</li> <li>• Të ardhura të rritura për institucionin</li> </ul>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)</b>		
Administrata e teatrit Administratat e bashkisë			Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)</b>					
Shpenzimet për çdo aktivitet			Totali 000/ lekë	Nga kjo:	
A.1 Energji elektrike			630	Paga, sig	operative kapitale
A.2 Ujë			101		630
A.3 Telefon + internet			80		101
A.3 Lëndë djegëse			350		80
A.4 Printime dhe publikime			200		350
A.5 Monitorimi i procesit					500
<b>Totali</b>			<b>1 361</b>		<b>1 361</b>
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon , kur përfundon) Gjatë vitit 2016</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>		

Nr. 43	<b>Projekti : P11.F2.O1.11</b> Shërbime administrative për Teatrin "Migjeni"	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
<p>Stafi i Teatrit "Migjeni" është i angazhuar të kontribuojë si përherë, në pasurimin e jetës kulturore dhe artistike të qytetit tonë. Gjatë vitit 2016 ne kemi parshikuar të realizojmë këto aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Dhjetë Urdhnimet - nga Roberto Benigni</b></li> <li>• <b>"In memoriam"- Pjerin Ashiku</b></li> <li>• <b>"Kopraci – sipas Molierit" Stefan Çapaliku</b></li> <li>• <b>"Kur Nënë Tereza ishte Gonxhe" – nga Bashkim Kozeli</b></li> <li>• <b>Shoë 2016</b></li> </ul> <p>Realizimi i aktiviteteve të parashikuara bëhet i mundur duke ndërmarrë disa shpenzime operative , që janë të rreshtuara më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpenzime për pritje, përcjellje (që përfshijnë akomodimin e artistëve të teatrosve të tjerë kombëtar dhe ndërkombëtar)</li> <li>• Sigurim për ndërtesën e Teatrit Migjeni për vitin 2016</li> <li>• Shpenzime për Honorare ( honoraret paguhen për pjesëmarrësit e kontraktuar në aktivitetet që zhvillon Teatri "Migjeni" dhe paguhen në bazë të vendimit të bordit</li> <li>• Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca (pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme kombëtare me qëllim ngritjen e nivelit profesional të artisteve të Teatrit)</li> </ul> <p>Niveli i honorareve është i përcaktuar me vendim të Bordit drejtues, dt 19.12.2015 në zbatim të ligjit 10405 dt 24.03.2011 Neni 5, pika ç, nga ku thuhet : <i>"Shpërblimet e personave nga burimet e veta financiare të cilat caktohen në komitete, borde, këshilla, komisione e të tjera të kësaj natyre që ngrihen me vendim të këshillit përkatës"</i> (vendimi dhe tabela bashkëngjitur)</p>				
ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)				
Të realizojmë aktivitete cilësore dhe të rrisim kontributin në pasurimin e jetës artistike të Bashkisë Shkodër.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryerja e procedurave paraprake <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i nevojave</li> <li>• Testimi i tregut</li> <li>• Tenderimi</li> <li>• Lidhja e kontratave</li> </ul> </li> <li>• Shpenzime për pritje e përcjellje ( të ftuar në aktivitetet e Teatrit të artistëve apo personazheve të ndryshëm nga Shqipëria apo më gjërë)</li> <li>• Shpenzime për sigurim ndërtese</li> <li>• Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca</li> <li>• Monitorimi</li> </ul>				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitete të kryera në kohë</li> <li>• Përfundim të përmirësuar</li> <li>• Numër aktivitetesh i rritur</li> <li>• Numër spektatorësh i rritur</li> <li>• Të ardhura të rritura për institucionin</li> </ul>				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)</b>	
Administrata e teatrit Administratat e bashkisë			Bashkia e Shkodrës	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)</b>				
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali 000/ lekë	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
A.1		Procedurat		
A.2		Shpenzime për pritje, përcjellje	450	450



A.3	Siguracion ndërtese	53		53	
A.4	Pjesmarrje në konferenca	100		100	
A.5	Monitorimi				
	<b>Totali</b>	<b>603</b>		<b>603</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon , kur përfundon) Gjatë vitit 2016</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			

Nr.44	<b>Projekti : P11.F2.O1.12</b> Shërbime mbështetëse transporti për aktivitete artistike.	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
<p>Stafi i Teatrit "Migjeni" është i angazhuar të kontribuojë si përherë, në pasurimin e jetës kulturore dhe artistike të qytetit tonë. Aktivitetet dhe projektet që do të realizohen përfshijnë dhe bashkëpunime me teatro të tjera brenda dhe jashtë vendit. Duke patur parasysh se disa nga aktivitetet është menduar të shfaqen edhe jashtë Shkodrës duhet të parashikojmë dhe shpenzime udhëtimi e dieta</p> <p>Gjatë vitit 2016 ne kemi parashikuar të realizojmë këto aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Dhjetë Urdhnimet - nga Roberto Benigni</b></li> <li>• <b>"In memoriam"- Pjerin Ashiku</b></li> <li>• <b>"Kopraci – sipas Molierit" Stefan Capaliku</b></li> <li>• <b>"Kur Nënë Tereza ishte Gonxhe" – nga Bashkim Kozeli</b></li> <li>• <b>Shoë 2016</b></li> </ul> <p>Pagesat janë të parashikuara në bazë të VKM 997 dt 10.12.2010, nga ku përcaktohet se dieta për udhëtimet brenda vendit, në ditë është 1 000 lekë për person dhe për udhëtimet më shumë se një ditë është deri në 2 500 lekë. Shuma totale e dietave dhe transportit të llogaritura për udhëtimet brenda shtetit do jetë 1000 000 lekë dhe shuma totale e dietave dhe transportit për udhëtimet jashtë shteti do jete 1 000 000 lekë</p> <p>Shpenzimet e transportit llogariten duke patur parasysh që një shfaqje në Prishtinë, Mitrovicë, Preshevë, Shkup, dhe Korçë e ka vlerën 100 000 lekë, duke patur parasysh që do udhëtohet 10 herë brenda vitit, shuma totale është 1 000 000 lekë. Dietat do paguhet për 20 persona dhe do kenë një kohëzgjatje 2 ditore ( dmth 2500 x2 lek) nga ku 20 persona x 5000 lekë = 100 000 lekë</p> <p>10 aktivitete x 100 000 lek = 1 000 000</p>				
ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitim i grupit të synuar)				
Të realizojmë punën tonë dhe të rrisim kontributin në pasurimin e jetës artistike të Bashkisë Shkodër, duke rritur konkurrencshmërinë, cilësinë dhe përfshirjen qytetare				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kryerja e procedurave admin istrative <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i nevojave</li> <li>• Testimi i tregut</li> <li>• Tenderimi</li> <li>• Lidhja e kontratave</li> </ul> </li> <li>2. Kryerja e pagesave për udhëtimë brenda vendit</li> <li>3. Kryerja e pagesave për udhëtimeve jashtë vendit</li> <li>4. Monitorimi</li> </ol>				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitete të kryera në kohë</li> <li>• Përformancë e përmirësuar</li> <li>• Numër aktiviteteve të rritur</li> <li>• Numër spektatorësh të rritur</li> <li>• Të ardhura të rritura për institucionin</li> </ul>				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)</b>		
Administrata e teatrit Administratat e bashkisë		Bashkia e Shkodrës		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)</b>				
Shpenzimet për cdo aktivitet		Totali 000/ lekë	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
A.1	Procedurat administrative			kapitale
A.2	Udhëtimet brenda vendit	500		500



A.3	Udhëtimet jashtë vendit	500		500	
A.4	Monitorimi				
	<b>TOTALI</b>	<b>1 000</b>		<b>1 000</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2016</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>			

Nr. 45	<b>Projekti: P11.F2.O2.A1</b> Dita e Luleve 6 Maj	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit					
i. Situata (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën).					
Fillesat e këtij aktiviteti kanë prejardhje të hershme me ditën e Sh'Njergjit rreth viteve 1930. Ky aktivitet nuk është zhvilluar për shumë vite deri në rikthimin në vitin 2006 me emërtim "Dita e Luleve" dhe këtë vit është 10 vjetori.  Zakonisht zhvillohet në Pedonalet e qytetit, Serreq, sheshi "Nënë Tereza", Parrucë, Sheshi para Bashkisë Shkodër.					
ii. Synimi i projektit					
Zhvillimi dhe gjallërimi i jetës artistike, kulturore në qytet. Promovimi i turizmit. Konservimi i traditave.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Krijimi i Grupit të Punës, specialistë të turizmit, galerisë së arteve, Qendra Kulturore "Pjetër Gaci", etj. Organizimi i aktivitetit në këto zona: Kalanë Rozafa, Pedonalen Ura Bunës, Shirokë. Panari i Luleve. Ekspozitë artit pamor kushtuar pranverës dhe natyrës. Panair i punimeve artistike dhe produkteve ushqimore. Aktivitet me fëmijët me temë: "Shëtisin lulet në qytet". Aktivitet artistik për fëmijë në sheshin para Bashkisë. Këngë e valle nga ansambli i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci", pranë shatërvanit në pedonalen "Idromeno". Koncerti i madh festiv. Banda dhe grupi valleve.					
b) Rezultatet që prisni					
Aktivite kulturore dhe artistike të realizuara në Bashkinë e Shkodrës. Shkodra bëhet atraksion turistik e kulturor. Pjesëmarrje e qytetarëve në aktivitet. Aktivizimi kulturor i të rinjve.					
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt		
Komuniteti, bizneset, grupet muzikore rinore, piktorët e rinjë, nxënës të shkollave, etj.			Financohet nga Bashkia e Shkodrës, Qytetarët me anë të luleve, Nxënës të shkollave të ndryshme të qytetit, DAR Shkodër.		
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet			Total i (000 lek)	Nga kjo:	
A.1 Honorare				Paga, sig	transferte
A.2 Shpenzime të tjera skenë, foni, ndriçim dhe shpenzime të tjera për realizimin e aktivitetit.					kapitale
Shuma			<b>1200</b>		<b>1200</b>
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon vitit			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:  Eugjen Gargjola, Artan Draçini, Sidrit Lohja.		



Nr. 46	<b>Projekti: P11.F2.O2.A2</b> Ndërmendje	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit					
i. Situata .					
Në vitin 2008 u realizua për herë të parë koncerti me emërtim "Ndërmendje" në të cilin i jepet mundësia orkestrës simfonike për të performuar me një premierë. Në këtë koncert përmbledhen gjithashtu pjesët muzikore më të mira të vitit. Koncerti pasurohet edhe me pjesëmarrjen e artistëve më të shquar vendas të cilët performojnë në stile të ndryshme muzikore. Ndërmendje është aktivitet koncertor i cili përfshin të gjithë artistët e kualifikuar të qytetit.					
ii. Synimi i projektit					
Zhvillimi dhe gjallërimi i jetës artistike, kulturore në qytet. Promovimi i orkestrës simfonike.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Krijimi i Grupit të Punës, ku do të përfshihen të gjithë artistët aktivë të qytetit tonë. Programimi i provave në seksione të ndara (grupe). Organizimi i aktivitetit në Teatrin "Migjeni".					
b) Rezultatet që prisni					
Rritja e nivelit muzikor dhe bashkëpunimi ndërmjet artistëve. Përmirësimi i instrumentistëve. Pjesëmarrja e të gjitha mediave vendase					
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt		
Komuniteti, orkestra simfonike, mediat, shoqatat kulturore artistike.			Financohet nga Bashkia e Shkodrës dhe Banka Tirana.		
e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërme(pika iii)					
Shpenzimet për çdo aktivitet			Total i (000 lek)	Nga kjo:	
				Paga, sig	transferte
A. 1 Honorare					1100
A. 2 Shpenzime të tjera skenë, foni, ndriçim dhe shpenzime të tjera për realizimin e aktivitetit.					400
<b>Shuma</b>			<b>1500</b>	<b>1500</b>	
f) Periudha e zbatimit deri 28 Dhjetor			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Eugjen Gargjola, Kujtim Alia.		

Nr. 47	<b>Projekti: P11.F2.O2.A3</b> Lumturimi i Nënë Terezës	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
<b>i. Situata</b> ( Shjpego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)					
“Lumturimi i Nënë Terezës” zhvillohet në qytetin e Shkodrës prej disa viteve. Në këtë aktivitet parashikohet një koncert vokal-instrumental dhe recitime nga aktorët e fjalës poetike. Zakonisht koncerti është zhvilluar në Teatrin “Migjeni”.					
<b>ii. Synimi i projektit</b> ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problem kryesor, përfitimi i grupit të synuar)					
Nderimi i figurës së humanistes të madhe shqiptare e cila mban çmimin Nobel për paqen. Tradita e koncertit për Nënë Terezën. Aktivizimi i të rinjve (shkollave) në aktivitete bamirësie, frymëzuar nga Nënë Tereza.					
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>					
Propozim për kompozicion dedikuar figurës së Nënë Terezës. (kor dhe/ose orkestër harqesh/solist, 15 min për pjesë) Në vitin 2016 pritet shenjtërimi i Nënë Terezës dhe aktiviteti merr vlerë më të madhe. Do ishte mirë që në këtë koncert të kishte edhe <i>premiere kompozimi</i> i dedikuar kësaj figure.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Aktivizimi i të rinjve (shkollave) në aktivitete bamirësie, frymëzuar nga Nënë Tereza. Pjesëmarrje e gjerë e komunitetit në koncertin dedikuar Nënë Terezës.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Pjesëmarrja e të gjitha koreve të qytetit, kompozitorë, orkestër e vogël harqesh, aktorë dhe shkollat e qytetit.			Bashkia e Shkodrës.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>			Totali (000 lekë)	Nga kjo:	
A.1				Paga, sig	transferta
A.2					kapitale
<b>Shuma</b>			<b>505</b>	505	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Shtator – Tetor 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Eugjen Gargjola, Zef Coba, Gjon Shllaku, Markelian Kapedani, Rita Gjeka.		

Nr.48	<b>Projekti: P11.F2.O2.A4</b> Festivali i muzikës moderne.	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit					
i. Situata ( Shjpego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonen)					
Festivali i Muzikës Moderne zhvillohet prej 4 vitesh nga Shoqata Kulturore Prenkë Jakova në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. Gjatë këtyre viteve kanë marrë pjesë artistë të huaj, të ftuar (Alessandro Giachero-Drejtor i Siena Jazz, Gianni Dall'Aglio bateristi i Celentanos dhe Luca Marianini tromba e parë e "Pavarotti and Friends" e shumë të tjerë me famë botërore. Festivali është 3 ditor, zakonisht zhvillohet në Pedonalen Idromeno, Pedonalen Gjuhadol dhe sheshin para Bashkisë. Në çdo edicion përfshihen rreth 50 muzikantë të huaj dhe vendas. Në natën finale përformon Big-Band frymore e qytetit.					
ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problem kryesor, përfitimi i grupit të synuar)					
Promovimi i muzikës cilësore jazz, flamenco, pop, gospel, në qytetin tonë. Bashkëpunimi i artistëve internacionalë me artistët shqiptarë. Rritja e vlerave muzikore të artistëve vendas dhe edukimin e artdashësve me muzikë cilësore. "Master Class" në Shkollën e Muzikës Prenkë Jakova, e hapur për të gjithë.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Përgatitja e listës së pjesëmarrësve, vokalistë, instrumentistë, band, etj Përcaktimi i repertorit të përbashkët. Do të organizohen dy koncerte në Pedonalen Gjuhadol dhe Idromeno. Koncerti i natës finale do të zhvillohet në sheshin përpara Bashkisë së Shkodrës.					
b) Rezultatet që prisni ( shërbimet apo produktet që u dorezoni përfituesve të synuar)					
Gjallërimi i turizmit dhe përcjellja e imazheve kulturore të qytetit dhe jashtë kufijve. Aktiviteti me pjesëmarrjen më të madhe të artistëve ndërkombëtarë në Shkodër.					
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt			
Shoqata Prenkë Jakova, artistët e huaj, artistët vendas, rinia, shkolla muzikës, mediat, Big-Band frymore.		Kryesisht financon Bashkia e Shkodrës por do të kërkohen dhe sponsor të tjerë.			
e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërme (pika iii)					
Shpenzimet për çdo aktivitet		Total i (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	Transferta	kapitale
A.1	Honorare			300	
A.2	Shpenzime të tjera skenë, foni, ndriçim dhe shpenzime të tjera për realizimin e aktivitetit.			600	
	Shuma	<b>900</b>		<b>900</b>	
f) Periudha e zbatimit  Qershor		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:  Eugjen Gargjola, Gjon Shllaku.			

Nr. 49	<b>Projekti: P11.F2.O2.A5</b> Aktivitet me të persektuarit politik	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit					
i. Situata ( Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonen)					
Bashkia e Shkodrës mbështet çdo vit aktivitetet e Shoqatës me ish të përndjekurit politik. Në vitin 2015 në aktivitetin me këtë Shoqatë u realizuan 2 evente: Kinema forum, projekcion i dokumentarit "Në emër të pafajsisë" dhe promovimi i librit të autorit Marçel Hila me titull "Internimi i Kufomës".					
ii. Synimi i projektit					
Mbështetja morale ndaj dëshmitarëve të mbijetuar. Ruajtja e dëshmisë dhe kujtesës së historisë tonë. Ndikimi tek rinia e cila duhet të ketë një vizion të kthjelltë mbi realitetin historik.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet qe do të ndërmerri për të prodhuar rezultate)					
Realizimi i një vepre të madhe me tematikë mbi të persektuarit. Takim-Konferencë me të përndjekurit. Përfshirja e aktorëve të Teatrit dhe kompozitorëve. Përfshirja e shkollave në realizimin e një dokumentari me tematikë Gjenocidi Komunist.					
b) Rezultatet që prisni					
Nderimi dhe kujtimi i të përndjekurve politikë, gjatë periudhës së diktaturës. Informim i brezit të ri për krimet, dënimet, burgun e diktaturës komuniste në qytetin e Shkodrës.					
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarishtetj.)			
Do jenë të përfshirë "Shoqata e ish të persektuarve politikë", kompozitorë, aktorë, shkolla,		Kryesisht financohet nga Bashkia Shkodër, por duhen kontaktuar edhe "të tretë" për bashkëfinancim.			
e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërme (pika iii)					
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	transferta	kapitale
A.1	Honorare			600	
A.2	Shpenzime të tjera skenë, foni, ndriçim dhe shpenzime të tjera për realizimin e aktivitetit.			200	
<b>Shuma</b>		<b>800</b>		<b>800</b>	
f) Periudha e zbatimit  Gjatë vitit 2016		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:  Eugjen Gargjola, Tea Çuni, Pjerin Mirdita, Rita Gjeka.			

Nr.50	<b>Projekti: P11.F2.O2.A6</b> Aktivitete me rastin e 2 Prillit	Llojet e programit: P11. Kultura dhe shërbimet rekreacionale <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës		
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit				
i. Situata ( Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonen)				
Ky aktivitet organizohet nga Shoqata 2-prilli në bashkëpunim me Bashkinë e Shkodrës. Në këtë ditë organizohen homazhe dhe vendosen kurora në memorialin e 2-prillit e më pas vizita në shtëpitë e martirëve të demokracisë. Në varësi të viteve janë organizuar dhe mitingje me pjesëmarrje të madhe qytetare në mbështetje të kauzës së demokracisë. Aktiviteti më pas vazhdon me një koncert në Teatrin Migjeni, e më pas mbyllet veprimtaria me një koktejl për të gjithë të pranishmit në hollin e Hotel Turizmit.				
ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problem kryesor, përfitimi i grupit të synuar)				
Respektimi i Dëshmorëve të Demokracisë. Promovimi i ngjarjes së 2 Prillit 1991 dhe kujtimi i Heronjëve të Demokracisë				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vendosja e kurorave dhe homazhet tek memoriali i 2-prillit.</li> <li>2. Koncerti në Hollin e Teatrit Migjeni. Koncerti do të ketë repërtor të përzgjedhur në lidhje me tematikën. Pjesëmarrja e aktorëve.</li> <li>3. Koktejl per te gjithë pjesmarresit ne ceremonine e organizuar</li> </ol>				
b) Rezultatet që prisni				
Sensibilizimi i të gjithë qytetarëve dhe nderimi i familjeve të martirëve.				
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt	
Familjet e dëshmorëve dhe qytetarët.			Bashkia Shkodër.	
e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërme (pika iii)				
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (000 lekë)	Nga kjo:	
			Paga, sig	Shpenzime operative kapitale
A.1	1. Vendosja e kurorave dhe homazhet tek memoriali i 2-prillit. ( Kurora cope 4 x 2500 leke)			10
A.2	Koncerti në Hollin e Teatrit Migjeni. (Honorare 10 artista x 9 mije leke )			40
A.3	Koktejl per pjesmarresit			250
<b>Shuma</b>		<b>300</b>		<b>300</b>
f) Periudha e zbatimit deri Prill 2016			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Eugjen Gargjola, Kryetari shoqatës 2 Prilli	



Nr. 51	<b>Projekti:</b> P11.F2.O2.A7 "Shkodra Jazz Festival"	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit.</b>						
i. Situata (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonen)						
Edicioni i parë i festivalit ka filluar në vitin 2005 dhe është mbajtur për gjashtë edicione me radhë. Festivali 3 ditor është realizuar në Pedonalen Idromeno, Sheshin para Bashkisë dhe Teatrin Migjeni. Ky Festival është i pari në këtë stil në qytetin e Shkodrës. Shkodra Jazz Festival pati jehonë të madhe në të gjithë botën artistike dhe jo vetëm. Morën pjesë artistë të shquar ndërkombëtarë si Fred Ferrari, Eugenia Androne, Bruno Varalda, Silvana De Giovanni, Vagnarelli Stefano, Coni Ana, Fioravanti Gustavo, De Stefano Dario etj.						
ii. Synimi i projektit .						
Edukimi i spektatorëve me muzikën Jazz e cila ka më shumë se 100 vite histori. Shkodra të ketë një Festival Jazz, siç do qytet tjetër i emancipuar në Europë. Të krijohet një traditë e këtij stili muzikor me vlera të larta muzikore, historike dhe edukative.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Aktivizimi i të rinjve muzikantë që mund të përfornojnë gjatë jam-session (bashkepunim muzikore) me artistët e ftuar. Gjallërimi i rrugëve me aktivitete muzikore cilësore dhe profesionale. Aktivizimi i grupeve rinore si pjesë e stafit organizativ.						
<b>b) Rezultatet që prisni ( shërbimet apo produktet që u dorezoni përfutuesve të synuar)</b>						
Gjallërimi i turizmit dhe përcjellja e imazheve kulturore të qytetit edhe jashtë kufijve. Pjesëmarrje më të madhe të artistëve ndërkombëtarë në Shkodër.						
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Muzikantë të shquar në rang botërorë. Pjesëmarrja e disa artistëve shqiptarë që janë të aftë në këtë stili muzikor. Grupet rinore me stile muzikore të ndryshme.			Bashkia Shkodër Sponsor të ndryshëm			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërme (pika iii)</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>			Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
				Paga, sig	transferta	kapitale
A.1	Honorare			300		
A.2	Shpenzime të tjera skenë, foni, ndriçim dhe shpenzime të tjera për realizimin e aktivitetit.			700		
<b>Shuma</b>		<b>1000</b>		<b>1000</b>		
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  <b>Qershor- Gusht</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Eugjen Gargjola, Florian Jakaj, Labeat Jakaj, etj.			

Nr.52	<b>Projekti: P11.F2.O2.A8</b> Karnavalet	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës	
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>			
i. Situata			
<p>Karnavalet në qytetin e Shkodrës janë festuar që në vitin 1861. Ato kanë pasur tipikën e vet të prezantimit të trashëguar që është shpalosur si një opozitë ndaj problematikave prezente, po edhe atë të karakterit dëfryes e kulturor që ka sjell humor dhe optimizëm; tregues ky që Shkodra ka bërë përherë jetë kulturore të pasur dhe bashkëkohore perëndimore.</p> <p>Nga viti 2011 e në vazhdim, karnavalet u prezantuan nën drejtimin e punishtës së veshjeve e maskave "Arlekino", me mbështetjen financiare të Bashkisë së Shkodrës dhe të Ministrisë së Kulturës.</p> <p>Festimi i Karnaveleve gjatë viteve të fundit është fokusuar sidomos në paraqitjen e veshjeve e maskave tipike veneciane, për vetë faktin që kjo punishtë prodhon e tregon një produkt të tillë, por duke devijuar dukshëm nga festimet tipike shkodrane, me të cilat Shkodra krenohet dhe i ruante si vlerë e madhe e trashëgimisë kulturore.</p> <p>Duke u nisur nga ky fakt, që festimet karnavaleske tipike shkodrane po tjetërsohen dhe po e humbin qëllimin e tyre, mendohet që në bashkëpunim me shoqatat kulturore, organizatat e bizneset sociale, këtë vit të realizohet festimi i Karnaveleve sipas traditës së qytetit të Shkodrës, në tipikën e vet të bukur e të larmishme duke mos përjashtuar dhe modifikimet që koha sjell.</p>			
ii. Synimi i projektit			
<p>Të ripërtërijmë traditën e festimit të karnaveleve tipike shkodrane.</p> <p>Të transmetojmë në komunitet mesazhe paqeje, pajtimi, tolerance, e mirëkuptimi dhe asaj që është më e rëndësishme të drejtësisë.</p> <p>Të ndikojnë në përmirësimin dhe gjallërimin e jetës kulturore të qytetit e më gjerë.</p> <p>Të bëhen karnavalet një atraksion për shqiptarët dhe turistët e huaj, që do të duan të vizitojnë Shkodrën në këtë periudhë.</p> <p>Gjithashtu synohet futja e karnaveleve në guidat turistike në mënyrë që të jenë sa më të promovuara.</p> <p>Kërkohej që festa e karnaveleve të bëhet përherë e më tepër, festë mbarë qytetare, jo vetëm të prezencës shikuese por dhe të aktivizimit direkt të tyre me paraqitjen karnavaleske, qoftë kjo edhe modeste si dhe festimit të saj në familje, rrugë, lagje apo lokale, etj.</p>			
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerni për të prodhuar rezultate)			
<p>Krijimi i stafit që do të drejtojë dhe organizojë festën e karnaveleve për vitin 2016.</p> <p>Sigurimi i buxhetit e materialeve të nevojshme për të gjithë programin e parashikuar.</p> <p>Realizimi i kërkesave të dekorit karnavalesk për ambientet e jashtme e të brendshme ku do të zhvillohet aktiviteti.</p> <p>Realizimi i kërkesave të garderobës e maskave.</p> <p>Bërja e njohur nëpërmjet sponsorit mediak dhe promovimi në të gjithë median e shkruar, duke kërkuar sensibilizimin për pjesëmarrje sa më të gjërë të qytetarëve.</p> <p>Organizimi i aktiviteteve të ndryshme në katër ditët e festimeve të karnaveleve.</p> <p>Konferencë shtypi me gazetarët përpara dhe mbas aktivitetit, për të shtuar këtu popullaritetin e kësaj veprimtarie.</p>			
<b>b) Rezultatet që prisni</b>			
<p>Rikthimi i traditës së festimit të karnaveleve tipike shkodrane.</p> <p>Përmirësimi dhe gjallërimi i jetës social kulturore në qytetin e Shkodrës.</p> <p>Gjithëpërfshirja e komunitetit dhe pjesëmarrje e gjerë e komunitetit në festime.</p>			
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Komuniteti Organizatat Shkollat e qytetit Artistët (aktorë, poetë, instrumentistë, etj)		Bashkia Shkodër Shoqata Kulturore Organizatat Institucionet publike (Policia, DAR, etj)	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>			
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (lekë)	Nga kjo:
			Paga, sig      operative      kapitale
A.1	Materiale të veshjeve karnavaleske	340	340
A.2	Kërkesa të materialeve dekorative e kancelerike	240	240
A.3	Shpenzime te tjera	155	155
A.4	Promocion	225	225
A.6	TOTALI	<b>960</b>	<b>960</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar – Shkurt 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së Kulturës Stafi i institucioneve dhe organizatave e shoqatave partnere	

Nr.53	<b>Projekti: P11.F2.O2.A9</b> Koncertet e verës	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
<b>i. Situata</b>					
Vitin e kaluar, koncertet e verës u realizuan me pjesëmarrjen e Summer Jazz In Albania. Shoqata "Syri Blu" konceptoi, përgatiti, organizoi dhe realizoi edicionin e pestë të Festivalit Ndërkombëtar "Jazz in Albania 2016" i cili do të shtrihet në disa qytete kryesore të vendit. Në Festival morën pjesë rreth 9-12 grupe muzikore "Jazz" nga vende të ndryshme të botës si dhe grupe muzikore jazz shqiptare. Sejcili grup muzikor jazz përformon në 2-3 koncerte në qytetet ku zhvillohet ky Festival.					
<b>ii. Synimi i projektit</b>					
Të ketë sa më shumë koncerte të muzikës Jazz si edukim i lartë muzikor.  Me realizimin e Festivalit në qytete me trashëgimi kulturore elitare arrihet një mbështetje gjithnjë e më e zgjedhur e turizmit kulturor, promovimit në mënyrë të drejtëpërdrejtë të resurseve që menaxhojnë këto qytete.					
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do të ndermerni për te prodhuar rezultate)</b>					
Do jepen dy koncerte, të cilat do zhvillohen në Pedonalen Gjuhadol. Skena do vendoset pranë Qendrës Rinore Arka në mënyrë që ky stil muzikor të jetë sa më afër qytetarëve dhe sidomos të rinjve.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Të mos luhet pothuajse gjithmonë muzikë komerciale. Pjesëmarrja masive në koncertet Jazz. Frymëzimi për të eksperimentuar stile dinjitoze muzikore.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Të gjithë qytetarët artdashës, të rinjtë, muzikantët profesionist dhe amator			Bashkia Shkodër		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërme (pika iii))</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	transferta	kapitale
A.1	Honorare			250	
A.2	Shpenzime të tjera skenë, foni, ndriçim dhe shpenzime të tjera për realizimin e aktivitetit.			50	
<b>Shuma</b>		<b>300</b>		<b>300</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Korrik 2016, java e tretë.			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Besim Petrela, Eugjen Gargjola.		





Nr.54	<b>Projekti: P11.F2.O2.A10</b> Aktivitetet e fundvitit	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situat (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)					
Në dy vitet e shkuara, për festat e fundvitit është organizuar një treg artistik, festiv, dëfryes. Në sheshin "Nënë Tereza" vendosen disa shtëpiza të vogla druri të cilat do të ofrojnë shërbime dhe atraksione të ndryshme për qytetarët. Parashikohet vendosja e një podi dhe e fonisë në dispozicion për performanca të ndryshme muzikore.					
ii. Synimi i projektit .					
Zhvillimi dhe gjallërimi i qytetit në muajin e festave. Krijimi i një qendre atraktive për turizmin. Mundësimi i performancave të muzikantëve të rinj për publikun					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Marrëveshje në organizimin e të gjithë aktivitetit ndërmjet stafit të Bashkisë Shkodër dhe Shoqatës bashkëpunuese. Zbukurime artistike dekorative.					
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorezoni perfituesve të synuar)</b>					
Organizim i aktiviteteve të ndryshme artistike me rastin e festave të fundvitit.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Komuniteti		Bashkia Shkodër Organizatrat Bizneset			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	transferta	kapitale
A.1	Honorare			200	
<b>shuma</b>		<b>200</b>		<b>200</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> <b>4 dhjetor- 6 janar</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> <b>Eugen Gargjola</b>			

Nr.55	<b>Projekti: P11.F2.O2.A11</b> Dita Botërore e Muzikës	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
<b>i. Situata</b> (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)					
Çdo vit me datë 21 qershor është organizuar një koncert me rastin e ditës ndërkombëtare të muzikës. Ky aktivitet është organizuar nga shoqata kulturore Rozafa Expression me Kryetar Prof. Zef Çobën. Koncertet çdo vit janë realizuar me kualitet të lartë artistik.					
<b>ii. Synimi i projektit .</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Promovimi i vlerave të muzikës së kultivuar nëpërmjet interpretimit profesional.</li> <li>○ Aktivizimi i formacioneve të "muzikës së dhomës" si trio, kuartet, kuintet, etj.</li> <li>○ Pasurimi i repertorit klasik, për artistët dhe artdashësit.</li> </ul>					
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b> (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Takime me Kryetarin e Shoqatës Bashkëpunuese me ekspertë të Bashkisë Shkodër.</li> <li>▪ Promovimi i aktivitetit nëpërmjet agjensive turistike si vlerë artistike e qytetit.</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Shoqatat Kulturore. Pjesëmarrja e qytetarëve dhe turistëve në aktivitet Promovimi i vlerave të muzikës klasike.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Shoqata Rozafa Expression, solistë, instrumentistë dhe koristë.			Bashkia Shkodër financoon realizimin e koncertit.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	transfera	kapitale
A.1	Honorare			200	
<b>Shuma</b>		<b>200</b>		<b>200</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Maj- 21 Qeshor.			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Zef Çoba, Eugjen Gargjola		

Nr.56	<b>Projekti: P11.F2.O2.A12</b> Dita e Artizanatit dhe Zejeve	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekracionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
<b>i. Situata</b> (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)					
Në qytetin e Shkodrës ekzistojnë disa shoqata që merren me punimet Artizanale. Përveç shoqatave janë dhe disa zona në rrethina që janë të specializuara në këtë fushë. Dita e Artizanit dhe Zejeve është një aktivitet i veçantë që Bashkia mbështet shoqatat për të realizuar 2-3 ditë panairë me punimet artizanale si vlerë e lartë trashëgimie.					
<b>ii. Synimi i projektit</b>					
Promovimi i punimeve Artizanale, atraksioni për turistat që janë relativisht në numër të lartë në Shkodër, Frymëzim për të rinjtë që të vazhdojnë këtë traditë.					
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>					
E rëndësishme është që të shihet me prioritet dhe prurja e imazhit dekorativ të rinovuar.. Do të angazhohemi që në këtë aktivitet të marrin pjesë disa shoqata ekzistuese në Shkodër dhe rrethina që merren me punimet e artizanatit.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Të ketë impakt të lartë interesi tek komuniteti dhe tek turistat. Rrethinat të më i madh duke e realizuar këtë aktivitet në zona ku realizohen punimet artizanale si p.sh në Shirokë, apo dhe në ndonjë zonë tjetër.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Shoqatat dhe individë që merren me punime artizanale			Kryesisht financohet nga shoqata e artizanatit dhe nga Bashkia Shkodër.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	transferta	kapitale
A.1	Shpenzime të tjera për realizimin e aktivitetit			200	
<b>Shuma</b>		<b>200</b>		<b>200</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Qeshor 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Zef Gjini, Gentian Mema		

Nr.57	<b>Projekti: P11.F2.O2.A13</b> Aktivitete të ndryshme gjatë vitit.	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
<b>i. Situata</b> (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)					
Gjatë vitit vijnë propozime të ndryshme për mbështetje të instrumentistëve dhe artistëve, kërkesa këto shumë të vlefshme të zhanreve të ndryshme. Në këto kushte ne e kemi të vështirë planifikimin e këtyre çasjeve artistike. Meqenëse një pjesë e mirë e tyre janë cilësore atëherë sugjerojmë që mund ta përdorim gjatë vitit në vijim për mbështetjen e këtyre prurjeve.					
<b>ii. Synimi i projektit .</b>					
Të krijojmë një fond të veçantë rezervë me klasifikimin "honorare të ndryshme gjatë vitit" Ky fond na lejon të rrisim ndjeshëm numrin e aktiviteteve të vogla dhe të mesme.					
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Marrje informacioni për prezencën e përkohshme të artistëve të shquar në terren.</li> <li>▪ Zyra kulturës do mbajë lidhje të vazhdueshme me Shoqata dhe Agjensi që organizojnë Evente Artistike.</li> </ul>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mirëpritja e artistëve të kualifikuar që ofrohen të performojnë në qytetin tonë.</li> <li>• Koncerte të nivelit të lartë artistik.</li> <li>• Edukimi i publikut në dëgjimin e veprave të pa konsumuara (premiere).</li> </ul>					
<b>c) Aktoret e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Shoqatat Artistike, artistët, publiku etj.			Bashkia Shkodër		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura (për cdo aktivitet të mësipërm (pika iii))</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	transferta	kapitale
A.1	Honorare			800	
A.2	Shpenzime të tjera të paparashikuara gjatë vitit			176	
A.3	Buqeta lulesh për të fuarit (12 copë)			24	
<b>Shuma</b>		<b>1 000</b>		<b>1 000</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>		
Gjatë gjithë vitit			Eugjen Gargjola, Sanida Kraja, Ingrid Gushta, Gerti Gjyli.		

Nr.58	Projekti: <b>P11. F2.O2.A14</b> Honorare anëtarët e këshillit kulturor artistik	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit					
i. Situata					
<p>Në Bashkinë e Shkodrës funksionojme disa institucione kulturorenë varesi saj të cilat janë përgjegjëse për planifikimin dhe organizimin a aktiviteve kulturore, kulturore e sportive. Njekohësisht sektori i kultures dhe sportit pranë Bashkisë planifikon dhe organizon aktiviteve kulturore, artistike e sportive në bashkëpunim me institucionet e varesisë dhe me partner jashtë institucionit të Bashkisë. Bashkëpunimi me partnerët privat si individe ose OJF ka qënë i vështirë nga ana administrative dhe pak transparent në përzgjedhjen e tyre.</p> <p>Në mbështetje të VKM 150, datë 03/04/1993, ndyshuar me VKM 315, datë 8/07/1999, Udhëzimi nr 1 datë 17/06/1999 të Ministrisë së Kultures Rinisë dhe Sporteve, të Udhëzimit të përbashkët nr 5 datë 18/05/2000 të Ministrisë së Kultures dhe Ministrisë së Financave, si dhe të Udhëzimit Nr 1, datë 24/05/2005 të Ministrisë se Kultures Rinisë dhe Sporteve "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko-kulturore", krijohet dhe funksionon Këshilli artistiko-kulturor pranë Bashkisë së Shkodrës, planifikojmë të krijojmë pranë Bashkisë së Shkodrës Këshillin Kulturor dhe Artistik.</p>					
ii. Synimi i projektit					
Krijimin pranë Bashkisë së Shkodrës të Këshillit Kulturor dhe artistik. Rritjen e transparencës dhe të efciences në zbatimin e projekteve te aktiviteve kulturore, artistike, teatrore dhe sportive pranë Bashkisë së Shkodrës.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Perzgedhja e 11 Anëtareve të Këshillit Kulturo dhe Artistik pranë Bashkisë së Shkodrës me personalitete prej fushës së artit, sportit, teatrit, muzikes, etj. Përzgedhja e projekteve kulturore, artistike, teatrore dhe sportive pjese a gjendes se Bashkisë së Shkodrës. Organizimi i së pakut 4 - 8 mbledhjeve në vit të Këshillit Kulturore Artistik.					
b) Rezultatet që prisni					
Këshilli Kulturor dhe Artistik pranë Bashkisë së Shkodrës i krijuar dhe funksiona. Organizimi i thirrjeve për propozim dhe vleresimi i projekteve kulturore, artistike dhe sportive. Rritja e transparencës dhe e efciences në zbatimin e aktiviteve të mësipërme pranë Bashkisë Shkodër.					
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt		
Artistë, Institucione kulturore, Sportiste, Nxenes dhe studente Spektatorë			Bashkia Shkodër, OJF, Profesioniste,		
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për cdo aktivitet		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Honorare për anëtarë 10 x 11 anëtarë dhe 8 mbledhje ne vit	880		880	
A.2	Sherbime te tjera	120		120	
Shuma		1 000		1 000	
f) Periudha e zbatimit Mars –Dhjetor 2016			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:  Drejtorja e Kultures, Arsimit, Sportit dhe Rinise		

Nr.59	<b>Projekti: P11.F2.O2.A15</b> Lëvizja e Postribës	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
<b>i. Situata</b> (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)					
Nëntë shtatori sjell çdo vit përvjetorin e Lëvizjes Antikomuniste të Postribës, e cila ndodhi përkatësisht me 9 shtator të vitit 1946. Postriba erdhi si revoltë ndaj regjimit komunist dhe është provë e pakundërshtueshme e rezistencës së shqiptarëve ndaj diktaturës komuniste.					
<b>ii. Synimi i projektit</b>					
Të promovojmë ngjarje të rëndësishme të historisë antikomuniste të vendit tone. Të ruajmë dhe të zhvillojmë e traditave historike e kulturore të popullit shqiptar. Synojmë informim dhe sensibilizim të të rinjve për të njohur historinë dhe traditat e zonës tyre					
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>					
Organizimi i grupit të punës për aktivitetin. Performancë e bandës frymore të qytetit. Recitime nga aktorët e teatrit "Migjeni". Mbajtja e fjalëve përshëndetëse nga autoritetet kryesore vendore dhe qendrore. Vendosja e kurorave në memorialin e "Lëvizjes së Postribës".					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Organizimi i aktivitetit kulturor, artistik, historik "Lëvizja e Postribës". Promovimi i ngjarjeve të rëndësishme historike, antikomuniste të vendit tonë. Informimi dhe sensibilizimi i të rinjve mbi traditën dhe historinë e vendit tonë.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Komuniteti Banda frymore e qytetit Aktorët e Teatrit "Migjeni" Përfaqësues të politikës Njësia administrative, Postribë			Bashkia Shkodër.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	transferta	kapitale
A.1	Transport për trupën e bandës frymore			5	
A.2	Koktejl/katering			65	
<b>Shuma</b>		<b>70</b>		<b>70</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> gusht – shtator 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Stafi i drejtorisë së Kulturës Banda frymore e qytetit Aktorët e teatrit "Migjeni"		

Nr.60	<b>Projekti: P11.F2.O2.A16</b> "Koncert – Premiere i Orkestrës Frymore" në Tiranë	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
<b>i. Situata</b>				
<p>Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unike që ka qyteti ynë me fillimet e saj të hershme që nga viti 1876.</p> <p>Siç dihet ky formacion është vijues i traditave më të mira të formacioneve që kanë debutuar në qytetin e Shkodrës dhe jo vetëm.</p> <p>E mbështetur nga Bashkia e Shkodrës dhe e menaxhuar nga Qendra Kulturore "Pjetër Gaci", është një formacion mjaft i konsoliduar.</p> <p>Në vitin 2009 ky formacion fitoi çmimin e parë në një festival ndërkombëtar në Xhulia-Nova Itali.</p> <p>Gjithashtu ky formacion është fitues në shumë takime kombëtare të organizuara ndër vite të orkestrave frymore.</p> <p>Për këto arsye, duke parë potencialin artistik të saj duhet të angazhohet sa më tepër me koncerte dhe pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme brënda dhe jashtë vendit.</p> <p>Prandaj është duke u punuar që kjo trupë të realizojë një koncert në kryeqytetin e Shqipërisë, në Tiranë për ti dhënë një vlerë kombëtare këtij formacioni, duke zgjuar interesin e specialistëve të shumtë, artdashësve dhe mediave të shumta.</p>				
<b>ii. Synimi i projektit</b>				
<p>Promovimi i Orkestrës Frymore në rang kombëtar dhe më gjërë.</p> <p>Promovimi i vlerave si një qytet me tradita kulturore dhe historike.</p> <p>Rritja e nivelit artistik duke e mbajtur këtë formacion në skenat me prestigjioze kombëtare.</p>				
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>				
<p>Ngritja e grupit realizues.</p> <p>Përzgjedhja e repertorit.</p> <p>Sigurimi i partiturave.</p> <p>Sigurimi i ambienteve, fonisë dhe ndriçimit.</p> <p>Sigurimi i transportit.</p> <p>Prova intensive me orkestrën dhe këngëtarët e ftuar.</p> <p>Përgatitja e materialeve promociionale dhe reklamimi cilësor në media.</p> <p>Bashkërendimi i punëve me zyrën ekonomike të kulturës për realizimin.</p>				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
<p>Krijohet vëmendje maksimale për këtë formacion, i cili është unik në llojin e tij për të siguruar dhe vazhdimësinë.</p> <p>Përfiton qyteti i Shkodrës që ruan traditën e këtij formacioni që njihet në arenën kombëtare e ndërkombëtare</p>				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Komuniteti artistik, instrumentistët dhe muzikantët, artdashës të muzikës por dhe më gjërë.			Bashkia Shkodër.	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
A.1	Këngëtar (Honorare)			190
A.2	Shpenzime transporti			30
A.3	Ftesa postera banera			24
A.4	Ambient me qera			40
<b>Totali</b>		<b>284</b>		<b>284</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Qershor 2016.			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" Sidrit Lohja	

Pasqyra e shpenzimeve për realizimin e aktivitetit

**“Koncert-Premiere i Orkestrës Frymore në Tiranë”**

Këngëtar	3 persona	x	10.000 lekë	=	30.000 lekë
Krijimtari me autorë shqiptarë 3 vepra muzikore	x	40.000 lekë	=	120.000 lekë	
Konferencier	1 person	x	15.000 lekë	=	15.000 lekë
Skenari/kordinator	1 person	x	15.000 lekë	=	15.000 lekë
Prapavija				=	10.000 lekë
Shpenzime transporti		vajtje-ardhje		=	30.000 lekë
Ambjent me qera				=	40.000 lekë
Poster	50cm x 70cm x 10 copë	x	500 lekë	=	5.000 lekë
Poster në baner				=	12.000 lekë
Ftesa	200 copë	x	30 lekë	=	7.000 lekë
<b>TOTAL</b>				=	<b>284.000 lekë</b>



Nr.61	<b>Projekti: P11.F2.O2.A17</b> Çmimi "Pjetër Gaci" Edicioni 15-të	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
<b>I. Situata</b>					
<p>Çmimi "Pjetër Gaci" është një takim interpretuesish në fushën e muzikës së kultivuar. Nga viti 2000 e në vazhdim, ky aktivitet organizohet çdo vit në qytetin e Shkodrës nga Qendra Kulturore "Pjetër Gaci". Dimensionohet si një konkurs kombëtar-rajonale me shtrirje ballkanike, i cili nga viti në vit është konsoliduar. Ai është i ndarë në kategori dhe degë të veçanta muzikore dhe pjesëmarrja është e lirë në bazë të kriterëve të përcaktuara nga stafi organizator duke bashkëpunuar në mënyrë specifike me shkollat artistike dhe shoqatat artistike. Aktiviteti zgjat tre ditë dhe regjistrimi në konkurs bëhet kundrejt shumës 500 lekë për person. Juria e çdo kategorie përbëhet nga tre personalitete të muzikës ku njëri anëtar jurie është i huaj. Juritë mbledhen në finale për të dhënë çmimin special.</p> <p>Në edicionin e fundit kanë marrë pjesë rreth 100 konkurentë nga vendi dhe rajoni. Bie në sy niveli i lartë i pjesëmarrësve nga Tirana dhe nga shkolla e Podgoricës. Në përvjetorin e 15-të të aktivitetit që përkon dhe me 85-vjetorin e lindjes së artistit Pjetër Gaci është menduar të realizohet një koncert me artistë të ftuar, fitues të edicioneve të kaluara dhe një ekspozitë me fotografi të edicioneve ndër vite. Në këtë aktivitet dega e Pianos është paraqitur mjaft mirë, ndërsa nevojitet të ketë më tepër bashkëpunim me shkollën artistike "Prenkë Jakova", sidomos në degët Kanto dhe Harqe.</p> <p>Mungesa e instrumenteve cilësore si piano-forte (koncertore) ka sjellë mjaft shqetësime në mbarëvajtjen e konkurimit.</p>					
<b>II. Synimi i projektit</b>					
<p>Gjallërimi i jetës artistike të qytetit. Evidentimi dhe promovimi i talenteve të reja në degë të ndryshme muzikore duke ballafaquar njëkohësisht shkolla dhe stile të ndryshme interpretimi. Promovimi i vlerave si një qytet me tradita kulturore dhe historike në pjesëmarrësit e shumtë që vijnë nga qytete dhe vende të tjera.</p>					
<b>III. Aktivitetet kryesore të projektit</b>					
<p>Ngritja e grupit realizues. Bashkëpunim me institucione dhe specialistë që përfaqësojnë shkollat artistike pjesëmarrëse. Sigurimi i pjesëmarrjes, brenda dhe jashtë vendit. Përzgjedhja e një jurie profesionale me personalitete shqiptarë dhe të huaj. Sigurimi i infrastrukturës, hoteleri, restorante dhe ambiente ku do të mbahen audicionet. Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promocionale. Realizimi i dekorit. Përgatitja për realizimin e ekspozitës. Bashkërendimi i punëve me zyrën ekonomike të kulturës për realizimin e aktivitetit.</p>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<p>Rritje e interesit dhe e cilësisë së interpretimit të muzikës së kultivuar. Edukimi i shijeve artistike të artdashësve në masë të gjërë, duke bashkëpunuar dhe me TV serioze. Promovimi i talenteve të reja në fushën e muzikës së kultivuar.</p>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Artistët e rinj dhe artdashësit. Shkollat artistike Komuniteti artistik.			Bashkia Shkodër. Të ardhurat nga rregjistrimet. Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër. Galeria e Arteve Shkodër. Teatri "Migjeni" Fondacioni "Loutier sans Frontier" Belgjike. (e cila dhuron çdo vit instrumente që kushtojnë për fëmijët fitues, të talentuar që nuk kanë mundësi financiare.)		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:		
A.1	Çmimi "Pjetër Gaci" Edicioni 15-të		Paga, sig	operative	kapitale
		<b>1308.5</b>		<b>1 308.5</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Viti 2016.		<b>g) Përgatitja dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Stafi i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" Sidrit Lohja			



**Pasqyra e shpenzimeve për realizimin e “Çmimi Pjetër Gaci” Edicioni 15.**

Fituesit për çdo kategori		7 interpretues	x 14.000 lekë	=	98.000 lekë
Fituesit për çdo kategori (cikli i lartë)		3 interpretues	x 20.000 lekë	=	60.000 lekë
Çmimi Special		1 interpretues	x 50.000 lekë	=	50.000 lekë
Juria		6 persona	x 20.000 lekë	=	120.000 lekë
Juria (personalitete jashtë vendit tonë)	3 persona		x 35.000 lekë=		105.000 lekë
Udhëheqës artistik	1 person		x 30.000 lekë=		30.000 lekë
Konsulent artistik	1 person		x 20.000 lekë	=	20.000 lekë
Asistentë artistik në rrethe	5 personax	10.000 lekë		=	50.000 lekë
Shoqërues në piano	2 persona		x 25.000 lekë	=	50.000 lekë
Skenari/kordinator	1		x 30.000 lekë	=	30.000 lekë
Akordues piano dhe mirëmbajtje	2		x 10.000 lekë	=	20.000 lekë
Konferencier dhe libret	1		x 15.000 lekë	=	15.000 lekë
Prapavija	2		x 10.000 lekë	=	20.000 lekë
Artist i/e ftuar	1 grup		x 35.000 lekë	=	35.000 lekë
Trajtim ushqimor	50 persona	x 2 ditë x	1.200 lekë	=	120.000 lekë
Fjetje	40 persona	x 2 netë x	1.500 lekë	=	120.000 lekë
Fjetje (të ftuar special dhe juria)	10 persona	x 3 netë x	4.000 lekë	=	120.000 lekë
Ambjente me qera (Salla kokurimi)	2 ditë	x 15.000 lekë		=	30.000 lekë
Shtypje biletash per pjesmarresit				=	10.000 lekë
Realizimi i një ekspozite në kuadër të edicionit të 15-të				=	100.000 lekë
Foni				=	10.000 lekë
Fletëpalosje		A4 x 2.000 copë x	30 lekë	=	60.000 lekë
Ftesa		200 copë x	30 lekë	=	6.000 lekë
Poster		50cm x 70cm x 70 copë x	250 lekë	=	17.500 lekë
Poster në baner		150cm x 200cm x 2 copë x	6.000 lekë	=	12.000 lekë
<b>TOTALI</b>				<b>=</b>	<b>1 308 500lekë</b>



Nr.62	<b>Projekti: P11.F2.O2.A18</b> "Ahengu Shkodran"	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
<b>I. Situata</b>				
<p>Pjesë e traditës së këngës popullore shkodrane është dhe Ahengu Shkodran, i cili me të drejtë është shpallur si një ndër shtatë kryeveprat e trashëgimisë shpirtërore shqiptare.</p> <p>Duke u nisur nga kjo, në ditën e trashëgimisë kulturore, organizojmë aktivitetin tradicional "Ahengu Shkodran".</p> <p>Është një aktivitet me një ndjeshmëri të lartë artistikë shpirtërore për qytetin, ku janë të përfshirë forcat më të mira krijuese dhe interpretuese të kësaj trashëgimie.</p> <p>Vitet e fundit është vënë re që në ambientet festive familjare të qytetit ka devijime të shijeve artistike që përfaqësojnë trashëgiminë kulturore muzikore të Shkodrës, sidomos për edukimin e të rinjve.</p> <p>Ahengu Shkodran do të realizohet në ambientet e Muzeut Historik "Oso Kuka" ose në ndonjë ambjent karakteristik të ngjashëm me të, pasi ky ambjent të sjell ndërmend kopshtet dhe bahçet e dikurshme të Shkodrës, aty ku kjo këngë mori jetë.</p> <p>Aktiviteti do të regjistrohet në studio – audio, masteri do të përdoret për promovime të ndryshme.</p>				
<b>II. Synimi i projektit</b>				
<p>Vazhdimësia e kësaj tradite, e cila ne na dallon nga të gjitha trevat e tjera.</p> <p>Edukimi i brezit të ri me bukurinë e këngës shkodrane duke e transmetuar brez pas brezi si trashëgimi shpirtërore e popullit tonë.</p> <p>Nxitja e turizmit kulturor.</p>				
<b>III. Aktivitetet kryesore të projektit</b>				
<p>Ngritja e grupit realizues.</p> <p>Përzgjedhja e repertorit, këngëtarëve dhe instrumentistëve.</p> <p>Përgatitja dhe realizimi i materialeve promovionale.</p> <p>Realizimi i dekorit, fonisë, ndriçimit dhe ambjenteve.</p> <p>Shtypja e biletave.</p> <p>Bashkërendimi i punëve me zyrën ekonomike të kulturës për realizimin.</p>				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
<p>Rritje e interesit dhe e cilësisë së interpretimit të këngës popullore sidomos tek këngëtarët e rinj.</p> <p>Edukimi i shijeve artistike të artdashësve në masë të gjërë, duke bashkëpunuar dhe me TV serioze.</p> <p>Promovimi i figurave të njohura që kanë kontribuar në fushën e këngës popullore.</p> <p>Çmimi i biletës do të jetë simbolik për artdashësit që duan ta ndjekin aktivitetin, 200 lekë.</p>				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Komuniteti artistik Artdashës. Instrumentist			Bashkia Shkodër. Muzeu Historik "Oso Kuka". Të ardhurat nga biletat.	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
A.1	"Ahengu Shkodran"			478.5
<b>Totali</b>		<b>478.5</b>		<b>478.5</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>	
29 Shtator 2016			Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" Sidrit Lohja	

**Pasqyra e shpenzimeve për realizimin e aktivitetit “Ahengu Shkodran”2016.**

Këngëtar	8 persona	x	10.000 lekë	=	80.000 lekë
Këngëtar të rinj	8 persona	x	8.000 lekë	=	64.000 lekë
Konferencier	1 person	x	15.000 lekë	=	15.000 lekë
Skenari/kordinator	1 person	x	15.000 lekë	=	15.000 lekë
Orkestrime	15 këngë	x	8.000 lekë	=	120.000 lekë
Prapavija	2 persona	x	10.000 lekë	=	20.000 lekë
Regjistrim në studio (Audio)	1 person	x	40.000 lekë	=	40.000 lekë
Dekor				=	20.000 lekë
Shpenzime per ftesa + bileta				=	15.000 lekë
Karrige plastike me qera	300 copë	x	100 lekë	=	30.000 lekë
Poster	50cm x 70cm	x	70 copë	x	250 lekë
Poster në baner	150cm x 200cm	x	2 copë	x	6.000 lekë
Fletëpalosje (karton)	44cm x 21cm	x	1.000 copë	x	30 lekë
<b>TOTAL</b>				=	<b>478.500 lekë</b>



Nr.63	<b>Projekti: P11.F2.O2.A19</b> "Riaktivizimi i Grupit të Valleve"	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet reaktivizionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
<b>i. Situata</b>		
<p>Grupi i valleve ka një traditë në vite me një numër të madh pjesmarrësish dhe drejtues të njohur, të cilët kanë kontribuar në shumë aktivitete të ndryshme, duke na lënë një pasuri të çmuar në këtë fushë.</p> <p>Siç dihet edhe kërcimi dhe vallja kanë shoqëruar popullin tonë në festa të ndryshme me karakter familjar apo ritualistik deri në kohët e sotme.</p> <p>Profesionistë dhe amatore të kësaj fushe u mbështetën në këtë traditë të pasur dhe arritën të realizonin shfaqje me vlera artistike në bashkëpunim dhe me artet e tjera të zhvilluar në qytetin tonë.</p> <p>Janë inskenuar tablo të ndryshme, akte operash, dasma, përfaqësim ansamblesh brënda dhe jashtë vendit.</p> <p>Pjesmarrja ka qënë thuajse në të gjitha festivalet popullore dhe folklorike ku dhe jemi nderuar me trofe si grup dhe në elemente të vecantë.</p> <p>Mund të përmendim emra të njohur në vite që kanë lënë gjurmë në artin e kërcimit si; Nexhat Agolli, Gëzim Kaceli, Kolec Thani, Filip Gjergji, Nikolin Ujka, Skënder Cani, Sirian Selimi, Vladimir Seiti dhe pas viteve 90-të me koreografin Aldo Nika i cili vazhdon me ambicie profesionale ta ushtrojë këtë profesion.</p> <p>E shohim të arsyeshme që ky grup të riaktivizohet duke iu bashkangjitur përsëri Qendrës Kulturore "P.Gaci" me pagesa mujore ku do të realizojë aktivitetet si:</p> <p>A) Koncerte festive. Karnavalet e Shkodrës. Dita e Luleve. Dita e Liqenit. Aktiviteteve artistike në ambiente të ndryshme të qytetit dhe në zona rurale.</p> <p>B) Pjesmarrje dhe përfaqësim në aktivitete kulturore të qytetit dhe në festivale folklorike kombëtare dhe ndërkombëtare. Festivali Folklorik Kombëtar Gjirokastrë. Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Valles Popullore Burimore. Oda Dibrane. Ahengu Shkodran.</p> <p>Panaire të ndryshme me karakter artizanale dhe turistike. Dita Botërore e Turizmit. Dita e Artizanatit dhe Zejeve.</p> <p>Grupi i valleve i mbështetur nga Bashkia Shkodër do të menazhohet nga Qendra e Kulturës "Pjetër Gaci" që ka në dispozicion koreografin dhe bazën materiale që i duhet trupës. Kjo trupë do të përbëhet nga 12 persona, 6 vajza dhe 6 djem për 10 muaj të vitit. Ajo do t'i përgjigjet të gjitha aktiviteteve artistike që kërkojnë këto institucione.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
Konsolidimi i një grupi kompakt dhe eficient me valltarë që t'i përgjigjet nevojave eventuale të qytetit. Ruajtja e traditës së këtij formacioni. Realizimi i aktiviteteve me rastin e festave të ndryshme. Gjallërimi i jetës artistike të qytetit. Promovimi i vlerave artistike të kësaj trupe. Nxitja e turizmit kulturor.		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
Përzgjedhja e elementëve më cilësorë (valltarëve). Realizimi i kontratës kolektive me valltarët. Realizimi i projekteve të ndryshme artistike për trupën dhe konkretizimi i tyre. Përzgjedhja e repertorit për të gjitha aktivitetet. Prova intensive me trupën. Përgatitja e materialeve promocionale. Promovimi në media i të gjitha aktiviteteve.		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
Ruajmë traditën e këtij formacioni. Edukimi i brezit të ri me elementë të traditës dhe asaj bashkëkohore. Spektatorët marrin kënaqësinë e dëshiruar gjatë performancave artistike.		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Komuniteti artistik, valltarët.	Bashkia Shkodër.	

<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	Kapitale
A.1	Honorare "Riaktivizimi i Grupit të Valleve" (12 persona x 6.000 lekë x 10 muaj)			720	
<b>Shuma</b>		<b>720</b>			
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë 10 muajve të vitit 2016		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Sidrit Lohja			



Nr.64	<b>Projekti: P11.F2.O2.A20</b> "Festivali i Këngës Qytetare" me krijimtari të re.	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekracionale  <b>Funksioni: P11.F2.</b> Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
<b>i. Situata</b>				
<p>Organizimi i një festivali të tillë për herë të parë që pas viteve 90-të, me qëllimin që t'i japë një dimension të ri këngës popullore, qytetare shkodrane, duke ruajtur vazhdimësinë e këngës tradicionale, aq e dashur dhe e njohur jo vetëm në mjediset tona por dhe në gjithë realitetin shqiptar.</p> <p>Festivali do të zgjasë 3 netë dhe do të ketë një gjithëpërshirje të krijuesve në muzikë, tekste, orkestrues dhe interpretues të afirmuar dhe të rinj.</p> <p>Gjithashtu bëhet një barrierë e fuqishme e shumë krijimeve të rëndomta që sot po i serviren publikut si krijime popullore shkodrane, por që s'kanë lidhje me këtë traditë.</p> <p>Krijimtaria dhe interpretimi do të vlerësohen nga njëri prej komponentëve që përbëjnë këngën (kompozitori, autori i tekstit ose këngëtar) .</p> <p>Çmimi i biletës do të jetë simbolik për artdashësit që duan ta ndjekin aktivitetin, 300 lekë.</p>				
<b>ii. Synimi i projektit</b>				
<p>Ruajtja e këngës popullore shkodrane dhe pasurimi me këngë të reja qytetare.</p> <p>Edukimi dhe afirmimi i artistëve, kryesisht i brezit të ri, të cilët e duan dhe e promovojnë këngën popullore shkodrane dhe shqiptare.</p> <p>Nxitja e turizmit kulturor.</p>				
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>				
<p>Ngritja e grupit realizues.</p> <p>Kontakti me krijuesit, përzgjedhja e këngëve, këngëtarëve dhe instrumentistëve.</p> <p>Prova intensive me orkestrën dhe këngëtarët.</p> <p>Sigurimi i ambjenteve, fonisë, ndriçimit dhe e gjithë bazës materiale.</p> <p>Përgatitja e materialeve promocionale dhe reklamimi cilësor në media.</p> <p>Realizimi i dekorit të ambjenteve.</p> <p>Bashkërendimi i punëve me zyrën ekonomike të kulturës për realizimin.</p>				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
<p>Rritja e interesit për të gjithë komunitetin artistik dhe artdashës, për ruajtjen dhe pasurimin me repertor të ri të kësaj trashëgimie, e cila na dallon nga kulturat e komuniteteve të tjera.</p> <p>Rritja e nivelin artistik të krijimit dhe të interpretimit.</p> <p>Gjallërimi i mëtejshëm i jetës artistike në qytet dhe më gjërë.</p>				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Komuniteti artistik dhe artdashës.		Bashkia Shkodër. Teatri "Migjeni". Të ardhurat nga biletat.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
A.1	"Festivali i Këngës Qytetare" me krijimtari të re.			1 284.5
<b>Totali</b>		<b>1284.5</b>		<b>1284.5</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Nëntor 2016.		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" Sidrit Lohja		

**Pasqyra e shpenzimeve për aktivitetin “Festivali i Këngës Qytetare” me krijimtari të re.**

Muzika	16	x	20.000 lekë	=	320.000 lekë
Teksti	16	x	10.000 lekë	=	160.000 lekë
Orkestrime	16	x	10.000 lekë	=	160.000 lekë
Këngëtar	16 persona	x	10.000 lekë	=	160.000 lekë
Instrumentist	4	x	25.000 lekë	=	100.000 lekë
Çmimi i parë				=	100.000 lekë
Çmimi i dytë				=	70.000 lekë
Çmimi i tretë				=	50.000 lekë
Udhëheqës artistik				=	30.000 lekë
Konferencier	1 person	x	20.000 lekë	=	20.000 lekë
Skenari/kordinator	1 person	x	15.000 lekë	=	15.000 lekë
Prapavija				=	20.000 lekë
Dekor				=	30.000 lekë
Bileta				=	10.000 lekë
Poster	50cm x 70cm x 70 copë	x	250 lekë	=	17.500 lekë
Poster në baner	150cm x 200cm x 2 copë	x	6.000 lekë	=	12.000 lekë
Ftesa, diploma dhe çertifikata				=	10.000 lekë
<b>Totali</b>				=	<b>1 284 500 lekë</b>





Nr.65	<b>Projekti:</b> P11.F2.O2.A21 "Formacioni i Harqeve - Riorganizimi dhe aktivitetet"	<b>Llojet e programit:</b> P11. Kultura dhe shërbimet rekracionale  <b>Funksioni:</b> P11.F2. Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës	
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>			
<b>i. Situata</b>			
<p>Formacioni i Harqeve është një sektor shumë i rëndësishëm i jetës artistike të Shkodrës në vite. Specifikë e tij është se ai prezantohet si një formacion më vehte, kompakt, operativ me repertor të larmishëm duke realizuar aktivitete të ndryshme vetëm apo në bashkëpunim me solistë vokali dhe instrumentistë. Gjithashtu, element thelbësor i këtij formacioni është vendi dhe roli që ai ka në përbërje dhe aktivitetin e orkestrës simfonike kur bëhet e mundur organizimi dhe mbështetja e saj.</p> <p>Aktivitetet në vite dhe personalitetet e muzikës që kanë drejtuar dhe punuar me këtë trupë e bëjnë një vlerë më vehte të kulturës së qytetit tonë por njëkohësisht dhe asaj kombëtare.</p> <p>Element tjetër i rëndësishëm është se krijohet një urë bashkëpunimi dhe një motivim i talenteve të reja, të cilët për fat të mirë dalin nga shkolla artistike "Prenkë Jakova", fidanishte e artistëve në qytetit tonë.</p> <p>Ndonëse pretendimet artistike kanë qënë si të një trupe profesioniste, aktiviteti i saj në vite nuk ka qënë konstant. Arsyet për këtë janë të ndryshme.</p> <p>Për kushtet, rrethanat, mundësitë e bashkëpunimit që ka, mendojmë që ky formacion duhet të mbështetet që të realizojë tre aktivitete të rëndësishme në vit, përfshirë këtu edhe koncertin jubilar të fundvitit.</p> <p>Në varësi të aktivitetit do të përcaktohen dhe bashkëpunimet me solistë, këngëtarë apo instrumentistë.</p> <p>Tre Aktivitetet që do të realizohen gjatë vitit nga formacioni i harqeve:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Aktivitet artistik në 85 vjetorin e lindjes së artistit "Pjetër Gacit". - Mars 2016.</li> <li>2. Koncert Premiere i Formacionit të Harqeve. - Tetor 2016.</li> <li>3. Aktiviteti i fundvitit. "Ndërmendje". - Dhjetor 2016.</li> </ol> <p>Formacioni i harqeve do të përbëhet nga 20 instrumentistë, 1përgjegjës formacioni dhe 1 dirigjent.</p>			
Nr. 74	<b>Projekti: P11.F3.O1 .A1</b> Aktiviteti letrar: "Dita e poezisë për fëmijë".	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekrucionale  <b>Funksioni: P11.F3.</b> Zhvillimin, mbrojtjen, dhe promovimin e bibliotekave			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
<p>Biblioteka është një hapësirë e hapur për të gjithë. Një kategori e veçantë lexuesish janë edhe fëmijët. Biblioteka i ka kushtuar kujdes jo vetëm krijimit të hapësirave të veçanta, por edhe shtimit të aktiviteteve kulturore. Fëmijët janë përdoruesit e ardhshëm të bibliotekës dhe aktivitetet që zhvillojmë i familjarizojnë ata me bibliotekën. Aktiviteti i përvitshëm letrar për fëmijë është edhe "Dita e poezisë". Ky aktivitet filloi në vitin 2010. Qëllimi i tij është rritja pranisë së fëmijëve të ciklit 9-vjeçar në bibliotekë, me synimin që përdorimi i bibliotekës në të ardhmen t'i bëhet pjesë e jetës. Aktiviteti synon të zhvillojë personalitetin e fëmijëve, të nxisë krijimtarinë letrare, të evidentojë talentin artistik të interpretuesve, por edhe të edukojë kulturën e leximit. Nxënësit ftohen të marrin pjesë me një krijim letrar bazuar në një tematikë të caktuar, që ndryshon në vite.</p> <p>"Dita e poezisë për fëmijë" zhvillohet në bashkëpunim me shkollat, prindërit dhe shoqatën e shkrimtarëve. Stafii i bibliotekës në bashkëpunim me mësuesit, jo vetëm ftojnë nxënësit të bëhen pjesë e aktivitetit, por ofrojnë edhe ndihmë metodike (nëse i kërkohet) në mbarëvajtjen e punës së bibliotekave shkollore.</p> <p>Bashkëpunimi me prindërit është një tjetër element i rëndësishëm i këtij aktiviteti. Një pjesë e prindërve, që i shoqërojnë fëmijët në bibliotekë gjatë antarësimit, i nxisin ata të shfaqin dëshirat e tyre edhe përmes krijimeve të tjeshta.</p> <p>Aktiviteti letrar "Dita e poezisë për fëmijë" është konceptuar edhe si mbështetje për bibliotekat shkollore. Nxënësve fitues të aktivitetit së bashku me çmimet personale i dhurohen edhe një sasi librash që shërbejnë për pasurimin e bibliotekave të shkollave që përfaqësojnë.</p>					
ii. Synimi i projektit					
Nxitjen dhe evidentimin e talenteve të reja të moshës fëmijërore, në fushën e letërsisë por edhe promovimi i bibliotekës, jo vetëm si vend studimi, por edhe vend promovimi vlerash kulturore.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Shpallja e ftesës për konkurim në bibliotekë dhe në shkolla. Takime me drejtues të shkollave, mësues të letërsisë dhe grupet letrare të nxënësve. Ngritja e jurisë selektuese të krijimeve dhe përcaktimi nga ana e saj e fituesve të konkursit. Zhvillimi i aktivitetit në bibliotekë.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Krijimi i një forumi letrar të fëmijëve në bibliotekë. Ridimensionimi i funksioneve të bibliotekës si vend studimi, por edhe promovimi i talenteve të reja. Shtimi i librave në bibliotekat shkollore aty ku funksionojnë. Rritjen e bashkëpunimit me nxënës, mësues, dhe prindër.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Punonjësit e bibliotekës, drejtuesit, mësuesit dhe nxënësit e shkollave, prindërit. Shoqata e shkrimtarëve të Veriut.			Bashkia Shkodër.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000	Nga kjo:		
		lekë)	Paga, sig	operative	Kapitale
<b>A.1</b>	Honorare (6 persona*5 000 leke)			30	
<b>A.2</b>	Libra për shkollat fituese (75 copë x 800)			60	
<b>Totali</b>		<b>90</b>		<b>90</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Nëntor - Dhjetor 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Denise Mesi		

Nr.75	<b>Projekti: P11.F3.O1 .A2</b> <b>Periodiku gegnisht</b>	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale <b>Funksioni: P11.F3.</b> Zhvillimin, mbrojtjen, dhe promovimin e bibliotekave			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
<p>Gegnishtja është një nga dialektet kryesore, me një sistem morfologjik dhe sintaksor të zhvilluar ndër vite. Mjaft shkrimtarë të trevave të veriut kanë dhënë kontributin e tyre në lëvrimin e këtij dialekti. Dokumentat më të vjetër të gjuhës shqipe janë shkruar në gegnisht. Në këtë dialekt u krijuan veprat dhe kryeveprat e letërsisë shqiptare nga Fishta, Gjeçovi, Mjeda, Koliqi, Camaj, Draçini etj.</p> <p>Gjatë periudhës moniste qëllimshëm u mënjana përdorimi i formave të gegnishtes në gjuhë dhe letërsi, gjë që me kalimin e kohës solli edhe mospërdorimin e saktë të formave gjuhësore të dialektit.</p> <p>Ruajtja e këtij varianti të shqipes së shkruar përmes këtij projekti është në koherencë me misionin e madh të kulturës, atë të pasurimit dhe trashëgimit të vlerave kulturore, që rrezikojnë të humbasin.</p> <p>Periodiku do i përcjellë brezave të rinj thesarin gjuhësor që trashëguam, thesar i cili nuk njihet thuajse fare nga ata. Shkrimtarët dhe studiuesit do të sjellin edhe forma të reja të evolimit të dialektit geg në vite. Revista do i krijojë mundësi të të shprehurit ndryshe në gjuhën dialektore shkrimtarëve, përdoruesve dhe hulumtuesve të gjuhës geqe.</p>					
ii. Synimi i projektit					
Ruajtja, pasurimi dhe trashëgimi i vlerave kulturore që rrezikojnë të humbasin, përmes një reviste të re gjuhësore-letrare					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<p>Ngritja e redaksisë. Përcaktimi i platformës redaksionale.</p> <p>Caktimi i periodicitetit (revistë e përvitshme në një ose dy numra).</p> <p>Përcaktimi i formave gramatikore të të shkruarit në gegërisht.</p> <p>Evidentimi autorëve që lëvrojnë me botimet dhe origjinalitetin e shkrimeve.</p> <p>Zyrtarizimi i revistës. Plotësimi i dokumentacionit për marrjen e ISSN</p>					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<p>Qytetit do t'i shtohet një revistë e re.</p> <p>Bibliotekës do t'i shtohet një pronë letrare.</p> <p>Rivitalizimi i autorëve të vjetër të shqipes.</p> <p>Njohja e të rinjve me pasurinë gjuhësore dhe letrare të dialektit gegë.</p> <p>Rritja e krijimtarisë letrare të shkrimtarëve që lëvrojnë gegnishten.</p>					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>			
Komuniteti i shkrimtarëve, gjuhëtarëve, studiuesve dhe i lexuesve që preferojnë gjuhën, leximin dhe përdorimin e gjuhës geqe.		Bashkia Shkodër.			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000	Nga kjo:		
		lek)	Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Honorare (2 persona*2 numra*15 000)			60	
A.2	Botime (2 numra)			160	
<b>Totali</b>		<b>220</b>		<b>220</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar-Qershor Korrik- Nëntor		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Gjovalin Çuni Gëzim Puka			

Nr.76	<b>Projekti: P11.F3.O1 .A3</b> Festivali letrar i Shkodrës	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F3.</b> Zhvillimin, mbrojtjen, dhe promovimin e bibliotekave		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
<p>Bibliotekat në ditët e sotme nuk janë thjesht vende të kërkimeve shkencore, por ata përpiqen të gjejnë forma dhe mënyra të reja për të ndikuar në jetën intelektuale, kulturore dhe shoqërore të njerëzve.</p> <p>Organizimi i veprimtarive kulturore është pjesë e pandarë e veprimtarive të bibliotekave, sidomos atyre publike.</p> <p>Festivali letrar i Shkodrës është një aktivitet kulturor, që në bibliotekën tonë zhvillohet që prej tetë vitesh. Ai lindi me kërkesën e vetë shkrimtarëve shkodranë, që dëshironin të kishin një forum të përvitshëm letrar. Ky forum letrar i është dedikuar kryesisht shkrimtarëve shkodranë, që jetojnë në Shkodër dhe jashtë saj, por është synuar të jetë edhe një urë lidhëse me shkrimtarë të hapësirave shqiptare nga Ulqini dhe Tuzi. Ideja e krijimit të këtij aktiviteti ishte për të bërë të mundur kontaktin e drejtpërdrejtë të krijuesve me lexuesit dhe anëtarët e bibliotekës. Shkrimtarët e ndryshëm që janë ftuar ndër vite, jo vetëm kanë paraqitur krijimtarinë e tyre, por edhe kanë referuar rreth temave të ndryshme, që lidhen me zhvillimet letrare bashkëkohore. Festivali nuk është shoqëruar me çmime. Në optikën e organizatorëve çmimin çdo shkrimtari ia jep lexuesi. Gjatë viteve janë paraqitur 35 shkrimtarë. Festivali nuk ka arritë të plotësojë të gjitha kërkesat e autorëve. Ai zgjon interesimin e një publiku të gjerë, i cili nga viti në vit e ka mirëpritur dhe është rritur në numër. Është shtuar edhe interesimi i mediave lokale dhe kombëtare. Festivali ka ruajtur ritmikën kohore të zhvillimit. E meta e kësaj nisme është se nuk ka arritur deri më tani të tërheqë sa duhet shkrimtarët e rinj, kryesisht studentët.</p>				
ii. Synimi i projektit				
Promovimi i vlerave krijuese të autorëve shkodranë, që banojnë në Shkodër dhe jashtë saj, përmes nxitjes së debatit letrar.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
Përcaktimi i pjesëmarrësve dhe kontakti me ata. Përcaktimi i tematikës së çdo takimi. Përcaktimi i periudhës së kohëzgjatjes së aktivitetit.				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
Vijueshmëria e forumit letrar. Tërheqja e të rinjve në këtë aktivitet. Ngritja e nivelit të aktivitetit përmes pjesëmarrjes së një shkrimtari të shquar të vitit. Rritja e bashkëpunimeve ndërkulturore. Rritja e frekuentuesve të bibliotekës. Shtimi i kontakteve shkrimtarë –lexues.				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>		<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Shkrimtarë Shoqata shkrimtarësh Shoqata rinore Shoqata kulturore nga Ulqini dhe Tuzi		Bashkia Shkodër.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000	Nga kjo:	
		lek)	Paga, sig	operative
				kapitale
<b>A.1</b>	Honorare (5 persona * 10 000)			50
<b>A.2</b>	Publicitet			20
	<b>Totali</b>	<b>70</b>		<b>70</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Tetor-Nëntor		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Gjovalin Çuni		



Nr. 77	<b>Projekti: P11.F3.O2.A1</b> Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekracionale  <b>Funksioni: P11.F3.</b> Zhvillimin, mbrojtjen, dhe promovimin e bibliotekave
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
i. Situata		
<p>Detyra kryesore e çdo biblioteke është zhvillimi dhe pasurimi i koleksioneve, përmes zgjedhjes së materialeve të shtypura dhe jo të shtypura që shërbejnë për plotësimin e nevojave për edukim dhe çlodhje të komunitetit. Koleksionet e bibliotekës synojnë plotësimin e kërkesave të komunitetit në fushën e arsimit, kulturës dhe informacionit. Pasurimi në vite i fondeve të bibliotekës ka qenë dhe ngelet, një nga përparësitë kryesore të punës sonë. Zgjidhja materialeve bibliotekare, që do të pasurojnë koleksionet është një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm, që kërkon jo vetëm harmonizimin e kërkesave të punonjësve që administrojnë fondet, por edhe marrjen e mendimit për zhvillimin e koleksioneve nga lexues të niveleve të ndryshme të zhvillimit kulturor; të gjinive dhe moshave. Duke qenë se bibliotekat në përgjithësi kanë fonde buxhetore të kufizuara jemi përpjekur që të pasurojmë koleksionet tona përmes zgjedhjes së materialeve bibliotekare, (kryesisht libra dhe periodikë) në varësi të llojit të bibliotekës sonë dhe gjendjes së koleksioneve. Termi tradicional "bibliotekë", përgjithësisht shënon koleksione librash dhe periodikësh, por jashtë vëmendjes sonë nuk kanë ngelur edhe zhvillimi i koleksioneve të veçanta. Shtimi i materialeve jo libra siç cilësohen në terminologjinë e bibliotekave, është shoqëruar me krijimin në vitin 2010 të koleksioneve të veçanta të Mediatikës dhe Bibliotekës Digjitale. Biblioteka ka nënline rreth 20.000 faqe të digjituara. Libra 9 tituj, 26 njësi; 3 koleksione revistash me 230, si dhe 1 koleksion gazete. Materiale të tjera të digjituara, që nuk janë të hedhuna në online janë rreth 17.000. Vitet e fundit kemi krijuar pikat e shërbimit me koleksioneve të hapura, si një risi e ndryshme shërbimi nga ajo tradicionale. Koleksionet e hapura kanë lehtësuar hyrjen në botën e informacionit, kryesisht për nxënësit dhe studentët, përmes kontaktit të drejtëpërdrejtë me librin. Zhvillimi dhe pasurimi i koleksioneve, të bibliotekës sonë është një detyrë e përhershme. Procesi lidhet edhe me pasurimin e fondeve të veçanta dhe të rralla që ka kjo bibliotekë edhe në rang kombëtar. Një pjesë e mirë e koleksioneve tona janë të aksesueshme përmes katalogut elektronik. Kjo ka rritur përgjigjësinë dhe kujdesin për zhvillimin e pasurimin e koleksioneve. Bashkia Shkodër ndër vite i ka kushtuar kujdes planifikimit të fondeve buxhetore, për pasurimin e koleksioneve. Zëri i buxhetit të planifikuar për blerje librash dhe periodikësh për disa vite ka qenë 2.000.000 lekë. Vitet e fundit buxheti është përgjysmuar duke sjellur vështirësi në zhvillimin dhe pasurimin e koleksioneve. Blerja e librave ngelet sfidë pasi janë vështirësuar praktikatat e blerjes përmes tenderit. Fituesit e tenderit, nuk kanë qenë seriozë. Ata që u paraqitën nuk plotësonin kërkesat tona në tituj. Një tjetër element që krijon vështirësi në zhvillimin e pasurimin e koleksioneve është edhe blerja e librave një herë në vit. Kjo procedurë është joproduktive, pasi ka edhe tituj librash që shiten dhe nuk gjenden më në treg. Problem ka qenë edhe vijueshmëria e tërheqjes së periodikut, në kushtet kur buxheti nuk lëvrohet menjëherë. Pritshmëria për fillimin e procedurës së blerjes deri në aprovimin e buxhetit ka sjellur dëmtimin e koleksioneve të periodikut. Megjithë vështirësitë koleksionet e bibliotekës zhvillohen dhe pasurohen çdo vit. Fondet e akordura jemi përpjekur t'i administrojmë duke i dhenë përparësi titujve në raport me sasinë Bashkia ka qenë financuesja kryesore për zhvillimin dhe pasurimin e fondeve, por në vite bibliotekës i janë afruar libra nga projekte të ndryshme, shoqata dhe donatorë privatë. Në vitin 2015 me fondet e akordurara të buxhetit koleksionet tona janë pasuruar me 927 njësi bibliotekare që i korespondojnë 297 tituj, ndërsa pasurimi nga të ardhurat sekondare, kryesisht dhuratat për këtë vit kanë qenë 250 njësi. Vitet e fundit koleksionet janë pasuruar nga dhuratat e shkrimtarëve të trevave shqiptare të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Zbatimi i detyrimit ligjor, mbi zhvillimin dhe pasurimin e koleksioneve. Pasurimi i fondeve kryesore me literaturë bashkëkohore. Pasurimi i katalogut on-line.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
Shqyrtimi i gjendjes së fondeve. Plotësimi i statistikave vjetore të hyrjeve të reja. Evidentimi i frekuentimit vjetor të fondeve dhe lloji i literaturës së lexuar. Ndjekja periodike e literaturës së publikuar. Ndarja e shumës së planifikuar sipas fondeve. Konsultimi me lexuesit. Konsultimi me programet shkollore të literaturës së planifikuar për lexime.		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
Pasurimi i fondeve me literaturë bashkëkohore. Zgjerimi i aktivitetit të bibliotekës. Shtimi i lexuesve. Rritja e shërbimit ndaj komunitetit që përfshijnë të gjitha kategoritë e moshave. Rritja e prestigjit të bibliotekës në rang kombëtar.		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	



Bibliotekarët Publiku qytetar		Bashkia Shkodër			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		<b>Totali (000/lekë)</b>	<b>Nga kjo:</b>		
			<b>Paga, sig</b>	<b>Operative</b>	<b>kapitale</b>
<b>A.1</b>	Blerje periodiku (shqip + i huaj) (15 tituj)				150
<b>A.2</b>	Blerje librash Fondi shqip				400
<b>A.3</b>	Blerje librash Fondi i fëmijëve				200
<b>A.4</b>	Blerje librash Albanologji				45
<b>A.5</b>	Blerje librash Fondi i hapur shqip				100
<b>A.6</b>	Blerje librash Fondi i hapur i huaj				105
		<b>1 000</b>			<b>1 000</b>
<b>f) Periudha e zbatimit Tetor 2016</b>		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Albana Komi Sidië Halluni Magdalena Haxhi</b>			

Nr. 78	<b>Projekti: P11.F3.O2.A2</b> Mbrojtja e aparaturave nga mungesa dhe oshilacionet e energjisë.	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F3.</b> Zhvillimin, mbrojtjen, dhe promovimin e bibliotekave			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Shërbimet që ofrohen në bibliotekë, janë të lidhura edhe me paisjet elektronike. Mbrojtja përherë në gadishmëri e këtyre pajisjeve siguron një proces normal të punës në bibliotekë. Aktualisht për mirëmbajtjen e tyre nga oshilacionet apo shkëputjet e energjisë elektrike është e nevojshme blerja herë pas herë e baterive UPS të cilat ndër vite konsumohen. Blerja e këtyre baterive ndihmon jo vetëm në ruajtjen e aparaturave, por edhe për kryerjen e veprimeve më të domosdoshme, që shpesh herë janë të kushtëzuara në kohë.					
ii. Synimi i projektit					
Mbrojtja e aparaturave elektronike dhe sigurimi e punëve në proces edhe në momentet e shkëputjes së rrymës.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Përcaktimi i llojit të UPS-ve që do të përdoren. Instalimi i UPS me kompiuterat që do t'i përdorin.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Normaliteti në ecurinë e punëve të përditshme. Mbrojtja dhe kohëzgjatja e apraturave. Shmangja e veshtrësive në kushtet e mungesës së energjisë elektrike.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Punonjësia e llogarisë. Bibliotekarët. Lexuesit e bibliotekës			Bashkia Shkodër.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet per çdo aktivitet</b>		Totali (000/lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	Opertive	kapitale
<b>A.1</b>	UPS (2 copë)			10	
<b>TOTALI</b>		<b>10</b>		<b>10</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Gjatë vitit 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Gjovalin Çuni Ingrit Gushta		

Nr.79	<b>Projekti: P11.F3.O2.A3</b> Rimbushje dhe blerje fikse zjarri	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale <b>Funksioni: P11.F3.</b> Zhvillimin, mbrojtjen, dhe promovimin e bibliotekave		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
Institucionet e D.E.K. janë të paisura me bombola të fikseve të zjarrit. Duke qënë se institucionet tona frekuentohen nga një publik i gjerë ,na lind detyrimi t'i paraprijmë çdo lloj pakujdesie që do të shkaktonte ndonjë shkëndijë zjarri në ambientet e institucioneve. Paisja me fikse zjarri e institucioneve të cilat posedojnë vepra arti është gjithashtu një detyrim ligjor.				
ii. Synimi i projektit				
Rritja e sigurisë në institucione.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
Përcaktimi i zonave ku do të vendosen fikset e zjarrit dhe ku do të shtohet sasia e tyre. Vendorsja e fikseve të zjarrit.				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
Rritja e sigurisë. Mbrojtja nga zjarri.				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Të gjitha godinat e D.E.K.			Bashkia Shkodër	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lek)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
A.1	Fikse Zjarri			235
	<b>Totali</b>	<b>235</b>		235
<b>f) Periudha e zbatimit</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>	
Gjatë 2016			Përgjegjësit përkatës të Istitucioneve	

## Preventivi

Nr	Emertimi	Qendra e Kultures	Muzeu Historik	Vendi i Deshmise dhe i kujteses	Galeria e Arteve	Bibloteka	TOTAL
1	Fikse Zjarri	45,000	45,000	45,000	45,000	55,000	235,000
Total		45,000	45,000	45,000	45,000	55,000	235,000

Nr. 80	<b>Projekti: P11.F3.O2.A4</b> Hostim, mirëmbajtje e faqes web të Bibliotekës "Marin Barleti"	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative <b>Funksioni: P11.F3.</b> Zhvillimin, mbrojtjen, dhe promovimin e bibliotekave			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b> i. Situata					
<p>Bibliotekat e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në një shoqëri në të cilën teknologjia dhe zhvillimi i informacionit janë gjithnjë në rritje. Përdoruesit e bibliotekës kërkojnë metoda më të shpejta dhe bashkëkohore për t'u informuar.</p> <p>Në funksion të kërkesave të kohës biblioteka ka realizuar automatizimin e proceseve përmes krijimit të katalogut elektronik, si dhe hyrjes së lirë në internet, bazuar në rregulloren e brendshme për anëtarët e bibliotekës.</p> <p>Katalogu elektronik, është një formë e re komunikimi me përdoruesit e bibliotekës. Ai mundëson dhënien e një informacioni të plotë, të shpejtë, drejtpërdrejtë pa limite kohore dhe hapësirë rreth pasurive bibliografike që ka biblioteka. Katalogu elektronik funksionon që në vitin 2009. Ai është ndërtuar duke u bazuar në formatin MARC (Machine-Readable Cataloging) dhe në standartet e njohura ndërkombëtare të përshkrimit bibliografik, ISBD dhe AACR2. Mbi këto baza funksionon Katalogu i Shërbimit Publik në rrjet (OPAC-Online Public Access Catalogue) përmes website-it <a href="http://www.bibliotekashkodër.com">www.bibliotekashkodër.com</a>.</p> <p>Në bibliotekë në shërbim të përdoruesve të fletës janë krijuar edhe postes e veçanta të kërkimit. Një tjetër risi që të ofron faqja e bibliotekës është edhe konsultimi me Bibliotekën dixhitale. Synimi i krijimit të kësaj biblioteke ka qenë dhe ngelet mundësia e qasjes të publikut në pasuritë arkivore të bibliotekës sonë.</p> <p>Biblioteka dixhitale e përmban 20.000 fletë të digjituara on-line dhe po aq të pablikuara në mungesë të një serveri.</p> <p>Përparësia e përdorimit të teknologjive bashkëkohore dhe përpjekja për të qënë "bibliotekë e së ardhmes", është e lidhur pazgjidhshmërisht me hostimin dhe mirëmbajtjen e faqes, e cila tanimë është pjesë e veprimtarisë së përditshme të punës në bibliotekë.</p> <p>Në mungesë të një IT-je, kujdesi për mirëmbajtjen e fletës do të kryhet nga firma të specializura në këtë drejtim, të cilat sigurojnë mirëmbajtjen e faqes, garantojnë veprimtarinë e përditshme në bibliotekë, si dhe japin garanci edhe për realizimin e projekteve të reja.</p>					
ii. Synimi i projektit					
Qasja ndaj përvojave bashkëkohore të lidhura me akumulimin, sistemimin, administrimin dhe vënien në përdorim të informacionit për përdoruesin, përmes hostimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të katalogimit elektronik dhe të faqes OPAC.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Përcaktimi i bazave të reja të të dhënave dhe harmonizimi i tyre me ato ekzistuese . Përcaktimi i elementëve të kontratës më synim ruajtjen dhe pasurimin e të dhënave, por edhe shtimin e elementëve të rinj. Përmirësimi i paraqitjes grafike në përshtatje me kërkesat e kohës.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Sigurimi i materialeve të shumëllojshme bibliotekare në përshtatje me ndryshimet sociale për t'iu përgjigjur kërkesave në ndryshim dhe në rritje të përdoruesve të bibliotekës. Krijimi i mundësive të reja për qasje në rrjete të integruara lokale dhe ndërkombëtare. Shkëmbimi i bazave të të dhënave në sistemin bibliotekar.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Bibliotekarët. Përdoruesit e bibliotekës. Studiuesit shkencorë.			Bashkia Shkodër.		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	Operative	kapitale
A.1	HOSTING			16.5	
A.2	DOMAIN NAME			2.0	
A.3	MIREMBAJTJE SERVERI (NE VIT)			31.2	
<b>TOTALI</b>		<b>49.7</b>		<b>49.7</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Janar- Dhjetor 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Siditë Halluni		

Nr.81	<b>Projekti: P11.F3.O2.A5</b> Materiale Kancelarie dhe Materiale Pastrimi	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative <b>Funksioni: P11.F3.</b> Zhvillimin, mbrojtjen, dhe promovimin e bibliotekave		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
Dega Ekonomike e Kulturës ka në strukturë 6 ndërtesa, të cilat kërkojnë mirëmbajtje dhe pastrim të vazhdueshëm. Gjithashtu, në veprimtarinë e përditshme të institucioneve, luajnë një rol shumë të madh pajisjet kancelarike, pasi plotësimi i një pjese pune të rëndësishme është e lidhur me këto mjete.				
ii. Synimi i projektit				
Normaliteti në ecurinë e punëve të përditshme.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
Përcaktimi i i shpenzimeve: Mjete Kancelarie dhe Mjete pastrimi, sipas nevojave të paraqitura nga secili përgjegjës i institucioneve.				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
Normalitetit në përditshmërinë e aktivitetit të institucioneve të Degës Ekonomike të Kulturës. Ofrimi i një ambienti të pastër për stafin dhe frekuentuesit e bibliotekës.				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Institucionet dhe punonjësit përkatës të DEK Frekuentuesit e ambienteve të D.E.K.			Bashkia Shkodër	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b>			Totali (000 lek)	Nga kjo: Paga, sig
				operative
				Kapitale
A.1	Materiale Pastrimi			68
A.2	Materiale Kancelarie			590
			<b>658</b>	658
<b>f) Periudha e zbatimit</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>	
Gjatë gjithë vitit 2016			Përgjegjësit përkatës të Institucioneve	

## Detajimi

Nr	Emertimi	Qendra e Kultures	Muzeu Historik	Vendi i Deshmise dhe i kujteses	Galeria Arteve	Bibloteka	TOTAL
1	Materiale kancelarie	41,300	170,300	120,500	128,600	129,300	<b>590,000</b>
2	Materiale Pastrimi	9,000	20,000	10,000	9,000	20,000	<b>68,000</b>
<b>Total</b>		<b>50,300</b>	<b>190,300</b>	<b>130,500</b>	<b>137,600</b>	<b>149,300</b>	<b>658,000</b>

Nr. 82	<b>Projekti: P11.F3.O2.A6</b> Administrimi, ruajtja dhe mirëmbajtja e fondeve muzeale te Bibliotekes Marin Barleti.	<b>Lojet e programit:</b> Fusha e Kulturës, sportit dhe shërbimeve kreative <b>Funksioni:</b> Zhvillimi, mbrojtja, promovimi i bibliotekave		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
<p>Administrimi, ruajtja dhe mirëmbajtja e kujdeshme e fondit të librave lidhet jo vetëm me plotësimin sa më të mirë të kërkesave të lexuesve, por edhe me plotësimin e dispozitave të veçanta për mirëmbajtjen e bibliotekave dhe materialeve bibliotekare. Mjediset ku ruhen materialet e shtypura duhet të jenë të bollshme, të siguruara nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore, të kenë ndriçimin, temperaturën dhe lagështirën e duhur; të ruhen nga mikroorganizmat etj.</p> <p>Në administrimin dhe ruajtjen e fondeve, rol të rëndësishëm nuk kanë vetëm lokalet ku vendosen librat, por edhe raftet. Shumica e bibliotekave publike kanë patur dhe vijojnë të kenë sistemin e vendosjes fikse në raftet. Materialet e shtypura (libra) vendosen sipas madhësisë në shtatë ndarjet e rafteve, nga syza e parë deri në të fundit. Të tillë janë edhe raftet e bibliotekës sonë. Ata i afrohen standarteve tradicionale të rafteve për libra dhe periodikë.</p> <p>Raftet e bibliotekës nuk afrohen me standartet e IFLA- s. Për më tepër ata tani nuk sigurojnë si duhet as ruajtjen dhe trajtimin e duhur të materialeve bibliotekare.</p> <p>Shumica e rafteve prej druri të fondeve në pjesën më të madhe janë të dëmtuar nga koha e gjatë e përdorimit. Të gjitha ndarjet të bazuara në material fibër, ose janë plasur, ose janë përkulur duke bërë që një pjesë e librave, sidomos ata të arkivit, të mbajnë ndarjet e njëri-tjetrit. Edhe paraqitja estetike e materialeve të shtypura në fonde lë shumë për të dëshiruar. Në këtë situatë është e domosdoshme që të fillohet gradualisht zëvendësimi i tyre me raftet metalikë, shumë të qëndrueshëm në kohë dhe që garantojnë një trajtim normal të librave dhe periodikëve.</p>				
ii. Synimi i projektit				
Përmirësimi i kushteve përmes administrimit, trajtimit dhe ruajtjes së materialeve bibliotekare me synimin, që pas disa vitesh nga magazinat e librave, të kthehen pika shërbimi me fonde të hapura.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
<p>Përcaktimi i fondeve ku do të ndërhyhet.</p> <p>Gjetja e përkohshme e hapësirave, ku do të zhvendosen librat.</p> <p>Përcaktimi i materialit të raftave.</p> <p>Bërja e analizës financiare.</p>				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
<p>Përmirësimi i vendosjes dhe i trajtimit të librave.</p> <p>Zgjerimi i hapësirave në dispozicion të librit.</p> <p>Përmirësimi i shërbimit ndaj lexuesve.</p> <p>Përpjekje për realizimin e normave të IFLA- s</p>				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Punonjësit e bibliotekës. Përdoruesit e bibliotekës.			Bashkia Shkodër	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet per çdo aktivitet</b>			Totali (000	Nga kjo:
			lek)	Paga, sig
				operative
				kapitale
<b>A.1</b>	Raftet (20 copë)			800
<b>Totali</b>		<b>800</b>		<b>800</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Gjatë 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Mimoza Jubica Lulzime Fatusha	

Nr.83	<b>Projekti: P11.F3.O2.A7</b>	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale			
	Shpenzime ndaj të tretëve (Energji Elektrike, Ujë ,Shpenzime Telefoni dhe Interneti, Shpenzime Postare )	<b>Funksioni: P11.F3.</b> Zhvillimin, mbrojtjen, dhe promovimin e bibliotekave			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Dega Ekonomike e Kulturës ka në përbërje 6 institucione (godina ): Biblioteka Publike "Marin Barleti", Qendra Kulturore "Pjetër Gaci", Galeria e Arteve, Muzeu historik "Oso Kuka", Muzeu i Kështjellës, Vendi i Dëshmisë dhe i Kujtesës. Për funksionimin normal të tyre është i domosdoshëm parashikimi i shpenzimeve operative ndaj të tretëve.					
ii. Synimi i projektit					
Normaliteti në ecurinë e punëve të përditshme.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Përcaktimi i i shpenzimeve për institucion/godinë ,mbështetur në shpenzimet e vitit paraardhës.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Normaliteti në përditshmërinë e aktivitetit të Institucioneve të Degës Ekonomike të Kulturës					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
6 institucionet dhe punonjësit përkatës Komuniteti			Bashkia Shkodër		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	Kapitale
A.1	Energji Elektrike			888	
A.2	Ujë			155	
A.3	Telefon (përfshirë internetin e administrates)			374	
A.4	Web			60	
A.5	Interneti Sallës			100	
A.6	Sh.Postare			2	
A.7	Tarifa			1	
	<b>Totali</b>	<b>1 580</b>		<b>1 580</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>		
Gjatë gjithë vitit.			Përgjegjësit përkatës të Institucioneve		

Detajim:

		Biblioteka	VDK	Qendra e Kulturës	Muzeu Historik	Galeria e Arteve
A.1	Energji Elektrike	228	300	60	200	100
A.2	Ujë	30	35	35	40	25
A.3	Telefon(perfshirë internetin e administr.)	54	80	75	90	75
A.4	Web	50		0	10	
A.5	Internet i Sallës	100		0		
A.6	Sh.Postare	1	1			
A.7	Tarifa	1				
	<b>TOTALI</b>	<b>464</b>	<b>416</b>	<b>161</b>	<b>340</b>	<b>200</b>





Nr. 84	<b>Projekti: P11.F3.O2.A8</b> Shërbime mirëmbajtje të mjediseve të Bibliotekës "Marin Barleti"	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreacionale  <b>Funksioni: P11.F3.</b> Zhvillimin, mbrojtjen, dhe promovimin e bibliotekave			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Një element i rëndësishëm në veprimtarinë e bibliotekave është edhe mirëmbajtja e strukturës. Hapësirat dhe shërbimet kundrejt përdoruesve të çdo moshe kërkojnë planikimin e shpenzimeve të zyrës, një nga elementët shumë të rëndësishëm të përditshmërisë së funksionimit normal të punës në bibliotekë. Planifikimi i shpenzimeve të zyrës bëhet edhe më i domosdoshëm në kushtet kur tanimë një pjesë e pajisjeve ekzistuese, mekanike dhe elektrike janë të amortizuara dhe kërkojnë mirëmbajtje të përherëshme. Konsumimi total i tyre shkakton rreziqe për jetën e personelit dhe përdoruesve të bibliotekës, prandaj duhet rritur kujdesi i vazhdueshëm kundrejt këtyre pajisjeve duke evidentuar në kohë dhe më pas duke riparuar apo zëvendësuar pajisjet e konsumuara.					
ii. Synimi i projektit					
Normaliteti në ecurinë e punëve të përditshme, si dhe ruajtja e personelit dhe e përdoruesve të bibliotekës nga të papriturat që mund të sjellin konsumimi i pajisjeve mekanike dhe elektrike.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Përcaktimi i prioriteteve në mirëmbajtjen e objektit. Përcaktimi i materialeve më të domosdoshme për të realizuar mirëmbajtjen. Shqyrtimi i tregut në përcaktimin e tipit dhe të çmimit të njësisë.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Sigurimi i mjeteve më të domosdoshme për ruajtjen apo edhe zëvendësimin e pajisjeve mekanike dhe elektrike që ndodhen në bibliotekë. Sigurimi i normalitetit në përditshmërinë e aktivitetit të bibliotekës.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Frekuentuesit e bibliotekës			Bashkia Shkodër		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
		<b>Totali</b>	Paga, sig	operative	Kapitale
<b>A.1</b>	Brava sekrete për dyer (3 copë)	3		3	
<b>A.2</b>	Tub plasmasi (25 mt)	5.5		5.5	
<b>A.3</b>	F.V. përcjellës (25 mt)	2.6		2.6	
<b>A.4</b>	F.V. çelësa + prize 10 A me nulifikim (10 copë)	5.1		5.1	
<b>A.5</b>	F.V. portollampa normale 10 A (10 copë)	2		2	
<b>A.6</b>	F.V. priza shuko "Gevis" universal (10 copë)	5.1		5.1	
<b>A.7</b>	Çelës 1 polar 220 V	0.443		0.443	
<b>A.8</b>	F.V. automat termo/el. Manj diferencial (1 cope)	4.652		4.652	
<b>A.9</b>	Llampa (30 copë)	9		9	
<b>A.10</b>	Të tjera	12.605		12.605	
<b>TOTALI</b>		<b>50</b>		<b>50</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b>  Gjatë vitit		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b>  Gjovalin Çuni Ingrit Gushta			

**Preventiv. Shpenzime zyre**

Bazuar në vendimin nr.629, dt. 15.07.2015

<b>A.1</b>	<b>Brava sekrete për dyer (3 copë)</b>	cope	3	1000	3000
<b>A.2</b>	Tub plasmasi (25 mt)	mt	25	220	5500
<b>A.3</b>	F.V. përcjellës (25 mt)	mt	25	104	2600
<b>A.4</b>	F.V. çelësa + prize 10 A me nulifikim (10 copë)	<b>copë</b>	<b>5</b>	<b>510</b>	<b>2550</b>
<b>A.5</b>	F.V. portollampa normale 10 A (10 copë)	copë	5	200	1000
<b>A.6</b>	F.V. priza shuko "Gevis" universal (10 copë)	copë	5	510	2550
<b>A.7</b>	Çelës 1 polar 220 V	copë	1	443	443
<b>A.8</b>	F.V. automat termo/el. Manj diferencial (1 cope)	copë	1	4652	4652
<b>A.9</b>	Llampa (30 copë)	Llampa	copë	30	300
<b>A.10</b>	Të tjera				12.605
	<b>TOTALI</b>				<b>50,000</b>



Nr.85	<b>Projekti: P11.F3.O2.A9</b> Shërbimi i ruajtjes së ndërtesës së Bibliotekës “Marin Barleti”	<b>Llojet e programit: P11.</b> Kultura dhe shërbimet rekreative <b>Funksioni: P11.F3.</b> Zhvillimin, mbrojtjen, dhe promovimin e bibliotekave			
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>					
i. Situata					
Kujdesi për parandalimin e të dëmtimeve të inventarit fizik dhe të koleksioneve të ndryshme nga një sërë faktorësh natyrorë është një objektivi i përhershëm i punës sonë. Çdo vit kemi bërë siguracionin fizik të ndërtesës dhe të librave si mundësi e minimizimit të humbjeve në rastet e fatkeqësive natyrore dhe zjarrit. Siguracioni i objektit dhe librave krahas të qenurit një element i domosdoshëm ligjor krijon edhe një atmosferë më të mirë pune në bibliotekë.					
ii. Synimi i projektit					
Të rritet siguria e objekteve me vlera artistike, kulturore , të memories, të edukimit etj. në mënyrë që të bëjmë të mundur pasurimin e këtyre vlerave dhe kalimin e tyre nga brezi në brez.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Përcaktimi i objekteve që duhet të sigurohen. Shqyrtimi i ofertave nga operatorë të ndryshëm. Përgatitja e situacionit nga specialistët.					
<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
Ruajtja e objektit dhe e librave përmes mbulimit të dëmeve financiare në raste fatkeqësish natyrore nga ana e kompanisë së siguracionit.					
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Biblioteka Specialistë			Bashkia Shkodër		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>					
<b>Shpenzimet per çdo aktivitet</b>		Totali (000	Nga kjo:		
		lekë)	paga, sig	operative	kapitale
<b>A.1</b>	Siguracion ndërtesë dhe librash			35	
<b>Totali</b>		<b>35</b>		<b>35</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Mars 2016			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Gjovalin Çuni		

Nr.86	<b>Projekti:</b> P11.F3.O2.A10 Administrimi dhe menaxhimi i Degës ekonomike të kulturës	<b>Llojet e programit:</b> P11. Kultura dhe shërbimet rekreative <b>Funksioni:</b> P11.F3. Zhvillimin, mbrojtjen, dhe promovimin e bibliotekave		
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>				
i. Situata				
<p>Dega Ekonomike e Kulturës ka strukturën e mëposhtme :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bibliotekën Publike "Marin Barleti" (14 punonjës) <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Sektorin e Finances</li> <li>○ Sektori i Librit dhe Mediatikes</li> </ul> </li> <li>• Muzeu Historik (14 punonjës) <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Muzeu "Oso Kuka"</li> <li>○ Vendi i Deshmise dhe Kujteses</li> <li>○ Muzeu i Kalasë "Rozafa"</li> <li>○ Sektori i shërbimeve mbështetëse</li> </ul> </li> <li>• Qendra e Kultures "Pjeter Gaci" dhe Galeria (7 punonjës).</li> </ul> <p>Për funksionimin normal të tyre është i domosdoshëm parashikimi (në bazë të strukturës aktuale) i shpenzimeve për paga dhe sigurime.</p>				
ii. Synimi i projektit				
Të rritet cilësia e ofrimit të shërbimit në funksion të pasurimit të jetës artistike, kulturore edukuese për komunitetin.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
Përcaktimi i shpenzimeve për Paga dhe Sigurime të 35 punonjësve të Degës ekonomike të kulturës.				
<b>b) Rezultatet që prisni</b>				
Normalitetit në përditshmërinë e aktivitetit të Institucioneve të Degës Ekonomike të Kulturës				
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
Institucionet dhe punonjësit përkatës të DEK			Bashkia Shkodër	
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>		Totali (000 lekë)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
A.1	Paga		16 299	
A.2	Sigurime Shoqërore		2 714	
		<b>19 013</b>	<b>19 013</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> Gjatë gjithë vitit.			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Përgjegjës të institucioneve	
E detajuar:				
Institucioni	Paga	Sigurime	Totali	
Biblioteka Publike Marin Barleti	6 911	1 154	8 065	
Muzeu Historik	5 231	860	6 091	
Vendi i Deshmise dhe i Kujteses	605	124	729	
Galeria e Arteve	1 472	246	1 718	
Qendra e Kultures	2 080	330	2 410	
	<b>16 299</b>	<b>2 714</b>	<b>19 013</b>	

Nr.1	<b>Projekti: P12.F1.O1.A1</b> Dita e vullnetarizmit	<b>Llojet e programit P12:</b> Rinia dhe sportet <b>Funksioni P12:F1:</b> Programet/projektet rinore			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit					
i. Situata					
Në territorin e bashkisë së Shkodrës, zhvillohen shumë pak aktivitete vullnetare. Këto aktivitete organizohen nga grupe jo shumë mirë të koordinuara dhe aktivitetet që organizohen, janë të dobishme por nuk janë në përputhje me nevojat emergjente që paraqet qyteti. Gjithashtu, vullnetarizmi është një mundësi zhvillimi personal dhe profesional i të rinjve, dhe nuk shfrytëzohet pothuajse fare nga të rinjtë e qytetit të Shkodrës. Të gjendur para kësaj situatë dhe duke besuar në vlerat e vullnetarizmit, mendojmë të organizojmë aktivitete të ndryshme të shtrira përgjatë gjithë vitit. Këto aktivitete kanë për qëllim promovimin e vullnetarizmit dhe ndërgjegjësimin e të rinjve për përfshirje në të tilla aktivitete.					
ii. Synimi i projektit					
Synojmë edukimin e të rinjve në fushata ndërgjegjësuese për përfshirje në aktivitete vullnetare. Synojmë promovimin e vullnetarizmit si mundësi për të fituar aftësi të reja, si mundësi për zhvillimin në karrierë, si mundësi për njohje vlerash etj. Synojmë nxitjen e vullnetarizmit, për përmirësimin e kushteve mjedisore, sociale, kulturore, etj, në qytetin e Shkodrës.					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
Hartimi i sloganit të vullnetarizmit dhe aktiviteteve që do organizohen. Printimi i bluzave. Blerja e materialeve. Organizimi i aktiviteteve të ndryshme vullnetare përgjatë gjithë vitit. Bashkëpunim me institucionet publike, kryesisht DAR, universiteti, organizatat, etj.					
b) Rezultatet që prisni					
Ndërgjegjësimi i të rinjve dhe mbarë komunitetit për përfshirje në aktivitete vullnetare. Përfshirje e të rinjve në aktivitetet vullnetare që do organizohen përgjatë gjithë vitit. Bashkëpunim me institucionet publike dhe organizatat për aktivitetet e ndryshme që do organizohen gjatë vitit. Përmirësimi i situatës mjedisore, sociale, kulturore, etj, si pasojë e zhvillimit të aktiviteteve vullnetare gjatë vitit.					
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt			
Të rinjtë DAR Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" Komuniteti		Bashkia e Shkodrës			
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali(000 lekë)	Nga kjo:		
			Paga, sig	operative	kapitale
A.1	Bluza (400 cope x 500 leke/copa)			200	
A.2	Thase (5.000 cope x 20 leke/copa)			100	
A.3	Doreza (1.000 cope x 100 leke/copa)			100	
A.4	Transport			100	
A.5	Kapele			76	
	<b>Shuma</b>	<b>576</b>		<b>576</b>	
f) Periudha e zbatimit janar – dhjetor 2016		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së kulturës, arsimit, rinisë dhe sportit			

Nr.2	<b>Projekti: P12.F1.O1.A2</b> Portali për rininë	<b>Llojet e programit P12:</b> Rinia dhe sportet <b>Funksioni P12:F1:</b> Programet/projektet rinore		
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit				
i. Situata				
<p>Në bashkinë e Shkodrës, është e nevojshme një zyrë informacioni, orientimi apo shërbimi për të rinjtë. Të rinjtë kanë nevojë për një hapësirë ku ata të drejtohen për të marrë një informacion mbi aktivitetet që organizohen, mundësitë që ofrohen, ose ka një grup të rinjsh që janë të gatshëm të ofrojnë ndihmë dhe të kontribuojnë vullnetarisht në shërbime të ndryshme por nuk e dinë se çfarë procedure ndiqet dhe ku të drejtohen.</p> <p>Duke qenë se rinia përbën grupin më të madh demografik, me një potencial të jashtëzakonshëm për të kontribuar në ndryshime pozitive, mendojmë që për vitin 2016 dhe në vazhdim të krijojmë një portal VETËM për këtë kategori.</p> <p>Ky portal do përmbajë informacion mbi shërbimet që ofrohen, aktivitetet kulturore, sociale, etj, mundësitë që ofrohen për rininë në të gjithë territorin e bashkisë së Shkodrës dhe përtej. Gjithashtu do ftojë të rinjtë të përfshihen në të gjitha aktivitetet e mundshme, ku do japin kontributin e tyre në ide dhe përfshirje. Në bashkinë e Shkodrës do krijojmë një paketë informacioni dhe shërbimesh gjithëpërfshirëse për rininë.</p>				
ii. Synimi i projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)				
<p>Të krijojmë një paketë informacioni mbi shërbimet që ofrohen dhe aktivitetet që organizohen në territor, në të cilat synojmë gjithëpërfshirjen direkte dhe indirekte të të rinjve që jetojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës.</p> <p>Synojmë të ofrojmë një sërë mundësish për kohën e lirë të të rinjve por jo vetëm.</p> <p>Synojmë të krijojmë një urë komunikimi me rininë.</p> <p>Nga bashkëpunimi me të rinjtë synojmë të identifikojmë problematikat rinore që ekzistojnë në territor.</p> <p>Synojmë aktivizimin e të rinjve duke promovuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të ndryshme.</p>				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
<p>Blerje domain, host, program, module etj.</p> <p>Krijimin dhe ndërtimin e web-it.</p> <p>Hartim teksti, përmbajtje dhe upload në web.</p> <p>Ndërtimin e seksioneve, kategorive, artikujve.</p> <p>Ndërtimin e rrjetit të qendrave dhe shoqatave rinore.</p> <p>Mirëmbajtja dhe përditësimi i web-it</p>				
b) Rezultatet që prisni				
<p>Krijimi i faqes web për rininë</p> <p>Gjithëpërfshirje e të rinjve</p> <p>Njohja, edukimi dhe informimi i të rinjve me shërbimin e ri</p> <p>Rritje e bashkëpunimit me të rinjtë dhe të gjitha institucionet publike e private, organizatat, bizneset sociale, etj.</p> <p>Ndikim në përmirësimin e cilësisë së jetës së rinisë që jetojnë në territorin e bashkisë Shkodër.</p>				
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt		
Rinia Komuniteti Institucionet Organizatat Bizneset sociale		BashkiaShkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura				
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (000 lek)	Nga kjo:	
			Paga, sig	operative
A.1	Blerje hosting (5.000 leke ne vit x 5 vjet)		25	
A.2	Blerje domain (2.000 leke ne vit x 5 vjet)		10	
A.3	Ndërtim dhe dizejim (30.000 lekë në joomla)		30	
A.4	Mirembajtje (35.000 per njevit)		25	
A.6	<b>Shuma</b>	<b>90</b>	<b>90</b>	
f) Periudha e zbatimit janar – dhjetor 2016		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së kulturës, arsimit, rinisë dhe sportit		

Nr.3	<b>Projekti: P12.F1.O1.A3</b> Kampionati i lojrave me dorë mes shkollave të mesme të Bashkisë së Shkodrës.	<b>Llojet e programit P12:</b> Rinia dhe sportet <b>Funksioni P12:F1:</b> Programet/projektet rinore		
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit				
i. Situata (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)				
Lojrat me dorë në Shkodër kanë një traditë të hershme dhe histori të suksesshme në sportin shqiptar. Ekipeve të basketbollit dhe të volejbollit për meshkuj e femra kanë arritur rezultate shumë të mira në të gjithë aktivitetet kombëtare duke përfaqësuar e përçuar vlerat e qytetit në vende të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare. Deri në fillim të viteve 90 janë zhvilluar periodikisht kampionate të lojrave me dorë në mes të shkollave të mesme. Prej disa vitesh këto kampionate nuk zhvillohen, për pasojë është ulur numri i të rinjve që praktikojnë sportet e basketbollit dhe të volejbollit duke sjellë kështu edhe më pak talente për ekipet e Vllaznisë.				
ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problem kryesor, përfitimi i grupit të synuar)				
Të gjallërojmë jetën sociale të të rinjve, nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive, promovimit të sportit si veprimtari sociale, integruese dhe burim shëndeti, ofrimi i të rinjve me sportin por dhe me njëri tjetrin.				
iii. Aktivitetet kryesore të projektit				
